

BIBLIOTEKA
SHTETIT

370

M 99



HYSNI MYZYRI

SHKOLLAT
E PARA
KOMBETARE
SHQIPE

320
1799


HYSNI MYZYRI

SHKOLLAT E PARA KOMBETARE SHQIPE

(1887-korrik 1908)

126

(Botim i dytë me plotësime e ndryshime)



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

«Populli ynë nuk e ka ndarë kurrë «dyfekun me gjalmë» nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën nga puna. Pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjake në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri, pavarësi, tokë, të drejta e përparim».

ENVER HOXHA

PARATHËNIE

Vlerësimi i drejtë dhe i gjithanshëm i traditave patriotike e revolucionare të popullit tonë, i përpjekjeve të tij për liri, përparim e demokraci u bë i mundur vetëm pas Çlirimit të vendit, në kushtet e pushtetit popullor dhe nën udhëheqjen e Partisë. Ky vlerësim është një faktor i madh për edukimin komunist të rinisë. Ai është gjithashtu një nxitje e fuqishme për studimin e mëtejshëm të së kaluarës së popullit tonë.

Historia e arsimit kombëtar shqiptar është pjesë përbërëse e historisë sonë të lavdishme. Ashtu si në fushat e tjera të veprimtarisë shoqërore e politike edhe në fushën e arsimit e të kulturës kombëtare populli shqiptar ka bërë një luftë të gjatë e të vështirë. Edhe në këtë fushë populli ynë çau përpara nëpërmjet një lufte të ashpër kundër armiqve të shumtë e të fuqishëm, të brendshëm e të jashtëm.

Ndonëse me mjete e forca shumë më të pakta, populli ynë i vogël por trim, duke u mbështetur në forcat e veta dhe në traditat e tij të pasura liridashëse e përparimdashëse, arriti të triumfojë mbi të gjithë armiqtë, të ruajë e të zhvillojë më tej kulturën kombëtare, të përhapë shkrimin shqip e shkollën shqipe, për të cilat nuk kurseu, kur qe nevoja, as gjakun e vet.

Studimi dhe njohja sa më e mirë e kësaj lufte, e kësaj tradite të pasur patriotike e revolucionare të krijuar me punë, me pushkë dhe me penë, ka rëndësi të veçantë jo vetëm njohëse, historike, por në radhë të parë për edukimin politik e patriotik të masave punonjëse e të rinisë sonë. «Duke u njohur me këto tradita të shquara të së kalua-

rës, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — brezat e sotshëm e të ardhshëm do të kuptojnë më mirë edhe vijën politike e ideologjike të Partisë, do të kuptojnë më mirë filozofinë e saj, sepse në mënyrë konkrete do të shohin që fjala dhe vepra e Partisë nuk janë diçka e shkëputur nga e kaluara e lavdishme e popullit tonë, përkundrazi, ato janë vazhdim i mëtejshëm dhe pasurim i gjithanshëm i saj në brendi e në formë me ideologjinë marksiste-leniniste»¹).

Kushtet ekonomike, shoqërore dhe politike që u krijuan në Shqipëri gjatë shekullit XIX shtruan, ndër të tjera, nevojën e domosdoshme të zhvillimit të mëtejshëm të arsimit e të kulturës shqiptare dhe të ngritjes së tyre në një shkallë të re, cilësisht më të lartë. Duke iu përgjigjur kësaj detyre që shtronte momenti historik, i gjithë populli shqiptar, pa dallim krahine e feje, i udhëhequr nga rilindësit tanë, bëri përpjekje e sakrifica të panumërta dhe përdori rrugë e forma të ndryshme për zhvillimin e arsimit e të kulturës kombëtare.

Qëllimi i këtij punimi është t'i paraqesë lexuesit e veçanërisht brezit të ri disa nga faqet e ndritura të historisë së shkollave të para kombëtare shqipe. Ai përfshin kryesisht periudhën 1887-1908 dhe përqëndrohet sidomos në Korçë e në qarkun e saj, ku spikati në mënyrë të qartë fizionomia kombëtare e tyre. Shkolla kombëtare shqipe, që u krijua në atë periudhë, kishte përmbajtje të re politike, ideologjike e shkencore dhe ndryshonte rrënjësisht nga shkollat që ekzistonin deri atëherë në Shqipëri.

Çelja e shkollave të para kombëtare shqipe është frut i përpjekjeve të përbashkëta të shqiptarëve, brenda dhe jashtë atdheut, është frut i gjithë lëvizjes kombëtare shqiptare. Është bërë gjithashtu një paraqitje e shkurtër e përpjekjeve të bëra në fushën e arsimit dhe në krahina të tjera të Shqipërisë. Por kjo nuk do të thotë se punimi trajton historinë e plotë të arsimit kombëtar për periudhën që ai

1) E. Hoxha «Përshëndetja drejtuar popullit të Gjirokastrës» me rastin e inaugurimit të qendrës së re muzeale dhe të obeliskut, në «Zëri i Popullit» datë 25 maj 1977, fq. 2.

përfshin. Përhapja fshehurazi e shkrimit shqip dhe e shkollës shqipe vetëm sa është cekur, ndërsa zhvillimi i arsimit në Shqipërinë veriore e verilindore, që kaloi nëpër një rrugë të veçantë, nuk trajtohet pothuajse fare në këtë punim. Gjithashtu nuk ka qenë objekt i këtij punimi studimi i mendimit pedagogjik shqiptar dhe as i programeve e i teksteve të përdorura në ato shkolla, megjithëse në këto drejtime u shënuan ndryshime e përparime të rëndësishme. Në atë periudhë u hodhën themelet e një arsimit përparimtar për kohën, të ndërtuar mbi baza kombëtare, demokratike e laike. Shkollat e para kombëtare shqipe, programet e tekstet e tyre përshkoheshin nga fryma patriotike dhe mbështeteshin në parime të reja pedagogjike. Me to kishte filluar në planin konkret edhe kundërvënia ndaj pedagogjisë skolastike mesjetare që sundonte jo vetëm në shkollat e sunduesit osman, por edhe në shkollat e çelura në gjuhë të huaj në Shqipëri nga shtete të tjera.

Në përgatitjen e këtij punimi jemi udhëhequr në radhë të parë nga materialet e Partisë e nga veprat e shokut Enver Hoxha. Na kanë ndihmuar gjithashtu rezultatet e gjertanishme të historiografisë sonë të re. Përsa i përket bazës burimore, punimi mbështetet kryesisht në materiale dokumentare arkivale të pabotuara vendase dhe të huaja si dhe në shtypin shqiptar të kohës. Materialet e huaja dokumentare janë parë në prizmin klasor dhe në kuadrin e kohës kur janë shkruar. Pjesa më e madhe e tyre përbëhet nga materiale dokumentare austro-hungareze. Perandoria austro-hungareze, duke zbatuar një politikë ekspansioniste ndaj Ballkanit e Shqipërisë, me anën e konsullatave dhe të klerit katolik filloi të ndjekë hap pas hapi lëvizjen kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe përparimet e arsimit e kulturës shqiptare në veçanti. Duke u hequr si «përkrahëse» e lëvizjes kulturore shqiptare, Vjena përpiqej ta fuste atë dhe nëpërmjet saj gjithë lëvizjen kombëtare shqiptare nën ndikimin e saj, të kufizonte objektivat kombëtare të saj dhe ta përdorte për interesat e veta politike në Ballkan. Duke i shërbyer kësaj politike, diplo-

matët austro-hungarezë ndoqën nga afër dhe informuan qendrën e tyre edhe me detaje mbi lëvizjen shqiptare.

Ndonëse Shqipëria e Jugut ishte jasht sferës së veprimt të kultus-protektoratit austriak, edhe shkollat kombëtare shqipe të çelura aty u bënë shpejt objekt vëzhgimi e relatimi për diplomatët austro-hungarezë.

Me gjithë pikësynimet e tyre politike antishqiptare, në raportet, informacionet, telegramet, etj. të diplomatëve të huaj në Shqipëri jepen të dhëna me interes që hedhin dritë mbi ngjarje e lëvizje pak ose aspak të njohura gjer tani, për të cilat materialet dokumentare vendase na mungojnë fare ose i kemi të kufizwara.

Edhe materialet dokumentare vendase, me gjithë rëndësinë e madhe, kanë gjithashtu kufizimet e tyre, që rrjedhin nga koha kur janë shkruar, nga tendencioziteti i tyre klasor dhe nga ideologjia që i përshkon.

Përveç shënimeve në fund të faqes janë bërë shpeshherë shpjegime brenda tekstit, veçanërisht në citimet e materialeve të vjetra, të cilat janë vënë brenda kllapash.

Ribotimi me disa ndryshime i këtij punimi po bëhet me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren më 1878.

A U T O R I

I

LUFTA PËR SHKOLLËN SHQIPE — PJESE E PANDARË E LUFTËS PËR ÇLIRIMIN KOMBËTAR

Shekulli XIX shënoi kthesa të rëndësishme në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të popujve ballkanikë e evropianë. Revolucionet borgjeze e kombëtare ishin kudo në rendin e ditës. Klasat e shtypura dhe popujt e robëruar ishin ngritur në këmbë për të fituar të drejtat e tyre klasore e kombëtare. Edhe Shqipëria e robëruar dhe e prapambetur, gjatë shekullit XIX, hyri në një periudhë të re zhvillimi e luftime.

Si rezultat i shturjes së marrëdhënieve të vjetra feudale dhe i lindjes së formave të para kapitaliste në ekonominë e qyteteve dhe të fshatrave të vendit, gjatë shekullit XIX e sidomos në gjysmën e dytë të tij, në strukturën ekonomike e shoqërore të Shqipërisë u bënë ndryshime të rëndësishme. As sundimi i huaj feudal osman, as vërshimi i mallrave të industrisë kapitaliste evropiane nuk mund ta ndalnin zhvillimin e marrëdhënieve të reja kapitaliste në Shqipëri, ndonëse i imponuan atij ritme mjaft të ngadalshme.

Zhvillimi i ekonomisë së mallrave së bashku me vërshimin gjithnjë e më të madh të mallrave të huaja sollën rrënimin e prodhimit të vogël zejtar, lindjen e punishteve manufakturale, lidhjen e ekonomisë çifligare e fshatare me tregun dhe futjen e pronësisë së tokës — bazës tradicionale të sundimit feudal — në sferën e marrëdhënieve të tregut. Pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre ndryshi-

meve ekonomike ishte diferencimi në radhët e klasave e të shtresave shoqërore ekzistuese dhe lindja e klasave dhe e shtresave të reja shoqërore, në radhë të parë, lindja e borgjezisë, roli i së cilës në jetën shoqërore e politike të vendit filloi të rritet.

Me shturjen e marrëdhënieve të vjetra feudale, me rritjen e marrëdhënieve të tregut po krijoheshin edhe bashkësisht e jetës së brendshme ekonomike, gjë që solli rritjen dhe forcimin e lidhjeve ekonomike e shoqërore ndërmjet krahinave të ndryshme të vendit dhe daljen në shesh të interesit të tyre të përbashkët që ishte, në radhë të parë, dëbimi i sundimitarit të huaj.

Ndryshimet e bëra në strukturën ekonomike e shoqërore të Shqipërisë u pasqyruan edhe në lëvizjen politike e kulturore të popullit shqiptar. Forcat e reja shoqërore ndjenë nevojën që të vinin luftën e popullit tonë në binarë të rinj dhe të përdornin metoda të reja të panjohura më parë. Si rrjedhim, në lëvizjen politike e kulturore të popullit shqiptar u shënua një kthesë e rëndësishme. Nga lëvizjet çlirimtare të mëparshme, të cilat, me gjithë rolin e madh pozitiv, kishin në përgjithësi karakter lokal dhe spontan, udhëhiqeshin nga kërkesa të kufizuara dhe karakterizoheshin nga mungesa e një programi të qartë e të plotë politik, u kalua në një lëvizje çlirimtare në shkallë kombëtare.

Lëvizja e re që filloi nga vitet 30-40 të shekullit të kaluar, e njohur në histori me emrin «Rilindja Kombëtare Shqiptare», ishte një lëvizje e organizuar dhe e programuar me përmbajtje politike, shoqërore e kulturore, që synonte jo vetëm të dëbonte sundimtarët e huaj osmanë, por edhe të krijonte një shtet kombëtar shqiptar. Duke folur për përmbajtjen dhe rëndësinë e epokës së Rilindjes, shoku Enver Hoxha e ka karakterizuar atë si «një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë», si «një epokë të ndritur të udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe», si epokën e daljes «nga errësira mesjetare-feudale, imperialiste, në dritë, në kry-

engritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë dhe arsim»¹).

Një ndër përfaqësuesit e parë të kësaj lëvizjeje të re, rilindësi ynë i shquar Naum Veqilharxhi, duke shprehur pikëpamjen më të përparuar të kohës, u drejtohej bashk-atdhetarëve të tij, qysh në vitet 40 të shekullit të kaluar me fjalët: «Është koha të hedhim poshtë të gjitha paragjykimet e vjetruara, është koha të mbledhim veten dhe të gjykojmë më me pjekuri dhe më me burrëri, të ndërrojmë taktikë, duke marrë që tani e tutje si shembull kombet e përparuara të botës. . . *le të shkojmë përpara me ballë hapur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje*» (nënvizimi ynë — H. M.)²).

Gjatë historisë së tij të lavdishme populli shqiptar është dalluar jo vetëm si një popull liridashës, por edhe si një popull përparimdashës. Ashtu si në fushat e tjera politike e shoqërore edhe në fushën e arsimit e të kulturës populli shqiptar ka bërë një luftë të gjatë e të vështirë, por të pandërprerë dhe këmbëngulëse për zhvillimin e përparimin e tij. Shoku Enver Hoxha ka thënë: «*Populli ynë nuk e ka ndarë kurrë «dyfekun me gjalmë» nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën nga puna. Pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjakë në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri, pavarësi, tokë, të drejta e përparim»*³).

Në epokën e Rilindjes, si në gjithë fushat e jetës ekonomike, shoqërore e politike, u shënua një kthesë, një ngritje e rëndësishme edhe në lëvizjen arsimore e kulturore shqiptare. Nga lëvizja arsimore e kulturore e mëparshme me përmbajtje kryesisht fetare, me një shtrirje

1) E. Hoxha, «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», 7 mars 1968. Në «Raporte e Fjalime» 1967-1968, fq. 368.

2) N. Veqilharxhi, «Letër Enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë», në: M. Islami, «Naum P. B. Veqilharxhi», Tiranë, 1967, fq. 127.

3) E. Hoxha, «Përshëndetje me rastin e 50-vjetorit të shkollës së mesme «Asim Zeneli» 11 nëntor 1973. Në «Raporte e Fjalime» 1972-1973 f. 429.

lokale dhe shpeshherë me rëndësi vetëm gjuhësore, u kalua në një lëvizje arsimore e kulturore me përmbajtje patriotike e shoqërore, me karakter masiv, me vlera artistike, u kalua në një lëvizje arsimore e kulturore që i shërbente drejtpërdrejt luftës për çlirimin kombëtar.

Një nga detyrat e para që u shtrua qysh në fillim të epokës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare ishte pikërisht ajo e lëvrimin të gjuhës shqipe, e përhapjes së shkrimit shqip e të shkollës shqipe, e përhapjes së njohurive shkencore dhe të letërsisë së re me përmbajtje patriotike. Natyrisht kjo nuk ishte diçka e rastit dhe as një dëshirë subjektive e personave të veçantë, e rilindësve, por rrjedhim i kushteve të reja ekonomike e shoqërore që u krijuan në Shqipëri në atë kohë. Kjo ishte e lidhur si me nevojën e rritjes së prodhimit e të shkëmbimit, ashtu edhe me nevojën e madhe për formimin dhe ngritjen e ndërgjegjes kombëtare ndër masat popullore dhe për edukimin politik të tyre.¹⁾

Vetë procesi i krijimit të bashkësisë ekonomike të vendit kërkon njësimin e shkrimit e të gjuhës së vendit. Ky njësim ndihmon nga ana e tij zhvillimin ekonomik, unitetin politik dhe formimin e shtetit kombëtar. Duke folur për lëvizjet kombëtare, V. I. Lenini ka theksuar se «Baza ekonomike e këtyre lëvizjeve qëndron në faktin se për fitoren e plotë të prodhimit të mallrave është i domosdoshëm pushtimi i tregut të brendshëm nga borgjezia, është i domosdoshëm bashkimi shtetëror i vendeve me popullsi që flet po atë gjuhë, zhdukja e të gjitha pengesave në zhvillimin e kësaj gjuhe dhe fiksimi i saj në letërsi, uniteti i gjuhës, zhvillimi i lirë i saj është një nga kushtet më të rëndësishme për një qarkullim tregtar me të vërtet të lirë, me të vërtet të gjerë...»²⁾

1) Z. Xholi, «Naim Frashëri — mendimtar i shquar shqiptar», në «Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës». Seria Shkencat shoqërore, 1959 Nr. 2. fq. 6.

2) V. I. Lenin, «Vepra të zgjedhura», botim shqip, Tiranë, 1958 Vëll. I, fq. 676.

Përveç kësaj, politika osmane e shkombëtarizimit dhe e asimilimit më të egër, ndarja e popullsisë në tri besime fetare të ndryshme dhe veprimtaria përçarëse e antikombëtare e klerit të të tri besimeve, politika antishqiptare e shteteve të mëdha evropiane dhe e shteteve fqinje ballkanikë për asimilimin e shqiptarëve dhe për copëtimin e truallit të tyre, mbizotërimi i një paditurie të madhe në gjithë vendin, sundimi i obskurantizmit mesjetar dhe ndalimi i plotë i shkrimit dhe i shkollës shqipe e rrisnin edhe më tepër nevojën e përhapjes së arsimit e të kulturës kombëtare dhe e bënë atë një domosdoshmëri historike, me të cilën ishte e lidhur vetë ekzistenca dhe e ardhmja e Shqipërisë.

Duke shprehur këtë nevojë të ngutshme të kohës, Kostandin Kristoforidhi ka shkruar: «ndë mos u shkroftë gjuha e shqipesë edhe sot mbë këtë ditë nuk do të shkollënë shumë vjet, edhe nuk do të ketë më Shqipëri në faqet të dheut as nuk do të shënonetë më emri i Shqipërisë ndë hartët të botësë, as nuk do të përmendetë më bir shqipëtar i a bijë shqipëtar!»¹⁾

Detyrat e rëndësishme me karakter ekonomik, politik e ideologjik që shtronte zhvillimi i vendit dhe momenti historik në fushën e arsimit nuk mund të zgjidheshin aspak nga sistemi arsimor që sundonte atëherë në Shqipëri, sepse ai përbëhej nga një numër i kufizuar shkollash të një niveli të ulët, të huaja nga gjuha, skolastike nga përmbajtja, të kufizuara nga frekuentimi dhe gjysmëshe nga cilësi. Siç e thotë Naum Veqilharxhi arsimin këtu mund ta ndiqnin vetëm kamësit, ndërsa skamësit ishin të dënuar të mbeteshin përgjithmonë në errësirën

1) Letër e K. Kristoforidhit dërguar nga Dëlbasani Nikolla Naços në Bukuresht më 25 janar 1888. Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (më tej AQSH i i RPSSH), Fondi Kostandin Kristoforidhi, Dosje 11, Originali në dorëshkrim shqip.

e paditurisë.¹⁾ Edhe ato palk shkolla që ekzistonin ishin veç për popullsinë myslimane dhe veç për atë kristiane. Shkollat për myslimanët administroheshin nga institucionet fetare islamike dhe mësimet jepeshin turqisht e arabisht, shkollat e të krishterëve ortodoksë administroheshin nga institucionet kishtare ortodokse që vareshin nga Patrikana e Stambollit dhe mësimet jepeshin greqisht, shkollat e katolikëve administroheshin nga kleri katolik dhe mësimet jepeshin italisht. Për më tepër ky sistem arsimor ishte shndërruar në një mjet të fuqishëm ndikimi politik e kulturor si të sunduesit osman ashtu dhe të shteteve të tjera ballkanike e evropiane.

Në të tilla kushte, nga gjiri i popullit dolën një varg atdhetarësh të flaktë, të cilët, të shtytur nga dashuria për atdheun, iu përveshën punës me vetëmohim për t'i ndriçuar popullit të tyre rrugën drejt lirisë. Midis këtyre u shquan qysh herët Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Zef Jubani, Jeronim De Rada, Thimi Mitko, vëllëzërit Naim e Sami Frashëri, Pashko Vasa, Koto Hoxhi etj.

Lufta e armatosur për t'u çliruar nga robëria osmane nuk mund të ndahej nga lufta për zhvillimin dhe mbrojtjen e arsimit e të kulturës kombëtare. «Çlirimi i atdheut nga okupatorët — ka thënë shoku Enver Hoxha — ishte i lidhur me fitoren e diturisë. Rilindësit tanë e konsideronin diturinë dritë, sepse me anë të saj do të shpërndahej errësira që kish pllakosur popullin tonë gjatë shekujve, sepse ajo do të çonte lart ndërgjegjen dhe patriotizmin e shqiptarit, sepse ajo, e bashkuar me pushkën, do të konsolidonte pavarësinë e fituar dhe do të sillte përparimin dhe begatinë e Atdheut»²⁾. Me amën e arsimit dhe të kulturës kombëtare rilindësit tanë synonin ta nxirrnin popullin shqiptar nga padituria në të cilën ndodhej, të luftonin fanatizmin dhe përçarjen fetare të mbjella e të

1) K. Frashëri, «Fillimet e Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri», në «Studime historike» 1978 Nr. 1 fq. 47.

2) E. Hoxha, «Përshëndetja drejtuar popullit të Gjirokastrës», Në «Zëri i Popullit», datë 25 maj 1977.

nxitura nga robëruesit e huaj, duke vënë kombësinë mbi fenë dhe të ngrinin ndërgjegjen kombëtare të tij.

Rilindësit udhëhiqeshin nga teza racionaliste se pa emancipim kulturor nuk mund të ketë emancipim politik. Si iluministë që ishin, ata synonin të ndriçonin mendjen e popullit dhe ta përgatitnin atë për detyrat e mëdha që kishte ndaj atdheut, për luftën për çlirim kombëtar.

Në të njëjtën kohë synohej që, me anën e shkollës shqipe dhe të diturisë, t'u pritej rruga propagandave e ndikimeve të huaja armiqësore që po vepronin me aq energji për të përçarë e për të asimiluar popullin tonë dhe të tërhiqeshin në rrugë të drejtë, në anën kombëtare, gjithë ata që kishin rënë viktimë e tyre. Me anën e arsimit e të kulturës kombëtare, me anën e shtypit, të historisë dhe të letërsisë rilindësit bënë përpjekje të mëdha edhe për afirmimin e shqiptarëve si komb në arenën ndërkombëtare, për të rrëzuar e hedhur poshtë gjithçka të gabuar dhe të shtrembër që përhapej qëllimisht në opinionin publik me anë të shtypit dhe të «studimeve shkencore» nga armiqtë e popullit shqiptar.

Në këto rrethana, përpjekjet e rilindësve shqiptarë për përhapjen e arsimit e të kulturës kombëtare nuk qenë përpjekje me karakter thjesht kulturor e iluminist, ato morën qysh në fillim karakter të theksuar politik dhe u bënë pjesë përbërëse e programit të Rilindjes sonë Kombëtare.

Për zhvillimin e arsimit e të kulturës kombëtare, rilindësit tanë, iu drejtuan në radhë të parë gjuhës amtare, «bazës së kulturës sonë kombëtare» që kishte luajtur «një rol aq me rëndësi në jetën e popullit tonë»¹⁾ dhe që u kishte bërë ballë me sukses presioneve shekullore që kishin ushtruar ndaj saj pushtuesit e huaj me anën e kultit, të arsimit dhe të letërsisë së tyre. Qysh në fillim të epokës së Rilindjes, tek rilindësit në përgjithësi ishte

1) E. Hoxha, Nga «Fjala e mbajtur në Konferencën e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë të rrethit të Elbasanit», 4 prill 1965. Në «Raporte e Fjalime» 1965-1966, fq. 65-66.

formuar mendimi se vetëm në gjuhën amtare mund të zhvillohej arsimiti e kultura, mund të shkolloheshin edhe fëmijtë e «skamësve», mund të edukoheshin «shqiptarizmi» e dashuria për Atdheun, dhe se nga shkollat në gjuhë të huaj asnjë dobi, përveç dëmit, nuk mund të pritej. Duke shprehur këtë mendim Kostandin Kristoforidhi shkruante se: «Shqipëria nuk mësonetë dot, as nukë ndritetë dot, as nuk qytetëronetë dot me gjuhë të huaj, përveç me gjuhënë e mëmësë që është shqipja»¹).

Përhapja e shkrimit shqip dhe krijimi i shkollës kombëtare shqipe do t'i shërbenin, në radhë të parë, idesë së madhe dhe kryesore të rilindësve, idesë së bashkimit të popullit, sepse te bashkimi pa dallim feje dhe krahine ata shihnin bazën e vetme të luftës për çlirimin e Shqipërisë. «Krahas luftës politike dhe luftës së armatosur... fjala e shkruar do të ishte ai rrip transmissioni i rëndësishëm për te masat, nëpër të cilin do të rridhnin si përrua idetë çlirimtare dhe zjarri i pashuar i njerëzve më të përparuar të kohës. Ajo... do të zgjonte e kalitte ndjenjat kombëtare në zemrat e shqiptarëve, do t'i edukonte, do t'i lidhte e do t'i bashkonte më fort masat, do t'i hidhte në luftë për liri»²).

Prandaj përpara Rilindjes u shtrua qysh në fillim detyra e rëndësishme e krijimit dhe e përhapjes së arsimit kombëtar. Kërkesat e para të rilindësve në fushën e arsimit e të kulturës kombëtare u zgjeruan e u përpuanuan më tej dhe u përfshinë në të gjitha memorandumet e programet e hartuara nga lëvizja kombëtare shqiptare deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Mirëpo, megjithëse detyrë e rëndësishme dhe e ngutshme, në kushtet e Shqipërisë së atëhershme, përhapja e arsimit dhe e kulturës kombëtare ndeshte në vështirësi e pengesa të panumërta të brendshme e të jashtme, nde-

1) K. Kristoforidhi, Letër e cituar, AQSH i RPSSH.

2) E. Hoxha, «Fjala në pritjen e dhënë në Vlorë me rastin e 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe të 18-vjetorit të çlirimit të Atdheut», 29 Nëntor 1962. Në Veprat, vëll. 24, fq. 9-10.

shte në luftën e ashpër e shumëformëshe të armiqve të popullit shqiptar. Armiku kryesor ishte Perandoria feudale Osmane, e cila gjatë gjithë kohës së sundimit të saj ishte përpjekur t'i mbante shqiptarët në errësi dhe padituri dhe të shuante çdo shkëndijë në fushën e arsimit dhe të kulturës. Porta e Lartë, e cila me dekretet e bujshme të Tanzimatit kishte shpallur se do t'u lejonte të gjitha kombësive të Perandorisë të ushtronin lirisht gjuhët e tyre në institucionet arsimore e fetare, i përjashtoi shqiptarët nga kjo e drejtë elementare, duke u mbështetur në tezën e saj mesjetare absurde të përcaktimit të kombësisë sipas fesë. Edhe pas reformës arsimore turke të vitit 1844 shqiptarëve nuk iu njoh e drejta e arsimit në gjuhën amtare dhe ata vazhduan të konsideroheshin sipas fesë «turq», «grekë» dhe «latinë».

K. Marks, duke karakterizuar politikën osmane të përçarjes fetare, ka shkruar më 1854: «Kurani dhe legjislacioni mysliman i bazuar në të e reduktojnë gjeografinë dhe historinë e popujve të të gjithë botës në formulën e thjeshtë dhe të volitshme të ndarjes në dy pjesë: besimtarë e të pabesë. I pabesi është «kaur», është armik. Islami e mallkon kombin e të pabesëve dhe krijon një gjendje armiqësie të pandërprerë midis myslimanëve dhe të pabesëve»¹).

Krahas dhunës, sunduesi osman përdori në këtë luftë gjithnjë e më shumë edhe shkollën e tij e fenë islame. Sulltani turk, që ishte njëkohësisht dhe kalif, e kishte lidhur pas qerres së tij edhe fenë myslimane dhe klerikët reaksionarë myslimanë shqiptarë bënë lodrën e tij në Shqipëri. Përpjekje të shumta u bënë gjithashtu nga sunduesi osman për përhapjen e «arsimit e të kulturës» së tij ndër shqiptarët.

Qëllimi i vërtetë i sundimtarëve osmanë, i armatës së

1) K. Marks — F. Engels, Veprat, botim gjermanisht. Vëll. II fq. 170 (cituar sipas M. Islamit «Naum P. B. Veqilharxhi», Tiranë 1967, fq. 72-73).



klerikëve myslimanë dhe i «mjeteve të tjera kulturore» ishte që t'i asimilonin shqiptarët myslimanë, të ngjallnin fanatizmin e përçarjen fetare, t'i ndanin ata nga bashkëdhëtarët e tyre kristianë; me anën e propagandës, të fesë dhe të shkollës në gjuhën turke ata përpiqeshin gjithnjë që fatin e shqiptarëve myslimanë ta paraqisnin të lidhur me fatin e Perandorisë Osmane. Në të njëjtën kohë sundesit osmanë, për qëllime gjithnjë përçarëse, u lanë pak a shumë dorë të lirë shteteve të tjera evropiane e ballkanike, veçanërisht kishës ortodokse fanariote e asaj katolike, për të vepruar mbi popullsinë shqiptare ortodokse e katolike jo vetëm në fushën fetare, por edhe në atë arsimore e politike.

Shumë shtete të mëdha e të vogla, evropiane e ballkanike, parashikonin në planet e tyre ekspansioniste edhe përfshirjen ose copëtimin e truallit shqiptar, aq më tepër që ai bënte pjesë në një shtet të dobët siç ishte Perandoria Osmane, shembja e së cilës pritej prej të gjithëve si një gjë e afërt. Gjatë shekullit XIX, e sidomos në gjysmën e dytë të tij, ato e rritën edhe më tepër veprimtarinë e tyre. Në këtë drejtim ato përdorën gjithnjë e më shumë, krahas kishës e konsullatave, edhe shkollat në gjuhë të huaj si dhe luftën kundër shkollës shqipe e kulturës kombëtare.

Borgjezia shoviniste e vendeve fqinje dhe armiqtë imperialistë e paraqisnin Shqipërinë si vend me një popull «të egër», «barbar», «pa kulturë», me zakone «të rënda» dhe veten e tyre si «shpëtimtarë», si «përhapës të kulturës e të arsimit», gjë që bëhej për të «justifikuar» planet e tyre pushtuese e për t'i hapur rrugën realizimit të synimeve politike antishqiptare. «Borgjezia imperialiste — ka thënë shoku Enver Hoxha — gjithnjë është përpjekur të denigrojë apo të zhdukë traditat kulturore të popujve të vegjël, frymën kombëtare të artit e të kulturës së tyre.

Kjo është një nga rrugët për realizimin e agresionit të saj kulturor e të nënshtrimit të popujve»¹⁾.

Në atë kohë, një veprimtari të madhe armiqësore ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare e veçanërisht në fushën e arsimit e të kulturës zhvilluan qarqet sunduese reaksionare të Mbretërisë Greke. Borgjezia shoviniste greke, Patrikana e Fanarit dhe kleri ortodoks grek e grekoman i vënë në shërbim të tyre e të «megali idesë»,²⁾ përdorën mjetet më barbare të inkuizicionit mesjetar, që nga mallkimet e deri tek helmimet e vrasjet në pusi. Duke folur për këtë qëndrim armiqësor, Jeronim De Rada shprehej në një letër se «kjo kulturë (kultura e arsimit në gjuhën shqipe) është fantazma e Bankos për panhelenizimin e çmendur»³⁾. Ashtu si Kalifi edhe Patriku i Stambollit e mbante kishën ortodokse shqiptare nën thonjtë e tij, edhe klerikët reaksionarë ortodoksë shqiptarë bënin lojën e Fanarit dhe ishin nën urdhrat e tij. Dhe nën maskën e fesë punohej për t'i helenizuar shqiptarët ortodoksë dhe për të përgatitur aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Mbretëria Greke.

Pengesa të mëdha i sollën çështjes së shkollës kombëtare shqipe edhe shtetet e tjera fqinje e Fuqitë e Mëdha imperialiste të interesuara për Shqipërinë, veçanërisht Austro-Hungaria, Italia, Serbia, Mali i Zi e më vonë Bullgaria, si dhe kleri katolik e misionarët jezuitë

1) E. Hoxha, «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre». Raport në Plenumin IV të KQ të PPSH, 26 qershor 1973. Në «Raporte e Fjalime» 1972-1973, fq. 319.

2) «Megali ideja» («Ideja e madhe») ishte platforma politike e qarqeve shoviniste greke e përpunuar që në vitet 40 të shekullit XIX, sipas së cilës ato kërkonin krijimin e një Greqie të madhe, në të cilën do të bënin pjesë edhe viset e banuara nga popullsitë ortodokse jogreke të Perandorisë Osmane, duke përfshirë edhe Shqipërinë deri në lumin Shkumbin.

3) M. A. Canini, «Lettere al giornale «L'Adriatico», Venedik, 1886, fq. 22.

ë françeskanë që ishin vënë në shërbim të tyre. Austro-Hungaria, si fuqi e madhe imperialiste, nën maskën e protektoratit të kultit, duke u paraqitur si «përkrahëse» e shqiptarëve dhe duke përdorur metoda më të rafinuara, bëri të gjitha përpjekjet që, krahas kishës e klerit, të përdorte edhe shkollat e saj për të shuar lëvizjen e armatosur dhe për të përdorur lëvizjen arsimore e kulturore shqiptare në dobi të planeve të veta imperialiste aneksioniste ndaj Shqipërisë dhe Ballkanit.

Kleri i lartë katolik i Shqipërisë dhe Vatikani u vunë në shërbim të imperialistëve të ndryshëm dhe, duke përdorur si maskë fenë e arsimit fetar, u përpoqën të pengonin çlirimin e popullit shqiptar dhe të mbronin errësirën, robërinë e reaksionin.

Ideologjikisht kisha katolike në Shqipëri ishte nën vartësinë e papatit roman, por politikisht ajo që vënë në shërbim të Perandorisë Austriake. Qëllimi kryesor i meshtarëve dhe misionarëve të kishës perëndimore ishte të rrënjosnin te besnikët dhe nxënësit e tyre bindjen fetare katolike, nënshtrimin ndaj kishës së Romës dhe simpatinë ndaj Perandorisë Austriake. Fryma që përshkonte programin e punës së tyre ishte «feja mbi të gjitha». Me një frymë të tillë, kisha katolike, ndonëse nuk e mohonte kombësinë shqiptare, nuk bënte gjë tjetër veçse plotësonte veprimtarinë përcarëse që kryenin dy institucionet e tjera në dëm të lëvizjes kombëtare shqiptare¹⁾.

Duke përgjithësuar qëndrimin armiqësor që është mbajtur nga të huajt ndaj shkrimit shqip e shkollës shqipe, Sami Frashëri ka shkruar: «...u bashkuanë të gjithë për të ndaluarë të shkruarët e gjuhësë shqipe. Tyrq, grekër, shqeh e të tjerë, sado që janë armikë në mes të tyre, dhanë dorënë njëri-tjetrit kuntrë neve. Port' e Lartë... Patrikëri e Fenerit, qeveri e Athinës etj. u bashkuanë në këtë punë»²⁾.

1) K. Frashëri, «Fillimet e Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri». Në «Studime historike», 1978, Nr. 1, fq. 44-45.

2) S. Frashëri, «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë». Tiranë, 1962, fq. 55.

Përveç këtyre, përpjekjet për përhapjen e shkrimit shqip dhe të shkollës shqipe duhej të kapërcenin edhe vështirësitë që ekzistonin brenda vendit si fanatizmi fetar, që ushqehej e nxitej nga të huajt, konservatorizmi i kultivuar gjatë shekujve të mesjetës feudale e të robërisë osmane dhe sidomos kundërshtimi i turkomanëve dhe i grekomanëve. Turkomanët rridhnin nga shtresa të caktuara të shoqërisë së atëhershme shqiptare e në radhë të parë nga elementët fanatikë të klerit mysliman shqiptar, si dhe nga një pjesë e feudalëve të vendit, të cilët pozitën e privilegjet që kishin si funksionarë fetarë e shtetërorë ia detyronin sulltanit dhe prandaj ishin të interesuar të mos prisheshin e as të prekeshin lidhjet me të. Në radhët e turkomanëve bënin pjesë edhe elementë borgjezë myslimanë. Turkomanët mbështesnin politikën obskurantiste e panislamike të sundesit osman në Shqipëri dhe përpiqeshin të shfrytëzonin për qëllimet e tyre faktin se shtresa të prapambetura të shoqërisë shqiptare nuk ishin shkëputur ende nga paragjykimet fetare¹⁾.

Grekomanët vinin në radhë të parë nga një pjesë e borgjezisë ortodokse të Shqipërisë së Jugut. Dobësia e borgjezisë shqiptare si klasë dhe ndikimi i fesë e i propagandës panheleniste me anën e kishës dhe të shkollës greke bënë që grekomanët të bëheshin përçues të politikës shoviniste greke ndaj Shqipërisë. Duke shfrytëzuar ndjenjat fetare dhe duke përdorur parulla sociale e politike të luftës «çlirimtare» e «antifeudale», grekomanët përpiqeshin të ndikonin edhe në masën e popullsisë së paditur ortodokse, duke e nxitur atë që të shihte tek Greqia «të vetmen mbështetje» për t'u «çliruar» nga zgjedha osmane.

Duke analizuar forcat shoqërore që e pengonin zhvillimin e arsimit e të kulturës shqiptare, Kostandin Kristoforidhi vërente: «dhespotërit e priftërit e dhaskenjët (mësuesit e shkollave greke) e të parët e të gështerëvet janë kundër kësaj pune, edhe nuk e lenë gjendienë (popullin)

1) Historia e Shqipërisë, Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vëll. II, Tiranë 1965, fq. 86.

t'apënë ndihmë, ... ndë thëng ... për bejlerët e për agallarët e për zotërit, ata nuk apënë ndihmë, sepse kanë frikë nga dera e lartë (Porta e Lartë) mos kallëzojnë keq për ata, e u vjen ndonjë rrezik mbi krye t'atyre»¹⁾.

Në të tilla «rrethana e kushte jashtëzakonisht të vështira e të rënda, të brendshme e të jashtme, kur sundonin terrori e absolutizmi shekullor otoman, kur mbretëronte politika djallëzore «përça e sundo», kur fuqitë imperialiste luanin me fatet e popujve të vegjël»²⁾, rilindësit filluan përpjekjet për të përhapur në Shqipëri arsimin e diturinë në gjuhën amtare, për të ngritur popullin në luftë për liri e pavarësi. Puna e filluar nga Naum Veqilharxhi u vazhdua nga Kostandin Kristoforidhi, Zef Jubani, Hasan Tahsini, Thimi Mitko, Koto Hoxhi etj. dhe në mënyrë të organizuar nga «Shoqëria shqiptare e Stambollit» e themeluar më 1879.

Përpjekjet e rilindësve gjenin në radhë të parë mbështetjen e masave popullore arsimdashëse të qytetit e të fshatit, të cilat ishin të etura për dije e kulturë. Në një letër që iu dërgua nga Korça Naum Veqilharxhit që më 1845 thuhej: «Mjaft më, kaq vjet, në errësirën e paditurisë, shpresojmë se brenda një kohe të shkurtër të përhapet dituria në tërë shtrirjen e atdheut tonë dhe në gjithë kombin»³⁾. Përhapja e arsimit gjente gjithashtu mbështetjen e intelektualëve përparimtarë shqiptarë, të pjesës më të madhe të borgjezisë së re kombëtare dhe të një pjese të çifligarëve shqiptarë. Me lëvizjen kombëtare ishte afruar ajo pjesë e çifligarëve shqiptarë që kishte hyrë në rrugën e borgjezimit dhe shihte më qartë situatën

1) K. Kristoforidhi, Letër dërguar N. Naços më 25 janar 1888. AQSH i RPSSH, Fondi K. Kristoforidhi, dos. 11.

2) E. Hoxha, Fjala në pritjen e dhënë në Vlorë me rastin e 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 18-vjetorit të çlirimit të Atdheut, më 29 Nëntor 1962. Në Veprat, vëll. 24, f. 9.

3) «Me përulje vëllazërore». Letër dërguar nga qyteti i Korçës Naum Veqilharxhit më 22 prill 1845 (sipas kalendarit tonë 4 maj 1845). Në: M. Islami, vep. e cituar, fq. 138.

politike të Shqipërisë së atëhershme dhe perspektivën. Ajo shihte se Perandoria Osmane po shkonte drejt shembjes së saj të shpejtë dhe se shtete të tjera më të fuqishme po përgatiteshin të aneksonin tokat shqiptare. Me atë afroheshin edhe çifligarë që ishin në opozitë me regjimin osman. Duke shpjeguar motivet që i shtynin çifligarët shqiptarë të Shqipërisë së Jugut të bashkëpunonin me lëvizjen kombëtare dhe të ndihmonin përhapjen e shkrimit dhe të shkollës shqipe, K. Kristoforidhi shkruan: «Edhe këtë (përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe) e duanë më fort sepse kanë frikë mos marrënë Shqipërinë grekët, prandaj duanë të shkruhet e të këndonetë e të përhapetë gjuha e shqipesë, që të shohë Evropa se shqiptarëtë ndajënë nga grekëtë, edhe flasënë një tjetërë gjuhë edhe janë një tjetërë komb, prandaj duanë... që të bënetë një komp me gjuhë të shkruarë e me vivlia (libra) shkruarë në gjuhë të tyre, e me skolira (shkolla) ndë gjuhë të tyre që flet vendi... edhe të qëndrojnë në vend të tyre porsì vëndarë që janë nesërë pasnesërë kur ta dëbojnë Turqinë nga Rumelia, mos u thonë këtyre piqi (bashkohuni) me Elladhënë a me Bullgarinë, a ndë mos daçi, ikni ndë Azi»¹).


Këta elementë çifligarë, ndonëse dilnin me parulla «patriotike», niseshin në radhë të parë nga interesat e veta klasore. Ashtu si në gjithë lëvizjen kombëtare shqiptare, edhe në fushën e arsimit u bashkuan në një front klasa e shtresa të ndryshme të shoqërisë shqiptare, të cilat në përputhje me interesat e veta klasore dhe për aq sa e lejonin ato, kontribuan në luftën për shkollën kombëtare shqipe.

1) K. Kristoforidhi, Letër dërguar N. Naços më 25 janar 1888. AQSH i RPSSH, Fondi K. Kristoforidhi, Dos. 11.

II

PËRPJEKJET E PARA PËR KRIJIMIN E SHKOLLËS KOMBËTARE SHQIPE

Abetaret në gjuhën shqipe të hartuara nga Naum Veqilharxhi dhe të botuara në Rumani më 1844 e 1845 ishin lajmëtarët e para të arsimit kombëtar shqiptar. Ato u shpërndanë në Shqipëri dhe u pritën kudo me entuziazëm të madh.



Naum Veqilharxhi

Qysh në fillim të Rilindjes u bënë përpjekje për ngritjen e një shtypshkronje dhe për çeljen e shkollave shqipe. Në letrën që iu dërgua Naum Veqilharxhit nga Korça më 1845, pasi flitej për pritjen e mirë të abetares së tij të parë dhe entuziazmin që kishte shkaktuar ajo, thuhet: «mësojmë me gëzim të madh se kini përgatitur dhe dorëshkrime të tjera... libra fillestare... që të jenë gati kur të ngrihet tipografia dhe për rrjedhim të mund të hapen edhe shkolla për përpërimin e mësimin kombëtar»¹⁾.

1) M. Islami, Vep. e cituar, fq. 138-139.

Me përulje në Uozëronë,

morem letren dhe obelaret shqipe që na dërguat dhe si na shkruanin zotëria juaj bëmë shpërndarjen e tyre si këtu në Korçë e në gjithë rrethin e saj, edhe në Përmet e në Berat. Të gjithë i morën me të madh gëzim e kënaqësi, duke lavdëruar e hyjnizuar zotën e plotfuqishëm që ju ndihoi mendjen të bëni në gjuhën tonë shkronja që prej kësaj shekulli kombi ynë ka qenë privuar për të lëguar historinë e ty. Tashmë me këtë trimëri të guximëshme të zotërisë suaj që meriton çdo lëvdatë, kombi ynë do të ru-
murohet me këtë iniciativë në radhën e popujve të nisur të Evropës. Mjaft (qendruam) për 99 vjet nën ligëdhën e padijes; të shpresojmë se në një kohë të shkurtër, mesimi do të shtrihet në gjithë atdheun tonë dhe në gjithë kombin tonë dhe emri i zotërisë suaj do të mbetet i përdëkur gjër në mbarim të she-
kujve

Ju lutem zotëri, në qoftë se keni obelare nga ato që na keni dërguar me parë, të na dërgoni sa më shumë sepse bashkëatdhetarët kërkojnë papushim; prej atyre obelareve kanë mësuor të lexojnë, e të shkruajnë duke hapur edhe korespondencë me letra sikur stë të ishna burim mrekullie...

Thomas Paskali dhe të tjerë
nga qyteti Korçë e Shqipërisë

(Origjinali greqisht)

Pjesë nga letra e korçarëve dërguar Naum Veqilharxhit
në Rumani në vitin 1845

Më poshtë tregohet se në Korçë ishte hapur një fushatë ndihmash në dobi të këtij qëllimi. «Megjithëse kombin tonë — vazhdon letra — e ka pushtuar varfëria, por sipas dëshirës që kanë bashkatdhetarët, shpresojmë që të mbli-dhen diçka pare»¹).

Këto përpjekje të rilindësve shqiptarë tërhoqën vë-mendjen dhe simpatinë e rretheve përparimtare e ilumi-niste të vendeve ballkanike. Midis tyre gazetari Petko Raçev Sllavejkov shkruante në vitin 1867 se «Shqiptarët e Korçës kanë dashur të kenë shkolla për t'u arsimuar në gjuhën e tyre amtare, bile ata kishin botuar një alfa-bet (dhe) një gramatikë...»²

Por përpjekjet e filluara ndeshën në vështirësi të shumta, e në radhë të parë në qëndrimin armiqësor të Portës së Lartë e të Patrikanës së Stambollit. Kundër Naum Veqilharxhit e pasuesve të tij filloi një fushatë e rreptë ndjekjesh, veçanërisht nga ana e kishës ortodokse. Helmimi i Naum Veqilharxhit nga Patrikana e Fanarit dhe shpifjet që filluan të bëheshin kundër pionierëve të arsimit e të lëvizjes kombëtare shqiptare tregonin se ajo po mbante po atë qëndrim armiqësor që mbante edhe Porta e Lartë. Shumë shqiptarë të pasur ortodoksë u trem-bën dhe hoqën dorë nga premtimet që kishin bërë në dobi të zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe. Megjithatë «fara ishte mbjellur» dhe shumica e saj kishte rënë jo «midis barnave dhe gjembave» apo «në rrugë ku shke-lej» por «në tokë të mirë dhe pjellore»³).

Veprimtaria e Naum Veqilharxhit nuk mbeti e ve-çar, ajo u ndoq nga rilindësit e tjerë. Qysh në fund të viteve 50 të shekullit XIX Thimi Mitkoja u përpoq të çelte në Korçë një shkollë shqipe⁴). Thimi Mitkoja, në

1) M. Islami, Vep. e cituar, fq. 139.

2) Gazeta «Makedonia», Nr. 47, dt. 21 tetor 1867.

3) M. Islami, vep. e cituar, fq. 143-144. Letër e Naum Veqil-harxhit dërguar të nipit, Jani Calit, më 7 prill 1866.

4) Gazeta «Makedonia» Nr. 47, datë 21 tetor 1867.

një takim me Anastas Bykun¹), më 1857, i paraqitej këtij të fundit *me mburrje* si «anëtar i një shoqërie filalbaniste» në Stamboll, e cila po mblidhte të holla për libra e shkolla në gjuhën shqipe. Për të arritur qëllimet për të cilat përpiqej shoqëria, «duhet — thoshte Thimi Mitkoja — të pregatisim një ringjallje kombëtare, të bëhemi tok me ata bashkatdhetarë myslimanë që ëndërrojnë këtë»²).

Në pamundësi për të krijuar shkolla shqipe më vete, për shkak të qëndrimit armiqësor të Portës së Lartë dhe Patrikanës së Stambollit, patriotët rilindës luftuan për të përhapur mësimin e shqipes në forma të ndryshme ilegale.

Mësimi i gjuhës shqipe filloi të jepej fshehurazi edhe në shkollat e huaja që ekzistonin në Shqipëri. Në këto shkolla morën mësimet e para Jani Vretoja, Spiro Di-neja etj.³)

Ndërkohë në Shqipërinë Veriore e veçanërisht në Shkodër, që ishte qyteti më i zhvilluar i gjithë vendit, u krijuan disa qendra mësimore, me mësues kryesisht vendës si Geg Kodheli, Gjon Shkrumi, Jak Kraja (Speci), Zef Kamsi etj. Qendrat e para mësimore të Shkodrës i ndeshim rreth viteve 40 të shekullit të kaluar. Mësuesit e tyre paguheshin nga vetë qytetarët shkodranë. Këto qendra mësimore apo shkolla të vogla private, të ngritura në lagje të ndryshme të qytetit, zhvilluan një veprimtari të kufizuar, si për shkak të ndjekjeve të auto-

1) Anastas Byku, nga Lekli i Gjirokastrës, kishte kryer gjimnazin grek të Janinës dhe për shumë vjet kishte punuar si mësues i greqishtes në qendra të ndryshme të Perandorisë Osmane. Në vitet 1860-1861 botoi gazetën «Pellazgos» në Lami të Greqisë.

2) A. Buda, «Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859-1861», në «Studime historike» 1965, Nr. 2, fq. 62.

3) S. Pollo, «Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar dhe Shpallja e Pavarësisë më 28 nëntor 1912». Në Buletini i USHT, Seria Shkencat shoqërore 1962, Nr. 4, fq. 81.

riteteve osmane të pushtimit¹⁾, ashtu dhe për shkak të kushteve jo të mira materiale e të nivelit të ulët të tyre. Ato i zhvillonin mësimet më tepër fshehurazi, kishin programe të ngushta mësimore dhe frekuentoheshin nga një numër i kufizuar nxënësish. Megjithatë, rëndësia e këtyre qendrave mësimore është e madhe, sepse ato shprehnin dëshirën e përpjekjet e popullit e të patriotëve për arsim e kulturë, dhe u bënë vatrat e para për përhapjen e shkrimit e të leximit, sidomos në gjuhën amtare, e të njohurive elementare. Por, qendrat e para mësimore private nuk patën jetë të gjatë. Ato qëndruan deri në vitin 1855, kur tregtarët shkodranë dhe kleri i lartë, me ndërmjetësinë e konsullit austriak në Shkodër, sollën nga jashtë mësues të huaj që filluan nga puna në vitin shkollor 1855-1856²⁾. Kjo zgjidhje shënoi një kthim prapa sepse, ndonëse qendrat e mëparshme mësimore u zëvendësuan me shkolla të rregullta, këto të fundit u vunë nën kontrollin e Austrisë dhe mësimi zhvillohej nga mësues të huaj e në gjuhën italiane. Mësuesit e huaj, që nuk u pritën mirë, u larguan nga Shkodra aty nga viti 1861. Duke shfrytëzuar këtë situatë të krijuar në Shkodër, kleri katolik, i cili ishte vënë në shërbim të Austrisë, çeli po atë vit një shkollë fillore për djem, ku mësimi, ndonëse në gjuhën shqipe, zhvillohej nga klerikë të huaj dhe i hapte rrugën fetarizimit të arsimit e të kulturës. Në këtë mënyrë, ndonëse vazhdoi të funksiononte fshehtas edhe ndonjë shkollë private shqipe, për djem ose për vajza, u pengua dhe u ndërlikua zhvillimi i arsimit në Shkodër dhe në përgjithësi në Shqipërinë e Veriut e të Verilindjes, vise në të cilat, me marrëveshje ndërkombëtare, i ishte njohur Austrisë e drejta e protektoratit të kultit. Kjo erdhi jo vetëm si pasojë e zgjerimit të ve-

1) M. Prenushi, «Vështrim historik mbi zhvillimin e arsimit në Shkodrën e shekullit XIX». «Studime historike» 1974, Nr. 3, fq. 66-67.


2) Po aty.

primtarisë ekspansioniste të Perandorisë Austriake në Shqipëri, por edhe për shkak të dobësisë së borgjezisë katolike shqiptare, të lidhjeve e të vartësisë së saj nga kapitali i huaj.

Kjo gjendje asfiksie për shkollën shqipe e krijuar në Shkodër për shkak të sundimit të huaj osman, të ndërhyrjes së shteteve të tjera dhe të qëndrimit reaksionar të klerit katolik shkaktoi pakënaqësinë dhe reagimin e masave popullore e të rretheve patriotike, të cilat kërkonin që arsimit e kultura të zhvilloheshin në rrugë të pavarur e kombëtare. Shprehës i këtyre aspiratave bëhet rilindësi i shquar Zef Jubani, i cili iu kundërvu asaj pjese të borgjezisë që ushtronte «mjeshtërinë e tregtarit, tue pritë shpëtimin e qytetnimit e Shqipnisë nga kombet e

hueja»¹). Duke kuptuar synimet politike të Austrisë e të shteteve të tjera, ai vinte në përfundimin se nuk duhej pritur nga të huajt «se mund të na bajnë një të mirë, pa një qëllim të dytë!»²).

Zef Jubani u ngrit gjithashtu kundër klerit të lartë katolik, veçanërisht kundër klerit të huaj, i cili, «i çuem prej Romës don me ushtruar absolutizmin, monopolin e inteligjencës sipas aspiratave e ndikimeve të huaja... don



Zef Jubani

1) Z. Jubani, «Vepra të zgjedhura», Tiranë 1936, fq. 78.

2) Po aty.

me e larguë popullin me mësimë ekzotike prej ndjesisë kombëtare»¹⁾).

I bindur se në shkollat e huaja «shqiptari do ta ndjejë veten që prej rinisë e mbrapa i zotnuem dalngadalë, nga dashunia për atë komb, 'të cilit i zu gjuhën»²⁾, Zef Jubani jo vetëm i kundërshtoi ato me forcë, por parashitroi pikëpamjet e veta të përparuara për krijimin e shkollës kombëtare e laike shqipe dhe për shtrirjen e saj në qytetet e në fshatrat e vendit. «Na — shkruante Zef Jubani — kena nevojë të madhe për shkolla për me mësue djelmëninë tonë e mos me e lanë në terr si kanë mbetë deri sot. Ne na duhet me i mësue të bahen shqyptarë të mirë e të dashtun...»³⁾. Ai kërkonte që shkollat të shtriheshin edhe në malësi «për çdo kryevend krahine» dhe në to të emëroheshin «mësues kombëtarë të aftë dhe të ndershëm». Gjithashtu ai shtronte nevojën e «krijimit të një kolegji popullor gjimnazial, të lirshëm nga ndikime klerikale dhe të huaja... e ky kishte me u lypë të vendoset në qytet, qendër e krahinës...»⁴⁾ Por ndërsa mbante një qëndrim të vendosur kundër klerit të huaj, rilindësi ynë ushqente iluzione për klerin shqiptar katolik, i cili, sipas tij, gjendej në marrëdhënie të drejtpërdrejta me popullin dhe duhej të punonte për zhvillimin e kulturës kombëtare⁵⁾.

Me gjithë kushtet e vështira, përhapja e mësimit të shqipes vazhdoi të zgjerohej. Më 1868 Kostandin Kristoforidhi botoi në Stamboll një abetare të re në të dy dialektet, gegërisht e toskërisht, e cila u përhap me shumë sukses në Shqipëri. Dhe kur ai erdhi vetë në Shqipëri për

1) Z. Jubani, «Vepra të zgjedhura», Tiranë 1966, fq. 71-72.

2) Po aty.

3) Po aty, fq. 52.

4) Po aty, fq. 62.

5) K. Xoxi, «Probleme të arsimit në Shqipëri në prag të Lidhjes së Prizrenit», në «Revista pedagogjike», 1972 Nr. 4, fq. 125; I. Gogaj, «Mbi qëndrimin reaksionar të klerit në fushën e arsimit», Tiranë 1972, fq. 15.

t'i shpërndarë abetaret dhe libra të tjera fetare që ai kish-
te përkthyer në gjuhën shqipe, u prit kudo «ngrohtë e
madje me adhurim»¹⁾ Në një letër të Kristoforidhit të
vitit 1871 është shprehur
mënyra entuziaste me të
cilën ishte pritur ai në
«Shqipërinë Qendrore, ve-
çanërisht në qytetet Elba-
san, Durrës, Tiranë, Kava-
jë, Peqin e Dibër»²⁾ dhe
në vise të tjera të Shqi-
përisë. Para se të largohej
nga Shqipëria ai pati një
kërkesë të fortë nga po-
pullsia e Beratit për ta vi-
zituat atë qytet «dhe për
të filluar një punë të tillë
edhe midis toskëve, siç e
pati bërë për gegët, saqë e
ndjeu se nuk mund të ku-



Kostandin Kristoforidhi

ndërshtonte»³⁾). Me interes të veçantë është fakti se jo ve-
tëm abetarja, por edhe librat e tjera me karakter fetar
të sjella nga Kristoforidhi, që u përkisnin të krishterëve
të ritit ortodoks, kërkoreshin njëlloj si nga shqiptarët
ortodoksë ashtu edhe nga ata myslimanë e katolikë. Kjo
tregon qartë se shqiptarët i kërkonin ato të nisur jo nga
motive fetare, por në radhë të parë nga ato kombëtare,
nga dëshira e zjarrtë për të mësuar në gjuhën amtare.
Në të njëjtën kohë Hasan Tahsini, i ardhur në Ça-

1) Xh. Lloshi, «Të dhëna dokumentare të reja mbi veprim-
tarinë e V. Meksit, G. Gjirokastritit e K. Kristoforidhit». Në «Stu-
dime filologjike» 1974, Nr. 2, fq. 146.

2) Po aty.

3) Po aty, fq. 149.

mëri e gjetkë, përpiquej t'u mësonte shqip bashkatdhetarëve të tij.

Përhapja fshehurazi e mësimit të shqipes ishte shtrirë jo vetëm në qytete, por edhe në fshatra. e bile edhe në zona malore, siç ishte krahina e Shpatit të Elbasanit. Si shprehje e shqetësimit për këtë, në statutin e Sillogut të Madh në Stamboll¹⁾, botuar më 1872, vihej në dukje se në Shpat «kanë dalë disa veta, të cilët i nxitin njerëzit e thjeshtë të mësojnë shqip»²⁾.

Krahas përpjekjeve për botimin e librave shqip. për përhapjen e shkrimit shqip dhe për çeljen e shkollave shqipe, rilindësit shqiptarë, qysh në fillim, bënë përpjekje, edhe për të vendosur një alfabet të përbashkët kombëtar për gjithë shqiptarët. Çështja e alfabetit të përbashkët ishte një hallkë tjetër e rëndësishme që do t'i shërbente si zhvillimit të arsimit në gjuhën amtare e përhapjes së diturisë në popull, ashtu edhe bashkimit politik të shqiptarëve. Gjer në pragun e Rilindjes në rrethet kulturore e fetare të ndryshme të Shqipërisë ishin përdorur një numër relativisht i madh alfabetesh dhe shkrimi i shqipes karakterizohej nga mungesa e theksuar e njësisë, gjë që përcaktohej nga kushtet e rendit feudal, të pushtimit të huaj, të përçarjes fetare dhe nga ndikimet e kulturave të huaja. Si rrjedhim shkrimtarët e vjetër si Gj. Buzuku, P. Budi, P. Bogdani etj. në Shqipëri si dhe arbëreshët e Italisë kishin përdorur në shkrimet e tyre shqip alfabetin latin; të tjerë si Th. Kavalioti, G. Gjirokastriti përdornin alfabetin grek. Bejtexhinjtë si N. Frakulla, H. Z. Kamberi etj. kishin përdorur alfabetin arab; ndërsa Grigor Durrsaku e Dhaskal Todri kishin krijuar alfabete krejt origjinale për gjuhën shqipe.

Mungesa e një alfabeti të vetëm e të përbashkët për

1) Sillogu apo Klubi Kulturor Epirot u themelua në Stamboll në vitin 1871 dhe u shërbente synimeve shoviniste greke.

2) Historia e Shqipërisë, botim i USHT, vëll. II, Tiranë 1965, fq. 105.

shqipen përbënte një pengesë të madhe për përhapjen e ditorisë e të arsimit, rrjedhimisht edhe për zgjimin e ndërgjegjës kombëtare të popullit shqiptar¹). Edhe rilindësi ynë i parë, N. Veqilharxhi, i ndodhur përpara këtij problemi, qysh rreth vitit 1825 kishte filluar të përgatiste një alfabet shqip të posaçëm. Alfabetet latin, grek ose arab, që ishin përdorur deri atëherë për shkrimin e shqipes, jo vetëm nuk ishin në gjendje të jepnin plotësisht të gjithë linguajt e saj, por asnjëri prej tyre, për arsye fetare, nuk do të mund të pranohej pa vështirësi nga të gjithë shqiptarët së bashku. Veç kësaj, N. Veqilharxhi mendonte se gjuha shqipe, si gjuhë më vete, duhej të kishte alfabetin e saj, në mënyrë që alfabetet e huaja të mos bëheshin përcues të ndikimeve politike armiqësore²). Me alfabetin e ri që krijoi ai hartoi edhe abetaret e disa tekste të tjera në gjuhën shqipe.³

Me gjithë pritjen e mirë të botimeve të N. Veqilharxhit, alfabeti i tij, për arsye edhe të vështirësive praktike, nuk u bë dot alfabeti i vetëm i gjuhës shqipe. Përpjekjet për caktimin e një alfabeti kombëtar vazhduan edhe për shumë kohë. Ato përbëjnë një histori të gjatë e të ndërlikuar, të lidhur ngushtë jo vetëm me historinë e kulturës, por edhe me historinë shoqërore politike. Në këtë histori të gjatë e të ndërlikuar për vendosjen e një alfabeti të përbashkët të shqipes vëmë re shpeshherë të ndeshen rryma, tendenca e pikëpamje të ndryshme, ku janë pasqyruar interesat klasore dhe ato politike të fuqive të huaja⁴).

Si pasojë, edhe në fillim të Rilindjes, për shkrimin e gjuhës shqipe vazhduan të përdroreshin alfabete të ndrysh-

1) Sh. Demiraj — K. Prifti, «Kongresi i Manastirit — ngjarje me rëndësi për lëvizjen kombëtare shqiptare», Tiranë, 1968, fq. 13.

2) Historia e Shqipërisë, vep. e cituar, fq. 52.

3) Po aty.

4) M. Domi, «Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit». Në «Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit». Tiranë, 1972. fq. 14.

me. Në vitet 60 të shekullit XIX, nga përpjekjet individuale u kalua në përpjekje të organizuara për caktimin e një alfabeti unik për gjuhën shqipe. Caktimi i një alfabeti të vetëm ishte bërë një nevojë e domosdoshme për zavrillimin e mëtejshëm të lëvizjes sonë kombëtare. Gjatë viteve 60 të shekullit të kaluar, në Stamboll, me iniciativën e K.Kristoforidhit e të patriotëve të tjerë, u bënë shumë mbledhje dhe u shkëmbyen mendime «midis shqiptarëve ortodoksë, myslimanë e katolikë për të caktuar një alfabet të plotë, të bukur e të njohur për gjuhën shqipe» — shkruan Jani Vreto¹). Por pengesat dhe intrigat e Portës së Lartë e të Patrikanës së Stambollit si dhe të feudalëve turkomanë shqiptarë, që nuk ishin të interesuar për zgjimin e popullit tonë, bënë që zgjidhja e këtij problemi të rëndësishëm të zvarritej e të mos merrte udhë²).

Edhe përpjekjet e bëra nga patriotët shqiptarë të Stambollit në fillim të viteve 70 të shekullit XIX për caktimin e një alfabeti unik dhe për krijimin e një shoqërie që do të organizonte e drejtonte veprimtarinë arsimore e kulturore të shqiptarëve nuk u kurorëzuan me sukses.

Ndërsa procesi i arsimit në gjuhën shqipe përparonte me ritme shumë të ngadalshme për shkak të kushteve të vështira, në Shqipëri u zgjerua mjaft rrjeti i shkollave në gjuhë të huaj, veçanërisht pas shpalljes së dekreteve të Tanzimatit. Për të forcuar perandorinë në një kohë kur ishin ashpërsuar kontradiktat me kombësitë joturke, Porta e Lartë, veç institucioneve fetare myslimane përdorte gjithnjë e më shumë edhe institucionet arsimore. Duke u mbështetur gjithnjë në parimin teokratik islam të prioritetit të fesë mbi kombësinë, qysh nga viti 1845 ajo krijoi për shqiptarët myslimanë një rrjet shkollash shtetërore, fillore (iptidaije), qytetse (ruzhdiye) dhe pastaj gjimnaze (idadije). Ashtu si në shkollat e mëparshme fetare, edhe në shkollat e reja shtetërore osmane mësimet zavrillohe-

1) Historia e Shqipërisë, vep. e cituar, fq. 97-98

2) Sh. Demiraj — K. Prifti, vep. e cituar, fq. 14.

shin vetëm në gjuhën turke¹⁾ dhe, megjithëse formalisht ato u quajtën laike, pjesën dërmuese të programit të tyre e mbushnin përsëri lëndët fetare islamike²⁾).

Në krahinat ku banonin popullsi shqiptare katolike, kleri i organizuar e i drejtuar nga Vatikani dhe i financuar nga Perandoria Austriake fitoi të drejtën të çelë shkolla në gjuhën italiane. Që më 1841, dy vjet pas shpalljes së dekretit të gjylhanesë, Vatikani dërgoi në Shqipëri ekipin e parë të jezuitëve, i cili kishte për mision, përveç të tjerave, të organizonte edhe një rrjet arsimor në gjuhën italiane, në dobi të kishës katolike dhe të politikës së Austrisë. Edhe shkollat katolike, ndonëse më të pakta në numër, jo vetëm bazoheshin në gjuhën italiane, por përshkoheshin nga fryma fetare dhe e intolerancës ndaj elementëve jokatolikë.

Përhapje të madhe mori veçanërisht shkolla greke. Në qytetet e Shqipërisë së Jugut filloi të shtohet numri i shkollave të komuniteteve ortodokse. Me gjithë programin e tyre laik, shkollat ishin nën mbikëqyrjen e peshkopëve grekë dhe përshkoheshin nga një frymë intolerance fetare. Për kishën ortodokse, e cila ishte plotësisht në duart e klerit të lartë grek, jo vetëm myslimanët («turqit»), por as katolikët («papistanët») shqiptarë nuk kishin gjë të përbashkët me ortodoksët ose «grekët», siç e quanin klerikët e Patrikanës së Stambollit gjithë popullsinë ortodokse të Ballkanit.

Më vonë këto shkolla filluan të financoheshin edhe nga qeveria e Athinës, e cila përpigjej të kultivonte, nëpërmjet gjuhës, fesë dhe historisë së Greqisë, ndërgjegjen kombëtare greke në rininë shqiptare ortodokse. Duke u paraqitur si «përhapëse e arsimit dhe e kulturës» dhe duke spekuluar mbi ndjenjat arsimdashëse dhe ato fetare, propaganda shoviniste greke në fillim bëri për vete një pjesë të shqiptarëve ortodoksë, veçanërisht të pasurit. Më

1) Historia e Shqipërisë, vep. e cituar, fq. 50.

2) K. Frashëri, «Fillimet e Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri». Në «Studime historike» 1978, Nr. 1, fq. 38-39.

1850, me kontributin e disa reshperëve të qytetit dhe sidomos të emigrantëve pasanikë korçarë të Rumanisë e të Egjiptit, u krijua në Korçë një «Arkë për përhapjen e arsimit» që u quajt «Llaso». Në shkollat e ngritura me fondet e «Llasos» mësimet jepeshin greqisht.

Intensifikimit të propagandës së «helenizmit» i shërbente edhe organizata e themeluar më 1867 në Stamboll, nën hijen e Patrikanës, me emrin «Vëllazëria Qendrore Kulturalë» dhe në mënyrë të veçantë «Sillogu (Klubi) Kultural Epirot» i themeluar më 1871. Me përkrahjen e tyre në Shqipërinë e Jugut u rrit mjaft numri i shkollave greke. Sipas një statistike të vitit 1878, vetëm në krahinat e Gjirokastrës, Vlorës dhe Beratit, numri i shkollave greke arriti shifrën 163¹⁾.

Me anën e shkollave në gjuhë të huaj të hapura në Shqipëri, armiqtë e vendit tonë përpiqeshin të pengonin zgjimin kombëtar dhe të nxisnin përçarjen ndërmjet shqiptarëve myslimanë, ortodoksë dhe katolikë.

Në këto rrethana, në etapën e parë të Rilindjes, me gjithë nevojën e madhe dhe përpjekjet e bëra, në fushën e arsimit kombëtar u arritën vetëm rezultate të pjesshme.

Lufta trevjeçare e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren (1878-1881) shënoi një etapë më të lartë për Rilindjen tonë Kombëtare. Ajo shënoi një ngritje si në luftën e armatosur kundër synimeve e vendimeve shoviniste e imperialiste të shteteve fqinje e fuqive të mëdha evropiane për mbrojtjen e truallit shqiptar dhe kundër sundimit shekullor osman për të fituar autonominë politike, ashtu edhe në fushën e mendimit politik e të arsimit e kulturës shqiptare.

Në të gjitha memorandumet e projektet autonomiste të hartuara gjatë ekzistencës së Lidhjes së Prizrenit, bënte pjesë edhe kërkesa për shkolla në gjuhën shqipe.

Veprimtaria luftarake e Lidhjes Shqiptare ishte bazar me disa dhjetëra vjete pune propagandistike në kushete paqeje dhe në rrethana ilegaliteti. Siç na mëson

1) Historia e Shqipërisë, vep. e cituar, fq. 105.

V. I. Lenini, «Në jetën politike muajt e kohës së luftës historia i regjistron si vjete»¹).

Sado që vëmendja kryesore e popullit shqiptar ishte drejtuar në ato vite të zjarrta në problemet e mprehta politike, rilindësit shqiptarë edhe në fushën kulturore zhvilluan një veprimtari më të organizuar e më të gjerë, e cila duhej të plotësonte dhe t'i shërbente veprimtarisë politike të filluar nga Lidhja Shqiptare. Përballë politikës sinkombëtarizuese të ndjekur nga sunduesi osman, shtetet shoviniste fqinje e fuqitë imperialiste nëpërmjet shkollave të tyre në Shqipëri, Lidhja Shqiptare kërkonte zhdukjen e këtyre shkollave, hapjen e shkollave shqipe, njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë kombëtare si dhe caktimin e një sasive të përshtatshme nga të ardhurat e vendit për arsimin, me qëllim që populli të qytetërohej e të pajisej me kulturë. Në këtë drejtim u shfrytëzuan sa që e mundur edhe rrethanat e vështira që krijoi për Perandorinë Osmane kriza lindore e viteve 1875-1878. E zënë ngushtë nga rreziqet e jashtme dhe nga presioni i lëvizjes kombëtare shqiptare, Porta e Lartë, me themelimin e Lidhjes, që e detyruar që për të parën herë të bënte disa lëshime të përkohshme.

Duke përfituar nga kjo rrethanë, udhëheqësit e Komitetit Shqiptar të Stambollit²) mendonin se, për të organizuar veprimtarinë arsimore e kulturore, duhej të formohej një qendër që të merrej me këto detyra dhe të vendosej një alfabet i përbashkët i shqipes. Kështu, në muajt e fundit të vitit 1878, nga gjiri i Komitetit të Stambollit u formua një komision i posaçëm për shqyrtimin e çështjes së alfabetit. Pjesëtarët e këtij komisioni patriotët shqip-

1) V. I. Lenin, «Mbi Arsimin Popullor», Tiranë 1969, fq. 56.

2) Komiteti i Stambollit (emri i plotë «Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare») u formua nga patriotët shqiptarë të Stambollit në vitin 1877 për të mbrojtur të drejtat e popullit shqiptar. Në të bënë pjesë Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Sami Frashëri, Jani Vretua, dhe Zija Prishtina.

tarë Sami Frashëri, Jani Vreto, Pashko Vasa, Hasan Tahsini e Koto Hoxhi — pas diskutimesh të gjata arritën të vendosin një alfabet, që do të ishte i përbashkët për të gjithë shqiptarët dhe që njihet në histori me emrin «alfabeti i Stambollit»¹⁾).

Ky alfabet mbështetej kryesisht në alfabetin latin. Por, duke ndjekur parimin që për çdo tingull të përdorej vetëm një shkronjë, për disa tinguj të veçantë të shqipes merrte disa shkronja nga alfabeti grek e ai sllav. Caktimi i këtij alfabeti të ri shënoi një hap të rëndësishëm përpara në mënjanimin e vështirësive për shkrimin e gjuhës shqipe. Me gjithë pengesat e intrigat e qeveritarëve osmanë e të Patrikanës së Stambollit, alfabeti i ri pati një përhapje të mirë në Shqipërinë Jugore e të Mesme²⁾ dhe me të u botuan një numër i madh librash shkollorë³⁾.

Pas caktimit dhe pranimit të alfabetit, iniciatorët e tij botuan më 1879 librin e parë të shtypur me këtë alfabet, që mbante titullin «Alfabetare e gjuhës shqip». Përveç alfabetit të Stambollit e udhëzimeve gramatikore, libri përmbante edhe shkrime të Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos dhe Koto Hoxhit.

Caktimi i alfabetit të Stambollit dhe botimi i Alfabetares ishin vetëm hapi i parë. Në fillim të tetorit 1879 udhëheqësit e Komitetit të Stambollit thirrën një konferencë, në të cilën morën pjesë përfaqësues nga të tri besimet fetare e pothuajse nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, dhe më 12 tetor u themelua «Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip». Në grupin iniciator për themelimin e kësaj shoqërie bënë pjesë mendjet më të shquara shqiptare

1) Historia e Shqipërisë, Vep. e cituar, fq. 152.


2) Po aty.

3) Alfabeti i Stambollit nuk u përhap në Shqipërinë e Veriut dhe nuk arriti kështu të bëhej alfabeti i vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe. Për këtë arsye çështja e përcaktimit të një alfabeti të vetëm mbeti e pazgjidhur përfundimisht deri në Kongresin e Manastirit të vitit 1908.

të kohës: Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Sami Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina etj.¹⁾). Kryetar i shoqërisë u zgjodh Sami Frashëri.

Qëllimi i «Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip»²⁾ u shpall në statutin themeltar (kanonizimën) të saj, në të cilin përmbledheshin vijat themelore të programit kulturor të Rilindjes. Shoqëria kulturore arsimore e themeluar në Stamboll do të luftonte për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe me anën e shkollave dhe të teksteve shkollore. Ajo synonte të krijonte degë në Shqipëri dhe në vendet e huaja ku jetonin e punonin shqiptarë. Me fondet që do të krijonte, Shoqëria mendonte të ngrinte një shtypshkronjë, me anën e së cilës do të shtypte libra, gazeta e revista shqipe. Shoqëria do të hapte edhe shkolla shqipe me shpenzimet e saj. Këto shkolla do të ishin të pavarura dhe do të formonin bërthamën e rrjetit arsimor kombëtar shqiptar.

Në vazhdim të aktivitetit për zbatimin e programit të Shoqërisë, po në vjeshtën e vitit 1879, Jani Vreto nxori



Sami Frashëri

1) S. Pollo, «Të bashkuar, një dhe të pandarë». Në «Drita», 19 mars 1978, fq. 5.

2) Emri i shoqërisë do të bëhet më i qartë dhe më i plotë kur shprehjes «shkronja shqip» t'i japim kuptimin «shkrime shqipe», «libra shqip», siç e kishte në kohën kur u themelua ajo.

nga Porta e Lartë lejen për botimin e një organi kulturor e arsimor shqiptar. Shoqëria e Stambollit mendonte të botonte gjithashtu një gramatikë dhe një fjalor.

Por veprimtaria e mëtejshme e Shoqërisë së Stambollit filloi të ndeshte në vështirësi nga ana e qeverisë osmane, e cila, e trembur nga hovi dhe karakteri kombëtar i lëvizjes shqiptare, e ndryshoi qëndrimin ndaj Shoqërisë. Në Stamboll mundi të botohej vetëm «Alfabetarja». Porta e Lartë ia hoqi lejen e dhënë Jani Vretos, ndaloi botimin e librave të tjera shqipe dhe pengoi veprimtarinë e aktivistëve të Shoqërisë të dërguar në Shqipëri!).

"Gjithë sa kombe janë të ndriturë dhe të qytetëruarë, janë ndriturë dhe qytetëruarë prej shkronjash në gjuhë të veta. Edhe çdo komb, që nuk ka shkruarë gjuhën e vet, edhe s'ka shkronja në gjuhë të vet, është në terrët dhe barbar. Edhe shqipëtarët mendojnë dhe shohën këtë të madhe të keqe, shohën dhe të madhe nevojë të shkruanjen gjuhën e tyre dhe të kenë shkronja e të këndonjen në gjuhët të tyre. E kështu bëcete shoqëri shqiptarësh për të shtypur shkronja shqip. Edhe fillohet në Konstandinupojë sot ditën e dielë të tridhjetën e Vjeshtësë parë, të një mij e tetë qind e shtatëdhjetë e nëndit vit (sipas stilit të ri 12 Tetor 1879-Red.) . . . me të tillë Kanonizme."

Nga "KANONIZMA E SHOQËRISË TË SHTYPURI SHKRONJA SHQIP"



Pjesë nga statuti i Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip të Stambollit

Këto veprime të Portës përkraheshin edhe nga kisha ortodokse greke dhe kreu i saj Patrikana e Stambollit, e cila lëshoi solemnisht mallkimin kishtar kundër librave në gjuhën shqipe si dhe kundër atyre ortodoksve shqiptarë që kishin marrë pjesë në botimin e tyre ose i përdornin ato. «Patriku — informohej në një raport nga Stambolli — është ngritur me forcë kundër gjithë kësaj pune dhe ka

1) Historia e Shqipërisë, Vep. e cituar, fq. 154.

nxjerrë një qarkore për ta lexuar në të gjitha kishat, duke i paralajmëruar kundër këtyre planeve dhe duke i njoftuar se gjuha e tyre amtare është greqishtja e jo shqipja dhe se ata janë grekë e jo arnautë!¹⁾ Ndërsa në qarkoren e Patrikanës të lëshuar në vitin 1879, në lidhje me librat në gjuhën shqipe thuhej: «Këto janë një kurth i ngrehur me anën e të cilit mundohen t'ju largojnë nga rruga e drejtë dhe t'ju hedhin në humnerë... krijojnë një çështje shqiptare atje ku nuk ka shqiptarë dhe për qëllimin e tyre kanë hartuar libra shqipe dhe këto i kanë shpërndarë... Flasin disa nga ju shqip, po a është e arsyeshme që atdheu juaj të quhet pjesë e Kombit Shqiptar?»²⁾.

• Patriotët shqiptarë u gjendën kështu përballë një kundërshtimi të dyfishtë. Koto Hoxhi, i cili ishte kthyer tashmë në Shqipëri dhe përpiqej të vinte në jetë programin e Shoqërisë, duke i paraqitur valiut të Janinës³⁾ një kërkesë të nënshkruar nga shumë qytetarë të Gjirokastrës për hapjen e një shkolle shqipe, jo vetëm nuk mori lejen e dëshiruar, por u bë objekt ndjekesh nga kleri grekoman



Koto Hoxhi

1) Xh. Lloshi, «Duke kërkuar nëpër arkivat e huaja». Në gazetën «Drita» Nr. 33, datë 30 shtator 1972, fq. 12.

2) Th. Papapano, «Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës». Në «Arsimi popullor» 1963 Nr. 3, fq. 68.

3) Sanxhaku i atëhershëm i Gjirokastrës, nga pikëpamja administrative, bënte pjesë në vilajetin e Janinës.

e veçanërisht nga peshkopi ortodoks Anthimi i Gjirokastrës.

Si rezultat i acarimit të mëtejshëm të marrëdhënieve midis Portës së Lartë dhe Lidhjes Shqiptare dhe sidomos me luftën e armatosur që u zhvillua midis ushtrive osmane dhe forcave të Lidhjes, në pranverë të vitit 1881, për veprimtarinë e Shoqërisë së Stambollit u krijuan kushte shumë të vështira. Terrori që shpërtheu nga ushtritë osmane në Shqipëri pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare dhe situata e re politike ndërkombëtare e krijuar pas Kongresit të Berlinit ndikuan negativisht në gjithë zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare.

III

KUSHTET POLITIKE E ARSIMORE TË SHQIPËRISË PAS SHTYPJES SË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Me përfundimin e krizës lindore të viteve 1875-1878 dhe shtypjen e Lidhjes Shqiptare më 1881, për Shqipërinë u krijuan kushte të reja shumë të vështira të brendshme dhe të jashtme. E tronditur thellë nga vrulli dhe përparimet e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe me qëllim që t'i pritej rruga në të ardhmen përsëritjes së ngjarjeve të tilla, qeveria osmane vendosi në Shqipëri një regjim terrori politik të pabarë gjer atëhere. Qindra e mijëra patriotë shqiptarë iu nënshtruan ndjekjeve, internimeve dhe burgimeve. Shtetrrëthimi dhe gjykatat ushtarake vepruan për një kohë të gjatë në Shqipëri. Kompetenca të veçanta iu dhanë në këto vite organeve të xhandarmërisë dhe policisë.

Krahas dhunës, në këtë periudhë të re, qeveria e Stambollit vazhdoi të ndiqte me këmbëngulje akoma më të madhe politikën e vjetër të mohimit të kombësisë shqiptare dhe të nxitjes së përçarjeve fetare e krahinore. Si pasojë e këtij regjimi gjakatar dhe të kësaj politike anti-shqiptare, lëvizja kombëtare shqiptare bësoi një goditje të rëndë dhe populli shqiptar e udhëheqësit rilindës ndjenë peshën e vuajtjeve të panumërta.

Së bashku me forcën brutale të drejtpërdrejtë, sun-

duesit osmanë përdorën kundër shqiptarëve, ashtu si më parë, edhe mjete të tjera si ideologjinë fetare islame, arsimin në gjuhën turke e arabe etj. Për këtë qëllim ata kishin angazhuar në Shqipëri një numër të madh klerikësh myslimanë, të cilët përpiqeshin gjithnjë që fatin e shqiptarëve, sidomos të myslimanëve, ta paraqisnin të lidhur me fatin e Perandorisë Osmane. Çdo pakënaqësi ose lëvizje të drejtuar kundër sunduesit osman, hoxhallarët e interpretonin si fryt të propagandave të shteteve të huaja të krishtera.

Edhe situata e jashtme politike nuk ishte aspak e favorshme për Shqipërinë. Stabiliteti politik i vendosur me traktatin e Berlinit të vitit 1878 ishte i pjesshëm e i përkohshëm. Kontradiktat kapitaliste midis shteteve evropiane jo vetëm nuk ishin zgjidhur, por acaroheshin gjithnjë e më shumë. Secila fuqi e madhe apo e vogël përpigjej ta shfrytëzonte këtë periudhë «qetësie» e «stabiliteti» për t'u përgatitur politikisht dhe ushtarakisht që, me t'u krijuar rrethana të reja, të realizonte synimet e veta imperialiste e shoviniste ndaj Shqipërisë.

Krahas depërtimit të mëtejshëm ekonomik, shtetet e interesuara për copëtimin e truallit shqiptar ose për zëvendësimin e sundimit osman zhvilluan në Shqipëri një veprimtari të madhe propagandistike në favor të planeve të tyre politike. Ato vunë në veprim klerin, kishën, konsullatat dhe shkollat. Nën petkun e priftit, të konsullit, të mësuesit apo të tregtarit, agjentura e huaj përshkonte të gjitha anët e Shqipërisë. Politika imperialiste e fuqive të mëdha evropiane për ruajtjen e statukuosë e të «ekuilibrin të forcave» në Ballkan dhe veprimtaria e tyre propagandistike e vështirësuan akoma më tepër luftën për çlirimin kombëtar të popullit shqiptar dhe ndikuan për zgjatjen e sundimit mesjetar të perandorisë së kalbur osmane në Ballkan e në Shqipëri. «Historia e Evropës — ka thënë shoku Enver Hoxha — e ka provuar se «ekuilibrin i forcave» të fuqive të mëdha ka qenë kurdoherë armë në duart e klasave shfrytëzuese për shtypjen e lëvizjeve nacionalçlirimtare e revolucionare. Intervencioni

ka qenë gjithmonë armë e sistemit të ekuilibrit, për ta rivendosur kur ai priset, ose për ta ruajtur atë të mos priset»¹⁾. Aktive u treguan veçanërisht Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia, të cilat synonin të ishin pasardhëset e Perandorisë Osmane në Ballkan. Pas tyre vinin Anglia, Gjermania dhe Franca.

Një dëm tepër të madh vazhdonte t'i shkaktonte luftës së popullit shqiptar për çlirimin kombëtar qëndrimi shovinist i shteteve fqinje ballkanike. Greqia, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, të cilat, siç shkruante më 1888 gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit, «nuk u kënaqën me plagët që i bënë afro për vdekje (gjatë krizës së fundit lindore të viteve 1875-78) po bëheshin gati ta gllabëronin fare për të forcuar trupin e tyre»²⁾. Nën parullën e çlirimit të Ballkanit nga sundimi osman, shtetet ballkanike u përpoqën me të gjitha mënyrat për të realizuar planet shoviniste pushtuese në dëm të popullit shqiptar, i cili vazhdonte të vuante nën robërinë osmane. Në këtë periudhë «stabiliteti» të përkohshëm qarqet sunduese reacionare ballkanike i vazhduan në mënyrë të ethshme përpjekjet me mënyra të ndryshme e sidomos me anën e kishës dhe të shkollës, për t'i orientuar shqiptarët nga politika e tyre dhe për të mohuar në arenën ndërkombëtare ekzistencën e kombit shqiptar. Politika shoviniste e shteteve të Ballkanit mbolli përçarjen kombëtare midis popujve ballkanas, lehtësoi ndërhyrjen e fuqive të mëdha imperialiste dhe vonoi e ndërlikoi procesin e çlirimit përfundimtar të Gadishullit Ballkanik.

Një veprimtari të madhe armiqësore ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare vazhduan të zhvillojnë gjatë kësaj periudhe veçanërisht qarqet sunduese shoviniste të Greqisë.

1) E. Hoxha, «Raport në Kongresin VII të PPSH», Tiranë 1976, fq. 215.

2) Gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit, viti I, Nr. 3, datë 28 gusht 1888.

Pararoja e interesave të borgjezisë shoviniste greke, Patrikana e Stambollit, punonte me ngulm në dobi të panhelenizmit. Veprimtaria kryesore e klerit për qëndrohej jo në predikimet fetare por në mbajtjen e popullit shqiptar në errësirë dhe padituri dhe në luftën kundër lëvizjes kombëtare shqiptare. Futja e shqipes në ceremonitë fetare, në librat «e shenjta» apo në shkollat greke që ishin hapur në Shqipëri, paraqitej si një gjë e ndaluar dhe antifetare. Ndëshkimet dhe masat më të rënda përdoshin kundër cilitdo shqiptar ortodoks që guxonte të punonte në dobi të gjuhës e të atdheut të vet.

Në shërbim të politikës shoviniste greke punonin një numër shoqërisht, komitetesh dhe organesh të ndryshme brenda dhe jashtë Greqisë, të themeluara qysh më parë, si edhe Komiteti politik i Korfuzit, themeluar më 1883, shoqata kulturore «Vllamët Shqipëtarë», themeluar në Athinë më 1884, gazeta «Neologos» që dilte në Stamboll etj.

Ndonëse në kushte shumë të rënda të brendshme dhe të jashtme, lëvizja kombëtare shqiptare u zhvillua më tej. Grupe të ndryshme udhëheqësish e aktivistësh të lëvizjes kombëtare, që kishin mundur t'i shpëtonin valës së arrestimeve e të internimeve vazhdonin veprimtarinë e tyre brenda vendit në një ilegalitet të thellë dhe sidomos jashtë atdheut, në kolonitë e të mërguarve shqiptarë, ku kishte kushte më të mira veprimi. Shqiptarët kishin mësuar shumë në zjarrin e luftës të udhëhequr nga Lidhja Shqiptare. Në kushtet e reja politike që ishin krijuar pas shtypjes së saj, ata e kuptuan se përkohësisht nuk ishin të përshtatshme kushtet e sulmit të drejtpërdrejtë, se kishte filluar një periudhë e re, periudha e grumbullimit dhe e përgatitjes së forcave.

Përvoja e Lidhjes Shqiptare kishte nxjerrë ndër të tjera detyrën e rëndësishme që të punohej me të gjitha mënyrat për të ngritur në një shkallë më të lartë ndërgjegjen kombëtare të masave të gjera popullore, aq sa

kërkesa për autonomi të kuptohej si një nevojë e domosdoshme historike¹).

Rreziku i copëtimit dhe politika imperialiste e ruajtjes së statuskuosë bëri që shqiptarët me të drejtë ta vlerësonin situatën e re si jo të favorshme për një kryengritje të armatosur të përgjithshme, e cila do të kishte përballë vetes jo vetëm forcat osmane por edhe fuqitë e mëdha. Në këto kushte rilindësit përpunuan edhe një taktikë të re, në të cilën lufta për shkollën shqipe dhe kulturën kombëtare zinte një vend të dorës së parë dhe tërhoqi në këtë periudhë vëmendjen kryesore të lëvizjes kombëtare.

Hapja e shkollave shqipe dhe zhvillimi i kulturës kombëtare do të shërbenin jo vetëm për të ngritur ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve, por edhe për të afirmuar përpara opinionit publik botëror ekzistencën e kombësisë shqiptare, për mohimin e së cilës punohej shumë nga të gjithë armiqtë e popullit shqiptar.

Nevoja për zhvillimin e arsimit e të kulturës kombëtare bëhej më e ngutshme edhe për shkak të zgjerimit të madh që mori arsimi në gjuhë të huaj në Shqipëri në dy dekadat e fundit të shekullit XIX dhe të politikës imperialiste dhe shoviniste të shteteve të huaja për asimilimin e shqiptarëve.

Përpjesëtime shqetësuese kishte marrë arsimi në gjuhë të huaj në Shqipërinë e Jugut, ku krahas sundesit osman po vepronte me shumë energji, në këtë periudhë, shovinizmi grek. Shkollat greke kishin arritur të përhapen deri në Durrës dhe Tiranë. Qysh në vitin 1879 në krahinat Berat, Korçë dhe Durrës kishte 125 shkolla greke, nga të cilat 6 shkolla qytetëse dhe një shkollë të mesme²). Sipas të dhënave të konsullatës franceze të Janinës në vitin 1882 vetëm në vilajetin e Janinës (që për-

1) S. Pollo, Artikull i cituar. Në Buletini i USHT, seria Shkenca Shoqërore, 1962, Nr. 4, fq. 86.

2) S. Shaplllo, «Rrugët kryesore të shkollës shqipe gjer në çlirim të vendit». Në «Arsimi Popullor» 1963, nr. 4, fq. 57.

fshinte gjithë Shqipërinë e Jugut përveç rrethëve të Kolonjës, Korçës e Pogradecit dhe që shumicën dërmuese të popullsisë e kishte shqiptare) kishte 643 shkolla për djem dhe mikse me 736 mësues, dhe 22 shkolla për vajza me 40 mësuese¹). Në vitin 1894 arriti që në sanxhakun e atëhershëm të Gjirokastrës të kishte 84 shkolla fillore greke²) dhe po aq në krahinën e Beratit³).

Gjithë organizimi dhe plani e programi mësimor i shkollave në gjuhën greke të Shqipërisë ishin identike me ato të shkollave në Greqi. Hapja e këtyre shkollave bëhej nga mitropolitë greke, të cilat në marrëveshje me konsujt grekë, emëronin drejtorët e shkollave dhe personelin mësimor. Mjetet kryesore financiare për mbajtjen e këtyre shkollave siguroheshin nga qeveria e Athinës nëpërmjet sillogut që ishte krijuar aty për përhapjen e gjuhës e të kulturës greke.

Sipas statistikave të viteve të fundit të shekullit XIX, në të katër vilajetet e atëhershme të Manastirit, Kosovës, Shkodrës dhe të Janinës, në të cilat shqiptarët përbënin një tërësi kompakte dhe shumicën e popullsisë, kishte: 1187 shkolla turke, nga të cilat 1125 shkolla fillore, 57 shkolla të mesme të ulëta (ruzhdiqe) e 5 shkolla të mesme të plota (idadiqe), më shumë se 1000 shkolla greke dhe mbi 300 shkolla bullgare, serbe e vllahe⁴), pa përmendur shkollat në gjuhën italiane që mbante Austro-Hungaria dhe Italia.

E gjithë kjo mori shkollash turke, greke, sllave etj.,

1) Archives du Ministère des Affaires Etrangères, Janina 1882 (dokumenta të mikrofilmuara, pranë Arkivit të Institutit të Historisë, Tiranë).

2) Haus-Hof-und Staatsarchiv-Politisches Archiv-Albanien (me tej H H StAPAA). Informacion i konsullit austro-hungarez të Janinës Nr. 40/res, datë 17 tetor 1894.

3) Po aty, Informacion i konsullit austro-hungarez të Janinës, Nr. 45/res, datë 25 dhjetor 1894.

4) «Kalendari Kombiar», viti IV, Sofje 1900, fq. 153-154. (Të dhëna të «Mearif salnamesi»).

punonte, gjoja, për t'i «qytetëruar» shqiptarët, në të vërtetë për të zhdukur tek të rinjtë e të rejat shqiptare çdo ndjenjë kombëtare shqiptare, për t'i asimiluar dhe për t'i vënë ata në shërbim të shteteve të huaja.

Shkollat në gjuhë të huaj punonin në mënyrë të tillë që prej tyre «me kohë të dalin ata më të liqtë e më të këqinjtë armiq të gjuhës edhe të kombit të vet» — shkruante gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit. «Me anë të atyre gjuhërave — vazhdonte po ajo gazetë — nuk do të mundim kurrë nonjëherë të mësojmë të vërtetën, kurrë nonjëherë nuk do të mundim të mësojmë historinë e vendit tonë edhe të stërgjyshërvet tonë, edhe kurrë nonjëherë do të mos mundim të mendohemi shqiptarisht për punërat tona»¹⁾.

Në këto rrethana duhej vepruar pa vonesë në fushën e arsimit kombëtar. «S'mund të ketë Shqipëri pa shqiptarë, s'mund të ketë shqiptarë pa gjuhë shqip, s'mund të ketë gjuhë shqip pa shkolla në të cilat të mësohet shqipja»²⁾, shkruante Sami Frashëri.

Por, ndërsa nevoja për zhvillimin e arsimit e të kulturës kombëtare ishte e madhe dhe e ngutshme, kushtet për një veprimtari të tillë — ashtu sikurse u tha më lart — ishin shumë të vështira. Ato ishin vështirësuar veçanërisht pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit, kur Porta e Lartë shpërtheu një fushatë të rreptë kundër çdo manifestimi kulturor shqiptar. Ishte krijuar një situatë kaq e rëndë sa, siç shprehej poeti dhe patrioti Filip Shiroka, «...mjaftonte një fjalë a një dyshim për me hupë jetën e me mjerue shtëpinë...»³⁾. Shkrimi shqip e shkolla shqipe ishin të ndaluara e të shpallura si antifetare.

1) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit. viti I, Nr. 13, datë 2 gusht 1897, fq. 3.

2) S. Frashëri, Vep. e cituar, fq. 68.

3) Filip Shiroka, Parathënje e përmbledhjes së poezive «Zani i Zembrës». AQSH i RPSSH, Fondi i F. Shirokës. Originali dorëshkrim.

Megjithëkëtë, idetë e mëdha të rilindësve, të fuqizuara edhe më shumë nga lufta e armatosur e masave popullore e veçanërisht nga lufta e udhëhequr nga Lidhja Shqiptare, çanë përpara dhe i prinë popullit shqiptar në rrugën e zhvillimit e të përparimit. Kushtrimi në vargje i Pashko Vasës,

*«Çoniu shqiptarë prej gjumit çoniu
Të gjithë si vllazën me një besë shtrëngoniu
Edhe mos shikoni kisha e xhamia
Feja e shqiptarit asht shqiptaria»,*

i kopjuar me dorë ose i shtypur në fletë volante qarkullonte ilegalisht nëpër Shqipëri dhe ushqente zjarrin e ndezur të lëvizjes kombëtare shqiptare edhe në kushtet e regjimit policor hamidian.

Me keqësimin e situatës politike brenda vendit, një rëndësi të veçantë për lëvizjen kombëtare shqiptare morën në këtë periudhë kolonitë shqiptare të mërgimit, të cilat ishin shtuar mjaft me emigrantë politikë të rinj. «Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip», pas tronditjes që kishte pësuar gjatë reaksionit të vitit 1881, mbeti me pak anëtarë dhe nuk mundi ta vazhdonte veprimtarinë e vet në forma të organizuara si më parë. Megjithatë, anëtarë të rëndësishëm si dhe kryetari i saj, Sami Frashëri, ndonëse «ishin në gojën e ujkut e afër kuçedrës së mallkuar, s'pushuan së punuari për të shpëtuar kombin e tyre»¹). Ata e vazhduan veprimtarinë patriotike në kushte ilegaliteti e më tepër në mënyra individuale.

Veprën arsimore e kulturore, të filluar nga kjo shoqëri në mënyrë të organizuar, e vazhduan kolonitë e tjera shqiptare jashtë Perandorisë Osmane dhe veçanërisht kolonia shqiptare e Bukureshtit, e cila si nga madhësia ashtu edhe nga veprimtaria arsimore e kulturore u bë më e rëndësishmja në këtë periudhë. Në përputhje me

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, viti III, Nr. 46, datë 14 qershor 1904, fq. 1.

mundësitë legale dhe me nevojat e lëvizjes kombëtare në këtë fazë zhvillimi, kolonitë shqiptare e shoqëritë patriotike që u formuan në gjirin e tyre ndihmuan moralisht dhe materialisht për përhapjen e ideve kombëtare, për botimin e librave, gazetave, literaturës artistike si dhe për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Brenda vendit, në vitet e para pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare, në përputhje me kushtet e rrezikshme të ndjekjes dhe të terrorit që u përmendën më lart, shkrimi i gjuhës shqipe vazhdoi të mësohej fshehurazi në vise të ndryshme të Shqipërisë. Elementë të shtresave të ndryshme, çirakë e zanatçinj, të varfër e të pasur, fshatarë e malësorë, tregtarë e nëpunës, të rinj e të moshuar, në dyqane dhe në bodrume, nëpër shtëpi e nëpër shkolla në gjuhë të huaj, në qytete e në malësi, me libra e pa libra filluan të mësojnë shkrimin e gjuhës shqipe. Koto Hoxhi, i detyruar të largohet nga Stambolli, vjen në vendlindjen e tij, në Qestorat dhe punon për të përhapur mësimin shqip në të rinj e në të moshuar¹). Koto Hoxhi tërhoqi rreth vetes gjithashtu nxënës shqiptarë të shkollës normale greke të Qestoratit, u dha mësim atyre në orët e lira dhe ngjalli dashurinë për gjuhën e për atdheun. Puna e tij e vuri patriotin e shquar në konflikt me autoritetet osmane dhe me peshkopin e Gjirokastrës. Ky i fundit e çkishëroi dhe futi njerëz për ta helmuar, po ai nuk u tërhoq përpara vështirësive. Në saje të punës së Koto Hoxhit nga shkolla e Qestoratit dolën edhe atdhetarë që ndoqën me guxim rrugën e mësuësit të tyre të madh²).

Po kështu arbëreshi i Greqisë Anastas Kullurioti kishte ardhur më 1883 për të shpërndarë abetare shqipe, por kur ai po vepronte në zonën e Gjirokastrës, autori-

1) Th. Papapano, «Shkollat e para shqipe në rrethin e Gjirokastrës». Në «Arsimi Popullor», 1963, Nr. 3, fq. 69.

2) I. Gogaj, Vep. e cituar, fq. 14.

tetet osmane, të nxitura dhe nga kleri grek, e dëbuan atë nga Shqipëria¹). Nën shembullin e mësuesit të tij Koto Hoxhi, Petro Nini Luarasi, ndonëse fare i ri në moshë dhe ndonëse punonte si mësues i greqishtes në shkollat greke të fshatrave Bezhan, Katund e Luaras, gjatë viteve 1882-1887 u bë një përhapës energjik dhe i guximshëm i shkrimit të gjuhës shqipe dhe i ndjenjave kombëtare. Kostandin Kristoforidhi, me t'u kthyer në atdhe më 1884, hyri si mësues në shkollën greke të Elbasanit dhe, ashtu siç pat bërë edhe më përpara në Tiranë, filloi t'u mësonte fshehurazi nxënësve në shkollë gjuhën shqipe.

Në Shkodër mësimi i gjuhës shqipe kishte krijuar një farë tradite dhe, me gjithë vështirësitë, vazhonte të mësohej në disa shkolla private për djem dhe për vajza.

Aty nga viti 1885 Gjerasim Qiriazhi kishte hapur në Manastir një shkollë private shqipe për djem dhe për vajza²). Në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë pranë kishave ekzistonin disa shkolla në të cilat mësohej edhe gjuha shqipe. Në krahinat malore të Elbasanit, pothuajse në çdo fshat, mësohej fshehurazi shkrimi shqip.

Megjithë përparimet që po bëheshin në përhapjen e mësimin në gjuhën shqipe, mbetej ende shumë për të bërë. Rezultatet e arritura gjer atëhere ishin të kufizuara dhe të pamjaftueshme. Pikëpamjet dhe kërkesat demokratike të rilindësve për zhvillimin e arsimit gjer tani nuk ishin realizuar veçse pjesërisht. Mësimi në gjuhën shqipe kishte mbetur ende privilegj i një rrethi të kufizuar shqiptarësh, botimet në gjuhën shqipe ishin të pakta dhe nuk ishte arritur të krijoheshin ende shkolla e vërtetë kombëtare. Në truallin shqiptar mësimi i gjuhës amtare, i gjuhës së popullit ishte gjithnjë i ndaluar. Rruga kryesore e përhapjes së tij ishte rruga ilegale.

1) Historia e Shqipërisë, Vep. e cituar, fq. 208.

2) Të dhënat për këtë shkollë janë fare të pakta. Ajo përmendet edhe në shkurt të vitit 1886 në një letër që Thimi Mitkoja i dërgonte nga Egjipti Jeronim De Radës në Kalabri.

Futja e mësimit të gjuhës shqipe si lëndë e veçantë ose më vonë si gjuhë mësimi në shkollat e hapura nën «patronazhin» e Austro-Hungarisë për popullsitë katolike të Shqipërisë së Veriut e të Verilindjes nuk e ndryshonte fizionominë e përgjithshme të tyre. Ndonëse kjo u shfrytëzua nga mësuesit patriotë dhe nga popullsia në të mirë të përhapjes së mësimit të gjuhës shqipe, ato shkolla i shërbenin synimeve imperialiste të shtetit që i kishte çelur dhe i subvenciononte.

Ato pak shkolla private që vepronin në Shkodër ishin gjithnjë të një niveli të ulët si nga pikëpamja e programit mësuesor ashtu edhe nga ana metodike e pedagogjike.

Megjithëse arritjet e gjeratëhershme shënonin një hap përpara në krahasim me të kaluarën, momenti historik shtronte kërkesa të reja më të larta. Në këto kushte rilindësit shqiptarë, brenda dhe jashtë Atdheut, e panë të nevojshme të ndërmerinin një aksion të përbashkët për ta shtuar dhe organizuar më mirë veprimtarinë arsimore e kulturore.

Rilindësit, «këta luftëtarë të pushkës e të penës, nuk mund të duronin më që në shkollat e Shqipërisë të mësohej gjuha e pushtuesve turq» dhe e shteteve të tjera të huaja «dhe të mos lejohej mësimi i gjuhës së nënës së tyre, që u ka kënduar aq ëmbël në shqip bijave e bijve të saj, duke i përkundur në djep me aq bukuri e trimëri...»¹⁾

Krahas përdorimit të formave të mëparshme ata vepruan me të gjitha forcat për të krijuar shkollën e paruarur shqipe, shkollën kombëtare shqipe, e cila do të ishte një nga mjetet e fuqishme për përhapjen e dijes e të ideve të çlirimit kombëtar në masat popullore.

1) E. Hoxha, «Përshëndetja me rastin e 50-vjetorit të shkollës së mesme «Asim Zeneli», 11 nëntor 1973. Në «Raporte e Fjalime» 1972-1973. fq. 430.

IV

ÇELJA E SHKOLLËS SË PARË SHQIPE TË KORÇES

Shqipëria e Jugut dhe veçanërisht Korça, ku përveç shtypjes së sunduesit osman kishte vërshuar më tepër se kudo shkolla dhe propaganda greke-fanariote, u zgjodhën edhe si zona kryesore ku duhej vepruar pa vonesë në fushën e arsimit kombëtar, për ta bërë atë «një mur ku të thyhej çdo tentativë e propagandës helene»¹).

Qyteti i atëhershëm i Korçës kishte rreth 15.000 banorë²), nga të cilët 1/3 ishin myslimanë dhe 2/3 të krishterë ortodoksë. Korça ishte qyteti i dytë me rëndësi i vilajetit të Manastirit. Nëpër të kalonin rrugë të rëndësishme tregëtare, që lidhnin Selanikun dhe qendrën e vilajetit të Manastirit me pjesën perëndimore të këtij të fundit si dhe me krahinat e tjera jugore të Shqipërisë, që nga pikëpamja administrative përfshiheshin në vilajetin e Janinës. Ajo ishte bërë një qendër e rëndësishme tregëtare sidomos për Leskovikun, Kolonjën, Oparin, Pogradecin, Frashërin, Përmetin etj. dhe mbante lidhje tregëtare me botën e jashtme edhe në mënyrë të pavarur nga qendra e vilajetit, nga Manastiri.

1) S. C. Cunesco, «Fondul National Cultural Albanez», Bukuresht, 1919, fq. 5.

2) Sipas disa burimeve të tjera 10.000 ose dhe 20.000 banorë. Shifra e fundit jepet në «Albania» e Brukselit, viti I, shtesë e numrit 8. 1897, fq. 143.

Banorët e Korçës, të rretheve të saj si dhe emigrantët korçarë jashtë atdheut ishin interesuar qysh herët për arsimin e kulturën kombëtare. Pritja e mirë e abetareve të N. Veqilharxhit dhe gadishmëria për ta ndihmuar atë në fushën e botimit të librave në gjuhën shqipe, flasin qartë në këtë drejtim. Mirëpo kundërshtimi i sunduesit osman dhe i shovinizmit grek i penguan banorët e Korçës të realizonin aspiratat e projektet e tyre arsimore e kulturore, të cilat mbetën për kohë të mëvonshme.

Si pasojë e kësaj politike armiqësore në qytetin e Korçës, sado që ishte një qytet i zhvilluar për kohën dhe me popullsi thjesht shqiptare, arsimi, ashtu si në krahinat e tjera të Shqipërisë, lejohej dhe zhvillohej vetëm në gjuhët e huaja, që nuk njiheshin nga popullsia vendase. Në vitet 80 të shek. XIX, qyteti i Korçës kishte 3 shkolla në gjuhën turke, 4 shkolla në gjuhën greke, ndër të cilat një gjimnaz, një shkollë fillore vllahe (themeluar më 1885) dhe një bullgare (themeluar më 1891)¹⁾. Me anën e shkollës në gjuhën greke, të kishës dhe klerit grek e grekoman në popullsinë ortodokse të Korçës prej kohësh propagandoheshin politika dhe ideologjia panheleniste greke. Megjithëse propaganda dhe politika shoviniste greke nuk kishte mundur t'ia arrinte qëllimit final — helenizimit të kësaj popullsie, ndikimet e saj ndjeheshin në shtresa të caktuara të popullsisë ortodokse shqiptare, si në borgjezinë e pasur ortodokse, e cila lidhej me Greqinë edhe me interesa ekonomike, në klerin vendës, në një pjesë të intelektualëve të arsimuar në shkollat greke të Shqipërisë apo të Greqisë dhe në elementë të veçantë të popullsisë së paditur, që ishin infektuar nga ideologjia fetare fanariote.

Gjithashtu xhamitë dhe hoxhallarët, propaganda dhe kultura e sunduesit shekullor osman kishin vepruar parrështur gjatë rrjedhjes së shekujve dhe tani, për shkak

1) HHStAPAA: Raport i nënkonsullatës austro-hungareze të Manastirit, Nr. 16, datë 21 qershor 1890; Nuçi D. Naçi, «Korça dhe Pshatrat përçark», Sofje, 1901, fq. 11-12.

të rrezikut që u vinte nga lëvizja kombëtare shqiptare që po rritej dhe për t'i prerë sadopak rrugën politikës anek-sioniste të shteteve fqinje të Shqipërisë, ishin riaktivizuar. Ashtu si në viset e tjera të Shqipërisë, edhe në Korçë, prej kohësh, midis popullsisë së të njëjtës kombësi, të të njëjtit qytet, që kishte të njëjtën gjuhë dhe të njëjtat zakone e tradita, nxitej përçarja fetare, antipatia dhe urrejtja.

Megjithë efektet negative të politikës përçarëse an-tishqiptare të sunduesit osman dhe të shovinistëve fqinj, edhe këtu, si kudo në Shqipëri, u ruajt gjuha shqipe si gjuhë e folur në familje dhe në marrëdhënjet e përdit-shme, dhe idetë kombëtare që po depërtonin gjithnjë e më shumë në radhët e popullsisë po i kundërviheshin propagandës panislamike të sundimit shekullor osman dhe asaj të panhelenizmit grek.

Një mbështetje gjithnjë e më të madhe idetë e reja kombëtare dhe përpjekjet e rilindësve për përhapjen e shkrimit dhe të shkollës shqipe gjenin në masat e gjera popullore të qytetit dhe sidomos të fshatrave të qarkut të Korçës.

Rrethi i Korçës, i Kolonjës, i Pogradecit, duke lënë mënjanë vetë qytetin e Korçës, kishin më tepër se 100.000 banorë. Popullsia fshatare, për shkak të qëndresës më të madhe dhe të kushteve të veçanta, u prek më pak nga ndikimet e huaja.

Zgjedhja e Korçës si qendër kryesore për përhapjen e shkrimit dhe të shkollës shqipe në atë kohë, diktohej pra nga arsye politike si qyteti që ishte rrahur më shumë nga propaganda shoviniste panheleniste dhe synohej të shndërrohej në një bazë për zgjerimin e politikës anek-sioniste greke në gjithë popullsinë ortodokse të Shqipërisë, nga arsye ekonomike e shoqërore — si qytet i zhvilluar në Shqipërinë e Jugut si dhe nga ajo traditë e mirë që ishte krijuar tashmë në këtë krahinë në fushën kombë-tare, qysh me fillimet e Rilindjes. Përveç këtyre, shumë atdhetarë shqiptarë të shoqërive patriotike të mërgimit ishin nga Korça dhe qarku i saj.

Një nga problemet e para me të cilin u ndeshën rili-

ndësit në fushën e arsimit kombëtar ishte ai i mungesës së teksteve shkollore. Shkolla kombëtare shqipe kërkonte tekste të reja, në gjuhën shqipe, me përmbajtje patriotike dhe të çliruara nga ndikimet e huaja politike, tekste me anën e të cilave të përhapeshin jo vetëm shkrimi e leximi, njohuritë shkencore etj., por në radhë të parë idetë kombëtare, në mënyrë që brezi i ri dhe masat e gjera popullore që do t'i përdornin ato, të edukoheshin me dashurinë për atdhe. Në këtë kuptim duheshin përballuar si pengesat e shumta për botimin e literaturës në gjuhën shqipe, ashtu edhe vëshirësitë e krijimit të teksteve të pavarura shkollore.

Në sajë të përpjekjeve të vendosura të rilindësve, të inteligjencës përparimtare shqiptare, vëshirësitë u përballuan dhe brenda një kohe mjaft të shkurtër abetareve të para shqipe do t'u shtohet një numër i konsiderueshëm tekstesh shkollore. Në këtë fushë u shquan veçanërisht Naim Frashëri e Sami Frashëri, që jetonin e punonin në Stamboll dhe pjesëtarët e shoqërisë «Drita» të Bukureshtit¹⁾.

Krahas punës për botimin e revistës «Drita» e «Dituria» (1884), Samiu dhe Naimi bënë një punë të madhe



Naim Frashëri

1) Që në vitin 1881 në Bukuresht shqiptarët kishin formuar një shoqëri me emrin «Degë e shoqërisë së Stambollit për libra shqip». Në dhjetor të vitit 1884 ajo u shndërrua në shoqëri më vete dhe mori emrin «Drita».

për hartimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, ndër-
sa shoqëria «Drita» e shqiptarëve të Bukureshtit, me fon-
det e grumbulluara, mundi të pajisej me një shtypshkron-
një dhe filloi menjëherë nga botimi i tyre.

Nga të 13 veprat e botuara prej rilindësit të shquar,
Naim Frashërit, 11 janë shkruar e botuar për të plotësuar
nevojat e ngutshme të arsimit tonë kombëtar, për nxënës
shkollash dhe për të rritur. Në vitet 1886-1888 shoqëritë
«Drita» dhe «Dituria» të Bukureshtit¹⁾ botuan në gjuhën
shqipe, ndër të tjera, nga N. Frashëri: *Këndonjëtoren* (në
dy pjesë), *Istorinë e Përgjithshme*, *Dituritë* (njohuri të
shkencave shoqërore e natyrore) dhe *Vjersha për mëso-
njëtoret e çara*²⁾; nga S. Frashëri: *Abetaren*, *Gramatikën*
(Shkronjëtoren) dhe *Gjeografinë* (Dheshkronjën); nga Jani
Vreto: *Arithmetikën* (Numeratoren) dhe *Mirëvetinë* (më-
sime morali); nga Gaspër Benusi *Abetaren*; nga J. L. Te-
rova *Abetaren* dhe *Librin e Këndimit*. Siç shihet, të gjitha
këto botime ishin tekste shkollore. Ato ishin ndërtuar mbi
parime didaktike dhe destinoheshin në radhë të parë për
shkollat që mendohej të hapeshin. Disa prej këtyre tek-
steve u ribotuan më vonë disa herë.

Njëkohësisht kishin filluar përpjekjet në Korçë, në
Stamboll dhe në Bukuresht³⁾ për të hedhur hapin e parë


1) Në vitin 1887 nga gjiri i Shoqërisë shqiptare «Drita» të
Bukureshtit dolën dy shoqëri të reja: shoqëria me emrin e parë
«Drita» dhe shoqëria me emrin «Dituria».

2) Po në këto vite u botua edhe «Bagëti e Bujqësi» e vepra
të tjera letrare të Naim Frashërit.

3) Duke parë rolin e madh negativ antishqiptar të kishës
dhe të klerit ortodoks, të cilët në ceremonitë fetare përdornin
vetëm gjuhën greke, u kërkua që gjuha shqipe të përdorej jo
vetëm në shkollat e huaja, por edhe në kishë e në ceremonitë
fetare. Një nga anëtarët më aktivë të shoqërisë «Drita», Ni-
kolla N. Naço, gjatë vitit 1885 ndërmori katër udhëtime për në
Stamboll nën pseudonimin Joanidhis dhe i paraqiti me shkrim
Pallatit intrigat që zhvillonin Patrikana e Stambollit, kleri fa-
nariot dhe mësuesit grekë për t'i bashkuar shqiptarët me Gre-

— për të futur mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e huaja që ekzistonin në Shqipëri.

Rëndësi të veçantë kishin përpjekjet e ndërmarra në këtë drejtim brenda në Shqipëri e veçanërisht në Korçë. Edhe shoqëria «Drita» e shqiptarëve të Bukureshtit, në marrëveshje me Sami e Naim Frashërin, po punonin për të ndihmuar më nga afër në realizimin e detyrës së caktuar. Ishte menduar që në fillim të punohej për krijimin e një shoqërie kulturore me qendër në Korçë, e cila do të kujdesej për të organizuar përhapjen e mësimin në gjuhën shqipe dhe në të njëjtën kohë t'i paraqitej në formë kërkesë Mitropolisë dhe Dhimogjerondisë (Pleqësisë së Mitropolisë) së Korçës dëshira e shqiptarëve brenda dhe jashtë Shqipërisë për të futur gjuhën shqipe në shkollat



Disa nga librat e para shkollore shqipe

qinë. Me qëllim që t'i jepej fund kësaj veprimtarie antishqiptare dhe, duke e paraqitur atë edhe si cënim të interesave të perandorisë, kërkohej që në shkollat dhe kishat e Shqipërisë të futej gjuha shqipe në vend të greqishtes. Porta e Lartë, e trembur nga pasojat politike që do të kishte realizimi i kërkesës shqiptare dhe për të mos acaruar marrëdhëniet me Greqinë, u përgjegj se çështjen e ngritur e konsideronte si një çështje që i përkiste kultit të krishterë, se nuk mund të ndërhynte për të tilla çështje dhe se i duhej drejtuar drejtpërsëdrejti Patrikanës. Kjo kërkesë iu paraqit edhe Patrikanës, ndonëse mbeti pa përgjigje.

greke të Shqipërisë. Shoqëria e Bukureshtit mendonte që, për realizimin e kësaj detyre të vështirë, të shfrytëzonte edhe një nga pasanikët më të mëdhenj në shqiptarët e Rumanisë, Anastas Avramidhi Lakçen¹⁾, i cili mund të ndihmonte edhe me autoritetin që gëzonte sidomos në Komunitetin ortodoks dhe në Mitropolinë e Korçës, për shkak të kontributeve të dhëna në dobi të tyre.



Thimi Marko

Shoqëria vendosi që, për të ndihmuar nga afër bashkatdhetarët arsimdashës, të dërgojë në Korçë anëtarin aktiv të Kryesisë së saj, Thimi Vasil Markon, i cili shquhej si «burrë energjik, i guximshëm, i mençur dhe i pajisur me aftësitë për të fituar mendjet dhe respektin e bashkëbisedonjësve»²⁾. Thimi Markoja, i pajisur me një letër të shkruar nga dora e Anastas A. Lakçes, por që në të vërtetë shprehte mendimin dhe dëshirën e Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit, nisej, në pranverën e vitit 1886, me një mision të lartë për në vendlindjen e tij, për në

1) Anastas Avramidhi Lakçeja kishte marrë pjesë në Shoqërinë «Drita» të Bukureshtit qysh në themelimin e saj në dhjetor 1884, ishte zgjedhur kryetar i saj dhe kishte premtuar se do ta ndihmonte Shoqërinë nga ana financiare për realizimin e programit kulturor të saj. Më vonë, i ndodhur edhe nën presionin grek e grekoman, hoqi dorë nga premtimi i dhënë.

2) L. Poradeci, «Mbi veprimtarinë patriotike të Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit».

qytetin e Korçës, duke qenë i vetëdijshëm për pengesat dhe rreziqet e mëdha që do të ndeshte.

Me të arritur në Korçë misionari i arsimit kombëtar shqiptar, Thimi Markoja, i parashtroi Pleqësisë së Mitropolitë së qytetit kërkesën e guximshme — dëshirën e gjithë shqiptarëve të Bukureshtit si dhe letrën e Anastas A. Lakçes, në të cilën thuhej se «interesi e donte që të futej gjuha shqipe në shkollat e komunitetit të Korçës, që të mësohej nga çunat e vajzat»¹⁾. Kërkesa e paraqitur nga Thimi Markoja ra si një bombë e papritur. Ajo i turbulloi dhe i vuri përpara një problemi të vështirë Dhimogjeron-dinë dhe Mitropolinë e Korçës.²⁾

Ky ishte një sulm kundër panhelenizmit që bëhej në Shqipëri dhe pikërisht në Korçë, ku ai nuk kishte lënë gur pa lëvizur dhe mjet pa përdorur kundër lëvizjes kombëtare shqiptare. Aty ku mendohej se suksesi i politikës panheleniste do të arrihej më parë se kudo gjetkë në Shqipëri, aty po ndodhte e çara e parë e madhe, goditja e parë e fortë kundër saj. Qëndrimi që do të mbante Mitropolia dhe Dhimogjeronia që vepronte nën diktatin e saj, pak a shumë dihej, por përgjigja që dhanë ata nuk qe e prerë. Në fillim vetë Dhimogjeronia, e përbërë kryesisht nga elementë të pasur ortodoksë të Korçës, u lëkund, por me ndërhyrjet e dhespotit të Korçës, Filotheos, i cili «dëshëronte që gjithë bota të mos fliste gjuhë tjetër veç greqishtes, u bind shumica e saj që të mos futej gjuha shqipe në shkollat, se ishte «mëkatë» dhe të mos deshinin gjuhën e mëmës së tyre»³⁾

Përgjigja e dhënë ishte se për këtë kërkesë duhej pye-

1) N. Naçi, «Shkolla shqipe në Korçë, viti 1927, fq. 166.

2) Shqetësimin e rriste fakti se kërkesa e paraqitur ishte nënshkruar edhe nga «mirëbërësi i madh» korçar, Anastas A. Lakçe, i cili gjer atëhere kishte kontribuar me fonde të rëndësishme në dobi të kishës ortodokse dhe të shkollës në gjuhën greke dhe konsiderohej si «rrethi me ar i Komunitetit orthodoks të Korçës».

3) Po aty.

tur Patrikana e Stambollit nga e cila varej Mitropolia; Patrikana tregoi Sillogun e madh Epirot të Stambollit, i cili kishte në varësi shkollat greke të këtyre viseve dhe Sillogu tregoi Babialinë (Portën e Lartë) nga përgjigja e së cilës «varej» qëndrimi i tij.

Sillogu grek, duke e paraqitur Portën e Lartë si instancën e epërme, i vinte asaj si kusht që kërkesa e paraqitur mund të pranohej dhe gjuha shqipe mund të vihej në shkollat greke të Shqipërisë vetëm në qoftë se ajo do të pranonte gjuhën shqipe në shkollat turke dhe në medresetë e Shqipërisë¹⁾.

Kushti i vënë ishte i perealizueshëm, sepse diheshin parimet dhe politika panislamike që ndiqnin në Shqipëri sundimtarët osmanë.

Në përgjigjen me shkrim që iu dha Thimi Markos, theksohej më fort si arsye e refuzimit se gjoja «një kërkesë e tillë nuk rridhte nga dëshira e popullit, por nga disa njerëz të blerë prej propagandës austriake e nga disa protestantë²⁾ prandaj ajo nuk mund të pranohej.

Megjithë kundërshtimin e Mitropolisë dhe të Patrikanës, kërkesa gjeti përkrahës të shumtë dhe të vendosur në radhët e qytetarëve të thjeshtë arsimdashës të Korçës, bile edhe më tepër nga ç'ishte parashikuar në Bukuresht³⁾. Në një letër Thimi Markoja i shkruante Shoqërisë se në përkrahje të kërkesës së parashtruar ishin regjistruar «njëqind e tetëdhjetë mëmëdhetarë⁴⁾. Kërkesa gjeti mbështetje edhe në një pjesë të anëtarëve të Dhimogjerondisë së qytetit, në pjesën më të shëndoshë, që me vendosmëri u shkëput nga diktati i mitropolitit. Ndër këta më aktivi u tregua Jovan Cico Kosturi, i cili në shenjë proteste ishte larguar nga mbledhja e Dhimogjerondisë⁵⁾.

1) I. M. Qafëzezi, «Dhaskal Gjoka», Korçë, 1936, fq. 146-147.

2) N. Naçi, «Shkolla shqipe në Korçë». Vep. e cituar, fq. 166.

3) Shoqëria shqiptare e Bukureshtit e konsideronte si të mjaftueshme përkrahjen e 30-40 shtëpive në Korçë për të krijuar një arkë më vete për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe.

4) V. Dodani, «Memorjet e mija», Kostancë 1930, fq. 38.

5) N. Naçi, Vep. e cituar, fq. 166.

Ngjarjet që po ndodhnin në Korçë, përçarja në gjirin e Dhimogjerondisë prej së cilës u largua «Tarafrati i Shqipërisë» i kryesuar nga Jovan C. Kosturi, kundërshtimi i vendosur i mitropolitit grek dhe për-krahësve të tij grekomanë dhe propaganda me sukses të Thimi Markos në dobi të gjuhës shqipe, elektrizoi gjithë qytetin e rrethin e tij.



Jovan C. Kosturi

Ideja për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe po gjente gjithnjë e më shumë mbështetje në popull dhe po shndërrohej në një lëvizje të fuqishme inkurajuese për udhëheqësit rilindës dhe shqetësues, tronditëse për kundërshtarët, për Mitropolinë dhe gjithë ata që qëndronin pas saj. Në lëvizjen që shpërtheu për gjuhën e shkollën shqipe merrete pjesë, krahas popullsisë ortodokse, edhe popullsia myslimane. Në këtë mënyrë ndjenja kombëtare ishte ngritur mbi ndjenjën fetare.

Për drejtimin e kësaj lëvizjeje u krijua brenda në Korçë një komitet kombëtar i fshehtë i përbërë nga Jovan C. Kosturi, Orhan Pojani dhe Thimi Markoja. Patriotët shqiptarë brenda dhe jashtë Atdheut ndiqnin me kujdes dhe hap pas hapi ato që po ndodhnin në Korçë. Një korrespondencë e dendur personale zhvillohej midis Korçës dhe qyteteve të tjera të Shqipërisë Jugore dhe të



Orhan Pojani

shqiptarëve të kolonive të mërgimit. Me anën e saj informonin njëri-tjetrin mbi zhvillimin e ngjarjeve dhe rrihnin mendimet e tyre për të gjetur rrugët e kapërcimit të pengesave dhe për ta çuar përpara veprën e filluar. Zhvillimi i ngjarjeve e shndërroi Korçën në një vatër të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare dhe e vuri atë në ballë të luftës për përhapjen e arsimit kombëtar. Të mbështetur në gadishmërinë e masave arsimdashëse, duke parë kundërshtimin e vendosur lidhur me kërkesën e shqiptarëve për të futur gjuhën shqipe në

shkollat e huaja ekzistuese, u mendua që tani kjo kërkesë të avancohej më tej, të krijohej një arkë me kontributet që do të mblidheshin nga popullsia, të veprohej për të çelur shkollat të veçanta, të pavarura nga të huajt, me gjuhë mësimi shqipe dhe të krijohej një shoqëri që do të kujdesej për shkollat që do të hapeshin dhe për mësuesit e tyre.

Tepër të shqetësuara nga këto përparime të shpejta të lëvizjes kombëtare, Mitropolia dhe kisha ortodokse lajmëruan të alarmuara Athinën dhe Patrikanën e Stambollit për ato që ngjishnin në Korçë dhe sipas udhëzimeve filluan të kundërveprojnë. Patrikana me anën e mitropolitit të Korçës u dërgonte të krishterëve ortodoksë letra «këshilluese» duke i porositur që të largoheshin sa më parë nga bashkëveprimi me myslimanët në çështjen e shkri-

mit shqip, sepse gjoja «detyrat e larta të fesë e ndalonin këtë gjë (!)». Njëkohësisht qarqet sunduese shoviniste të Athinës i dërguan letra lajkatare parësisë ortodokse të Korçës duke i quajtur pjesëtarët e saj «patriotë grekë» dhe duke i «këshilluar» të tërhiqeshin nga çdo shoqëri apo bashkëpunim me «otomanët» (me shqiptarët myslimanë) që punonin në dobi të shkollës shqipe. Letrat shoqërohehin edhe me dekorata «të çmuara», të cilat iu shpërmdanë gjithashtu krerëve më të fuqishëm të korçarëve ortodoksë¹⁾. Nga ana tjetër Thimi Markos e përkrahësve të tij u shkaktonin provokime e shqetësime të vazhdueshme, duke arritur desisa të fushin në xhepat e Thimi Markos letra provokuese «kryengritëse», me qëllim që ai të ndiqej nga autoritetet osmane të vendit²⁾. Megjithatë ai vazhdoi i patundur veprimtarinë patriotike, duke bërë të gjitha përpjekjet për të vënë në jetë dëshirën e masave që po e përkrahnin dhe porosinë e Shoqërisë nga kishte ardhur. Krahas aktivitetit që zhvillonte në Korçë ai mbante lidhje të vazhdueshme me shumë patriotë shqiptarë brenda dhe jashtë atdheut. Në një letër dërguar shqiptarëve të Bukureshtit Thimi Markoja shkruante në fillim të vitit 1887: «Unë këtu (në Korçë) gjendem në shumë brenga. E para është që unë nuk rri nat' e ditë, duke përkujdesur për të shentëruarën punë. . . që të vihet në udhë (çështja e shkollës shqipe); e dyta jam në pa rehat se grekomanët këtu më lëftojnë shumë, dhe unë dua t'u qëndroj kundër gjer sa t'u thyhet qafa; e treta këmbej kartëra me shumë mëmëdhetarë të mirë e të urtë në Egjipt, në Stamboll, në Manastir e në Gjirokastrë, të cilët na lavdurojnë dhe përpiqen për t'u ngjallë e mjera gjuhë shqip»³⁾.

Dhespoti grek bëri të gjitha përpjekjet për t'i prerë edhe burimet financiare lëvizjes në rritje për gjuhën e shkollën shqipe. Ai së bashku me suitën e tij grekomane refuzuan testamentin e dërguar nga Bukureshti prej

1) «Mallkimi i shkronjave shqipe». Në «Petro Luarasi — Jeta dhe vepra» Tiranë, 1958, fq. 241.

2) V. Dodani, Vep. e cituar, fq. 29.

3) Po aty, fq. 37.

25.000 napolonash (500.000 frangash) të Anastas A. Lakçes, i cili ishte bindur nga Shoqëria e atjeshme që t'i linte në dobi të gjuhës shqipe. Ata i përgjigjeshin, gjoja në emër të banorëve të Korçës, se «nuk e duan gjuhën shqipe, pse Krishti u ka dhënë helenishten»¹⁾.

Edhe shuma e rëndësishme prej 52.000 frangash, e lënë nga Grigor Nukoja në Egjipt që prej v. 1883, vazhdon-te «të flinte në duart e konsullit të Rosisë në Kajro për shkak të dinakërive të Elenëve» dhe ishte rrezik të humbiste fare²⁾.

Pati edhe elementë të lëkundur, të cilët, të ndodhur përballë «këshillave», premtimeve e kërcënimeve, u tërhoqën nga rruga e nisur dhe kaluan në anën grekomane. I tillë u tregua edhe vetë Anastas A. Lakçeja, i cili, i trembur nga letrat kërcënuese që iu dërguan nga agjentë të Mitropolisë së Korçës, hoqi dorë nga premtimi i dhënë dhe u tërhoq nga rruga e nisur në Shoqërinë e Bukureshtit.

Pavarësisht nga këto lëkundje dhe tërheqje, kryesisht të elementëve të pasur ortodoksë të Korçës, pjesa e shëndoshë vazhdonte me vendosmëri përgatitjet për të realizuar objektivat e caktuara.

Përpjekjet e përbashkëta të patriotëve shqiptarë të Korçës, të Bukureshtit dhe të Stambollit ishin përqëndruar tani në çeljen e një shkolle shqipe në qytetin e Korçës. Komiteti Kombëtar i Korçës përsëriste kërkesat në patriotët shqiptarë të Bukureshtit dhe të Stambollit për të dërguar tekste mësimore dhe për të nxjerrë lejen e nevojshme nga autoritetet osmane të Stambollit. Në përgjigje të këtyre kërkesave, nga Bukureshti ishte nisur për në Shqipëri kontigjenti i parë i teksteve shkollore të botuara atje. Diamandi Tërpo, një nga anëtarët e shoqërisë së Bukureshtit, e dhuroi shtëpinë e tij në Korçë dhe e vuri në dispozicion të Komitetit për ta përdorur si shkollë. Ky ishte një akt i madh

1) AQSH i RPSSH, Dosja e E. Mitkos, Letër e E. Mitkos dërguar J. De Radës më 31 dhjetor 1886.

2) Po aty.

patriotik dhe plotësonte një nevojë urgjente. Në rrethanat e krijuara në Korçë ishte vështirë të gjenje shtëpi qoftë edhe me qira për shkollë shqipe, sepse si Myftiu ashtu edhe Dhespoti kishin dhënë porositë e duhura që askush të mos jepte shtëpinë për t'u mësuar gjuha «e mallkuar» shqipe, e cila i bënte myslimanët kaurë dhe kristianët masonë (!).

Pikërisht në këto momente Diamandi Tërpo shkruante nga Bukureshti «Të zbrazet shtëpia ime edhe të bënet shkollë shqipe»¹⁾.



Diamandi Tërpo

Një ndihmë shumë të çmuar në kapërcimin e pengesave të tjera dhanë shqiptarët e Stambollit, e veçanërisht Sami e Naim Frashëri, të cilët qëndronin në krye të këtyre përgatitjeve. Ata e përsëritën disa herë pranë Portës së Lartë kërkesën e shqiptarëve për shkollën shqipe dhe më në fund u shkëput prej saj një leje në emrin e Pandeli Sotirit, për të çelur një shkollë shqipe në Korçë.

Dhënia e lejës nga Porta e Lartë shënonte një sukses për lëvizjen tonë kombëtare. Qeveria osmane kishte pësuar një tronditje të re në vitet 1885-86 me kryengritjen e Kosovës dhe krizën e Rumelisë Lindore dhe ishte detyruar të

1) Sot kjo shtëpi është kthyer në Muzeum të Arsimit Kombëtar. Diamandi Tërpo, para se të vdiste, la me testament në dobi të shkollës shqipe edhe tërë pasurinë që kishte në Rumani.

bënte premtíme të reja. Sado që, me kalimin e krizës, ajo hoqi dorë nga premtimet e dhëna, vazhdonte t'i trembej hovit të lëvizjes që po rritej në Shqipëri. Nga ana tjetër propaganda greke në Shqipërinë e Jugut ishte bërë shqetësuese për Portën e Lartë në këtë periudhë dhe me dhënien e lejes për shkollën shqipe mendonte ta dobësonte atë¹⁾.

Por në qoftë se rrethanat dhe presioni i lëvizjes kombëtare shqiptare e detyruan ta jepte këtë leje, Porta e Lartë qëndronte konsekuente në politikën e saj ndaj shqiptarëve myslimanë, të cilët, siç shkruanin Samiu e Naimi në atë kohë, «i kanë për tyrq e s'duan t'u ndahe-



Ndërtesa ku u çel shkolla e parë shqipe e Korçës

1) AQSH i RPSSH, Fondi i J. Vretos, Dos. 7, fq. 10-11. Letër e J. Vretos dërguar nga Bukureshti Spiro Dines në Sibin-El-Kom të Egjiptit më 12 prill 1897.

në»¹⁾. Në këto kushte nuk është e rastit që leja ishte dhënë në emër të një shqiptari ortodoks. Shqiptarët e Stambollit ndihmuan gjithashtu në sigurimin e kuadrit mësimor, duke ngarkuar me këtë detyrë patriotin Pandeli Sotiri, mbi emrin e të cilit ishte nxjerrë leja²⁾.

Në përfundim të të gjitha përgatitjeve Pandeli Sotiri nisej nga Stambolli për në atdhe me një mision të lartë. Me gjithë vështirësitë që paraqiste transportimi i librave në gjuhën shqipe, sepse ato ishin të ndaluara, kontigjenti i parë iu dërgua Pandeli Sotirit nga shoqëria e Bukureshtit që kur ky ishte ende në udhëtim për në Korçë dhe po kalonte nëpër Selanik.

Ndërkohë në Korçë, nën drejtimin e Komitetit Kombëtar, ishin bërë përgatitjet e nevojshme për çeljen e shkollës shqipe. Vetë Jovan C. Kosturi, përveç shpenzimeve të tjera, kishte pajisur ndërtesën e dhuruar për shkollë «me levenxe dhe të shtruara nga të shtëpisë së tij»³⁾.

Pas një lufte të gjatë e këmbëngulëse, sapo arriti drejtori i parë i shkollës, Pandeli Sotiri, më 7 mars 1887

1) V. Dodani, Vep. e cituar, fq. 35: letër e Sami e Naim Frashërit dërguar nga Stambolli V. Dodanit në Bukuresht më 10 shkurt 1887.

2) Pandeli Sotiri ishte nga Selcka e Gjirokastrës. Qysh kur vazhdonte shkollën normale greke të Qestoratit kishte filluar të mësonte edhe shkrimin e gjuhës së tij amtare nga patrioti i dëgjuar Koto Hoxhi. Më vonë ishte dalluar si një aktivist i palodhur i lëvizjes sonë kombëtare. Kishte qenë anëtar i kryesisë së «Shoqërisë së Stambollit» dhe kishte ndihmuar, duke vajtur personalisht në Bukuresht dhe në Egjipt, për krijimin e degëve të asaj Shoqërie. Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare ai e vazhdoi pa ndërprerje veprimtarinë patriotike në fushën kulturore dhe, në bashkëveprim të ngushtë me rilindësit e shquar Sami e Naim Frashëri, kontribuoi në botimin e revistës së parë në gjuhën shqipe në Stamboll me titull «Drita» e më vonë «Dituria». Edhe leja për revistën «Dituria» ishte nxjerrë me emrin e tij. Pas mbylljes së kësaj reviste, së bashku me shokët e tij të idealit, vazhdoi të ndihmonte në përgatitjet që po bëheshin për çeljen e shkollave shqipe.

3) V. Dodani, vep. e cituar, fq. 35.



Pandeli Sotiri

drejtori i shkollës, Pandeli Sotiri. Ai falënderoi nënat, baballarët dhe bijtë e tyre për gadishmërinë që treguan. Pastaj u foli për rëndësinë e mësimin në gjuhën shqipe,

u çel shkolla e parë shqipe në Korçë¹⁾. Çelja e shkollës shqipe të Korçës ishte një ngjarje e shënuar dhe përbënte një fitore për gjithë lëvizjen kombëtare shqiptare. Dita e inaugurimit të saj u kthye në një ditë feste dhe gëzimi. Në shkollë kishin ardhur rreth 35 nxënës së bashku me prindërit e tyre. Përveç drejtorit të shkollës, Pandeli Sotirit, aty ndodheshin edhe shumë patriotë e aktivistë të lëvizjes shqiptare si Jovan C. Kosturi, Thimi Marko, Orhan Pojani etj.

Përpara nxënësve, prindërve dhe personave të tjerë, i pari e mori fjalën

1) Në shkrime të ndryshme, në organe të ndryshme të shtypit, duke filluar që nga *Kalendari Kombiar* i Sofies i vitit 1898, si dhe në kujtimet e lëna nga ish-mësues apo ish-nxënës të asaj shkolle data e çeljes së shkollës jepet më përpara. Disa e japin në fund të vitit 1885 dhe disa në vitin 1886. Kjo pasaktësi ka rrjedhur kryesisht për shkak të ngatërresës së shkaktuar nga kalendari i vjetër por edhe për shkak të pasigurisë së memories në çështje date. Sot për ne data 7 mars 1887 merret pa asnjë dyshim si data e saktë e çeljes së shkollës së parë shqipe të Korçës. Kjo provohet përveç të tjerash nga një letër që Thimi Markoja u shkruante nga Korça shqiptarëve të Bukureshtit vetëm një ditë pas çeljes së shkollës, d.m.th. më 8 mars 1887. Po ashtu gazeta

dhe të shkollës që po hapej atë ditë dhe që do të kishte si gjuhë mësimi gjuhën shqipe. Pas tij folën edhe persona të tjerë).

Të nesërmen e kësaj ngjarjeje, më 8 mars 1887, Thimi Markoja u shkruante shqiptarëve të Bukureshtit «... Dëshira jonë u mbarua; shkolla shqipe u hap, druri që vumë në dhët këtu e dy vjet, sot lulëzoj dhe dha pemë të ëmbla. Mundimet tona... dhe të luftuarit e faqezinjvet grekomanë gjersa mbaruam këtë të shenjtëruar punë janë aq shumë sa nuk mund t'jua shkruanj ndë kartë»²⁾).

Natyrisht shkolla shqipe e Korçës nuk mund dhe nuk duhet cilësuar si shkolla e parë në gjuhën shqipe, siç ka ndodhur disa herë në literaturën përkujtimore apo edhe historike. Shkolla ku është mësuar gjuha shqipe, të hapura nga shqiptarë, ka pasur edhe para vitit 1887, bile shumë kohë përpara. Megjithatë, çelja e shkollës shqipe të Korçës shënonte një hap të madh përpara, një ngritje cilësore në zhvillimin e arsimit tonë kombëtar. «Mësonjëtorja shqipe e Korçës» ishte e para shkollë shqipe me fizionomi të qartë e të plotë kombëtare, laike e demokratike³⁾. Si e tillë ajo u përgjigjej dhe realizonte aspiratat e idealet e masave popullore dhe të rilindësve shqiptarë. Ajo, duke u mbështetur në traditën më të mirë rilindëse, e zhvilloi dhe e ngriti atë më lart. Mësimi në shkollën

«Shqipëtarë», që delte në Bukuresht, shkruante në vitin 1888: «Në vitin 1887 hapmë një shkollë shqip në Korçë».

1) Duke kujtuar këtë ditë të shënuar, një nga ish-nxënësit e parë të kësaj shkolle, Thoma Kostë Furxhiu, pas 85 vjetëve, sjell ndërmend:

«Pasi ikën prindërit, drejtori i shkollës, Pandeli Sotiri, na u drejtua ne nxënësve dhe na tha se mësimi i gjuhës shqipe është i lehtë, sepse kjo është gjuha që flisni në shtëpi dhe nuk është gjuhë e huaj». (Kujtime të Thoma K. Furxhiut — marrë në Korçë më 1972).

2) V. Dodani, Vep. e cituar, fq. 39.

3) H. Beqja, «90 vjetori i Mësonjëtores Shqipe të Korçës». Në «Zëri i Popullit», datë 6 mars 1977, fq. 3.

shqipe të Korçës zhvillohej krejtësisht në gjuhën amtare, në gjuhën shqipe, e cila qëndronte ashtu siç i takonte, «zonjë» në vend të vet e jo «shërbëtore» e ndonjë gjuhe të huaj.

Çelja e kësaj shkolle është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të patriotëve brenda vendit dhe të shoqërive patriotike shqiptare të mërgimit. Mësuesit e saj jo vetëm ishin të gjithë shqiptarë, por dalloheshin si patriotë e aktivistë të flaktë të çështjes kombëtare. Tekstet mësimore që u përdorën në këtë shkollë, ishin hartuar nga rilindës të shquar si Naim Frashëri e Sami Frashëri dhe dalloheshin për përmbajtjen e shëndoshë kombëtare e përparimtare për kohën, gjë që i shërbente edukimit patriotik të nxënësve dhe të masave.

Shkolla e parë shqipe e Korçës dallohej dhe për karakterin e saj laik. Për të punuan e kontribuan shqiptarët e të gjitha besimeve. Ajo qe shkollë e përbashkët për nxënës ortodoksë e myslimanë dhe nuk varej as nga kisha as nga xhamia. Mësuesit e saj kanë qenë të gjithë laikë. Si shkollë e përbashkët për nxënës të besimeve të ndryshme fetare, ajo realizonte në praktikë edhe një parim tjetër të rëndësishëm ideologjik të rilindësve, atë të vënies së kombësisë mbi fenë. Kjo i hapte rrugën forcimit të ndërjegjes kombëtare dhe bashkimit politik të popullit. Kjo ishte gjithashtu një goditje kundër gjithçkaje që ishte kurdisur nga të huajt në Shqipëri. Prandaj ky tipar i rëndësishëm i shkollës shqipe u rrinte më tepër si halë në sy sundimtarëve osmanë, shovinistëve grekë dhe elementëve fanatikë turkomanë e grekomanë. Ata e përdorën këtë si «argument» për ta paraqitur shkollën kombëtare shqipe si të papajtueshme dhe në kundërshtim me parimet fetare e shtetërore osmane dhe me porositë e kishës ortodokse.

Shkolla e parë kombëtare shqipe e Korçës dallohej edhe për karakterin e saj demokratik. Ajo frekuentohej nga djem e vajza të shtresave e të klasave të ndryshme të popullsisë së qytetit dhe të fshatit. Në të mësonin fëmijë të popullit pa paguar kurrfarë takse shkollore, bile shpesh duke marrë falas libra, fletore etj.

Ajo u bë shpejt edhe një qendër për përhapjen e mësimin të shkrimit e të këndimit shqip tek të rriturit. Përveç se vatër për përhapjen e diturisë në gjuhën shqipe, shkolla shqipe e Korçës u shndërrua në një vatër të rëndësishme për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, për edukimin patriotik të brezit të ri e të masave popullore¹⁾. Ajo mishëroi karakteristikat më të mira të arsimit tonë kombëtar të periudhës së Rilindjes. Ajo u bë lajmëtarja e kohëve të reja, u bë pishtar dhe shembull i shkëlqyer praktik i rrugës së ndjekur nga rilindësit shqiptarë²⁾.

Korça me «Mësonjëtorën shqipe» tërhoqi vëmendjen dhe simpatinë e të gjithë shqiptarëve brenda dhe jashtë atdheut dhe me shembullin e saj po frymëzonte qytetet dhe krahinat e tjera shqiptare. Poeti i shquar i Rilindjes sonë, Naim Frashëri, i entuziazmuar nga ngjarjet e Korçës, i kushtoi «Mësonjëtores» poezinë e tij të mirënjohur, duke e përshëndetur atë me vargjet plot frymëzim:

.
*«Hapu, hapu errësirë,
 Pa jakë tëhu o dritë!
 Se arriti koh'e mirë,
 U-gdhi nata u bë ditë.*

.
*Lumja ti! moj Korç' O lule!
 Q'i le pas shoqet e tua
 Si trimi në ball' u sule,
 Ta paçim për jetë hua.*

.
 Shkolla e Korçës në fillim kishte katër klasë, përveç klasës përgatitore³⁾.

1) K. Koci, «Mësonjëtorja shqipe e Korçës». Në «Arësimi popullor» 1961, Nr. 3, fq. 14-15.

2) «Arësimi popullor» 1963, Nr. 3 fq. 50.

3) «Arësimi popullor», 1963, Nr. 4, fq. 60.

Lëndët kryesore që zhvilloheshin ishin: shkrimi dhe këndimi shqip, gramatika e gjuhës shqipe, historia, gjeografia, aritmetika, mësimi i natyrës etj.

Përveç gjuhës shqipe në shkollë mësohej në fillim edhe turqishtja si gjuhë zyrtare e Perandorisë, në të cilën bënte pjesë Shqipëria. Më vonë u vu edhe greqishtja e frengjishtja. Vënia e gjuhës greke në shkollën shqipe të Korçës ka kuptimin e vet. Në atë shkollë erdhën edhe shumë nxënës që më parë ndiqnin shkollat greke të qytetit. Me të drejtë patriotët që udhëhiqnin shkollën shqipe të Korçës menduan, që pavarësisht nga politika e propaganda zyrtare greko-fanariote, nxënësit shqiptarë që vinin nga shkollat greke jo vetëm nuk duhej ta humbinin atë që kishin arritur në mësimin e gjuhës greke, por duhej ta zhvillonin më tej dhe të mësonin kështu edhe një gjuhë të huaj më tepër. Në këtë drejtim ndikonin gjithashtu lidhjet ekonomike me Greqinë dhe veçanërisht nevoja për zhvillimin e marrëdhënjëve tregtare, në të cilat gjuha greke luante një rol të rëndësishëm prej kohësh në trevat ballkanike. Vënia e gjuhës greke ishte në të njëjtën kohë edhe një lëshim që u bëhej elementëve të lëkundur e grekomanë, të cilët nuk mund ta kuptonin përgatitjen arsimore e kulturore të një të riu pa mësuar gjuhën greke.

Për një farë kohe, në shkollën shqipe jepte mësim vetëm Pandeli Sotiri. Më vonë si ndihmës i Pandeliut u muar Thanas Sina, i cili dha edhe gjuhën greke në këtë shkollë¹).

Sado që shkolla u hap në mars, pra disa muaj para

1) Në kujtimet e Thanas V. Mborjes, ish-nxënës i kësaj shkolle, thuhet: «Në shkollën shqip ishte vetëm një mësues që quhej Pandeli Sotiri, por pas pak kohe, në muajin maj të atë viti erdhi dhe zoti Thanas Sina nga Postenani si mësues i gjuhës greke në shqip se nxënësit që vinin në shkollën shqip ishin më të shumtët që vinin nga shkolla greke, prandaj duhej që të që edhe një mësues i gjuhës greke që të mos i harronin ato që kishin mësuar më parë». (Kujtime të Thanas V. Mborjes, dorëshkrimi origjinal pranë Muzeumit historik të Korçës).

mbarimit të vitit shkollor, numri i nxënësve erdhi duke u rritur. Me interes është fakti se shumica e këtyre nxënësve braktisën shkollat greke apo vllahe, që ndiqnin deri atëherë dhe u regjistruan në shkollën shqipe¹⁾. Pandeli Sotiri dhe përkrahësit e tij punuan parreshtur dhe me durim për të afruar sa më shumë nxënës në shkollë dhe luftuan kundër propagandës armike që bëri çmos për të penguar mbarëvajtjen e saj. Nga një numër i kufizuar, rreth 35 nxënës, që u regjistruan në fillim²⁾, në fund të vitit shkollor, d.m.th. pas tre muajve, arriti të kishte rreth 60 nxënës³⁾ dhe në vitin e dytë rreth 200 nxënës⁴⁾.

Pati raste që nxënës shqiptarë të cilët vazhdonin shkollat në gjuhën greke, të largohen edhe kur ishin në klasat e larta. I tillë është rasti i Thoma Avramit, i cili, ndonëse ishte në klasën e fundit të gjimnazit grek (gjysmë gjimnaz), e la atë dhe shkoi në shkollën shqipe, në të cilën shërbeu për disa kohë edhe si mësues, ndihmës i Pandeli Sotirit, për gjuhën shqipe⁵⁾.

1) Në kujtimet e Thanas V. Mborjes thuhet: «Ati im më vuri në shkollën e Dhaskal Kopanit (greqisht) me pagesë, që i paguanim për muaj, por në atë shkollë nuk vazhdova shumë se ati tim deshte që të më dërgonte në Bukuresht... dhe kështu kur u hap shkolla rumune këtu në Korçë më vuri në atë shkollë. Por kur u hap e para shkollë shqipe këtu në Korçë... na muarnë që nga shkolla rumune neve nja tre djem që... qemë shqipëtarë dhe na shpunë në shkollën shqip që në atë ditë që u hap... dhe pastaj zunë po vinë edhe djem të tjerë të patriotëve shqiptarë që i merrnin prindërit e tyre që nga shkollat greke dhe i sillnin atje në shkollën shqip» (dorëshkrim në Muzeun Historik të Korçës).

2) Sipas burimeve të tjera shkolla në fillim nuk kishte veçse 12 nxënës («Albania» e Brukselit, Viti III, Nr. 3, mars 1899, fq. 48).

3) Po aty.

4) Historia e Shqipërisë, Vep. e cituar, fq. 219.

5) Në kujtimet e Thoma Avramit thuhet: «Kur isha 14-15 vjeç dhe vazhdoja mësimet në gjimnaz — u çel shkolla shqipe këtu (në Korçë). Ndonëse isha në klasën e fundit e lashë shkollën greke

Problem i vështirë ishte plotësimi i nevojave të nxënësve me tekste shkollore. Siç dëshmon ish-nxënësi i asaj shkolle, Thoma Furxhiu, në fillim përdorëshin më tepër dërrasa e zezë dhe pllakat, mbasi librat e nevojshme mungonin dhe priteshin të vinin nga kolonitë shqiptare të mërgimit.

Në letrën që Thimi Markoja i dërgonte V. Dodanit nga Korça më 8 mars 1887, i shkruante: «Tashi vinj të të them... që lipset të përkujdesi që të gjithë... që të dalim faqebardhë përpara grekomanëve, të cilët nuk pushojnë së luftuari me çdo farë marifeti. Përkujdesi të na dërgoni sa më shpejt nga 200 abetare dhe këndonjëto, për të cilat kemi të madhe nevojë; se mësonjësi Pandeli Sotiri nuk solli më shumë se 50 copë për të trija sojet... është nevojë të më dërgoni që të mos çalojmë»¹).

Çelja e shkollës shqipe në Korçë pati jehonë të gjërë në gjithë Shqipërinë e veçanërisht në Shqipërinë e Jugut. Shembulli i Korçës nuk mbeti i vetëm, por u ndoq edhe nga krahinat e tjera.

Vetëm pak ditë pas çeljes së shkollës së Korçës, u çel në Pogradec, më 14 mars 1887, një shkollë tjetër shqipe²). Edhe këtu çelja dhe mbajtja u bë në saje të bashkëveprimit të popullsisë së të dy besimeve. Mësuesi i saj i parë ka qenë Koço Sotiri, i vëllai i Pandeli Sotirit. Koço Sotiri njihet edhe me emrin Koço Shqiptari, epitete që i ishte vënë sepse punonte për përhapjen e mësimit të shqipes dhe të librave në gjuhën shqipe.

Shkolla shqipe u çelën gjithashtu në Ohër, Rekë, Treskë dhe u bënë përgatitje për të tilla në Elbasan,

dhe vajta ditën e parë pasdreke. Atë kohë unë dinja të këndoja shqip... Mësonjës asi kohe ish Pandeli Sotiri. Kur më pa mua që këndonja liruar shqip më mbajti si ndihmës... Motn'e dytë u emëruash mësonjës në shkollën kombëtare shqipe».

1) V. Dodani, vep. e cituar, fq. 39.

2) Gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit, viti I nr. 4, datë 11 vjeshtë e I, 1888.

Leskovik, Ersekë e gjetkë¹⁾. Në shumë fshatra, si në Polenë, Luaras etj. mësohej gjithashtu shkrimi e këndimi në gjuhën shqipe²⁾.

Në një letër që i dërgohej nga Shqipëria «Fiamurit të Arbërit»³⁾, në korrik 1887, duke bërë fjalë për shkollat shqipe të çelura në Shqipëri, thuhej midis të tjerave: «deri sot janë gjithsejt gjashtë. Pse nuk vjen edhe ndonjë mësues prej jush për të filluar shkollën mundësisht në Berat dhe në Kavajë... Po le të kemi durim të mbajmë ato që kemi»⁴⁾.



Koço Sotiri

Pothuajse në çdo krahinë kishte patriotë shqiptarë që kujdeseshin dhe punonin për përhapjen e shkrimit shqip, të librave e gazetave të para shqipe.


Një veprimtari të madhe vazhdoi të zhvillonte në këtë kohë në krahinën e tij, në Kolonjë, Petro Nini Luarasi. Ai shpërndante pa shpërblim libra shqipe të bo-

1) Historia e Shqipërisë, vep^e e cituar, fq. 219; V, Dodani, Vep, e cituar, fq. 47.

2) V. Dodani, vep. e cituar, fq. 47: letër e Jovan Kosturit dërguar nga Korça V. Dodanit në Bukuresht më 17 janar 1888.

3) «Fiamuri i Arbërit» u botua nga arbëreshët e Italisë nën drejtimin e De Radës në vitet 1883-1887.

4) «Fiamuri i Arbërit», Viti III, Nr. 6, datë 15 gusht 1887, fq. 1.



Petro N. Luarasi

tuara dhe të dërguara nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit. Tani, pas hapjes së shkollës shqipe në Korçë, Petro Nini hoqi dorë nga detyra zyrtare që mbante si mësues i shkollave greke dhe iu kushtua krejtësisht punës për t'u mësuar bashkëfshatarëve të tij shkrimin e gjuhës amtare.

Me iniciativën e tij u çel në Ersekë në vitin 1887 një shkollë private shqipe, e cila vazhdoi gati dy vjet. Në të mësuan jo vetëm të vegjlit, por edhe të rriturit. «Përsëshpejti — shkruan Petro Nini — nisë të këndojnë

dhe të shkruajnë shqip më të shumët e shtëpiakëve (banorëve) të Kolonjës dhe të fshatrave të Vakëfeve, dhe secili përkujdesej fort çkathëtë, t'i jepte mendimet e tij, mikut, duke u bërë, në këtë mënyrë, secili mëmëdhëtar edhe nxënës i tij edhe mësonjës i të afërmit të tij»¹⁾

Petro Nini, i mbështetur nga banorët arsimdashës të krahinës, vazhdoi të punonte me sukses si në shkollën që kishte hapur, ashtu edhe jashtë saj.

Siç shihet, me gjithë vështirësitë dhe pengesat, lufta për çeljen e shkollave shqipe dhe për përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe ishte zgjeruar edhe jashtë rrethit të Korçës dhe vazhdonte të zhvillohej me sukses.

Qyteti i Korçës po luante tani një rol udhëheqës në këtë çështje. Ai ndihmonte qytetet e krahinat e tjera jo

1) «Mallkimi i shkronjave shqipe», vep. e cituar fq. 230.



Ndërtesa e shkollës shqipe të Pogradecit

vetëm me shembullin e vet, por edhe konkretisht me libra shkollore e me udhëzimet e nevojshme.

Duke shprehur këtë situatë, Thimi Markoja shkruante në një letër në prill të 1887: «Sot nuk është vent i Shqipërisë që të mos ndodhen burra shqiptarë, në fyejt të të cilëve të mos lëvrinjë gjak shqiptari, dhe të cilët të mos përpiqen për këtë të shenjtëruar punë. Nga të gjitha anët e Shqipërisë marrimë kartra hiri dhe gëzimi për shkollën që hapmë. Orhan (Pojanit) i shkruajnë dhe i kërkojnë libra. Ky... ka mendje (ka ndërmend) të dalë në gjithë Shqipërinë për të ndezur të gjithë... dhe të mbledhë ndihma. Megjithëqë na dërguat afro 600 copë libra, u lutemi të na dërgoni edhe të tjera¹).

1) V. Dodani, vep. e cituar, fq. 44.

Përpjekje për të çelur shkolla të reja shqipe u bënë edhe në qytete të tjera të Shqipërisë si në Berat, Përmet, Vlorë dhe sidomos në Gjirokastrë¹⁾, por nuk u arrit të kapërceheshin pengesat e mëdha të sunduesve osmanë e të shovinistëve fqinj.

1) AQSH i RPSSH, Fondi i J. Vretos, Dos. 7, fq. 10; HHStA PAA: informacion i konsullatës austro-hungareze të Manastirit, Nr. 16, datë 21 qershor 1890.

V

FORMIMI I «SHOQËRISË SË MËSIMIT SHQIP» NË KORÇË

Një problem i rëndësishëm që kishte dalë qysh me fillimin e përpjekjeve për çeljen e shkollave shqipe ishte ai i formimit të një shoqërie arsimore, që do të kishte si detyrë të kujdesej për sigurimin e mjeteve financiare e të personelit mësues, për botimin e teksteve shkollore, për botimin e një gazete javore ose mujore në gjuhën shqipe dhe të ndihmonte për mbrojtjen e kapërcimin e të gjitha vështirësive e pengesave që do t'u dilnin shkollave shqipe.

Çelja e një numri shkollash shqipe, rritja e kërkesave për tekste e literaturë në gjuhën shqipe, kishte shtuar edhe më tepër nevojën e një organizimi më të mirë të lëvizjes arsimore që kishte marrë hov dhe e kishte bërë të domosdoshme krijimin e një shoqërie të tillë.

Ndërsa në fillim, në vitet 1885-1886, Porta e Lartë, për shkak të vështirësive politike që po kalonte, kishte lënë të kuptohet se nuk ishte kundër formimit të një shoqërie të tillë, në pranverën e vitit 1886, kur kriza e Rumelisë Lindore mori fund me një kompromis, ajo u kthye në politikën e saj të mëparshme armiqësore ndaj shqiptarëve. Pengesa të shumta i sollën formimit të kësaj shoqë-

rie arsimore-kulturore shqiptare edhe kisha ortodokse si dhe elementët grekomanë.

Në pamundësi të krijohej një shoqëri e tillë, ishte krijuar në fillim një komitet i fshehtë kombëtar i quajtur më vonë «Këshilli i mësonjëtores shqipe». Megjithatë, përpjekjet vazhduan pa ndërprerje nga ana e patriotëve shqiptarë. Nga korrespondenca e zhvilluar midis shqiptarëve të Korçës, Bukureshtit, Stambollit dhe Egjiptit, del se në pranverën e vitit 1887, përpjekjet për formimin e kësaj shoqërie kishin arritur në fazën e tyre të fundit.

Në një letër të Sami e Naim Frashërit të majit 1887 mësojmë: «Kartat që muarmë këtë javë nga Korça na rrëfejnë se shkolla atje vete shumë mbarë edhe kanë ndërmend të bëjnë një shoqëri e të bëjnë 400-500 ndihma që të paguajnë për të shtypur libra mësimi e ç'do farë fletore (gazete) të nevojshme»¹). Me përpjekjet e përbashkëta këmbëngulëse të shqiptarëve ortodoksë e myslimanë, pasi u përballuan të gjitha pengesat e armiqve të jashtëm e të brendshëm, u arrit të formohej në Korçë një shoqëri me emrin «Shoqëria e Mësimit Shqip»²). Krijimi i kësaj shoqërie ishte një ngjarje e rëndësishme dhe shënonte një hap tjetër përpara të lëvizjes sonë kombëtare. Duke i dhënë sihariqin e formimit të kësaj shoqërie, Thimi Mitkoja i shkruante nga Egjipti De Radës në Kalabri të Italisë, në shtator të vitit 1888: «në Korçë u bë një shoqëri prej të krishterësh e myslimanësh për gjuhën...»³)

Shoqëria kishte mbi 160 anëtarë. Në të bënë pjesë shqiptarë të të dy besimeve dhe që u përkisnin shtresave të ndryshme shoqërore. Anëtarë të saj ishin mbi 60 shqip-

1) V. Dodani, vep. e cituar, fq. 46: letër e Samiut, Naimit e Vretos dërguar nga Stambolli shqiptarëve të Bukureshtit më 1 maj 1887.

2) Gazeta «Shqipëtari» e Bukureshtit, viti I, Nr. 6, datë 9 vjeshtë II 1888.

3) AQSH i RPSSH: Fondi i J. De Radës, dosja e korrespondencës me Th. Mitkon, Letër e Th. Mitkos, datë 27 të vjeshtës (shtator) 1888.

tarë myslimanë. Midis të tjerëve në këtë shoqëri bënin pjesë Jovan Kosturi, Orhan Pojani, Pandeli Sotiri, Thoma A. Avrami, Kristo Mitkua, Ali Babani, Spiro Jovan Kosturi, Thanas Sina etj.¹⁾. Çdo anëtar paguante një kuotë mujore. Arka e Shoqërisë do të përdorej në radhë të parë për mbajtjen e shkollave ekzistuese dhe të mësuesve të tyre dhe për çeljen e shkollave të reja shqipe. Në krye të shoqërisë u vu Alo Dishnica, i cili kishte kontribuar në mbrojtjen dhe përkrahjen e shkollës shqipe të çelur në Korçë.

Përveç kontributit në fushën arsimore e kulturore, «Shoqëria e Mësimit Shqip» bëri një punë të frutshme edhe në luftën kundër përçarjes fetare që nxitej nga të huajt dhe nga institucionet fetare. Parashikohej që gradualisht numri i anëtarëve të saj të shtohej. Shoqëria u bë qendra kryesore brenda vendit që merrej me organizimin e drejtimin e arsimit kombëtar. Ajo u kujdes për të mbajtur e për të mbrojtur shkollat shqipe ekzistuese si dhe për përhapjen e mëtejshme të arsimit në viset e tjera. Ajo dha gjithashtu një kontribut shumë të madh për të krijuar marrëdhënie miqësore midis shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë.

Megjithë vështirësitë që iu krijuan e luftën që iu bë, megjithëse nuk mundi të vazhdojë për një kohë të gjatë, formimi dhe veprimtaria patriotike e «Shoqërisë së Mësimit Shqip» pati rëndësi të madhe politike e kulturore.

Përparimet e lëvizjes kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe sukseset në fushën e arsimit kombëtar në veçanti si në çeljen e shkollave shqipe, në përhapjen e shkollimit shqip, në formimin e «Shoqërisë së Mësimit Shqip» etj., u arritën në saje të përpjekjeve dhe sakrificave të panumërta të patriotëve rilindës dhe të masave të gjera popullore. Një kontribut të çmuar jepnin gjithnjë shqiptarët e shoqërive patriotike të mërgimit, sidomos ata të Bukureshtit, të Stambollit dhe të Egjiptit. Por sukseset në këtë

1) Në gazetën «Shqipëtar» datë 9 tetor 1888 jepet lista e anëtarëve të kësaj shoqërie.

pushë shiheshin me shqetësim nga të gjithë armiqtë e lëvizjes kombëtare shqiptare, prandaj ato u arritën nëpërmjet një lufte të ashpër politike. Në këtë luftë krahas sundesit osman dallohej gjithnjë kisha ortodokse fanariote dhe shovinizmi grek.

Armiqtë e luftuan arsimin tonë kombëtar në çdo hap të zhvillimit të tij. Qysh ditët kur po çelej shkolla shqipe e Korçës, gazeta greke e Stambollit «Neologos» villte vrer kundër saj dhe informonte qeverinë otomane për ato që po ngjisnin në Korçë, me qëllim që t'i dilej përpara punës që në fillim¹⁾.

Një luftë e ashpër shpërtheu kundër shkollave shqipe kudo që u hapën. Në këtë luftë përputheshin interesat e autoriteteve osmane me ato të kishës e të agjenturës së shovinizmit grek.

Qeveritarët osmanë morën një varg masash. Gjithë ata që kujdeseshin dhe ndihmonin shkollat shqipe u akuzuan si «revolucionarë të rrezikshëm». Vetë Valiu i Manastirit dhe shefi i policisë së vilajetit erdhën disa herë personalisht në Korçë për të parë gjendjen në vend dhe për të marrë masat e duhura.

Një qëndrim të tillë antishqiptar mbajti dhespoti i Korçës, Filotheos Kostantinidhis, i cili shpalli mallkimin jo vetëm kundër mësuesve e kujdestarëve të shkollës, por edhe kundër prindërve të nxënësve. Ai u ndaloi priftërinjëve të kryenin çdo funksion kishtar (pagëzime, kurorëzime, varrime) në familjet e tyre. Ai ndaloi gjithashtu varrimin e patriotëve shqiptarë në vorrezat ortodokse²⁾.

«Më luftojnë aqë sa nuk bënet më tepër — u shkruante Thimi Markoja nga Korça shqiptarëve të Bukureshtit në mars 1887 — por kam miq të shëndoshë, të cilët më

1) V. Dodani, vep. e cituar, fq. 45: letër e J. Vretos dërguar nga Stambolli V. Dodanit në Bukuresht më 8 mars 1887.

2) HHStAPAA: «Vrejtje mbi shkollën shqipe në Korçë» dërguar nga Orhan Pojani e Thanas Sina Konsullatës austro-hungareze në Manastir, më 1899.

ruajnë si dritën e syrit tyre, edhe nuk trembem kurrë se do të pësonj gjëkafshë...»¹⁾

Pastaj u përhap shpifja se me anën e shkollave shqipe «të krishterët do të bëheshin myslimanë dhe tirania osmane do të forcohej përgjithmonë»²⁾.

Përveç presioneve që u bënë me anën e ideologjisë dhe të institucioneve fetare, armiqtë e lëvizjes kombëtare shqiptare u përpoqën ta paraqesin shkollën shqipe si të padobishme për ata që e ndiqnin, si një shkollë që gjoja nuk kishte mundësi të përgatiste për jetën, se nxënësit e saj «nuk mund të bëheshin as priftërinj apo hoxhallarë», dhe «as nëpunës apo oficerë të osmanliut». Në të vërtetë ajo që i shqetësonte armiqtë e popullit shqiptar ishte jo «mospërgatitja» për jetën, por fakti se nga bankat e shkollave shqipe do të dilnin në radhë të parë luftëtarë të çështjes kombëtare, mbrojtës të atdheut të robëruar, do të dilnin patriotë shqiptarë që do të kuptonin më mirë dhe do t'i luftonin më me vendosmëri ndërhyrjet dhe intrigat e armiqtve dhe që do t'u kundërviheshin hoxhallarëve, priftërinjve, nëpunësve e zabitëve, të cilët punonin së bashku për ta mbajtur nën zgjedhë vendin tonë.

Lufta zhvillohej e ashpër jo vetëm në Korçë po kudo ku u hapën shkolla shqipe si në Pogradec, Ersekë etj. dhe kudo ku u përhap mësimi në gjuhën shqipe.

Një gjendje mjaft e acaruar u krijua në Pogradec, ku masat popullore, të egërsuara nga gjithë ato që po bëheshin mbi kurrizin e tyre, u ngritën ta vrisnin dhespotin

1) V. Dodani, Vep. e cituar, fq. 39.

2) Në kujtimet e Mina Gramenos, vëllait të Mihal Gramenos, thuhet: «Me t'u hapur kjo shkollë (shkolla shqipe e Korçës e vitit 1887), dhespoti dhe të gjithë priftërinjtë mbanin llogo në kishë, duke mallkuar ata që përkrahnin këtë shkollë si dhe gjuhën shqipe... Kohë pas kohe thërrisnin babanë në Mitropoli dhe i thoshin që të hiqte djemtë prej asaj shkolle të mallkuar prej besës tonë... mirëpo babaj dinte se si t'u përgjigjej atyre dhe sa rroji nuk i hoqi prej shkolle...». Në AQSH i RPSSH. Fondi i Mihal Gramenos, Dos. 1, fq. 13.

grek që kishte shkuar atje për të mallkuar ata që për-
krahnin gjuhën shqipe. Ai mundi të shpëtonte vetëm në
saje të ndërhyrjes dhe të mbrojtjes që i bënë autoritetet
osmane të vendit.

Ndjekje të rrepta u bënë gjithashtu në krahinën e
Kolonjës dhe të Vakëfeve, kundër cilitdo që mësonte vetë
ose e mbronte mësimin e shqipes dhe të literaturës pa-
triotike në gjuhën shqipe e veçanërisht kundër mësuesit
të shkollës shqipe të Ersekës, Petro Ninit. Në krye të kë-
tyre ndjekjeve qëndronte mitropoliti i Kosturit. Në për-
pjekjet e tij antishqiptare ai bashkëpunoi edhe me feu-
dalë shqiptarë.

Më 1887 mitropoliti i Kosturit, gjatë vizitës së tij
vjetore që bëri nëpër krahinën e Kolonjës, të cilën e kish-
te nën juridiksionin e vet kishtar, erdhi në Luaras dhe
pasi dështoi në përpjekjet për ta bindur Petro Ninin që
të qëndronte në detyrën e mëparshme si mësues i gre-
qishtes, e qortoi atë, e mallkoi përpara bashkëfshatarëve
dhe e shkishëroi¹⁾. Gjithashtu shpërndaui një qarkore në
krahinën e Kolonjës dhe të Vakëfeve, ku kishte vepruar
Petro Nini, me anën e së cilës i porosiste fshatarët që «të
mos e pranonin Petron si mësues në katundet e tyre, me
që ishte aforisuar e shkishëruar»²⁾.

Të gjitha këto jo vetëm nuk e dekurajuan dhe nuk e
larguan Petro Ninin nga rruga e nisur dhe nga qëllimi i
tij, por ia forcuan edhe më shumë kurajon dhe dëshirën
për ta vazhduar veprën e filluar.

Ndjekje u bënë edhe kundër priftit shqiptar të ka-
tundit Luaras, Papa Stefanit³⁾, i cili, duke shkelur urdhë-
rat e eprorit të tij, nuk e kishte përjashtuar Petro Ninin

1) P. N. Luarasi, «Mallkimi i shkronjave shqipe». Në Vep.
e cituar, fq. 230.

2) Po aty.

3) Papa Stefani ishte i ati i Kristo Luarasit — mësuesit të
shqipes në Luaras dhe më vonë krijuesit të shtypshkronjës «Mbro-
thësia» në Sofje, në të cilën u botuan libra e organe shtypi të
rëndësishme.

nga meshimet e kishës së fshatit dhe nuk kishte luftuar kundër përhapjes së mësimit shqip, por, përkundrazi, ai vetë u mësonte shqip të bijve, megjithëse ishte këshilluar shumë herë edhe me letra të dërguara nga Kosturi.

Për këtë mitropoliti i Kosturit erdhi personalisht në Luaras, në korrik 1889, dhe duke vepruar me dinakëri u përpoq ta merrte me vete në Kostur priftin e përmendur për ta ndëshkuar sipas dëshirës. Papa Stefani në fillim u nis dhe arriti gjer në Dardhë por, pasi kuptoi qëllimet e mitropolitit dhe duke patur mbrojtjen e bashkëfshatarëve të tij dhe të Petro Ninit, nuk e ndoqi më tej eprorin, por u kthye në Luaras¹⁾. Si rezultat Papa Stefanit iu hoq e drejta e meshimit në kishë dhe u pushua nga puna.

Në shtator të po atij viti mitropoliti Grigor u drejton-te nga Dardha një letër banorëve të Luarasit, me anën e së cilës i porosiste të mos e pranonin Papa Stefanin në shtëpitë e tyre as si prift e as si vizitor, sepse ishte i çvetmuar (i aforisur)²⁾. Në të njëjtën kohë mitropoliti i shkruante kajmekamit të Kolonjës. Dilaver beut: «që ta kapte Papa Stefanin... me suvari (kalorës)... dhe ta dërgonte në Mitropoli të Korçës»³⁾.

Por fshatarët e Luarasit u ngritën në mbrojtje të Papa Stefanit dhe nuk ua vunë veshin urdhërave e porosive që u dërgonte mitropoliti grek i Kosturit.

Mitropoliti grek i Kosturit, duke vazhduar veprimtarinë antishqiptare arriti nga ana tjetër të siguronte përkrahjen e feudalit të fuqishëm të krahinës, Dajlan bej Qafëzezit, të cilit i lidhi një «rrogë» të veçantë. Njerëzit e Dajlan beut duhej të vrisnin gjithë ata shqiptarë që punonin për përhapjen e shkrimit të gjuhës shqipe⁴⁾.

Ndjekje të forta iu bënë Petro Ninit, i cili edhe pas mbylljes së shkollës së Ersekës e vazhdoi aktivitetin në forma ilegale.

1) P. N. Luarasi, Vep. e cituar, fq. 216.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty, fq. 36.

E gjithë kjo luftë e ashpër, të gjitha këto masa e mjetet të përdorura ndikuan negativisht në zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar. Efektet negative filluan të ndjehen si në Korçë ashtu edhe në vise të tjera. Numri i shkollave shqipe nuk mundi të shtohet më tej, bile një pjesë e atyre që u çelën e patën jetën të shkurtër. Shkollat e Pogradecit dhe të Ersekës u mbyllën. Numri i nxënësve të shkollës shqipe të Korçës filloi të pakësohet. Megjithatë kjo e fundit e vazhdoi veprimtarinë. Drejtori i saj së bashku me ndihmësin, Thanas Sinën, të ndihmuar edhe nga «Shoqëria e Mësimi Shqip», po u qëndronin me vendosmëri këtyre dallgëve të furishme dhe po punonin me durim për të ruajtur kontingjentin e nxënësve dhe për të përballuar edhe vështirësitë ekonomike të shkollës. Megjithë kushtet e vështira, viti i parë shkollor u mbyll në një mënyrë ceremoniale. Provimet e nxënësve u kthyen në një manifestim shkollor e kombëtar njëkohësisht.

Por tani që shkolla e Korçës kishte mbetur e vetme, presioni e ndjekjet kundër saj u shtuan edhe më tepër. Armiqtë e saj synonin ta mbyllnin atë, duke menduar se kështu do të shuhej lëvizja shqiptare që kishte marrë zjarr. Intrigat e vazhdueshme të Mitropolisë së Korçës dhe të Patrikanës së Stambollit e shtrënguan Pandeli Sotirin të largohej nga Korça, pa e mbyllur vitin e dytë shkollor¹⁾, dhe të shkonte në Stamboll. Kisha ortodokse, për të luftuar drejtorin e parë të shkollës shqipe, Pandeli Sotirin, kishte arritur me mënyrat e saj dinake të bënte për vete edhe të shoqen e tij, që ishte greke nga lagja Fanar e Stambollit. Ajo u përdor si për largimin e shpejtë nga Korça ashtu edhe për përgatitjen e vdekjes «aksidentale» të Pandeli Sotirit në Stamboll, rreth vitit 1891²⁾. Vdekja e parakohshme e Pandeli Sotirit, e përgatitur nga armiqtë e kombit shqiptar, e vuri emrin e tij në radhën e dëshmorëve të arsimit shqiptar dhe të luftës për çlirimin

1) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 166.

2) N. Naçi, Artikull i cituar; «Albania» e Brukselit, viti I shtesë Nr. 8, viti 1897, fq. 143.

kombëtar. Ajo shkaktoi hidhërim në zemrat e të gjithë shqiptarëve por jo dëshpërim dhe dekurajim.

Ishte parashikuar që me vrasjen e Pandeli Sotirit të zhdukej leja e dhënë nga qeveria otomane në emërin e tij dhe kështu shkollës shqipe të Korçës të mos i mbetej gjë tjetër veçse të mbyllej. Këto që ndodhën ishin një goditje për shkollën shqipe të Korçës. Por planet e armiqve nuk u realizuan.

Shkolla shqipe, ndonëse në kushte të vështira, e vazhdoi veprimtarinë e saj. Viti i ri shkollor 1888-1889 filloi duke patur si drejtor Thanas Sinën nga Postenani i Leskovikut, me ndihmës Koço Sotirin, të vëllanë e Pandeli Sotirit dhe Thoma Avramin.¹⁾

Ndjekjet nga ana e autoriteteve lokale osmane dhe e Mitropolisë ortodokse të Korçës u bënë tani edhe më të forta, sepse dihej se leja e shkollës që i ishte dhënë Pandeli Sotirit ishte zhdukur me vrasjen e tij,

Në fund të vitit shkollor 1888-1889, i ndodhur përballë presioneve të vazhdueshme dhe duke mos pasur lejen e nevojshme për mbajtjen e shkollës, u detyrua të largohet edhe Thanas Sina nga detyra e drejtorit të shkollës, ndonëse vazhdoi t'i shërbejë shkollës shqipe e çështjes kombëtare. Edhe Koço Sotiri nuk mundi të vazhdonte më tej detyrën si mësues i kësaj shkolle.

Mungesa e kuadrit mësimor ishte tani një problem



Thanas Sina

1) I. M. Qafëzezi, vep. e cituar, fq. 149; «Arësimi Popullor» 1957, Nr. 6, fq. 58.



Thoma Avrami

tjetër që duhej përballuar. Megjithë rrethanat e vështira, mësuesi trim dhe patriot Petro Nini Luarasi pranoi ftesën që i bënë kujdestarët e shkollës dhe mori drejtimin e shkollës pa patur lejen e duhur. Në këtë mënyrë u arrit që viti i ri shkollor 1889-1890 të fillonte rregullisht. Si ndihmës Petro Nini pati mësuesin Thoma Avrami dhe shërbyesin e shkollës Kristo Karagjozin nga Vodica e qarkut të Korçës¹⁾.

Për këtë vit shkollor Kristo Karagjozi, që njihet edhe me

emrin Kristo Vodica, dha edhe mësim në klasën e parë. Ky u shqua si mbrojtës e agjitor i shkollës. Krahas punës në shkollë, ai bënte një punë të rëndësishme propagandistike jashtë shkollës, në familjet korçare, për të ruajtur dhe shtuar kontigjentin e nxënësve. Kristo Vodica i shërbeu me besnikëri deri në fund shkollës shqipe të Korçës²⁾.

Armiqtë, duke ditur se Petro Nini Luarasi nuk kishte lejen e nevojshme, i shtuan ndjekjet kundër shkollës.

1) I. M. Qafëzezi, vep. e cituar, fq. 149.

2) Thuhet se në kohën që ishte Petro Nini drejtor i shkollës, aty shërbente si kujdestare edhe një plakë e quajtur Nonkë. Kjo kujdesej më tepër për një konvikt të vogël prej 3-4 vetësh, që kishte shkolla. Shih për këtë I. M. Qafëzezi, «Dhaskal Gjoka» fq. 148 si dhe G. Sevo: «P. N. Luarasi», fq. 41.

Si pasojë e këtyre ndjekjeve shumë prindër u shtrënguan t'i largojnë fëmijët e tyre nga shkolla shqipe.

Për shkak të qëndrimit armiqësor të autoriteteve osmane, po largoheshin nga shkolla jo vetëm fëmijët e familjeve ortodokse, por edhe të atyre myslimane. Ndërsa dy vitet e para shkolla kishte pasur më shumë se 30 nxënës myslimanë, tani numri i tyre ishte pakësuar shumë, bile edhe ata që mbetën frekuentonin vetëm ditët e premtë, kur shkollat turke ishin të mbyllura¹⁾. Numri i përgjithshëm i nxënësve kishte zbritur në rreth 40-45²⁾, ndër të cilët myslimanë ishin më pak se 10. Shkolla po vuante tani edhe nga ana ekonomike. Burimet financiare ishin pakësuar. Shumë familje korçare, nën presionin politik e fetar të ushtruar nga autoritetet osmane e nga kisha ortodokse, jo vetëm kishin tërhequr fëmijët nga shkolla shqipe, por kishin prerë edhe ndihmat që jepnin më parë.

Autoritetet lokale osmane, sado që i njihnin mbrojtësit dhe kujdestarët e shkollës shqipe, nuk kishin fakte për të vepruar kundër tyre. Megjithatë, ato përpiqeshin të gjenin pretekste të ndryshme për t'i dënuar ata në mënyrë të tillë që të bëheshin shembull për gjithë qytetin. Duke përfituar nga mungesa e lejes, qeveritari i Korçës bëri paralajmërimin, sipas të cilit vitin e ardhshëm «ishte urdhër i lartë që të mos njihej asgjëkund mësorjëtore shqipe pa leje të Guvernës (qeverisë)»³⁾.

Shkolla ishte në rrezik të mbylles. Patriotët korçarë dhe veçanërisht Thimi Markoja, Orhan Pojani dhe Jovan Kosturi bënë të gjitha përpjekjet për të nxjerrë shkollën nga kjo situatë e vështirë. Problem shqetësues ishte bërë edhe mungesa e lejes për shkollën dhe e diplomës së Petro Ninit.

1) I. M. Qafëzezi. vep. e cituar, fq. 149.

2) N. Naçi, Artikulli i cituar, fq. 169. Burime të tjera japin shifra të ndryshme. Kështu në materialet dokumentare të Arkivit të Vjenës përmenden 50-60 nxënës.

3) Petro N. Luarasi, Vep. e cituar, fq. 216.

Pasi u këshillua me patriotë korçarë, Petro Nini vajti në Stamboll dhe u takua me Naim Frashërin, për të marrë mendimin dhe ndihmën e tij në zgjidhjen e këtij problemi. Më në fund iu shtrua një provimi në Manastir, në zyrën e arsimit të vilajetit, ku mori një vërtetim dhe lejen, duke u bazuar në atë të Pandeli Sotirit, me anën e të cilave mund të mbante çelur një shkollë fillore private në Korçë. Duke mos guxuar të arrinte deri në mbylljen e kësaj shkolle, valiu i Manastirit e porosiste me këtë rast mytesarifin (prefektin) e Korçës: «Kjo shkollë u çel si u çel, lereni. . . shikoni vetëm që të mos çelen të tjera»¹⁾.

Një luftë e ashpër këmbëngulëse u bë kundër «Shoqërisë së Mësimi Shqip», që ishte mbështetja kryesore e shkollës shqipe të Korçës. Presione të shumta e në forma të ndryshme iu bënë veçanërisht kryetarit të kësaj shoqërie, Alo Dishnicës.

Vetë Valiu i Manastirit shkoi dy herë në Korçë për ta parë gjendjen në vend dhe Alo Dishnica u thirr në Manastir në fund të vitit 1889, ku u mbajt për disa muaj me qëndrim të detyrueshëm. Autoritetet osmane nxiteshin në këtë drejtim edhe nga Mitropolia greke, me shtytjen e së cilës ishin bërë disa «ankesa» në emër të popullsisë së Korçës». «Ankesa» të tilla false iu dërguan gjithashtu Stambollit gjoja në emër të shqiptarëve të Bukureshtit dhe të Egjiptit²⁾. Por të gjitha «ankesat» ishin të sajuara nga agjentura shoviniste dhe nuk i përgjigjeshin së vërtetës. Për ta hetuar çështjen kishte shkuar në Korçë edhe shefi i policisë së vilajetit të Manastirit, por pa asnjë rezultat, sepse çdo gjë ishte e pabazuar. Hetimet s'kishin bërë gjë tjetër veçse kishin demaskuar edhe më tepër palën kundërshtare.

Çështja e Alo Dishnicës nuk ishte aspak një çështje personale; lufta kundër tij drejtohej në të vërtetë kundër

1) N. Naçi, artikull i cituar, fq. 169.

2) HHStAPAA: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 4, dt. 31 janar 1890.

shkollës shqipe, kundër Shoqërisë që ai drejtonte dhe në përgjithësi kundër lëvizjes kombëtare shqiptare, prandaj ai u mbrojt me vendosmëri si me anë të kërkesash të aprovuara në masë nga popullsia e Korçës, ashtu edhe nga patriotët shqiptarë dhe nga shtypi i Rilindjes.

Gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit shkruante në atë kohë në mbrojtje të shkollës: «Dhespoti ortodoks bëri të



Shkolla e parë shqipe e Korçës
(fotografi e vitit 1899)

gjitha të paudhat, me mallkime dhe manovra të tjera të quajtura fetare, për ta prishur atë (shkollën shqipe), por nuk ia arriti, sepse në mbrojtje të saj morën pjesë edhe myslimanët.

Gazetat greke thërrasin kundër Patrikanës, pse nuk bën intriga në Stamboll dhe pse nuk dërgon një dhespot

(shejtan) më të keq në Korçë, ku u ndez zjarri shqiptar... por të gjitha këto mundime u vanë kot»¹⁾).

Autoritetet osmane, të ndodhura përballë vrullit në rritje të lëvizjes shqiptare, u detyruan të tërhiqen. Pas disa muajsh qëndrimi të detyruar në Manastir, Alo Dishnica, në mars 1890, u lejua të kthehet i lirë në Korçë. Ai vazhdoi të qëndrojë në krye të «Shoqërisë së Mësimit Shqip». Për të qetësuar situatën e ndezur ndërhyri vetë Porta e Lartë, e cila tërhoqi nga Korça mytesarrifin e deriatëhershëm. Ky ishte një sukses për lëvizjen shqiptare dhe në të njëjtën kohë një disfatë për politikën shoviniste greke dhe përkrahësit e asaj grekomanë.

Lëvizja shqiptare kishte kaluar kështu një provë të rëndë. Shkolla shqipe e Korçës dhe «Shoqëria e Mësimit Shqip» e vazhdonin jetën e tyre. Bile në zjarrin e kësaj lufte u bënë përpjekje për ta zgjeruar numrin e shkollave shqipe. Me iniciativën e njërit prej anëtarëve të «Shoqërisë së Mësimit Shqip», u hap rishtas në Ersekë, në pranverë 1890, një shkollë shqipe për myslimanë e të krishterë. Por kjo nuk e pati jetën e gjatë, sepse qeveria otomane e mbylli atë²⁾.

Kështu shkolla e Korçës mbeti e vetme edhe për vitin shkollor 1890-1891. Drejtor i saj ishte përsëri Petro Nini Luarasi.

Pas atyre që kishin ndodhur gjatë këtij viti, nga ana e autoriteteve osmane nuk u muar ndonjë masë konkrete. Megjithatë pyetjet s'pushonin: kush e mban këtë shkollë? kush jep ndihma? etj. Numri i nxënësve ishte mjaft i kufizuar. Sasia e të ardhurave të shkollës kishte rënë. Sipas shprehjes së Nuçi Naçit ajo vuante në këtë kohë «posi një kandil që ka pakë vaj»³⁾. Ndërsa në vitin e parë shkollor ajo kishte patur 195 lira turke të ardhura dhe po aq

1) Gazeta «Shqipëtari» e Bukureshtit, viti II, Nr. 28 dt. 28 janar 1890, fq. 3.

2) HHStAPAA, informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit Nr. 6, datë 21 qershor 1890.

3) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 168.

shpenzime, në vitin shkollor 1890-1891 të ardhurat kishin zbritur në 68 lira, shumë tepër e vogël për të përballuar mbajtjen e personelit dhe nevojat e tjera të shkollës. Nxënësve librat u jepeshin gjithnjë pa të holla dhe të varfërve u jepeshin edhe fletore shkrimi, pena, lapsa e ndonjë herë këpucë ose opinga¹⁾. Tani edhe «Shoqëria e Mësimit Shqip» kish filluar të dobësohej. Si rezultat i ndjekjeve ishte pakësuar numri i anëtarëve të saj.

Mbasi përfunduan provimet e vitit 1891, u pa e nevojshme që Petro Nini Luarasi të ndërmernte një udhëtim për në Stamboll, Bullgari dhe Rumani, për të siguruar ndonjë ndihmë financiare nga shqiptarët e atjeshëm.

1) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 163-169.

VI

ÇELJA E SHKOLLËS SË PARË SHQIPE PËR VAJZA NË KORÇË

Krahas përpjekjeve që bëheshin nga patriotët shqiptarë për mbrojtjen e shkollës shqipe të Korçës dhe për shtimin e shkollave të tilla në vise të tjera, kishin filluar edhe përgatitjet për çeljen e një shkolle shqipe për vajza. Shkollimi dhe emancipimi i femrës shqiptare ishte një detyrë e vështirë por e rëndësishme. E vështirë sepse vinte në kundërshtim me gjithë botëkuptimin feudal sundues osman, me ideologjinë fetare në përgjithësi dhe me atë islamen në veçanti, që e paraqitnin femrën si inferiore ndaj mashkullit, si të destinuar për punët e shtëpisë dhe për të lindur e rritur fëmijë, si të paaftë për punë të tjera shoqërore e aq më tepër për punë diturie. E vështirë ishte lufta që duhej bërë kundër fanatizmit të kultivuar ndër shqiptarët nga sundimi i gjatë osman, nga feja e institucionet fetare dhe nga gjithë sistemi feudal e mbeburinat e theksuara patriarkale që vazhdonin prej shekujsh të tërë në Shqipëri. Me një fjalë duhej ngritur kundër regjimit sundues, duhej përmbysur një sistem i tërë conceptesh të vjetra e të dëmshme, që vazhdonin ta mbanin të ndrydhur e të paditur femrën shqiptare.

Prapambetja e madhe që karakterizonte vendin tonë në atë kohë «rëndonte më shumë te gratë, të cilat... i nënshtroheshin një shtypjeje e skllavërimi të shumëfishtë

nga klasat shfrytëzuese e të huajt dhe nga zakonet prapanike të kanuneve, të kishës e të sheriatit»¹⁾.

Megjithë prapambetjen dhe kushtet shtypëse «gruaja shqiptare... ka thënë shoku Enver Hoxha — ka qenë një faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik-shoqëror, pra një faktor përparimtar, me ndjenja të theksuara liri-dashëse, patriotike»²⁾.

Kushtet e reja ekonomike, shoqërore e politike shtruan nevojën e përhapjes edhe në gratë të shkrimit e të këndimit, të arsimit «si arma e parë që do t'i hapte femrës shqiptare rrugën e kulturës dhe të shkencës»³⁾.

Kjo ishte një detyrë e rëndësishme shoqërore dhe politike që pa vonesë duhej të hynte në rrugën e zgjidhjes. Duhej të pajiseshin me dituri dhe kulturë vajzat shqiptare, nënat e ardhshme, të cilat në këtë mënyrë jo vetëm do të bëheshin luftëtare të çështjeve shoqërore e politike që preokuponin popullin e shumëvujtur shqiptar, por do të ishin të afta të rritnin dhe të edukonin një brez të tërë të ri me idealet e reja, me idealet e luftës për liri dhe pavarësi kombëtare.

«Asnjë lëvizje çlirimtare e rëndësishme — ka thënë J. V. Stalini — nuk është bërë pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të grave»⁴⁾.

Shprehës të kësaj nevoje dhe luftëtarë për plotësimin e saj, për aq sa e lejonin kushtet e atëhershme historike, u bënë rilindësit shqiptarë, ndër të cilët u dalluan Sami Frashëri, Naim Frashëri, Gjerasim Qiriazhi etj. Ata, duke e kuptuar këtë detyrë të kohës, u bënë përkrahës të edukimit të femrës shqiptare, të ngritjes së rolit të saj

1) E. Hoxha, «Raport në Kongresin IV të Frontit». Në «Raporte e Fjalime» 1967-1968, fq. 195.

2) E. Hoxha, «Mbi disa aspekte të problemit të gruas shqiptare». Në «Raporte e Fjalime» 1967-1968, fq. 144.

3) E. Hoxha, «Fjala në takimin me një grup grash të dalluara të vendit tonë me rastin e 50 vjetorit të Ditës Ndërkombëtare të gruas», 9 mars 1960. Veprat, vëll. 18, fq. 110.

4) J. V. Stalin, Veprat, vëll. V, fq. 57.

në jetën shoqërore e politike të vendit. «Gratë — shkruante Sami Frashëri — janë gjysma e njerëzimit dhe prandaj një komb quhet i përparuar kur krah për krah me burrat ecën edhe gjysma tjetër, gratë»¹).

Rilindësit i vlerësuan drejt aftësitë e grave të cilat, siç shpreheshin ata, «përsa i përket mendjes, mprehtësisë dhe zgjuarësisë nuk mbeten më mbrapa nga burrat»²). Ata luftuan kundër koncepteve prapanike e reaksionare, sipas të cilave «arsimi dhe të mësuarit i dëmtojnë gratë». Rëndësi të veçantë rilindësit i jepnin ngritjes së rolit të gruas si edukatore, sepse, siç shprehej Samiu, gruaja «bashkë me dashurinë i jep fëmijës edhe edukatën, arsimin dhe kulturën»³). Poeti Naim Frashëri, jo vetëm i këndoi gruas shqiptare, por edhe kërkoi që të njiheshin të drejtat e saj. «Si mund të vejë mbroth një komb — shkruante ai — kur gratë... rrinë mbyllurë si në kuvli? Gruaja duhet të jetë e mësuar më shumë se burri. Gruaja është mëm' e fëmijës, zonj' e shtëpisë dhe kregj i njerëzisë»⁴).

Pikëpamjet e rilindësve për edukimin e vajzës shqiptare drejtoheshin kundër botës së vjetër feudale dhe botëkuptimit të saj konservator e reaksionar, ato ishin përparimtare për kohën dhe luajtën një rol progresiv në zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Megjithatë ato, duke qëndruar brenda kufijve të demokracisë borgjeze, kishin edhe kufizimet e tyre. Si iluministë që ishin, rilindësit në përgjithësi e mbivlerësonin rolin e diturisë dhe të arsimit, të cilat i konsideronin si faktorin kryesor në zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Sipas tyre «në botë shkaku kryesor i të gjitha të këqijave dhe gabimeve është padituria»⁵). Për rilindësit edhe përparimi i gruas dhe emancipimi i

1) Sh. Çollaku, «Gratë — gjysma e njerëzimit». Libri «Gratë» i Sami Frashërit. Në «Nëntori» 1972, Nr. 2, fq. 34-35.

2) Po aty, fq. 39-40.

3) Po aty, fq. 41.

4) N. Frashëri, «Mësime», fq. 14.

5) «Nëntori» 1972, Nr. 2, fq. 39: «Fragmente nga libri «Gratë» i Sami Frashërit.

saj do të bëhej me anën e përhapjes së arsimit e të kulturës.

Në të vërtetë faktorë të tjerë politikë dhe ekonomikë janë ata që përcaktojnë emancipimin e plotë të gruas. Siç na mëson marksizmi, emancipimi i gruas mund të bëhet vetëm me përmbysjen e sistemit borgjez, me çlirimin e saj nga shfrytëzimi kapitalist dhe me pjesëmarrjen masive të grave në prodhim, në drejtimin e ekonomisë dhe të shtetit, në marrjen e arsimit e të kulturës.

Megjithatë, ashtu si e kuptonin dhe me atdhedashurinë që i karakterizonte, rilindësit iu vunë punës për arsimimin e vajzave shqiptare.

Siç është përmendur, shkolla e parë shqipe e Korçës ishte një shkollë e përbashkët, për djem dhe për vajza, por numri i këtyre të fundit ishte mjaft i kufizuar. Për opinionin shoqëror të asaj kohe, veçanërisht në Shqipërinë e atëhershme të prapambetur, ishte punë e vështirë që vajza të dërgohej në shkollë e aq më tepër në një shkollë së bashku me djem. Numri i vajzave në shkollën shqipe ekzistuese mund të mbetej i kufizuar për një kohë të gjatë. Prandaj edhe rilindësit tanë, në përputhje me situatën e atëhershme, menduan që të krijonin kushte më të përshtatshme dhe konkretisht iu vunë punës për të përgatitur çeljen e një shkolle shqipe të veçantë për vajza.

Një kontribut të çmuar në këto përgatitje dha familja e Qiriazëve dhe veçanërisht vëlla e motër Gjerasim e Sevasti Qiriazzi. Familja e Qiriazëve ishte shpërngulur nga katundi Peras i Kolonjës dhe ishte vendosur në fillim në katundin Tërnovë, në afërsi të qytetit të Manastirit dhe pastaj brenda në këtë qytet të rëndësishëm, që ishte dhe qendër e vilajetit me të njëjtin emër¹⁾.

1) I ati i Gjerasimit dhe Sevastisë, Dhimitër Qiriazzi, merrej me tregtinë e dërrasave në Manastir. Dhimitri ishte martuar me një vajzë shqiptare, me Marien, familja e së cilës gjithashtu ishte shpërngulur nga katundi Vodicë. Nga kjo martesë lindën dhjetë fëmijë, shtatë djem dhe tri vajza. Djemtë dhe vajzat e Dhimitrit

Shtëpia e Qiriazëve, e ndodhur në qendrën e një vilajeti të madh, si dhe në rrugën e rëndësishme që lidhte Shqipërinë me Stambollin dhe vendet e tjera, u bë edhe një vatër e rëndësishme kombëtare që priste e përcillte patriotët e shquar shqiptarë të Rilindjes si Kostandin Kristoforidhin, Koto Hoxhin, Pandeli Sotirin, Petro Luarasin, Orhan Pojanin, Nuçi Naçin etj.

Vetë Dhimitër Qiriazit u interesua që të futej gjuha shqipe në shkollat greke dhe në kishë. Për këto «shkelje» të normave që po bënte, Dhimitri u bë armik i Mitropolisë dhe i Dhimogjerondisë. Puna arriti deri aty, sa Dhimitri të nxirrej nga kisha dhe të mallkohej prej saj.

Këto ngjarje e bënë edhe më të qartë për Dhimitrin se me çfarë armiqsh kishte të bënte populli shqiptar dhe ai e vazhdoi më me ngulm punën për edukimin sa më të mirë të fëmijëve të tij. Të rritur në këtë ambient dhe të edukuar me dashurinë për atdheun, fëmijët e Qiriazëve, sadoqë për shkak të rrethanave vazhduan shkolla të huaja në gjuhët greke dhe angleze, kur mbaruan iu kush-tuan me të tëra forcat luftës për përhapjen e shkrimit dhe të shkollës në gjuhën shqipe.

Të parët që u dalluan në këtë fushë nga fëmijët e Qiriazëve qenë Gjerasimi dhe Sevastia¹⁾.

dhe Maria Qiriazit quheshin: Tashko, Kostandin, Gjerasim, Gjergj, Naum, Kristo, Pandeli, Fanka, Sevasti dhe Parashqevi. Kjo familje, sadoqë jetonte në një qytet me popullsi heterogjene nga pikëpamja e kombësisë, i ruajti traditat shqiptare dhe i edukoi fëmijët me frymën e dashurisë për gjuhën amtare dhe për atdheun. Dhimitër Qiriazit, megjithëse i preokupuar për të përballuar jetesën, e megjithëse vetë kishte fare pak shkollë, i kushtoi një kujdes të veçantë edukimit dhe arsimimit të bijve dhe bijave të tij. Ai kishte grumbulluar mjaft libra dhe ngjarjet e rëndësishme dhe interesante që lexonte në to ua tregonte edhe fëmijëve gjatë mbrëmjeve.

1) Gjerasim Qiriazit, lindur në vjeshtë të vitit 1861, ndoqi mësimet në një shkollë të Manastirit dhe arriti të përfundonte me

Pasi mbaroi studimet e larta Gjerasim Qiriazhi u kthye në atdhe dhe në fillim bëri një udhëtim nëpër Shqipëri që nga Manastiri gjer në Shkodër. Gjatë udhëtimit ai u njoh nga afër me gjendjen e mjeruar të Shqipërisë menjëherë pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit dhe me nevojën e ngutshme që kishte atdheu për të shpërndarë errësirën e paditurisë dhe për të zhvilluar arsimin e kulturën kombëtare. Ndërkohë Qendra e Shoqërisë Biblike Britanike në Stamboll, e cila gjer atëhere kishte pasur në shërbim të saj K. Kristoforidhin, e ftoi Gjerasimin të bëhej përfaqësues i saj për degën e Maqedonisë dhe të Shqipërisë¹).

Duke parë kushtet e vështira politike, me qëllim që të kishte më tepër mundësi veprimi, Gjerasimi e pranoi vendin që iu propozua si përfaqësues i Shoqërisë Biblike me qendër në Manastir. Ashtu si vepruan edhe përfaqësues të tjerë të kombësive të shtypura të Perandorisë Osmane si bullgarë, armenë²) etj. edhe Gjerasim Qiriazhi

shumë sukses gjimnazin. Pasi mbaroi shkollën e mesme vazhdoi jashtë vendit studimet e larta, të cilat i përfundoi më 1882. Duke marrë parasysh suksesin që kishte patur në mësim dhe aftësitë e tij, drejtorja e shkollës ku studioi i ofroi atij një katedër. Por flaka e patriotizmit që i kishte rrëmbyer zemrën nuk e lejoi të qëndronte larg atdheut. Ai u përgjegj duke thënë se detyra e tij ishte t'i shërbente vendit ku kishte lindur.

1) Shoqëria Biblike për Anglinë dhe për vendet e huaja (British and Foreign Bible Society) u themelua në Londër në vitin 1804. Ajo ishte një kundërveprim ndaj ideve të revolucionit frëng dhe nëpërmjet përkthimeve fetare do të bëhej pararojë e depërtimit anglez në vendet e ndryshme të botës. Shumë shpejt ajo u interesua edhe për Shqipërinë dhe agjentët e saj kanë mbledhur të dhëna të ndryshme për të hetuar më parë vendin. Gjerasim Qiriazhi, ndonëse u lidh me shoqëritë protestane që vepronin në Ballkan, ka patur qëllime krejt të kundërta me to. Pikësynimi i tij kryesor ka qenë përhapja e arsimit shqip dhe çlirimi i atdheut nga robëria e huaj.

2) Gazeta «Drita» e Sofjes, Viti III, Nr. 49. datë 13 gusht 1904, fq. 1.

e shfrytëzoi këtë rast. Duke i shërbyer një shoqërie që ishte lejuar të vepronte brenda Perandorisë osmane, ai iu kushtua në radhë të parë çështjes kombëtare dhe nisi qysh i ri të punojë për përhapjen e mësimit të shqipës. Krahas detyrës zyrtare, predikimit shqip të ungjillit, ai zhvillonte



Gjerasim Qiriazi

propagandën kombëtare dhe mbillte në zemrat e shqiptarëve dashurinë për gjuhën amtare dhe për atdheun e robëruar. Së bashku me librat fetare të përkthyer në gjuhën shqipe nga Kristoforidhi, shpërndante edhe veprat patriotike ose didaktike të rilindësve tanë. Ai vetë përktheu copa letrare apo shkroi tekste shkollore, pjesë origjinale e poezi me përmbajtje patriotike, që shërbenin për edukimin patriotik të brezit të ri.

Nga Manastiri ai hyri në korrespondencë me patriotët e shquar të kohës, me Sami Frashërin në Stamboll, me Nikolla Na-

çon në Bukuresht, me Jeronim De Radën në Itali, me Thimi Mitkon në Egjipt e me shumë të tjerë si edhe me albanologë të huaj. Njëkohësisht ai mbajti lidhje dhe bashkëpunoi në Shqipëri me Koto Hoxhin, Petro Luarasin, Nuçi Naçin dhe Orhan Pojanin.

Një kujdes të veçantë Gjerasimi i kushtoi edukimit dhe arsimimit të së motrës, Sevastisë, që ishte rreth 10 vjet më e vogël se ai. Ky kujdes lidhej edhe me ëndrrën e tij për t'iu kushtuar edhe ajo një ditë punës arsimore

për ndriçimin e femrës shqiptare. Qysh në moshë të vogël Sevastia u dërgua në shkollë¹⁾.

Gjerasimi u kujdes për mbarëvajtjen e Sevastisë në mësim. Gjithashtu, rreth vitit 1885 i mësoi të shkruajë e të lexojë mirë gjuhën shqipe dhe i fliste mbi vlerën e madhe që kishte për një popull zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare.

Më 1888 Sevastia mbaroi shkollën plotore në Manastir dhe po atë vit u dërgua në një shkollë të lartë në Stamboll. Në këtë mënyrë përgatitjet për çeljen e një shkolle shqipe për vajza po hynin në fazën e fundit dhe më të rëndësishmen. Nga njëra anë Gjerasimi filloi me përgatitjen e terrenit për hapjen e shkollës në Korçë dhe nga ana tjetër Sevastia, e vetëdijshme për nevojën e ngutshme të kësaj detyre, u mobilizua për ta përfunduar shkollën e lartë 4-vjeçare brenda 3 vjetëve. «...Kur u nisa për në Stamboll — shkruan Sevastia — në mendjen time e kisha të përcaktuar se çfarë do të bëjja pasi të mbaronja studimet... Kur arrita në Kolegjin e Stambollit kërkova që të hynja në vitin e dytë por m'u përgjegjën se isha tepër e re dhe shkolla që kisha mbaruar nuk ma jepte këtë të drejtë... Unë propozova që t'u nënshtrohesh provimeve përkatese duke u thënë se vëllai po më priste

1) Në kujtimet e veta Sevastia ka shkruar më vonë: «Në moshën 4-5 vjeçe më dërguan për herë të parë në shkollë. Ishte shkollë greke, se në atë kohë përdorimi i gjuhës shqipe në shkollat ishte i ndaluar nga qeveria otomane... Në shkollë nëna u takua me drejtoreshën, e cila m'u duk një grua e gjatë, e bukur dhe e afrueshme. Pas pak minutash nëna u ngrit për t'u larguar, duke më lënë atje dhe me këtë rast më porositi duke më folur shqip, që të jem e urtë dhe e bindur. Drejtoresha, kur dëgjoi gjuhën shqipe, buzëqeshi me gëzim. Kur u ktheva në shtëpi unë e pyeta nënën pse kishte buzëqeshur drejtoresha. Mësova se ajo ishte shqiptare e arsimuar në Athinë dhe, megjithëse kishte përfitur nga dituria greke, nuk kishte humbur dashurinë për vendin dhe gjuhën e vet. Ajo pati një kujdes të veçantë për mua dhe bëri që unë ta dashuroj shkollën...»

për të çelur një shkollë për vajza në Shqipëri. Ata pas një konsultimi të shkurtër pranuan kërkesën time»¹).

Provimet plotësuese Sevastia i dha me sukses dhe fitoi të drejtën për të filluar mësimet në vitin e dytë. Natyrisht kjo ia shkurtoi afatin e studimeve, por e vuri atë përpara një prove të vështirë. Sidomos në vitin e dytë, asaj iu desh të përballonte një barrë mësimore mjaft të rëndë. Megjithëkëtë, këmbëngulja për të mos u turpëruar përpara kësaj detyre të vështirë, por të kërkuar me insistim prej saj, si dhe ndihma e shoqeve të klasës, që e pritën shumë mirë, ia lehtësuan asaj kapërcimin e vështirësive, bënë që ajo jo vetëm të mbarojë vitin e dytë, por edhe të dalë me rezultate mjaft të mira.

Në vitin e tretë dhe të katërt vështirësia ishte kapërcyer plotësisht, ajo doli shumë mirë në mësimet dhe emri i saj ishte vënë në tabelën e nderit²).

Po në vjeshtën e vitit 1888 edhe Gjerasimi kishte vajtur në Korçë, ku filloi të punonte për të përgatitur çeljen e shkollës shqipe për vajza. Në Korçë ai gjeti përkrahjen dhe inkurajimin e popullsisë. Duke përdorur fjalën shqipe dhe idetë kombëtare, ai filloi të tërheqë rreth vetes një numër të madh banorësh të Korçës. Por qysh në fillim ai u ndesh me dinakëritë e shovinistëve grekë dhe në luftë me to punoi për të ndriçuar mendjet e bashkatdhe-

1) S. Qiriazi, «Lufta për emancipimin e gruas shqiptare». Kujtime të pabotuara, dorëshkrim anglisht. Tiranë, 1936, fq. 13.

2) Gjatë kohës së qëndrimit në Stamboll S. Qiriazi i lindi edhe një dëshirë, të takonte patriotin rilindës, përhapësin e mësimin të gjuhës shqipe dhe mikun e familjes së saj, Koto Hoxhin, i cili dergjej në burgun famëkeq të Jedi Kules së Stambollit. Që një vajzë të takonte një të burgosur shqiptar në Jedi Kule ishte një punë sa e çuditshme aq edhe e vështirë, por vendosmëria e Sevastisë i kapërceu të gjitha pengesat dhe një ditë studentja shqiptare, e veshur si djalë, hyri trimërisht gjer në birucën e burgut, ku ndodhej Koto Hoxhi, e përshëndeti me mallëngjim dhe dëgjoji me vëmëndje fjalët optimiste të këtij mësuesi dhe patrioti të vendosur.

tarëve të tij, ndërsa «trundryshkurve grekomanë u theu hundët me dituritë e me vetijat e nalta që kishte»¹⁾. Në Korçë ai ra në kontakt edhe me kujdestarët e shkollës së parë shqipe²⁾ dhe u ndihmua prej tyre në realizimin e veprës së ndërmarrë.

Në qershorin e vitit 1891 Gjerasim Qiriazi u nis për në Stamboll për të marrë të motrën që përfundonte mësimet. Diplomimi i kësaj vajze shqiptare ishte një gëzim jo vetëm për familjen e Qiriazëve, por edhe për gjithë patriotët shqiptarë të atjeshëm. Midis shqiptarëve të Stambollit pjesëmarrës në ceremoninë e dhënies së diplomave ndodheshin edhe rilindësit e shquar Abdyl, Naim e Sami Frashëri. Duke e përgëzuar, Naimi iu drejtua Sevastisë me këto fjalë: «Motër, ti nuk mund të bësh punë më të mirë dhe më të vlefshme për Shqipërinë e varfër se sa atë që me kohë ke vendosur të kryesh për emancipimin e grave të vendit tonë. Detyra jote fillon tani dhe, në qoftë se do të jesh besnike dhe këmbëngulëse, do të arrish të bësh shumë për vendin tënd. Arsimi është arma që zhduk errësirën. Pa dyshim do të ndeshesh në vështirësi të mëdha. Veprën tënde do ta luftojnë autoritetet osmane, Patrikana e Stambollit dhe qeveritë e shteteve të Ballkanit. Nganjëherë do të të duken pengesa të pakalueshme, por bëju trime, shqiptare e vërtetë dhe do t'i kapërcesh të gjitha»³⁾.

Pastaj Naimi i kërkoi diplomën për ta regjistruar në Ministrinë e Arsimit, ku ai punonte atëherë. Regjistrimi dhe vula e ministrisë turke të arsimit i dhanë një vleftë të veçantë diplomës së Sevastisë në sytë e autoriteteve osmane.

Me rastin e ardhjes në Stamboll, Gjerasimi i paraqiti Portës së Lartë kërkesën për të çelur në Korçë një shko-

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, viti II, Nr. 33, dt. 21 nëntor 1903, fq. 2.

2) I. M. Qafëzezi, vep. e cituar, fq. 151.

3) S. Qiriazi, vep. e cituar, fq. 21.

nonin e përhapnin shpifjet më vulgare. «Ata — shkruan Sevastia — filluan me anatemat dhe persekutimet e tyre dhe arritën deri në atë pikë sa vendosën vrasjen e vëllait tim. Por ne ishim të vendosur të vazhdonim luftën tonë¹⁾».

Kishte filluar kështu një luftë e vërtetë midis këtyre forcave kundërshtare. U fol shumë se gjoja shkolla e re synonte t'u prishte fenë ortodokse shqiptarëve, se, duke frekuentuar atë shkollë, vajzat do të bëheshin protestante, se rruga e shkollës shqipe dhe gjuha e përdorur në të ishin në kundërshtim me parimet fetare dhe me mësimet e kishës ortodokse etj. etj.

Njëkohësisht përhapën fjalë nëpër qytet se prindërit myslimanë që do të dërgonin fëmijët e tyre në këtë shkollë do të internoheshin menjëherë nga autoritetet qeveritare. Vështirësi u krijuan personelit mësimor dhe nxënëseve që e frekuentonin shkollën. Godina shkollore dhe rrugët që çonin aty ishin nën një survejim të vazhdueshëm nga policia dhe nga agjentë të fshehtë të kishës fanariote. Por të gjitha këto nuk ia arritën qëllimit final, mbylljes së shkollës.

Që të mbyllej kjo shkollë nuk ishte e lehtë, sepse ajo ishte ngritur në truallin e vet, në truallin shqiptar dhe kishte gjithë përkrahjen e bijve e bijave të këtij trualli; përveç kësaj për këtë shkollë kishte edhe një dekret perandorak.

Në të vërtetë shkolla fitoi shpejt një popullaritet të madh në popullsinë e krishterë dhe në atë myslimane.

Megjithëse Gjerasim Qiriaz, që kishte kujdesin kryesor për shkollën, ishte në shërbim të shoqërive biblike, shkolla shqipe për vajza u shndërrua në një shkollë kombëtare dhe qëndroi mbi frymën e ndarjet fetare. Ajo ishte shkollë për vajza të të tri besimeve. Në përputhje me synimet e vërteta të Qiriazëve dhe të patriotëve të tjerë shqiptarë, plani mësimor i kësaj shkolle parashikonte arsimin në gjuhën shqipe dhe në radhë të parë edukimin me ndjenjat kombëtare.

1) Po aty.

Nga ana mësimore, vëmendja kryesore gjatë vitit të parë iu kushtua mësimëve të shkrimit e të leximit në gjuhën shqipe dhe të aritmetikës. Përveç këtyre, programi përmbante edhe njohuri elementare në lëndë të tjera si në gramatikë, gjeografi, histori të përgjithshme dhe zoologji. Gjithashtu, pothuajse për ditë kishin në program edhe punë dore¹⁾.

Duke kapërcyer të gjitha pengesat e vështirësitë, shkolla vazhdoi rregullisht mësimet dhe më 21 qershor 1892 përfundoi viti i parë shkollor. Një ceremoni e gëzueshme dhe mallëngjyese u organizua me këtë rast me pjesëmarrjen e nxënësve, të prindërve e të ftuarve të tjerë. Përveç poezive që u recituan dhe dialogjeve që u luajtën nga nxënëset që kishin mbaruar vitin e parë, Sevasti Qiriazhi mbajti një fjalim të shkurtër, në të cilin trajtonte probleme të rëndësishme me karakter politik, shoqëror dhe pedagogjik. Ajo foli «për nevojën e madhe që të kemi edhe gjetkë të këtilla (shkolla) ndëpër Shqipëri». «Ne — vazhdonte ajo — kemi nevojë për shkolla të mira, që të nxjerrim mëma të ditura edhe të ndriçuara ndë mëndje edhe ndë shpirt. Kurrë s'lipset të shpërejme (shpresojmë) të shohim Kombin tonë të ndriçuar... pa pasur mëma të zonja... Po këto mëma nuk mbijnë nga dheu, as kanë për të zbritur nga qielli»²⁾.

Duke qenë e vetëdijshme për kundërshtimet dhe vështirësitë që do të ndeshnin në punën e filluar, Sevastia shprehej: «E dinim që ndë krye (që në filim), se kjo barrë, që kemi marrë përsipër, është e rëndë dhe pun' e vështirë; se do durim të madh dhe mburojë të fortë; po malli (dashuria) për kombin na bëri të mos kujtojmë asgjë nga të gjitha pengimet edhe kundërshtimet, që mund të vinë e të na lodhin ndë këtë punë...»³⁾

Periudha e pushimeve verore nuk ishte një periudhë qetësie dhe çlodhjeje për Gjerasimin e Sevastinë. Me gji-

1) Kristomathi, Sofje, 1902 vëll. I, fq. 291.

2) Po aty, fq. 291-295.

3) Po aty.

thë luftën e bërë kundër shkollës gjatë vitit të parë, ishin të gjitha shenjat se në vitin e dytë shkollor, që do të fillonte pas pak muajve, numri i nxënësve do të rritej. Në radhë të parë dilte problemi i lokalit shkollor. Dhoma e përdorur në shtëpinë e marrë me qira nga Gjerasimi ishte e papërshtatshme dhe e pamjaftueshme. Prandaj ai iu drejtua për ndihmë patriotëve shqiptarë brenda vendit dhe atyre të kolonive shqiptare të mërgimit. Me ndihmën që mundi të siguronte, Gjerasimi bleu një shtëpi në she-shin e quajtur «Çezmat e arave» (sot në qendër të Korçës). Shtëpisë iu bënë disa ndryshime, duke ua përshtatur dhomat nevojave të mësimt.

Pikërisht në verën e vitit 1892, kur po bëheshin këto përgatitje fisnike për vitin e ri shkollor, Mitropolia me dhespotin në krye mendonin se ishte rasti i përshtatshëm për zhdukjen fizike të personit kryesor që organizonte e mbante shkollën, të Gjerasim Qiriazit, dhe paguan një agjent për ta vrarë atë. Kur atentatori u zbulua, dhespoti urdhëroi që ai të largohej njëherë për njëherë. Edhe një atentat tjetër i organizuar pas nja dy muajsh nuk arriti të realizonte qëllimin.

Megjithë këto ndjekje, puna përgatitore për rifillimin e mësimave vazhdoi me sukses. Në shtator të vitit 1892 mësimet filluan në ndërtesën e re dhe me fytyra të reja.

Në këtë vit shkollor numri i nxënësve pothuajse ishte dyfishuar, ai kishte arritur mbi 50¹⁾. Si drejtoreshë dhe mësuese vazhdonte të ishte gjithnjë Sevasti Qiriazit. Mësuesja e dytë, e shtuar këtë vit, ishte Fanka Efthim, gjithashtu nga Manastiri, e cila u bë një ndihmëse besnike dhe e aftë e Sevastisë.

Viti i dytë shkollor shënonte një ngritje të përgjithshme të shkollës: përveç numrit të nxënësve, të klasave e të mësuesve ishte shtuar edhe numri i lëndëve dhe përvoja tani ishte më e madhe. Në një letër që Gjerasim Qi-

1) «Foleja Kombëtare», Vep. e cituar, fq. 83.

riazi i dërgonte në këtë kohë Nikolla Naços, kryetarit të shoqërisë «Drita» të shqiptarëve të Bukureshtit, i shkruante: «...Skollia prej çupash na vete shumë mirë... Mësueset përpiqen me gjithë zemër ndër punët e tyre. Pasi më erdhi edhe im vëlla këtu (në Korçë) shpërenj (shpresoj) të bëjmë punë më shumë»¹⁾.

Përveç lëndëve mësimore në gjuhën shqipe, tani zhvilloheshin si lëndë të veçanta edhe greqishtja e anglishtja.

Gjithashtu ishte menduar që të mblidheshin ndihma dhe të shtoheshin dy dhoma për të fjetur vajzat jo korçare që do të vinin në shkollë vitin e ardhshëm nga krahinat e tjera të Shqipërisë²⁾.



Fanka Efthimi

Të gjitha këto rezultate që po arrinte shkolla shqipe e vajzave dhe çështja shqiptare bënë që Mitropolia e Korçës të ngrihej edhe një herë në këmbë kundër saj. «S'pushojnë duke folur dhe duke tremburë llauzë (popullin) me çdo të rrena», shkruante Gjerasimi në një letër tjetër. «E tepër është të them — vazhdonte ai — se dëmi është i atyre që lodhenë edhe u bien me shkelm gjembave, sa për ne, sa më shumë flasënë kundër nesh, kaqë më shu-

1) «Fletë nga historiku i shkollës sonë», Tiranë, 1963, fq. 26. Letër e G. Qiriazit dërguar nga Korça N. Naços në Bukuresht në 26 nëntor 1892.

2) Letër e Gjerasim Qiriazit dërguar nga Korça N. Naços në Bukuresht më 9/21 dhjetor 1892.

më kohë e pëlqyer na epetë për të bërë punën e shenjtëruarë»¹⁾.

Dhe vërtet, mallkimet, kërcënimet dhe ndjekjet e bëra për shkak të shkollës shqipe nuk arrinin të dëshpërojnë e të paralizojnë zemrat shqiptare.

Me afrimin e fundit të vitit shkollor Gjerasim Qiriazia la mënjanë punët e tjera dhe nga fillimi i majit shkoi nga Manastiri në Korçë për t'iu kushtuar tërësisht përgatitjeve për mbylljen me sukses të vitit të dytë shkollor. Përveç të tjerave, gjatë kësaj kohe, Gjerasimi shkroi poezi e skeçe të reja, që do të recitoheshin e do të luheshin nga nxënëset me rastin e provimeve. Ceremonia e mbylljes së këtij viti shkollor u kthye në një manifestim të fuqishëm kombëtar. Përveç efektivit të shkollës nxënës e mësues, në të morën pjesë edhe mbi 350 vetë, burra e gra, të krishterë e myslimanë²⁾.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast drejtoresha e shkollës, Sevasti Qiriazia, theksoi ndër të tjera rëndësinë e madhe të gjuhës amtare në përparimin e nxënësve në mësim, e cila kishte «ndihurë ndë të mësuarit ca mësimë kaqë shpejt që ndë gjuhë të huaj, mbase me vjete do të mos i kishin mësuarë dot». Duke kërkuar shkaqet e prapambetjes së popullit tonë, ajo vinte në dukje se «një nga rrënjët e të këqijave është paditja edhe ca mësimë e përralla (paragjykime) të vjetra që mbajnë njerëzit ndë hekurë errësire. Ato qëndrojnë si një kastel (kështjell-pengesë) e fortë përpara mëmëdhetarëve, edhe kështu kanë zënë udhën e mbrothësisë (përparimit)...»³⁾.

Duke u ngritur kundër koncepteve prapanike feudale e fetare, që kërkonin ta mbanin femrën të paditur e bre-

1) Letër e Gjerasim Qiriazit dërguar nga Manastiri N. Naços në Bukuresht më 27 prill 1893. Originali ruhet nga N. Burda në Korçë, i cili pati mirësinë të na e japë për ta konsultuar.

2) Letër e Gjerasim Qiriazit dërguar nga Manastiri N. Naços në Bukuresht më 8/20 korrik 1893; origjinali ruhet nga N. Burda në Korçë.

3) Kristomathi, vep. e cituar, fq. 303-308.

nda mureve të shtëpisë, Sevastia vazhdonte: «Shumë herë dëgjojmë të flitet: «Çupat s'kanë nevojë për mësim; ç'punë munt të bëjnë ato ndë të ndrequrit të kombit? Ato janë ndarë (caktuar) për punët e shtëpisë, edhe s'ka hije të dalën jashtë këtij rrethi». Shkoi ajo kohë, kur ua vinin veshin këtyre fjalëve; punërat sot faqezat tregojnë ç'mund të bëjnë gratë e ditura»¹).

Pas kësaj fjale u dha një program artistik i përgatitur nga shkolla. Nxënëset recituan vjersha e dialoge dhe së bashku kënduan këngë të ndryshme. I gjithë programi u prit me shumë interes nga pjesëmarrësit. Përshtypje bëri veçanërisht kënga «Mëma e varfër» e cila simbolizonte Shqipërinë e robëruar të asaj kohe dhe bëri «të qajnë ca mëmëdhetarë nga mallëngjimi e gëzimi që ndjenë kur e kënduan të gjitha vajzat së bashku»²).

Jo vetëm kënaqësia, por edhe efekti i kësaj ceremonie festive që i madh në prindërit dhe në pjesëmarrësit e tjerë. Shumë prej tyre para se të largoheshin u drejtuan këto fjalë drejtuesve të shkollës: «paskëtaj do të mos dëgjojmë botënë ç'flasënë për ju; pamë me sy sa bukur e sa mirë i keni mësuarë çupatë; do t'i dërgojmë edhe ne çupatë tona në vjeshtë të vinë ndë shkollë tuaj»³).

Gëzimi dhe krenaria kishte përfshirë edhe gjithë ata që kujdeseshin dhe mbanin shkollën shqipe të djemve. Ata u shprehën me këtë rast «edhe ne kemi me se të mburemi, se... edhe ajo jona është»⁴).

Me kalimin e kohës, përpara shkollës shqipe të vajzave në Korçë, ishin shtuar vështirësitë dhe problemet që duheshin përballuar. Numri i nxënësve kishte ardhur duke u rritur, nevoja për libra shqipe e në radhë të parë për ato shkolloret ishte shtuar; interesimi për shkrim-këndi-

1) Kristomathi, vep. e cituar, fq. 303-308.


2) Letër e Gjerasim Qiriazit dërguar nga Manastiri N. Naços në Bukuresht më 8/20 korrik 1893. Kënga «Mëma e Varfër» ishte shkruar e kompozuar nga vetë Gjerasimi.

3) Po aty.

4) Po aty.

min shqip ishte përhapur me shpejtësi në masat popullore të qytetit e të fshatit. Një ndihmë në këtë drejtim dhanë patriotët shqiptarë brenda dhe jashtë Atdheut.

Me kohë, shkolla e vajzave u pais me bibliotekë dhe me një muzeum të vogël që do të bënte edhe punën e kabinetit për dituritë mbi natyrën. Deri në fillim të vitit 1893 biblioteka kishte grumbulluar mbi 200 libra në disa gjuhë.



Shkolla shqipe e vajzave në Korçë
(fotografi e vitit 1899)

Në muezun e vogël që u ngrit pranë bibliotekës së shkollës u grumbulluan objekte të vjetra si dhe copëra minerale të ndryshme. Këto do të ndihmonin për konkretizimin dhe përvetësimin nga ana e nxënësve të diturive të natyrës, historisë dhe të lëndëve të tjera që zhvilloheshin në shkollë.

Zgjerimi i aktivitetit arsimor dhe patriotik të shkollës

së vajzave solli me vete edhe rritjen e shqetësimeve të armiqve të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të kundërveprimeve e intrigave të ndryshme. Përkrahësit e shkollës shqipe dhe të çështjes shqiptare nuk liheshin të qetë edhe pas vdekjes. «Ndë Korçë — shkruan Gjerasimi më 1893 — na është ngritur Mitropolia dhe kleri më këmbë. Ata duan edhe varret t'i kenë monopol. Kur vdes ndonjë nga ata që s'kanë mendjen e tyre, ata shkelin këmbë (ngulin këmbë) edhe nuk e lënë të vdekurin të kllitet në varr pa kthyer mendjen e tij.

Për çudi është, sot ndë këtë qintvjet (shekull) të ngjasën këto punë»¹⁾.

Në shtator të vitit 1893 Sevastia bashkë me Fankë Efthimin erdhën nga Manastiri në Korçë për të filluar vitin e tretë shkollor. Ato u pritën në Korçë me gëzim si nga nxënëset ashtu edhe nga miqt e përkrahësit e shkollës. Por në horizont po dukeshin prapë re të zeza. Në qytet thuhej se «shkolla do të mbyllej me siguri» dhe se «mësueset shqiptare do të dëboheshin prej andej». «E dinim — shkruan Sevastia — që kohët ishin të vështira dhe gëzimi ynë kufizohej nga ankthi, por nuk u dorëzuam dhe nuk i humbëm shpresat»²⁾. Ndonëse i sëmurë, Gjerasimi i shkruante së motrës në Korçë 2-3 letra në javë, e pyeste për gjendjen e shkollës dhe e udhëzonte për gjërat e nevojshme, ndërsa për shëndetin nuk i ankohej asnjëherë. Krahas sëmundjes kundër jetës së Gjerasimit vazhdonte të vepronte edhe dora gjakatare e mitropolitit.

Dëshmitarja e këtyre ngjarjeve të hidhura, vetë Sevastia, na tregon se doktori i shtëpisë së tyre që kuronte Gjerasimin, dhe doktorët e tjerë me të cilët ai konsultohesh, ishin bashkuar me mitropolitin dhe ishin vënë në shërbim të tij dhe arritën deri atje sa të tentojnë të përdorin helmin kundër jetës së Gjerasim Qiriazit, vetëm e vetëm për të arritur qëllimet e tyre antishqiptare.

1) Letër e Gjerasim Qiriazit dërguar N. Naços më 27/8 prill 1893.

2) S. Qiriazit, Vep. e cituar, fq. 28.

Më 4 janar të vitit 1894 vdiq Gjerasimi në lulen e moshës, sapo kishte mbushur 32 vjetët. Ai vdiq në kohën kur i ishte kushtuar tërësisht shkollës shqipe, gjuhës e letërsisë shqipe — çështjes shqiptare. Vdekja e parakohshme e Gjerasim Qiriazit që një humbje për lëvizjen kombëtare dhe për arsimin shqiptar¹).

Një bashkëkohës që e njihte nga afër Gjerasimin dhe veprën e tij, e vlerësoi atë me këto fjalë: «Ai ishte një mendimtar i thellë dhe i pavarur, një nga ata njerëz që bëhen të pavdekshëm për arsye të dashurisë dhe devotshmërisë ndaj popullit»²). Ai u shqua gjithashtu si autor poezish, dialogësh, skeçesh e tregimesh me përmbajtje patriotike dhe që destinoheshin kryesisht për qëllime pedagogjike. Shkrimet e tij u bënë një ushqim i kërkuar dhe i rëndësishëm për edukimin e brezit të ri³).

Me vdekjen e Gjerasimit barra kryesore e shkollës shqipe të vajzave ra mbi shpatullat e Sevastisë. Megjithatë, rruga kishte nisur të shtruhej, «fara kishte zënë rrënjë të mira në një tokë të përshtatshme»⁴). Ajo pati përkrahjen e popullsisë dhe të patriotëve shqiptarë. Ndihmës kryesor tani iu bë një nga vëllezërit më të rinj, Gjergj Qiriazit⁵).

1) Në këshillat e fundit Gjerasimi i thoshte së motrës edhe këto: «Mos harro se je shqiptare! Ti ke patur fatin të jesh e vetmja që more mësim të lartë, po gratë e tjera të vendit tënd, motrat e tua, janë të pamësuara. Është detyra jote të punosh e të mundohesh që të bëhen edhe ato të mësuara... Të ndezësh në gjithë zemrat dashuri për atdhenë dhe dëshirë për të mësuar gjuhën amtare. Ty të është dhënë detyra të punosh që të çelet porta e hekurt, që të shpëtojnë vajzat shqiptare nga skllavëria e këhëve të shkuara».

2) S. Qiriazit, vep. e cituar, fq. 30.

3) Një pjesë e prodhimtarisë së tij letrare është botuar në Kristomathinë e cituar.

4) S. Qiriazit, vep. e cituar, fq. 30.

5) Pas vdekjes së Gjerasimit më 1894, të gjitha funksionet zyrtare të tij si pronar e administrator i shkollës shqipe të vaj-

Gjergji jo vetëm që mori funksionet zyrtare të vëllait të vet, por u bë edhe një ndjekës besnik dhe i zellshëm i rrugës dhe idealeve patriotike të tij. Ndonëse ishte në shërbim të Shoqërisë Biblike, ai së bashku me Sevastinë e vazhdoi veprën e filluar nga Gjerasimi, dhe u bë një patriot e aktivist i shquar në fushën e arsimin e të lëvizjes kombëtare shqiptare.



Gjergj Qiriazhi

Shkolla shqipe e vajzave e vazhdoi jetën e vet, por për shkak të vështirësive dhe mungesave të tjera numri i nxënësve kishte patur një rënie Viti shkollor 1893-1894 u mbyll me 36 nxënës¹⁾.

zave në Korçë dhe përfaqësues i Shoqërisë Biblike në Manastir i mori përsipër i vëllai, Gjergj Qiriazhi.

Ai kishte lindur në Manastir rreth vitit 1865. Mësimet fillore dhe të mesme i kishte kryer në Manastir dhe pastaj kishte vazhduar studimet e larta jashtë vendit.

1) «Foleja Kombëtare», vep. e cituar, fq. 81.

VII

ÇELJA E SHKOLLAVE TË REJA SHQIPE NË KOLONJË E NË VAKËFE¹⁾

Është thënë më parë se në verën e vitit 1891, pasi kishte përfunduar viti shkollor, Petro Nini Luarasi, drejtor i shkollës shqipe të djemve në Korçë, me qëllim që të siguronte ndonjë ndihmë për shkollën, kishte ndërmarrë një udhëtim për në kolonitë shqiptare të mërgimit²⁾.

Në fillim shkoi në Stamboll, por shqiptarët e atje-shëm nuk patën mundësi ta ndihmonin me mjete financiare. Megjithatë, «që të mos mbylleshe shkëndia e ndezur në qytetin e Korçës, në të cilën vareshin shpresa të mëdha»³⁾, ata i premtuan se do të bënin hapat e duhura pranë shoqërive të tjera me të cilat mbanin lidhje. Nga Stambolli vajti në Sofje. Shqiptarët e kolonisë shqiptare të Bullgarisë i dhanë një farë ndihme dhe i premtuan se do t'i dërgonin 15 napolona në vit.

1) Me emrin Vakëfe përmblihdeshin fshatrat: Treskë, Trebiokë, Panarit, Grabockë, Katund dhe Stratobërdhë.


2) Në burime të ndryshme jepen data të ndryshme për këtë udhëtim. Shumica shënojnë vitin 1890 (si N. Naçi në artikullin e cituar; G. Sevo në kujtimet e veta ribotuar në «P. N. Luarasi», Tiranë 1958, fq. 48; I. M. Qafëzezi në «Dhaskal Gjoka», Korçë 1936, fq. 152, etj.).

3) N. Naçi, vepër e cituar, fq. 169.

Prej andej vajti në Bukuresht, ku kishte një koloni të madhe shqiptare e me tradita të mira organizimi. Në Bukuresht në atë kohë vepronin dy shoqëri shqiptare «Drita» dhe «Dituria». Megjithëse ekonomikisht nuk ishin në gjendje të mirë, ato i premtuan Petros se do të dërgonin ndihma. Shoqëria «Dituria» premtoi se do të dërgonte çdo vit 50 napolona, kurse shoqëria «Drita» u zotua për 150 napolona dhe pranoi që me këto të çelëshin shkolla shqipe në Kolonjë¹⁾.

Gjatë vitit shkollor 1891-1892 shkolla shqipe e Korçës pati një përmirësim të gjendjes ekonomike. Ndërkohë fshatarët arsimdashës të krahinës së Kolonjës dhe të Vakëfeve ishin aktivizuar dhe po vepronin me zell për të çelur shkolla shqipe. Një ndihmë të çmuar u dha në këtë drejtim Petro Nini Luarasi, që ishte gjithnjë drejtor i shkollës së parë shqipe të Korçës. Pasi u bënë përgatitjet e duhura, në vitin shkollor 1892-1893 u shënua një hap i ri i rëndësishëm në ecjen përpara të arsimit shqiptar. Popullsia e varfër por patriotë e krahinave të Kolonjës dhe Vakëfeve kishte ndezur edhe gjashtë pishtarë të rinj, për të ndriçuar mendjet dhe zemrat e brezit të ri.

Më 1 shtator 1892 gjashtë shkolla të reja çelën dyert e tyre në fshatrat Luaras, Gostivisht, Rehovë, Vodice, Senicë e Pishës dhe Treskë. Për sigurimin e kuadrit më-




Nikolla Naço, kryetar i Shoqërisë «Drita» të shqipëtarëve të Bukureshtit

1) N. Naçi, vepër e cituar, fq. 169.

simor kishte ndihmuar veçanërisht qyteti i Korçës, i cili luante rolin e qendrës arsimore. Në shkollën shqipe të djemve në Korçë për këtë vit drejtor ishte emëruar Janko Minxha¹⁾. Petro Nini ishte ndihmës i tij dhe kujdesej në mënyrë të veçantë për shkollat e reja që u çelën në Kolonjë; ai kryente si të thuash detyrën e inspektorit për këto shkolla.

Më vonë, gjatë po atij viti shkollor, Petro Nini u largua nga shkolla e Korçës dhe iu kushtua krejtësisht shkollave shqipe të Kolonjës.



Nuçi Naçi në moshë të re

cilit nuk e dimë. Në shkollën e Selenicës së Pishës ishte djaloshi vendas Balil Tahiri dhe në Rehovë u dërgua një

Në shkollën shqipe të Luarasi punoi si mësues Kristo Papa Stefani (Kristo Luarasi), i biri i priftit shqiptar të persekutuar nga Mitropolia greke e Kosturit dhe ish-nxënës i Petro Ninit. Në shkollën shqipe të Vodices u dërgua mësues Vasil Thanas Duro, gjithashtu nga Luarasi. Në shkollën shqipe të Treskës kishte shkuar si mësues Nuçi Naçi nga Korça, i cili me një dëshirë të zjarrtë iu kushtua qysh i ri arsimit shqiptar dhe çështjes kombëtare. Mësues i Gostivishtit ishte «një djalë fort i zjarrtë nga Pilkati», emrin e të

1) Janko Minxha, dhëndër i Koto Hoxhit, ishte diplomuar në shkollën Sulltanie dhe njihete mirë frëngjishten e turqishten, por nuk mbajti një qëndrim të mirë dhe patriotik, të denjë për detyrën që iu besue.

mësues nga Korça.¹⁾ Po atë vit gjuha shqipe filloi të mësohej edhe në shkollën e vogël greke të fshatit Lavdar të Oparit.

Duke shprehur gëzimin e optimizmin për të ardhmen, Gjerasim Qiriazhi shkruante në atë kohë: «Çdo shqiptar i vërtetë do të gëzohet të dëgjojë se sivjet u hapnë në Kolonjë skoli shqipe... Shpërejme (shpresojmë) se këto skoli do ta hapin udhën edhe për të tjera, dhe do të zgjojnë ata që kanë mbetur prapa ndë këtë punë».

Krahas gëzimit dhe entuziazmit që shkaktoi çelja e shkollave të reja shqipe, u rrit edhe shqetësimi e kundërveprimi i autoriteteve osmane, i kishës ortodokse dhe i elementeve turkomanë e grekomanë. E vështirë u bë situata sidomos në ato fshatra ku ekzistonin që më parë shkolla greke, si në Luaras e gjetkë. Në Rehovë, për shkak të kundërshtimeve të forta, shkolla shqipe nuk mundi të vazhdojë më tepër se tri javë dhe u mbyll²⁾. Një luftë e ashpër u zhvillua në Gostivisht. Shumë familje kristiane, duke qenë nën presionin e fortë të kishës e të klerit, vazhduan t'i dërgojnë fëmijët në shkollën greke. Megjithatë, mësuesi i shqipes, i përkrahur nga pjesa e shëndoshë e popullsisë kristiane si dhe nga familjet myslimane të fshatit, e vazhdoi punën. Shkolla shqipe e Gostivishtit arriti të kishte deri në 30 nxënës nga të dy besimet. Por mësuesi u sëmur dhe vdiq. Për këtë arsye shkolla e Gostivishtit u mbyll pas dy muaj ekzistence³⁾.

Shkollat e tjera vazhduan rregullisht gjatë gjithë vitit shkollor me gjithë luftën që u bë kundër tyre dhe pengesat që u dolën. Përfundime të mira u arritën veçanërisht në Treskë, ku mësuesi i ri i talentuar Nuçi Naçi u prit me gëzim e dashuri të madhe nga treskallijtë dhe u

1) K. Luçrasi, «Shkollat kombëtare më 1893 në Kolonjë». Në «Kalendari Kombiar», viti V, Sofje 1901, fq. 62; Kujtime të G. Sevos në «Petro Luarasi», Tiranë 1958, fq. 48.

2) K. Luarasi, Vepër e cituar, fq. 62.

3) Po aty.

përkrah e u mbrojt prej tyre në kryerjen e detyrës së rëndësishme, për përhapjen e mësimi dhe të diturisë në gjuhën shqipe. Në fund të vitit shkollor «nxënësit duan lën aqë mirë në provimet — shkruan Kristo Luarasi — sa sikur të kishin mësuar 5 vjet në gjuhën greke — them se nuk do të dilnin aqë të mbaruarë...»¹).

Në Vodicë shkolla shqipe pati gjithashtu mbështetjen e plotë të banorëve të fshatit dhe arriti përfundime të mira.

Vështirësi të mëdha ndeshën shkolla shqipe e Selenicës së Pishës e veçanërisht ajo e Luarasit. Megjithatë shkollat shqipe i frekuentuan nxënës të familjeve kristiane e myslimane. «Në Luaras — tregon Kristo Luarasi — mësues shqip, pata fatin pas dëshirës që më kërkonte zemra, të jem unë... Shumë të vojtura pësuam... Në Luaras ngjanë shumë gjëra të çuditshme, të cilat mund të mbushnin një libër...»²). Shkolla e Luarasit vuante edhe për mungesë lokali, shpesh mësimet zhvilloheshin jashtë apo në hajatin e kishës së fshatit.

Shkollave të reja shqipe iu desh të përballonin gjithë atë luftë të ashpër që u zhvillua kundër tyre. Ndjekje të forta u bënë kundër mësuesve të shqipes e veçanërisht kundër Petro Nini Luarasit. Në vjeshtën e vitit 1892 mitropoliti grek i Kosturit, Fillareti, bëri udhëtimin e zakonshëm³) nëpër krahinën e Kolonjës dhe të Vakëfeve dhe u skandalizua kur dëgjoi e pa nga afër mbarëvajtjen e shkollave shqipe. Ai «fort u pikëllua — shkruan Petro Nini, — duke u ndrydhur prej frikës që i nguli në zemër parandjenja e të përmbysurit dhe e të çrrënjosurit në ato vise të kuçedrales Megali-idhe prej dritës së shkronjave shqipe»⁴). Para se të mbërrinte në Luaras, mitropolitit iu

1) K. Luarasi, vepër e cituar, fq. 62.

2) Po aty.

3) Gjatë vizitës së përvitshme mitropoliti mblidhte edhe shuma të rëndësishme të hollash nga besimtarët e krahinës, që shtrihej në juridiksionin e tij kishtar.

4) P. N. Luarasi, vepër e cituar, fq. 210.

dërgua një letër e përbashkët e banorëve të Luarasit, me anën e së cilës i vihej si konditë që, në qoftë se donte të vinte në fshatin e tyre, nuk duhej të fliste asgjë kundër mësimit të gjuhës shqipe¹). Mitropolitit, i trembur nga paralajmërimi që i bëhej, u detyrua të zbatojë konditën që i vihej, por, me t'u larguar nga krahina, luftën kryesore e drejtoi pikërisht kundër përkrahësve të shqipes në Luaras. Prandaj prej andej vajti i dëshpëruar në Korçë dhe, pasi u këshillua me kolegun e miqtë e atjeshëm, lëshoi menjëherë një mallkim «të tmerrshëm» drejtuar kundër Petros e shokëve të tij, si dhe kundër çdo të krishteri që do të përqafohte shkronjat shqipe apo do të përkrahte shkollën shqipe²).

Në mallkimin e Mitropolitit të Kosturit, lëshuar më 20 shtator 1892 thuhej: «...Me pikëllim të madh pamë dhe dëgjuam në udhëtimin tënë që bëmë në ato vise se i mallkuari dhe i çvetëmuari prej Perëndisë, Petro Luarasi erdhi rrethepërqark në katundet e ndryshëm të Kazasë së Kolonjës, duke zotuar të përkufizonjë (emërojë) mësonjës shqiptarë gjoja për të mësuar gjuhën shqipe, e cila nuk është e qenë (nuk ekziston) po në të vërtetë që të përdredhë (ndryshojë, shtrëmbërojë) ndërgjegjen e ortodoksëve dhe të bënjë përkthenjës në Masonë dhe në Protestantizmë...»

...Për këto shkake pra... çpallim: Cilido nga të krishterët që do të pranonjë... nga i mallkuari Petro Luarasi dhe përngjanjësit (shokët) e tij... shqipmësonjës ose libra, qoftë i aforisur prej Perëndisë gjithëpushtetonjës... të mbetet i patretur dhe katruf pas vdekjes, dhe të mirë të mos shohë, as përparim të bënjë në këtë botë gjersa të pendohet»³).

Mallkimi i mësipërm u shpërnda nëpër gjithë fshatrat e Kolonjës e të Vakëfeve.

Po në atë datë Mitropolitit i Kosturit i dërgonte nga

1) K. Luarasi, vep. e cituar, fq. 62.

2) P. N. Luarasi, vep. e cituar, fq. 210.

3) Po aty, fq. 227.

Korça një letër të veçantë priftërinjve të katundit Luaras, me anë të së cilës i njoftonte se: «me qenë që Petrua nga katundi jua j Luaras përndau predikime kundër krish-tërimit dhe libra të çvetëmuara (të aforisura), është çki-shëruar familjarisht.

Nuk kini pra të drejtë ta qasni në kishë atë, as të bëni ndonjë meshë në familjen e tij, gjersa të pendohet dhe të kthehet nga udha e keqe që ndjek»¹⁾.

Ndjekje të rrepta u bënë përsëri kundër priftit të Luarasit, Papa Stefanit, i cili nuk zbatonte porositë e mitropolitit, i mësonte shqip të bijtë, njëri prej të cilëve ishte bërë mësuesi i shkollës shqipe të fshatit²⁾.

Me gjithë luftën e vështirësitë e mëdha, shkollat shqipe u mbrojtën nga banorët e këtyre krahinave dhe e përfunduan me sukses vitin e parë shkollor. Me rastin e përfundimit të provimeve të vitit të parë dhe të mbylljes së vitit shkollor në Luaras, më 6 gusht 1893, u organizua një ceremoni me pjesëmarrjen e nxënësve dhe prindërve. Me këtë rast foli mësuesi i shkollës, Kristo Luarasi, i cili ndër të tjera tha:

«... Me atë fuqi që patëm u përpoqëm, nukë vetëm si mësonjës i djemvet, por më tepër punuamë duke gëzuarë, se bëmë një të mirë për mëmëdhenë tënë, si çdo njeri i vërtetë ka detyrë të bëjë një të mirë në vëllezërit dhe në mëmëdhet.

Jemi detyrës (jemi borxhlinj) jo vetëm neve, po edhe

1) P. N. Luarasi, vep. e cituar, fq. 227.


2) Në një letër që Gjerasim Qiriazi i dërgonte Nikolla Naços në nëntor të vitit 1892, i shkruante: «Ndë Luaras e paskan thirrur priftin, i cili mëson djemtë shqip, te veçili i dhespotit ndë Treskë; po ay u paska thënë s'kam ndonjë punë me dhespotin, unë jam prift shqiptar. Të dytën herë dërguan zaptie, edhe u nangas (u detyrua) të vejë. Kush e di se qysh janë menduarë ta mundojnë të gjorin prift. E njoh priftin, është trim e s'do të dijë nga dhespoti, po kam frikë mos i bien mbë qafë. Grekomanët po përpiqenë me shumë mënyra të prishin punën e skollivet shqipe që janë hapur ndë Kolonjë». Në AQSH i RPSSH. Fondi i N. Naços, Dosja 4.

gjithë shqiptarët e thjeshtë, n'ata shqiptarë, që përpiqenë të mbajnë këtë fener, nga i cili fshati ynë si gjithë Shqipëria pret të ndritohetë dhe të dalë nga errësir'e madhe e paditurisë»¹⁾.

Në vitin e dytë shkollor rifilluan mësimet në shkollat shqipe të Vodicës, Luarasit, Treskës dhe të Selenicës së Pishës²⁾. Këtë vit shkollor mësuesi i Treskës, Nuçi Naçi, i ftuar nga kujdestarët e shkollës shqipe të djemve në Korçë, u largua nga Treska dhe mori detyrën e drejtorit të saj, të cilën e mbajti për shumë vjet.

Rifillimi i mësimëve rregullisht në shkollat e Kolonjës tregonte se kolonjarët nuk ua vinin shumë veshin kërcënimeve dhe mallkimeve të mitropolitit grek dhe atyre që e përkrahnin atë.

Shqetësimi i mitropolitit dhe i priftërinjve ishte i madh. Duke parë dobësinë e tyre, ata kërkuan ndihmën e autoriteteve osmane të vendit. Njëkohësisht mitropolit i Kosturit vuri në dijeni Patrikun e Stambollit për gjithë ato që po ndodhnin në zonën e tij. Patriku, pasi mësoi ngjarjet e Kolonjës, shpejtoi të nxiste kundër



Kristo Luarasi

1) K. Luarasi, vepër e cituar, fq. 67-68.

2) Sipas artikullit të Kristo Luarasi mbi shkollat të Kolonjës, botuar në «Kalendari Kombiar» të vitit 1901, del se shkollat shqipe të Treskës dhe të Selenicës së Pishës nuk mundën të vazhdojnë më tepër se një vit. Ndërsa vetë Petro Nini në një letër dërguar Nikolla Naços në gusht të vitit 1894 tregon se gjer atëhere vazhdonin shkollat e Vodicës, Luarasit, Treskës e Selenicës së Pishës.

shkollave shqipe të Kolonjës Portën e Lartë, duke i paraqitur ato si shkolla që ishin kundër Perandorisë Osmane. Në të vërtetë këto shkolla ishin çelur e funksiononin pa lejen e qeverisë dhe në kundërshtim me politikën e saj, prandaj, e shytur edhe nga Patrikana, ajo dha urdhër që të mbylleshin¹⁾.

Në këtë mënyrë qeveria tiranike e Stambollit, Patrikana e Fanarit, mitropoliti dhe gjithë veglat e tyre, po vepronin në bashkërendim dhe me energji kundër kolonjarëve e shkollave të tyre shqipe. Me urdhër të qeverisë u dërgua në Kolonjë kryekomisari i policisë së vilajetit të Manastirit, për t'u vënë kyçin shkollave shqipe dhe për të mbajtur qëndrim ndaj Petro Ninit, i cili ishte paditur pranë valiut të Manastirit nga mitropoliti i Kosturit.

Meqenëse mësuesi i shqipes, Petro Nini, ishte paraqitur si «një kriminel i madh» që po përgatiste një kryengritje në Dangëlli, kryekomisari, Haxhi Osman beu, erdhi në Kolonjë i shoqëruar me shumë ushtarë, këmbësorë e kalorës, dhe u drejtua për në fshatin e Petros, në Luaras²⁾.

«Siç ia kishin treguar armiqtë e Petros — shkruan në kujtimet e veta Guri Sevo — komisari pandehte se Petroja do të kishte ndonjë palë saraje dhe kush e di sa tri ma pas vetes, që ta ruanin»³⁾. Në të vërtetë ishte krejt ndryshe. Në fillim kryekomisari u përpoq ta largonte Petron nga rruga patriotike; i propozoi të hiqte dorë nga mësimi i gjuhës shqipe duke i premtuar se do t'i jepej një detyrë në Kolonjë apo gjetkë dhe do të merrte 50 lira në vit nga Perandoria.

Këtij propozimi Petroja iu përgjigj: «Pesëdhjetë lira e di sa vlejné. S'i kam për të zënë në jetën time. Po... nuk i marr. Udhën që kam nisur do ta ndjek»⁴⁾. Atëhere

1) K. Luarasi, vep. e cituar, fq. 62.

2) G. Sevo, vep. e cituar, fq. 48.

3) Po aty.

4) Po aty.

Petro Nini u dërgua në Manastir, u mbajt në mbikqyrje, u muar shumë herë në pyetje mbi qëllimet e tij, mbi shkollat shqipe e përkrahësit e tyre. Kur pas katër muajve u lirua, u urdhërua që të mos përzihej me asgjë që kishte të bënte me çështjen shqiptare.

Viktimë e këtyre ndjekjeve të armiqve të Shqipërisë dhe të reaksionit të brendshëm ra edhe mësuesi i Selenicës së Pishës, Balil Tahiri. Nga një bari, Balil Tahiri, duke ndjekur me dashuri të flaktë mësimet e rilindësve, arriti të bëhej mësues i fëmijëve të fshatit të vet. Atë e vranë më 1893 kur po kthehej nga Selaniku, pasi kishte kryer një mision patriotik.

Petro Nini, ndonëse i ndjekur dhe i kërcënuar nuk rreshti së punuari me mënyra të ndryshme për çështjen kombëtare.

I pajisur me libra shqipe, ai udhëtonte nëpër fshatra të ndryshme të Toskërisë dhe ua shpërndante ato falas gjithë atyre që kishin dëshirë të mësonin shkrimin shqip.

Qendër e veprimtarisë së tij u bë përsëri ndërtesa që quhej Hani i Selmanit në Ersekë, të cilën edhe më parë e kishte përdorur, për disa vjet me radhë, si shkollë private shqipe. Në këtë «han» bëhej takimi i shumë patriotëve shqiptarë të Kolonjës dhe mbaheshin lidhjet midis tyre.

Në të njëjtën kohë kolonjarët bënë të gjitha përpjekjet për t'i mbajtur çelur shkollat shqipe. Në verën e vitit 1894 Petroja bëri një udhëtim të ri nëpër kolonitë shqiptare të mërgimit, me qëllim që t'u shprehte atyre kërkesat në rritje të fshatrave të Kolonjës për shkolla shqipe dhe të siguronte ndonjë ndihmë të re financiare mjaft të nevojshme, aq më tepër që krahina e Kolonjës ishte malore dhe e varfër.

Në një letër që Petro Nini i dërgonte nga Sofja Nikolla Naços në Bukuresht në gusht 1894, i shkruante: «Përpara ca ditësh kam ardhur këtu në Shoqërit të

Shqiptarëve «Dëshirë»¹⁾ me shpresë që të marr noca të holla për të paguar rrogën e mësonjësve të fshatrave të Kolonjës që haptë mësonjëtoze Z/ja juaj dhe për këtë mot që shkoi nuk u dërguatë pagënë që qetë zotuarë. Unë... që të mos mbyllen skolitë nga grek-kryepriiftërinjtë sa munda u përpoqshë edhe katër shkolla u mbajtënë: e Luarasi, e Gostivishtit, e Vodics dhe e Selenicës. Për të paguar rrogën e tyre, bëra turlish cene, po gjer më sot vetëm gjysmënë u pagova... më vjen liksht të dal gënjeshtar në syt të kolonjarëvet dhe s'dua kurrë t'i shoh të mbyllura ato shkolla...»²⁾.

Në Bukuresht Petro Nini u takua me shqiptarët e kolonisë së atjeshme dhe me këtë rast i paraqiti Nikolla Naços një lutje për shkolla shqipe të nënshkruar nga 20 fshatra të Kolonjës dhe të Vakéfeve si nga Treska, Luarasi, Selenica e Pishës, Vodica, Gostivishti, Perasi, Rehova etj. Për t'u shpëtuar kontrolleve të ndryshme, kërkesa për shkolla shqipe ishte futur në një valixhe me fund të dyfishtë³⁾.

Me gjithë dëshirën e mirë këtë radhë përkrahja financiare e kolonive shqiptare qe e vogël. Vështirësive dhe luftës nga ana e sunduesve dhe shovinistëve fqinjë u shtohet edhe mungesa e mjeteve financiare. Shkollat shqipe të Treskës dhe të Selenicës së Pishës nuk mundën të vazhdonin më tej jetën e tyre. Megjithëkëtë «fara e shqiptarizmës» u mbuall në zemrat e shqiptarëve, të cilët vazhduan të mësonin gjuhën e tyre, me ato pak libra që u kishin mbetur.

1) Shoqëria «Dëshirë» u formua në fillim të vitit 1893 në Sofje nga shqiptarët e emigruar atje. Ashtu si shoqëritë e Bukureshtit, edhe ajo ndihmoi në zhvillimin e arsimit e kulturës kombëtare.

2) «Petro Luarasi», vep. e cituar, fq. 50-51.

3) HHStAPAA: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit Nr. 79/res, datë 8 dhjetor 1899; P. N. Luarasi. Vep. e cituar, fq. 231.

Për vitin e ri shkollor 1894-95 u hapën vetëm shkolla e Luarasit dhe e Vodicës. Vështirësitë ishin rritur.

E fundit që u mbajt edhe për vitin shkollor 1895-96 nga shkollat e Kolonjës ishte ajo e Luarasit. Përgjegjës i shkollës tani ishte vetë Petro Nini. Me qenë se ky shpesh lëvizte edhe jashtë fshatit, në Ersekë e gjetkë, kishte cak-tuar një ndihmës. Tani që kishte mbetur vetëm kjo shkollë, vështirësitë u bënë tepër të mëdha. Agjentët e kishës ortodokse përpiqeshin që të fusnin përçarje e in-triga midis banorëve të Luarasit dhe kështu të lehtësonin punën për mbylljen edhe të kësaj shkolle. Por me kohë situata kishte ndryshuar. Nga pak familje që ishin mbështetje kryesore e shkollës shqipe në vitin e parë të çeljes së saj, tani ishte shumica e banorëve të Luarasit që mbronte shkollën e vet. Ndërgjegjja kombëtare ishte rri-tur dhe njerëzit, që më parë ishin të gabuar nga kisha e propaganda shoviniste greke, kishin kuptuar të vërtetën dhe ishin kthyer në rrugën e drejtë e patriotike. Bile ta-ni ishte dëbuar nga fshati mësuesi i greqishtes. Mirëpo gjendja e vështirë ekonomike e fshatarëve nuk i lejonte që të ndihmonin shkollën edhe nga ana financiare. Petro Nini bëri përpjekje të mëdha e të shumëllojshme për të siguruar mjetet e nevojshme për vazhdimin e shkollës. Ai bëri udhëtime të tjera në kolonitë shqiptare të mërgi-mit dhe mbajti një korrespondencë të rregullt me shumë patriotë shqiptarë brenda dhe jashtë atdheut.

Të dhëna të rëndësishme mbi gjendjen e shkollës je-pen në një letër tjetër që Petro Nini i dërgonte Nikolla Naços, në shkurt 1896, nga Luarasi.

«...Këtu (në Luarasi) — shkruante ai ndër të tjera — Mësonjëtorja na vete mirë se fshati janë afro më një (mendje) ndonëse nga an' e mëkëmbësit të kryepriiftit na u kallë spica për ndarje, po nuk na bënë dot gjëkaf-shë...»¹⁾

1) Letër e Petro N. Luarasit dërguar nga Luarasi N. Naços në Bukuresht më 16 shkurt 1896.

Për shkak të vështirësive të shumta dhe të ndjekjeve të vazhdueshme edhe shkolla shqipe e Luarasi nuk mundi të vazhdonte më gjatë. Megjithëkëtë, mësimi i shqipes vazhdoi të përhapej në fshatrat e Kolonjës e të Vakëfeve. Ai që dinte të shkruante e të lexonte shqip e kishte si një detyrë nderi që të mësonte edhe të afërmit apo shokët e tij. Një punë të madhe propagandistike dhe për shkrimin shqip vazhdoi të bënte gjithnjë mësuesi i palodhur Petro Nini Luarasi.

VIII

PËRHAPJA E SHKRIMIT SHQIP DHE E SHKOLLAVE TË FSHEHTA SHQIPE NË KRAHINAT E TJERA TË VENDIT NË VITET 90 TË SHEKULLIT XIX

Rritja e mëtejshme e lëvizjes kombëtare shqiptare në vitet 90 të shekullit XIX u shpreh ndër të tjera edhe në zgjerimin e përpjekjeve për përhapjen e shkrimit e të shkollës shqipe në gjithë Shqipërinë.

Përvoja e shkollave shqipe të Korçës, të cilat po mba-heshin me shumë sakrifica nga patriotët shqiptarë, tregonte se sa vështirë ishte të çelej qoftë edhe një shkollë publike shqipe. Të ndodhur në një situatë të tillë politike, përballë luftës së ashpër e të vazhdueshme që i bëhej mësimit të gjuhës shqipe nga ana e autoritetëve osmane dhe e reaksionit klerikal, patriotët rilindës vazhduan me mjaft sukses dhe në përmasa të reja sistemin e mësimit klandestin, të filluar prej kohësh në Shqipëri.

Sa më tepër mprehej syri i censurës së sunduesit, sa më tepër shtoheshin ndjekjet kundër pishtarëve të dritës së arsimit shqiptar, aq më tepër rritej lëvizja për përhapjen ilegalisht të shkrimit shqip, aq më tepër shtohej qar-kullimi fshehurazi i librave e gazetave shqipe, duke arri-tur deri në viset më të largëta e më të thella të atdheut për të çuar dritën e Rilindjes, zërin e ri të shqiptarizmës. Qyteti i Manastirit dhe i Korçës ishin bërë qendra të rëndësishme nëpër të cilat kalonte rruga kryesore e shpër-

ndarjes së abetareve, librave e gazetave shqipe. Të dërguara aty prej kolonive shqiptare të mërgimit, ato merrnin rrugën e Ohrit, Dibrës, Matit, Kërçovës, Elbasanit, Tiranës, Kolonjës, Beratit etj. Një rrugë tjetër e rëndësishme nisej nga bregdeti shqiptar. Durrësi, Vlora dhe Preveza ishin qendrat kryesore për dërgimet që bëheshin me anën e detit.

Megjithë urdhëresat qeveritare drejtuar herë pas here vilajeteve shqiptare, pakot me libra shqipe lëviznin kontrabandë në të gjitha anët e vendit. Për qiraxhinjtë e tregtarët shqiptarë, librat shqipe ishin bërë një ngarkesë e zakonshme, megjithëse ato ndiqeshin nga autoritetet osmane dhe mbajtësit e tyre dënoheshin.

Një rol me rëndësi në shpërndarjen ilegalisht të këtyre librave në Shqipërinë e Jugut e të Mesme luajti Gjergj Qiriaz, i cili, duke shfrytëzuar mbajtjen legale të librarisë së shoqërisë biblike në Manastir, mbante ilegalisht edhe një librari të vogël me tekste mësimore e vepra letrare shqipe, që përdoreshin për furnizimin e shkollave publike e të fshehta shqipe dhe të autodidaktëve.

Çdo shqiptar i ndershëm dhe patriot tregohej i gatshëm t'i shërbente shkrimit shqip dhe çështjes së atdheut. Çirakë e zejtarë, fusharakë e malsorë, kafexhinj e tregtarë etj., shërbenin sipas mundësisë në të mirë të kësaj çështjeje, pa marrë parasysh rreziqet, persekutimet e torturat.

Historisë së arsimit shqiptar iu shtuan faqe të reja të ndritura. Ndonëse në kushte ilegaliteti, arsimit shqiptar zgjerohej e forcohej. Mësuesit e përgatitur të gjuhës shqipe natyrisht mungonin. Nuk ekzistonte asnjë shkollë për përgatitjen e mësuesve shqiptarë. Megjithatë mësuesit e shqipes nuk mungonin. Cilido që kishte mësuar shkrim e këndim shqip bëhej mësues për të tjerët, për vëllezërit e motrat, për të afërmit e shokët e tij.

Abetarja e vogël shqipe ruhej si një gjë e shenjtë, me të cilën mund të mësoheshin gjëra të mëdha, mund t'i ndihmohej atdheut.

Përveç mësimit individual, në krahina të ndryshme

të Shqipërisë, në shumë raste, shkrimi shqip mësohej në grupe të vogla, apo në shkolla të fshehta. Ashtu si më parë, edhe tani në raste të veçanta, mësues shqiptarë që shërbenin në shkollat në gjuhë të huaj u mësonin fshehurazi nxënësve të tyre edhe shkrimin shqip.

Në çdo krahinë të vendit patriotët shqiptarë punonin për përhapjen e ideve kombëtare e të shkrimit shqip dhe për sjelljen e shpërndarjen e librave shqipe. Ndër ta u shquan: Kostandin Kristoforidhi e Hysen Ceka në Elbasan, Dervish Hima në Shqipërinë e mesme, Murat Toptani e Refik Toptani në Tiranë, Said Najdeni e Hamdi Ohri në Dibër e Ohër, Petro Nini Luarasi në Kolonjë, Papa Kristo Negovani në Negovan, Babë Dudë Karbunara në Berat, Musa Berberi e Kristo Karbunara në Vlorë, Sabri Preveza e Rexhep Demi në Çamëri, Mati Logoreci në Kosovë etj.

Megjithë përhapjen e madhe ilegalisht të shkrimit dhe të shkollës shqipe, patriotët shqiptarë nuk hoqën dorë nga kërkesat drejtuar Portës së Lartë dhe nga përpjekjet për të siguruar, të paktën, të drejtën zyrtare të mësimit në gjuhën shqipe, por në këtë drejtim nuk u arrit ndonjë rezultat i ri.

Një vatër e rëndësishme e arsimit shqiptar dhe e lëvizjes kombëtare në vitet 90 të shekullit XIX ishte bërë qyteti i Elbasanit dhe rrethet e tij. Kostandin Kristoforidhi, i mbiquajtur «babai i gjuhës shqipe», vazhdoi të punonte me zellin e një patrioti të vendosur dhe me aftësitë e një shkencëtari të vërtetë për përhapjen e ideve kombëtare, për t'u dhënë ilegalisht mësimin shqip nxënësve të shkollës greke, në të cilën punoi deri më 1888, dhe bashkëqytetarëve të rritur. Ai vazhdoi njëkohësisht punën për përmirësimin e fjalorit që kishte përgatitur prej kohësh, por nuk kishte mundur ta botonte. Tani Kostandin Kristoforidhi nuk vepronte vetëm. Rreth vitit 1890 depoja që ndodhej prapa dyqanit të bojaxhiut dhe atdhetarit Loshi i Papamihalit ishte shndërruar në një «mësonjëtorë» të fshehtë. Aty rilindësi i shquar K. Kristoforidhi mbledhte një numër burrash të besuar si Ali Çau-



Muç Shqiptari

shin, Alush Saraçin, Emin Haxhiademin etj. dhe u mësonte shkrimin e këndimin e gjuhës shqipe. Këta shpërndaheshin pastaj në shokët e miqtë e tyre të besuar çirakë, mjeshtër, saraçë, bakej e tregëtarë dhe u mësonin abetaren në gjuhën amtare. Dyqani i Muçit të Mane Berberit (Mustafa Osman Berberi) ishte një fole tjetër patriotësh dhe qendër e propagandës kombëtare. Muçi qysh në moshën djaloshare mësoi shkrimin e këndimin shqip. Kur Muçi shkante në Manastir për të blerë mallra për dyqa-

nin, sillte s'andejmi fshehurazi një numër të madh librash shqipe, që dërgoheshin nga shoqëritë shqiptare të mërgimit. Dyqani i tij, më tepër se kinkaleri, ishte kthyer në një librari ilegale të librave shqipe dhe vetë populli e quajti këtë përhapës të librit shqip Muç Shqiptari¹).

Ndërsa mësimi i gjuhës shqipe përhapej me shpejtësi nëpër dyqanet e shtëpitë e Elbasanit, Hysen Ceka, i veshur me kostum shpatarakësh, për të mos u njohur, shetiste nëpër krahinën e Shpatit, mblihte nëpër hijet e lissave fshatarë e barinj, u dhuronte nga një abetare dhe u mësonte shkrim e këndim. Hysen Ceka mbante lidhje me shumë patriotë brenda dhe jashtë atdheut. Ai u tregua i gatshëm të punonte si mësues i gjuhës shqipe në fshatin Nezhan, por shkolla që ishte projektuar të çelej aty nga viti 1897, nuk arriti të çelej²). Po ashtu mësuesi i shkollës greke të Elbasanit, Dhimitër Pina (Tush Pina), mbas orëve të rregullta të mësimit greqisht, u mësonte nxënësve të besuar abetaren e gjuhës shqipe³).

Kur ishin pyetur disa tregtarë elbasanas në Stamboll nga një shqiptar i atjeshëm nëse kishin shkolla shqipe në qytetin e tyre, ata ishin përgjigjur: «Nuk kemi si duhenë, por gjithkush mban vivllatë (librat) në gji, dhe të gjithë kanë mësuarë të shkruajnë e të këndojnë. . . Tani shkrepni drita e diturisë edhe për Shqipërinë, hekurat e barbarisë, sado të trasha të jenë, do të këputen. Drita përndau mugesirën»⁴).

Në Elbasan patriotët shqiptarë u përpoqën të shfrytëzojnë edhe shkollën vllahe që ishte projektuar të hapej aty. Në programin e shkollës vllahe u arrit të futej mësimi i gjuhës shqipe. Përpjekjet për hapjen e kësaj shkolle patën gjithë përkrahjen e shqiptarëve kristianë e muhamedanë; por futja e gjuhës shqipe në programin e kësaj

1) «Arsimi popullor», 1959, Nr. 5, fq. 65.

2) HHStAPA:A: aneks i raportit të konsullit austro-hungarez të Manastjrit nr. 73/sek., datë 10 dhjetor 1900.

3) «Arsimi popullor», 1959, Nr. 5, fq. 65.

4) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 17, datë 30 gusht 1897, fq. 5.

shkollë shkaktoi kundërshtimin e rreptë të autoriteteve osmane dhe të shovinistëve grekë. Sado që ishin plotësuar të gjitha kërkesat ligjore, leja për çeljen e kësaj shkollë u kundërshtua për dy vjet me radhë (1897-1899) nga vetë valiu i Manastirit, i cili kishte deklaruar se sa kohë që ai do të ishte në krye të administratës së Vilajetit, nuk do të jpte kurrë aprovimin e tij për këtë shkollë.

Qyteti i Beratit ishte një tjetër qendër e përhapjes së shkrimit shqip. Këtu u dallua veçanërisht për një veprimtari të palodhur patriotike Jorgji Karbunara, apo siç njihet me emrin Babë Dudë Karbunara. Ky ishte vënë në lidhje me rilindës të shquar si Naim Frashërin, Kostandin Kristoforidhin, Hasan Tahsinin etj. Qysh në moshë të re, megjithëse kishte mbaruar shkollën në gjuhë të huaj, filloi t'u mësojë bashkëdhetarëve shkrimin shqip.

Nëpërmjet të kushëririt, Kristo Karbunarës, tregtar në Vlorë, Babë Dudës i vinin libra shqipe nga shoqëritë shqiptare të mërgimit dhe ky i shpërndante në Berat e në rrethin e tij.



Babë Dudë Karbunara

Në Berat u bënë përpjekje të reja për të çelur një shkollë shqipe. Më 1892 duket se popullsia e Beratit kishte arritur t'i shkëpuste qeverisë otomane edhe premtimin se do të lejonte hapjen e një shkollë shqipe në Berat, por ky mbeti vetëm premtim¹⁾.

Në kuadrin e këtyre përpjekjeve, po më 1892, Babë Dudë Karbunara, sa-

1) HHStAPAA: informac. i konsullit austro-hungarez të Janinës, Nr. 4/res, datë 2 mars 1892.

po mori vesh se Nikolla Naçoja do të hapte në Bukuresht një shkollë normale për përgatitjen e mësuesve të gjuhës shqipe¹⁾, zgjodhi dy të rinj beratas dhe i nisi për në atë shkollë, por autoritetet sunduese ranë në gjurmë dhe i arrestuan që të dy.

Për shkak të aktivitetit patriotik Babë Duda nuk po shihej me sy të mirë as nga autoritetet osmane dhe as nga mitropoliti i Beratit, Dorotheu, të cilët filluan ta luftonin. Meqenëse Babë Duda ishte bërë i njohur dhe gëzonte simpatinë e popullit, formalisht e linin të lirë, por fshehurazi e luftuan gjatë gjithë kohës. Ai vuajti sidomos nga intrigat e mitropolitit, i cili e akuzonte se gjoja «ai po orvatet që të bëjë shkëputjen e Shqipërisë prej Patrikanës ekumenike»²⁾ të Stambollit.

Në anën kundërshtare të Babë Dudës ishin edhe feudalët e mëdhenj të Beratit si Azis Pashë Vrioni etj.

Dora armike arriti gjer aty sa në shtatorin e vitit 1894 t'i djegë shtëpinë Babë Dudës, gjoja «aksidentalisht». Autorët e vërtetë të kësaj djegjeje ishin Azis Pasha dhe mitropoliti Dorothe. Vetë Babë Duda ka shkruar në ditarin e tij me këtë rast: «Duke gdhirë 14 shtator 1894 (simbas kalendarit julian) u dogj shtëpia e Karbunarës në Kala të Beratit prej zjarri jo aksidental, por të vënë»³⁾.

Lufta që po i bëhej nuk e mposhti dhe nuk e dekurojoi Babë Dudë Karbunarën. Përkundrazi, ai e shtoi edhe më shumë veprimtarinë e tij për përhapjen e gjuhës së shkruar shqipe dhe për forcimin e ndjenjës kombëtare midis bashkatdhetarëve. Ai mbante lidhje me shumë bashkëpunëtorë në Vlorë, Myzeqe, Fier dhe në disa fshatra të Beratit si në Poshnje, Paftal etj.

1) Shkolla normale shqiptaro-vllahe e hapur në Bukuresht nga Nikolla Naço, më 1892, ishte mjaft e kufizuar dhe për shkak të vështirësive që i dolën nuk mundi të plotësojë deri në fund detyrën e rëndësishme por të vështirë që i kishte vënë vetes.

2) HHStAPAA: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Vlorës Nr. 25, datë 24 gusht 1898.

3) «Arësimi popullor», 1961, nr. 2, fq. 53.

Ndërsa në fillim Babë Duda, krahas detyrës së avokatit, u jepte edhe mësim shqip djemve në një han të vogël dhe mbi një rrogoz, më vonë, për shkak edhe të ndjekjeve që po i bëheshin, hyri si mësues i gjuhës italiane në gjysmë-gjimnazin rumun të Beratit. Qëllimi i tij ishte që nëpërmjet mësimit të rregullt t'u mësonte nxënësve fshehurazi shkrimin shqip dhe t'u ngjallte atyre ndjenjën e atdhedashurisë.

Në përhapjen e shkrimit shqip në Berat u dalluan gjithashtu Sulo Resuli, Nyzhet Vrioni etj., që qysh herët u muarën me mësimin e gjuhës shqipe.

Përparimet e bëra në krahinën e Beratit i shqetësuan autoritetet sunduese osmane, të cilat në fund të shekullit XIX i shtuan ndjekjet kundër patriotëve shqiptarë. Kjo bëri që të kufizoheshin veprimtaria patriotike dhe kontaktet me shoqëritë shqiptare jashtë atdheut.

Një kontribut të çmuar dha në të mirë të shkollave shqipe Dervish Hima¹⁾. Për dy vjet me radhë Dervish Hima bëri udhëtime nëpër krahinat e Starovës, Elbasanit, Tiranës, Krujës, Matit, Dibrës e Gostivarit dhe zhvilloi kudo që shkoi një veprimtari të gjallë patriotike. Krahas propagandimit të ideve kombëtare, ai themeloi ilegalisht disa shkolla të vogla shqipe apo qendra mësimore dhe shpërndau libra shkollore. I ndjekur pa pushim nga autoritetet sunduese të vendit ai u detyrua të largohej nga atdheu më 1897. Megjithatë, ai e vazhdoi aktivitetin e tij patriotik në Rumani e gjetkë.

Shkolla ilegale shqipe u hapën edhe në shumë qytete e fshatra të Shqipërisë. Në vitin 1896 u bënë përpjekje që me ndihmën e Naim Frashërit të hapej një shkollë private shqipe në Përmet. Në një letër që Naim Frashëri i drejtonte një funksionari osman në Përmet (ose në Ja-

1) Në vitin 1895, Dervish Hima, në moshën 22-vjeçare, arratiset nga Stambolli, ku vazhdonte shkollën e lartë mjekësore, dhe kthehet ilegalisht në Shqipëri. I shtyrë nga ndjenjat patriotike dhe me qëllim që t'i shërbente sa më shumë atdheut të robëruar, ai braktisi shkollën e profesionin dhe iu kushtua çështjes kombëtare.

ninë) shkruhet: «Ky që të sjell letrën time të përvujtë, Lluqa Papa Avrami, dëshiron të çelë në Përmet një shkollë dhe t'i shërbejë vendit e bijvet të Atdheut. Në fakt shkollat kristiane (greke) aty janë gjithnjë në të vetmet duar të priftërinjvet dhe shkojnë sipas qejfit të tyre... Prandaj kryeni në këtë rast veprimet ligjore dhe të përpigëni që të hapet kjo shkollë»¹⁾. Por edhe kjo shkollë nuk rezultoi të jetë hapur.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe ndjenjat kombëtare përhapeshin me sukses, gjithnjë në forma ilegale, edhe në shumë krahina të tjera të vendit si në Gjirokastrë, Çamëri, Dibër, Vlorë, Skrapar etj.

Puna e filluar në Qestorat e Gjirokastrë nga Koto Hoxhi u vazhduar nga bashkëpunëtorët dhe nxënësit e tij. Harito Çakoja, babai i poetit të mirënjohur të Rilindjes, Anton Zako Çajupit, krahas ushtrimit të tregtisë, u muar edhe me përhapjen e idesë së bashkimit kombëtar; shpërndante abetare shqipe dhe u tregua i gatshëm të jepte një shumë të caktuar çdo vit për shkollën e Sheperit me konditë që të futej në të mësimi i gjuhës amtare²⁾. Për shkak të pengesave të shovinistëve grekë, mësimi i gjuhës shqipe nuk u fut në atë shkollë.

Në krahinën e Çamërisë gjithashtu kishte një përhapje të mirë lëvizja arsimore e kulturore. Një nga nxënësit e parë dhe më besnikë të Hasan Tahsinis ishte Rexhep Demi, i cili, duke vazhduar veprën e filluar nga mësuesi i tij, u shqua si përhapës i ideve kombëtare në Çamëri³⁾. Rexhep Demi u vu në lidhje me shoqëritë shqiptare jashtë atdheut, merrte prej tyre libra e gazeta shqipe dhe i shpërndante këto nëpër qytetet e fshatrat e Çamërisë, pa marrë parasysh rreziqet e kërcënimit që i vinin nga autoritetet osmane dhe veglat e tyre. Me punën propagandistike ai mundi të tërhiqte rreth vetes shumë të rinj, të

1) AQSH i RPSSH, Fondi N. Frashëri, dos. 2.

2) AQSH i RPSSH, Fondi «25 vjetori i pavarësisë». Dosja e Gjirokastrës.

3) Po aty.

cilëve vetë u mësonte shkrimin e leximin e gjuhës amtare¹⁾.

Me qëllim që të zgjerohej dhe të organizohej më mirë veprimtaria kombëtare Rexhep Demi, aty nga vitet 1893-1894, u takua në Filat me Sabri Prevezën, me të cilin ranë në marrëveshje që të zhvillonin më tej sidomos punën për përhapjen e shkrimit të gjuhës shqipe në të gjithë Çamërinë. Me krijimin e kësaj lidhjeje u forcuan marrëdhëniet edhe me shumë qendra të tjera të Shqipërisë si dhe me shoqëritë patriotike të mërgimit. Një pjesë e mirë e librave e gazetave shqipe, që dërgonin shoqëritë shqiptare jashtë atdheut me anën e Prevezës, shpërndaheshin jo vetëm në Çamëri, por edhe në gjithë viset e Toskërisë²⁾.

Vetëm në Prevezë Sabri Preveza u kishte mësuar shkrimin shqip më tepër se 40 vetave. Në këtë mënyrë po i pritej deri diku rruga përhapjes së mëtejshme të propagandës shoviniste greke dhe po forcohej ndërgjegja kombëtare.

Nga një letër e Sabri Prevezës dërguar shoqërisë «Dituria» të Bukureshtit në vitin 1899, mësojmë: «Duhet të zgjojmë ata mëmëdhetarë që gjenden në gjumë e të mos i trembemi Fizanit dhe Bosforit³⁾, se posa u trembëm këtyre... s'fitojmë gjëkafshë, andaj duhet të kemi guxim e shpejtim në shërbesë të mëmëdhesë sa që të fitojmë qëllimë. Këtu në Prevezë tashti... zunë të mësojnë shqipen, po na duhen abetare të mëdha dhe të vogla, se sa herë që i flasim ndonjë shqiptari për nevojën e shqipes, na kërkon abetare e kur s'kemi t'i apim helmohemi»⁴⁾.

1) AQSH i RPSSH, Fondi «25 vjetori i pavarësisë». Dosja e Gjirokastrës.

2) Po aty.

3) Në Fizan dhe Bosfor internoheshin e të shumtën e herës vriteshin gjithë ata që vepronin në kundërshtim me interesat e Perandorisë Osmane.

4) Letër e Sabri Prevezës dërguar nga Preveza shqiptarëve në Bukuresht më 26 dhjetor 1899.

Përparime në përhapjen e shkrimit e librit shqip u shënuan edhe në qytetin e Vlorës e në rrethin e tij. Në këtë fushë u dalluan në fillim Kristo Karbunara, Musa Ali Berberi e më vonë Epaminonda Koleka, Jani Minga etj. Kristo Karbunara, qysh kur ishte nxënës në shkollën greke të Kalasë së Beratit, kishte mësuar shkrim dhe lexim shqip, ashtu si edhe i kushëriri, Babë Dudë Karbunara. Ai u vendos në Vlorë dhe, megjithëse merrej me tregti, u bë një përhapës i dalluar i librave shqipe të sjella nga jashtë dhe i ideve kombëtare. Ai hyri shpejt në korrespondencë me Jani Vreton në Bukuresht, me Spiro Dinen në Egjipt dhe me shumë patriotë të tjerë¹).

Një punë të palodhur shumëvjeçare bëri në Vlorë Musa Ali Berberi. Ndonëse pa kryer ndonjë shkollë, Musa Berberi, i shtyrë nga atdhedashuria, që ndër të parët që përhap shkrimin e gjuhës shqipe në Vlorë. Për 20 vjet me radhë, deri sa vdiq (në fillim të vitit 1905) ai punoi me të gjitha mundësitë në dobi të gjuhës e të kombit të vet. Shtëpia dhe dyqani i Musait ishin edhe depo për librat e gazetatat shqipe, prandaj edhe ishin bastisur shumë herë nga sundimtarët osmanë, por ai kishte marrë masat e duhura dhe nuk ra në kurthet e tyre. Në saj të punës së tij dhe të patriotëve të tjerë vlonjatë, me qindra djem e vajza mësuan të shkruajnë e të lexojnë gjuhën e tyre²).

Përpyetje për përhapjen e shkrimit shqip u bënë edhe në zonën e Dibrës. Në këto përpyetje u shquan që në vitet 1895-1896 Hamdi Ohri dhe Said Hoxha (Najdeni), por autoritetet qeveritare morën menjëherë masa për t'i prerë rrugën kësaj veprimtarie «të rrezikshme». Hamdi Ohri, për shkak të veprimtarisë patriotike u arrestua në vitin 1895 dhe u mbajt në burgun e Manastirit deri në shtatorin e vitit 1899. Pothuajse të njëjtin fat pati edhe Said Hoxha, i cili u internua më 1896 si njeri «i dyshimtë». Por masat e sunduesve nuk mund ta ndalnin përhap-

1) AQSH i RPSSH. Fondi «25 vjetori i pavarësisë». Dosja e Qarkut të Beratit.

2) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 60, datë 22 prill 1905, fq. 2.

jen e shkrimit e të shkollës shqipe në Dibër. Bile Hamdi Ohri edhe në burg organizoi një kurs për mësimin e shqipes dhe shumë shqiptarë të burgosur kur dolën nga burgu i Manastirit dinin të shkruanin e të lexonin në gjuhën e tyre¹).

Dibranët ishin vënë në lidhje me patriotët shqiptarë të Manastirit, Kosovës, të Shqipërisë së Mesme si dhe me shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, prej nga silleshin libra e gazeta shqipe. Në formë ilegale e me përpjekje të përbashkëta, ndonëse pa patur shkollë e mësues, brenda një kohe të shkurtër, deri në fillim të vitit 1899, mësuan të shkruajnë e të lexojnë shqip më shumë se 300 veta²). Një kontribut të vyer për mbajtjen e kontakteve me rrethet patriotike shqiptare dhe për sjelljen e botimeve shqipe në Dibër dhanë në këto vite edhe Kadri Fishta e Selim Rusi. I pari ishte furnizues i ushtrisë turke, dhe e shfrytëzoi këtë detyrë, që i jepte mundësi të lëvizte më lirisht, për të kryer detyrat patriotike. Ata që e njohën atë personalisht e përshkruajnë si një burrë të gjallë, të arsyeshëm dhe besnik të çështjes kombëtare.

Zona e Korçës dhe e Kolonjës mbetej gjithnjë zona kryesore e përhapjes së shkrimit shqip dhe të shkollës shqipe. Pa marrë parasysh rreziqet, populli mësonte shkrimin e gjuhës së tij në mënyrë individuale ose në shkolla ilegale. Vendin e shkollave shqipe të Kolonjës dhe të Vakëfeve, të mbyllura për shkak të ndjekjeve, e zunë shkollat ilegale shqipe. Të tilla funksionuan në Luaras të Kolonjës, në Frashër dhe në fshatra të tjera. Duke e njohur këtë realitet, konsulli austriak i Manastirit i raportonte Vjenës në fillim të vitit 1899: «sa e madhe është bërë dëshira për arsim, del nga ajo që popullsia me gjithë rreziqet që i kanosen nuk trembet dhe kthehet vazhdimisht te dëshira e saj e zemrës, themelon shkolla fshehu-

1) HHStAPAA: Informacion i Kons. austro-hungarez të Manastirit, Nr. 22, datë 31 mars 1899.

2) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit Nr. 15, datë 12 mars 1899.

razi, dhe funksionimin e këtyre krijesave të saja përpiqet ta sigurojë deri sa të shkojë»¹⁾.


Kërkesa të forta për hapjen e një shkollë shqipe kish-te patur nga popullsia e Negovanit. Në fund të shekullit XIX, katundi Negovan, prej rreth 300 shtëpish, nga ana administrative bënte pjesë në kazanë e Follorinës të san-xhakut të Manastirit. Megjithëse popullsia e tij ishte shqiptare, aty kishte vetëm një kishë dhe një shkollë greke. Në kushtet e rënda të sundimit osman dhe të veprimt energjik të politikës helenizuese, negovanasit, të ushqyer me idetë e reja të rilindësve, u aktivizuan shpejt në lëvizjen kombëtare. Shpirti i aspiratave kombëtare u bë aty Kristo Harallambi, i njohur me emrin Papa Kristo Negovani²⁾. Pas tre vjet qëndrimi në Rumani, Kristoja, më 1897, kthehet në atdhe dhe hidhet në veprime konkrete patriotike, pa marrë parasysh as rreziqet e mëdha dhe as rrethanat e vështira.

Duke zbatuar porositë e shoqërisë shqiptare të Brailës, me të cilën i ruajti gjithnjë lidhjet dhe duke menduar se në kushtet e atëhershme mund t'i shërbente më

1) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 27, datë 11 prill 1899.

2) Pasi mbaroi shkollën fillore të fshatit të lindjes, Kristoja ndoqi edhe 5 klasë të gjimnazit, jashtë vendit. Kur i vdiq i ati, më 1891, ishte 16 vjeç dhe për të plotësuar nevojat e familjes hyri në punë si mësues në shkollën greke të Leskovacit, dhe një vit më vonë, në atë të Bellkamenit.

I pakënaqur nga puna që bënte, më 1894, në moshën 19 vjeçare, Kristoja, ashtu si shumë bashkëfshatarë të tij, emigroi në Rumani dhe u vendos në qytetin Braila. Filloi të punonte si marangoz për të siguruar jetesën e njëkohësisht u lidh me rrethet e përparuara patriotike shqiptare të atjeshme. Dashuria për atdheun e rrënjësor tek ai në vendlindje dhe atmosfera patriotike e krijuar në Brailë nga puna e bërë qysh herët prej Naum Veqilharxhit dhe më vonë prej degës së shoqërisë së Bukureshtit, bënë që Kristoja qysh në moshë të re të shquhet si një aktivist i palodhur i lëvizjes kombëtare.



Papa Kristo Negovani

mirë çështjes së atdheut, Kristoja u bë prift në fshatin e lindjes, në Negovan¹⁾. Nëpërmjet kësaj rruge, tani Papa Kristoja do të punonte pa u lodhur dhe me një zell të veçantë për kultivimin e përhapjen e gjuhës amtare. Pa dijeninë e eprorëve të tij ai i bënte predikimet në gjuhën shqipe. Në marrëdhëniet me famullitarët përdorte vetëm shqipen dhe nxënësve të shkollës greke filloi t'u mësojë shkrim e këndim shqip. Ai filloi të botojë edhe libra të vogla me karakter fetar dhe laik. Shtëpia e Pa-

pa Kristos u kthye në një shkollë të vërtetë ku mësonin në gjuhën amtare rreth 100 fëmijë e të rritur nga Negovani e Bellkameni. Kjo shkollë u bë edhe një çerdhe për edukimin patriotik. Për nevojat e kësaj shkolle, së cilës i mungonin të gjitha mjetet, Kristo Negovani shpenzonte edhe të ardhurat e veta mujore. Atë e ndihmonin edhe patriotët negovanas të Brailës. Negovanasit ishin treguar të gatshëm për hapjen e një shkolle shqipe dhe për caktimin e një mësuesi shqiptar, por realizimi i kësaj kërkesë ndeshte në vështirësi të shumta. Për këtë arsye në Negovan Papa Kristoja vazhdoi ta mbante të fshehtë shkollën shqipe, e cila dha rezultate mjaft pozitive.

Kristo Negovani u interesua gjithashtu për të dërguar nga fshati i tij vajza në shkollën shqipe të vajzave

1) Dh. Fullani, «Papa Kristo Negovani», Në Buletini USHT — Seria e shkencave shoqërore, 1960, Nr. 2, fq. 183.

në Korçë, për të mësuar gjuhën shqipe¹⁾ dhe për të ndihmuar pastaj në përhapjen e saj në bashkëfshatarët e tyre. Veprimtaria patriotike e Papa Kristos u prit mirë e u mbështet nga negovanasit dhe e bëri të njohur emrin e tij në rrethet patriotike shqiptare, por ajo shkaktoi njëkohësisht shqetësimin dhe kundërveprimin e armiqve të lëvizjes sonë kombëtare e veçanërisht të kishës ortodokse, e cila nuk mund të lejonte në asnjë mënyrë që një prift ortodoks të vepronte në kundërshtim me politikën helezuesë greke.

Shkrimi i shqipes po përhapej gjithashtu me shpejtësi ilegalisht në Tiranë, Krujë, Fier, Mallakastër etj.

Për të organizuar më mirë përhapjen e shkrimit shqip dhe shpërndarjen e botimeve në gjuhën shqipe si dhe për të përballuar shpenzimet në rritje që bëheshin për këto qëllime, u krijuan një numër shoqëriash të vogla të fshehta së bashku me arkat e tyre. Shoqëri të tilla u formuan në vitet e fundit të shekullit XIX në Tiranë, Dibër, Mat, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë²⁾, Krujë etj. Arkat e këtyre shoqërive shërbenin, në radhë të parë, për të plotësuar nevojat e zonës ku vepronte shoqëria, por, në raste të veçanta, ato ndihmonin edhe njëra-tjetrën.

Nga të dhënat dokumentare rezulton se shoqëria e fshehtë e Tiranës ishte formuar rreth vitit 1896. Çdo anëtar paguante një kontribut mujor që shkonte nga një grosh deri në një lirë turke. Organizimi i shoqërisë ishte i tillë që anëtarët dhe dhuruesit e shumave nuk mund të njihnin njëri-tjetrin. Shumat e paguara kalonin në duar të besuara deri sa arrinin në destinacionin e tyre. Ky fond përdorej për të blerë libra shkollore, broshura të ndryshme dhe gazeta shqipe, për t'i sjellë ato kontrabandë si dhe për të ndihmuar ata patriotë që ndiqeshin e vuanin brenda Perandorisë, ose ata që jetonin e punonin për kauzën shqiptare jashtë atdheut.

1) «Revista pedagogjike», 1972, Nr. 1, fq. 169.

2) HHStAPAA: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Durrësit, nr. 20, datë 3 shtator 1901.

Në këtë mënyrë, mësimi i gjuhës shqipe mundi të përhapej jo në shkolla të rregullta publike, jo në lokale shkollore dhe mbi banka, por në vende të fshehta, nëpër shtëpi, në dyqane e depo, në shkolla ilegale e në burgje, jashtë në natyrë, në male e në fusha, më shumë me djem të rritur, me burra të pjekur e me ushtarë shqiptarë, sesa me fëmijë të moshës shkollore.

«Shkollatë nuk u shtuanë e të vinin mbarë si duhe-
she, — shkruan Sami Frashëri — po shkronjatë shqipe u
përhapnë në të gjitha anët e Shqipërisë, edhe burra e gra,
djem e vasha të gjithë mësuari në pak kohë të shkruajnë
e të këndojnë... Shqipëtarë është mësuari të nxerë
shkronjat edhe pa shkollë nëpër sheshe...»¹).

1) S. Frashëri, Vepër e cituar, fq. 89.

IX

PERPARIMI I METEJSHËM I SHKOLLAVE SHQIPE TË KORÇËS NË DEKADËN E FUNDIT TË SHEKULLIT XIX

Vitet e fundit të shekullit XIX shënuan një hap tjetër përpara në zhvillimin e arsimit tonë kombëtar. Shkollat shqipe të Korçës, me gjithë pengesat e shumta, kishin bërë përparime dhe ishin shndërruar në vatra të rëndësishme të arsimit e të kulturës shqiptare, prej nga shpërndaheshin rrezet e dritës në gjithë Shqipërinë e Jugut e deri diku edhe të Mesme.

Në vitin shkollor 1893-94 si drejtor i shkollës shqipe të djemve në Korçë ishte Nuçi D. Naçi.¹⁾ Puna e dobët e

1) Nuçi Naçi kishte lindur në Korçë më 1871 në një familje të mesme tregtare. I ati, Dhimitri, kishte punuar, ashtu si shumë korçarë të tjerë, në kurbet, në Misir (Egjipt), së bashku me të vëllanë Sotirin, i cili në Korçë njihej dhe me mbiemrin Çami (Sotir Çami).

E ëma e Nuçit, Katerina, rridhte nga familja patriotë korçarë e Markollarëve, nga e cila ishte patrioti Thimi Markoja.

Mësimet fillestare Nuçi Naçi i mori, ashtu si dhe bashkëkohësit e tij, në shkollën e qytetit të lindjes, ku mbaroi edhe gjysmëgjimnazin në gjuhën greke. Shpejt pas përfundimit të shkollës ai iu kushtua detyrës së mësuesit të shqipes në fillim në Treskë e pastaj në Korçë.

drejtorit të mëparshëm, Janko Minxha, kishte bërë që shkolla të çalonte përkohësisht; shumë prindër i kishin larguar fëmijët nga shkolla pa ardhur provimet e fundit të vitit shkollor 1892-93. Armiqtë e çështjes shqiptare e kishin shfrytëzuar këtë rast në dobi të tyre dhe kishin shtuar përpjekjet për ta mbyllur fare shkollën.

Me ardhjen e Nuçi Naçit në detyrën e drejtorit të shkollës shqipe të Korçës gjendja u përmirësua. Ai i kishte gjithë aftësitë e duhura për detyrën që i ishte ngarkuar si dhe vullnetin e mirë për të justifikuar përgjegjësinë e luftës që lu besua. Ai bëri përpjekje për të shtuar numrin e nxënësve dhe luftoi me vendosmëri kundër të gjithë armiqtë të shkollës e të lëvizjes kombëtare shqiptare.

E gjithë barra e shkollës binte tani mbi Nuçi Naçin. Ai ishte drejtor dhe mësues. I vetmi ndihmës i tij ishte shërbëtori i shkollës, Kristo Vodica, i cili vazhdonte të jepte mësim në klasën e parë. Kjo gjendje vazhdoi për rreth tre vjet deri më 1896. Numri i nxënësve arrinte gjer në 60-80 për stinën e dimrit ndërsa në stinën e ngrohtë zbrishte në 45-50.¹⁾

Puna e drejtorit vështirësohej sepse nuk kishte diplomë për detyrën që kryente dhe kjo dihej nga organet qeveritare²⁾. Përveç këtyre, mungesa e mjeteve financiare nuk ishte një pengesë e vogël; drejtuesit e shkollës vepronin me shumë kujdes kur kërkonin ndihma, për të mos shkaktuar që përkrahësit e shkollës të bëheshin objekt ndjekjesh e arrestimesh nga ana e autoriteteve qeveritare osmane, të cilat nxiteshin për këtë pa ndërprerje nga Mitropolia e grekomanët. Shpenzimet për shkollën ishin shumë të kufizuara; ato siguroheshin nga disa familje shqiptare myslimane e të krishtera të Korçës dhe

1) Në stinën e ngrohtë numri i nxënësve pakësohej, sepse prindërit i ngarkonin me punë të tjera për të ndihmuar ekonominë e familjes.

2) N. Naçi, Artikull i cituar, f. 166.

një ndihmë që dërgohej nga Shoqëria «Dituria» e shqiptarëve të Bukureshtit.

Natyrisht, në krahasim me popullsinë e Korçës numri i nxënësve ishte mjaft i ulët. Por rëndësi kishte jo numri i nxënësve, por fakti që kjo shkollë, me gjithë luftën e ashpër që i bëhej dhe vështirësitë e tjera, mundi të qëndrojë e çelur dhe të frekuentohet pa ndërprerje e në harmoni si prej nxënësve të krishterë, ashtu edhe prej atyre muslimanë. Pikërisht ky bashkëpunim midis banorëve të të dy besimeve kishte rëndësi të madhe për të ardhmen e Shqipërisë së robëruar. Kjo bënte efektin e vet në mënyrë të heshtur në ndërgjegjen politike të masave popullore.

Shkolla shqipe e djemve në Korçë u bë gjithashtu një qendër e rëndësishme për mësimin e të rriturve. Kristo Vodisa nuk ishte vetëm shërbyes i shkollës e mësues për klasën e parë, por edhe mësuesi i të rriturve. Ai i shërbeu me besnikëri shkollës gjatë gjithë ekzistencës së saj, i kushtoi asaj pa kursim e për shumë vite të gjitha aftësitë e veta, dhe me punën e tij të palodhur hyri në historinë e arsimit shqiptar si një figurë e dashur dhe patriotike. Rreth Kristo Vodices mblidheshin djem të rritur, çirakë dyqanesh, zanatçinj, këpucarë, teneqexhinj, kovaçë etj. dhe «burra me mustaqet te veshi» të pashkollë, por të etshëm për të mësuar në gjuhën amtare. Numri i tyre

Letër e Naim Frashërit dërguar
Thimi Markos në Korçë më 1892

arrinte deri në 25 veta¹⁾. Kur ishte koha e keqe, mësimi i të rriturve zhvillohej brenda në klasë, por në pjesën më të madhe të kohës ai zhvillohej jashtë, në oborrin e shkollës.²⁾

Mësimi i të rriturve zhvillohej herë në orët e vona të paraditës, herë pasdite.

Në verën e vitit 1896³⁾, pas provimeve të qershorit, drejtori i shkollës, Nuçi Naçi, pas një pune të lodhshme dhe në kushte shumë të vështira politike dhe ekonomike, duke pasur si ndihmës vetëm Kristo Vodicën, u largua nga shkolla dhe nga Korça. Ai vajti tek i ungji në Misir, ku qëndroi vetëm dy vjet dhe u kthye përsëri në detyrën e mëparshme.

1) «Arësimi popullor», 1957, Nr. 6, fq. 58.

2) Një përshkrim interesant të mësimi të këtyre të rriturve na jep në kujtimet e veta ish-nxënësi i rregullt i shkollës së Korçës, Ilo M. Qafëzezi: «Atje në oborr, pasi ne (nxënësit e rregullt) hynim në klasat, mblihdheshin djem e burra, analfabetë të gjithë, ndër të cilët figurën më piktoreske e bënin *kollxhinjtë* (rojtarët e thjeshtë të duhanit) gunëzez e gunëbardhë dhe me fustanella, pastaj dhe burrat nxënës të tjerë, të veshur me dollama, stre të shëjakta, me feste në kokë, me opinga me xhufkë apo këpucë jançoçe etj., të zhuritur të mësojnë gramë shqipe, për të cilën tani ndjenin nevojë të madhe... Ndë mest të tyre, qëndronte Xha Ristua (Kristo Vodica), burrë i himët, butarak e gojëmjaltë, i veshur me dollama, pallto, feste të kuqe, këpucë me grykë, çorape të bardha ngjeshur me tizga të zeza.

...Në të mbaruar të mësimi, Xha Ristua kurrë nuk e përcillte klasën pa i kënduar ndonjë vjershë nga të Naimit, që ta mësonin dhe ata pas tij...». Në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej A. I. H.). Materiale të I. M. Qafëzezi, libri I, fashikulli 7.

3) Sipas artikullit të cituar të Nuçi Naçit dhe të materialeve të tjera, si vit i largimit të Nuçi Naçit nga shkolla jepet viti 1895. Siç duket edhe këtu ka një pasaktësi në datën e largimit, po ashtu dhe të kthimit. Sipas korrespondencave personale të kohës del qartë se ai është larguar më 1896 dhe është kthyer më 1898 dhe jo më 1897.

Krahas me shkollën e djemve në Korçë vazhdonte jetën e vet edhe shkolla shqipe e vajzave. Gjatë vitit shkollor 1894-95 shkolla kishte rreth 40 nxënese, të cilat ndiqnin me zell mësimet pa marrë parasysh asnjë vështirësi. Nga një letër që Thanas Sina i dërgonte Nikolla Naços në dhjetor 1894 mësojmë: «Skolij e çupavet vete mbar'e më mbarë, edhe me anë të asaj faqeza duketë, se sa e vjejturë është gjuh'e mëmësë jo vetëm për mësimet... si numuratore, dheshkronjë (arithmetikë, gjeografi) etj. po edhe për të mësuarë më shpejt e më hollë gjuhërat e huaja. Nxënëset mësojnë e arësenenë me të këtillë dituri e mënyrë, që të jenë shqiptarka të vërteta, jo vetëm me gjuhë po edhe me zemër. Neve shprejmë (shpresojmë)... se pemët e kësaj skoliqe do të jenë të shumta, të plota e të vjejtura për gjithë kombinë».¹⁾

Të shqetësuar nga vazhdimi me sukses i shkollës, armiqtë e popullit shqiptar duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin, po vepronin më me energji për të likuiduar këtë vatër kombëtare. Megjithëse formalisht ekzistonte një irade për këtë shkollë, vazhduan të përdoren mjete e metoda të ndryshme si intrigat, kërcënimet dhe persekutimet kundër personelit të saj dhe prindërve të nxënësve. Shpesh autoritetet qeveritare dërgonin policët që të sekuestronin ato të pakta libra shqipe që ishin siguruar me vështirësi dhe të urdhëronin mbylljen e shkollës.

«Një ditë — shkruan Sevastia në kujtimet e veta — pashë para derës së shkollës komisarin e policisë të shoqëruar prej 4 policësh, disa xhandarësh dhe disa hamejve të pajisur me thasë. Nga qëndrimi i komisarit të policisë kuptova se qëllimi i tij ishte të sekuestronte librat dhe të mbyllte shkollën. Por pas një beteje vullnetesh prej dy orësh ai u largua i mundur.»²⁾ Pas kësaj ngjarjeje shkolla u vu nën vëzhgim dhe policët vazhdimisht bënin rojë në rrugën e saj për të penguar nxënëset të hynin në shkollë, ndërsa priftërinjtë shkonin në familjet e nxënësve të

1) AQSH i RPSSH, Fondi i N. Naços. Dos. 4: letër e Thanas Sinës dërguar nga Korça Nikolla Naços në Bukuresht më 7/19 dhjetor 1894.

2) S. Qiriazi, Vep. e cituar, fq. 33.

duke i kërcënuar prindërit me çkishërim e burgim. Si pasojë numri i nxënësve të shkollës pati përsëri rënie, veçanërisht i atyre myslimane. Megjithatë, një pjesë e nxënësve vazhdonin rregullisht shkollën; shpesh ato nuk kalonin rrugës së zakonshme, por nëpër rrugë të tjera dhe hynin në shkollë duke kaluar nëpër portat e shtëpive rreth e rrotull shkollës. Dëshira dhe etja e tyre për arsim në gjuhën amtare dhe forcimi i ndjenjave kombëtare i shtynin të kapërcenin çdo pengesë.

Një vështirësi tjetër që duhej përballuar ishte mungesa e teksteve shkollore. Një punë shumë të madhe bënin vetë mësueset e shkollës Sevastia dhe Fanka. Në shkollë nuk kishin veçse abetare dhe disa libra leximi. Ato punonin deri në orët e vona të natës. Duhej punuar për tekstet që mungonin dhe njëkohësisht të përgatiteshin për mësimin. Materialet mësimore që përgatitsnin, duhej shumëfishuar në hektograf për t'ua dhënë nxënësve. Edhe këtë punë e bënte vetë Sevastia e ndihmuar nga Fanka. Në hektograf shumëfishoheshin gjithashtu shkrimet origjinale të Gjerasimit apo të Gjergjit. «Ne — shkruan Sevastia — kishim shumë pak libra. Netët i kthenja në ditë, por u shpërbleva me gëzimin dhe krenarinë për atë që arritëm të bëjmë... Një fjalë e veçantë mirënjohjeje duhet thënë për Fankë Eftimin, që me besnikëri punoi me mua duke më ndihmuar të hektografoj kopjet e nxënësve».1)

Krahas punës për plotësimin e nevojave të përditshme, Sevasti Qiriazhi arriti të përgatiste edhe tri tekste të reja mësimore: *Historinë*, *Fizikën* dhe *Numeratoren* (Aritmetikën), të cilat, sipas dëshmimeve të bashkëkohësve, ishin me një cilësi të mirë dhe shumë më të plota se ato që ekzistonin gjer atëherë. Në një letër që Thimi Markua u dërgonte shqiptarëve të Bukureshtit, shkruante: «Fort helmonemi se vivllat që kemi janë fort të pakta dhe të shkurtëra. Këtu Sevasti Qiriazhi ka bërë gati për të shtypur tri vivlla, të cilat janë shumë më të gjata dhe më të mbaruara, nuk dimë në muntni sot për sot t'i shtypni a

1) S. Qiriazhi, vep. e cituar fq. 33.

jo».¹⁾ Me gjithë përpjekjet e bëra, nga sa dihet, këto tekste kaq të rëndësishme për shkollat shqipe, për mungesë mjetesh financiare e për shkak vështirësish të tjera nuk mundën të shohin dritën e botimit.

Ashtu si shkolla e djemve, shkolla e vajzave ishte kthyer në një vatër mësimi edhe për të rritur. Një numër i madh djemsh të rritur vinin rregullisht pasdreme në oborrin e shkollës ku u mësonte shkrimin e leximin shqip vetë drejtoresha e shkollës, Sevastia. Dhe, posa mësonin këta djem të shkruanin e të lexonin, ua mësonin atë shokëve e të afërmëve të tyre.

«Ishte një kënaqësi për mua — shkruante Sevastia — kur shikonja zellin dhe dëshirën e tyre për të lexuar dhe shkruar. Duke qenë se numri po shtohet gjithnjë, unë u premtova atyre pushimet e mia të paraditës dhe pasditës. Ata vinin gjithmonë në kohë, bile para kohe, dhe prisnin në rrugë deri sa vinte ora e tyre.»²⁾

Pas përfundimit të vitit shkollor 1894-95, si zakonisht u organizua ceremonia e mbylljes së vitit shkollor. Gëzimi këtë vit ishte më i madh se herët e tjera. Një nga tri nxënëset e para të kësaj shkolle, Polikseni A. Dhespoti (Luarasi), e cila kishte arritur e vetme në klasën IV, e mbaroi shkollën dhe mori dëftesën e përfundimit të mësimëve. Polikseni qysh në moshë të vogël, pa u çelur ende shkolla e vajzave, kishte filluar mësimet në shkollën e parë shqipe të Korçës. Me t'u çelur shkolla e vajzave, ajo u regjistrua në të dhe e ndoqi me një zell e dëshirë të veçantë. Ajo u dallua jo vetëm për përparimin e mirë në mësim, por edhe në punën e gjallë për të tërhequr vajza të tjera në shkollën shqipe dhe në përhapjen e mësimi të shqipes³⁾. Për përgatitjen e mirë dhe

1) Letër e Thimi Markos dërguar nga Korça shqiptarëve në Bukuresht më 4/16 tetor 1897.

2) S. Qiriaz, vep. e cituar, fq. 35.

3) Vetë drejtoresha e shkollës e cilësonte Poliksenin me fjalët më të mira, me rastin e përfundimit të shkollës: «Ndë taksin (klasën) IV kemi paturë vetëm një çupë, Poliksena A. Dhespot,

për ndjenjat patriotike që kishte, Polikseni u mbajt si mësuese për klasat e ulëta në shkollën e vajzave.



Polikseni Dhespoti (Luarasi)

plotë dhe prej saj do të përgatiteshin edhe mësuese të tjera, të cilat, për kushtet e atëhershme të Shqipërisë, plotësonin një nevojë të madhe të kohës.

Në fjalën e drejtoreshës së shkollës, me rastin e mbylljes së atij viti shkollor, theksohej rëndësia e arsimit të rinisë shqiptare dhe optimizmi për të ardhmen. «Cili është ay njeri — thoshte Sevasti Qiriazhi — që ka lindurë i diturë ndë këtë botë, edhe cili është ay komb që prej

e cila mbaron mësimet e kësaj skolie. Nga kjo çupë neve jemi shumë të kënaqurë, tërë kohën e saj që ka qenë ndë skolit, munt të themi se ka qenë e çquarë ndë tërë mësimetë, si edhe ndë punë të dorësë. Shprejmë (shpresojmë) se këtë dituri që ka fituarë ndë këtë skoli, dota përdornjë, jo vetëm për të mirën e saj, po edhe për të mirën e kombit».

vetiu u gjent i ditur dhe i qytetëruar?... Shqipëtarët janë një komb i zgjuarë që kanë shumë kamje të vrejtura, të cilët vetëm nd'i punofshinë, mund të sjellën mirësi edhe lumëri për kombinë t'onë».1) Dhe më poshtë, duke folur për rolin e edukatës në shoqëri, vazhdonte: «Njerin të pa mësuarë munt t'a përgjajmë si një copë mermeri fshehurë ndë dhet, i cili s'ka as ndonjë bukuri më vethe, po kur meretë nga punëtori skalisetë, edhe zbukurrohetë, atëherë është vëjyerë për punë. Kështu është edhe me diturinë kur punohetë ndë mendjet të njeriut; bënë një gjë fort e vjejturë që e larton njerinë edhe e bën të jetë i zoti, edhe i dobishëm si për vetehn'e tij kështu edhe për kombinë (mëmëdhenë)».2)

Në vitin e ri shkollor 1895-1896 shkolla filloi mësimet duke patur drejtoreshën dhe dy mësuese. Me qëllim që përgatitja të bëhej sa më e mirë, kishin filluar të tërheqin vajza të vogla edhe në kopshtore. Me gjithë vështirësitë dhe rreziqet e shumta, shkolla ecte — siç ka shkruar Parashqevi Qiriazi më vonë — «gjithnjë përpara në rrugën e vet, posi një anije që ecën duke çarë valët e detit në kohë fortune».3). Sa më shumë pengime, sa më shumë vështirësi i shkaktoheshin shkollës, sa më shumë luftohej nga armiqtë e saj, aq më shumë ndizej flaka e patriotizmit në zemrat e nxënësve dhe të prindërvet të tyre.4)

Numri i nxënësve pati një farë ngritjeje. Për vitin shkollor 1895-1896 pati rreth 40 nxënës; për vitin shkollor 1896-1897 pati 42 nxënës dhe për vitin shkollor 1897-98 mbi 50 nxënës. Çdo vit provimet bëheshin publike dhe shoqëroheshin me programe artistike në gjuhën shqipe. Këto ceremoni shndërroheshin në manifestime të fuqishme patriotike dhe luanin një rol të madh edukues e propagandues në dobi të lëvizjes kombëtare.

1) Kristomathi, vep. e cituar, fq. 298-303.

2) Po aty.

3) P. Qiriazi, «Shkolla e parë shqipe e vajzave». Në «Fletë nga historiku i shkollës sonë». Tiranë, 1963, fq. 29.

4) Po aty, fq. 31.

Bile në përfundim të vitit shkollor 1897-98, përveç programit të zakonshëm artistik, me kërkesën e grave myslimane u dha një program i veçantë vetëm për to.¹⁾ Ato mbetën shumë të kënaqura e të mallëngjyera. Shumë prej tyre u shprehën se «do t'i dërgonin vajzat në këtë shkollë, ku, në gjuhën amtare, mund të mësonin më lehtë e më mirë çdo dituri të nevojshme»²⁾.

Dhe vërtet, numri i nxënëseve myslimane erdhi duke u rritur. Në fillim të vitit shkollor 1898-99, nga 45 nxënëse që ishin regjistruar, 16 ishin myslimane³⁾, megjithëse mësueset dhe drejtoresha, nga ana e besimit, ishin të krishtera. Përveç drejtoreshës dhe dy mësueseve, Fan-kës dhe Poliksenit, tani që shkolla ishte zgjeruar, jepte mësim (lëndën e aritmetikës) edhe Thanas Sina. Tekstet që përdorshin ishin po ato të shkollës së djemve, por mjetet e tjera mësimore i kishte më të shumta e më të mira.

Ndonëse autoritetet osmane shqetësoheshin për përparimet e shkollës dhe e kuptonin rëndësinë e saj për lëvizjen kombëtare shqiptare, nuk guxonin ta mbyllnin, jo vetëm sepse dikur sulltani kishte lëshuar një iradë për çeljen e saj, por edhe për shkak të mbështetjes morale e materiale që ajo gjente në masat popullore dhe në patriotët shqiptarë. Në këtë drejtim ndikoi edhe fakti se autoritetet osmane mendonin se shkolla shqipe e vajzave ishte nën mbrojtjen e shteteve të huaja. Në të vërtetë, ishte nën mbrojtjen e shteteve të huaja, nuk ishte shkollë shoqëri «bamireshë» e «fetare» të huaja, nuk ishte shkollë nën «mbrojtjen» e të huajve dhe u shërbeu jo synimeve politike të shoqërive «bamireshë» të shteteve imperialiste, por edukimit patriotik e lëvizjes kombëtare shqiptare.

1) Gratë myslimane në atë kohë bënë një jetë mjaft të mbyllur. Ato nuk mund të merrnin pjesë në programe artistike së bashku me burrat, prandaj edhe kërkuan një seancë të veçantë.

2) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, viti II, nr. 52, datë 15 tetor 1898, fq. 3.

3) HHStAPAA: Informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 27, datë 11 prill 1899.

Vetë konsulli austro-hungarez i Manastirit, pasi ishte mirinformuar dhe për qëllimet e qeverisë së vet e kishte studiuar çështjen edhe në këtë aspekt, detyrohej t'i raportonte Vjenës se «dhuruesit nuk kishin asnjë të drejtë mbikëqyrjeje, mbrojtjeje ose dispozicioni mbi institutin (shkollën shqipe të vajzave)... Kjo shkollë nuk është aspak një shkollë misioni e njëanshme konfesionale ose bile protestane»¹). Megjithatë, në ndonjë moment të rrezikshëm për shkollën, kjo u paraqit përpara autoriteteve sunduese osmane sikur ishte nën «mbrojtjen» e të huajve.²)

Ndërkohë shkollës shqipe të djemve në Korçë iu desh të përballonte disa vështirësi më të mëdha, sidomos për sigurimin e kuadrit mësimor.

Me langimin e drejtorit të mëparshëm të shkollës, Nuçi Naçi, për në Egjipt, në shkollë kishte mbetur vetëm Kristo Vodica. Mirëpo, në atë kohë, ishte një problem shumë i vështirë të siguroje qoftë edhe një mësues për shkollën shqipe. Përveç përgatitjes së nevojshme që duhej të kishte, personi që do të merrte përsipër këtë detyrë duhej të ishte, në radhë të parë, një patriot i mirë dhe i vendosur për të mbrojtur gjuhën shqipe e çështjen shqiptare nga çdo sulm i autoriteteve osmane, i kishës ortodokse e agjenturës shoviniste apo i kujdo qoftë tjetër.

Pasi nuk qe e mundur që drejtimin e shkollës ta mirrte përsipër Petro Nini, kjo detyrë iu ngarkua Kristaq Vajës nga Gjirokastra. Para se të mirrte këtë detyrë, Kristaq Vaja punonte në Starovë dhe siguronte të ardhura shumë të mira; megjithatë ai e pranoi detyrën që iu ofrua.³)


Në këtë mënyrë viti shkollor 1896-97 filloi me drejtor Kristaq Vajën, i cili pati si ndihmës Nikollaq Zografin dhe Kristo Vodicen⁴). Edhe nga ana ekonomike shkollë pati një përmirësim. Këtu ndikoi pozitivisht fakti që

1) Po aty. Informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 47/res, datë 7 korrik 1899.

2) Po aty.

3) Letër e Jovan Kosturit, dërguar nga Korça shqiptarëve në Bukuresht, më 30 tetor 1896.

4) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 171.



Kristo Vodica

shoqëria «Dituria» e shqiptarëve të Bukureshtit, pas riorganizimit të saj më 1896, kishte vendosur ta ndihmonte shkollën e Korçës me shumë vjetore prej 1000 frangash. Këto rrethana dhe sidomos sigurimi i personelit mësimor ngjallën shpresa për një zhvillim të mëtejshëm të shkollës. Duke shprehur këto shpresa, Jovan Kosturi shkruante në letrën drejtuar shqiptarëve të Bukureshtit: «Sot psoni se skolinë e vumë mbë udhë të mirë edhe kemi umis (shpresë)... që të bëjmë shumë përpara, se dhe

psonjësit i kemi shumë të mirë e të diturë, nga kjo sërë edhe djemtë na shtonenë dita me ditë. Edhe nevet e kemi marrë me nxehtësirë si e si ta nderojmë punën tonë». Dhe më poshtë, duke shprehur nevojën e ngutshme të shkollës për libra mësimore, ai vazhdonte: «Me të marrë këtë kartë të na dërgoni vivlla të mësimi të historisë, të vjershavet, të luleve të veresë, të numratorvet, të dheshkronjavet me gjithë një hartë që të refejë gjithë viset e Evropës...»¹).

Është e vërtetë se numri i nxënësve pati një rritje, në tetor 1897 shkolla kishte rreth 32 nxënës, ndërtesës shkollore iu bënë disa meremetime etj, por veprimtaria mësimore kishte treguar se çështja e personelit pedagogjik nuk ishte zgjidhur si duhet. Drejtori i shkollës Kristaq Vaja, që kishte peshën kryesore përsa i përkiste më-

1) Letër e Jovan Kosturit dërguar shqiptarëve të Bukureshtit më 30 tetor 1896.

simit të gjuhës shqipe, me gjithë gadishmërinë e tij nuk kishte përgatitjen e duhur.

Viti i dytë i punës së drejtorit në shkollë e bëri edhe më të qartë nevojën e sigurimit të një mësuesi të përgatitur mirë. «Shumë herë u shkrova — theksonte në një letër Thimi Markoja — sërënë të mësonjëtoresë, që është nevoja e madhe të viret në një udhë dhe rregull të mirë, që të muntjnë të mbrothësojë (përparojë) si duhetë, dhe për këtë lypsetë të gjendet një mësonjëtor i mirë, i diturë, i thjeshtë, dhe me vetija të paqme. Për fat të lik nuk gjejmë pa mundim mësonjëtorë»¹⁾.

Si u mendua çështja nga të gjitha anët, doli se një person i përshtatshëm të cilit mund t'i besohej edhe drejtimi i shkollës, ishte Nuçi Naçi, dhe u vendos që t'i drejtoheshin atij në Egjipt. «Unë dhe gjithë miqtë — shkruante Thimi Markoja — e gjejmë për të mirë dhe për nevojë të mësonjëtoresë, që Nuçi të vinjë dhe të jetë përgjithnjë në shkollë, se është djal'i nderçëmë, me zell të madh dhe me dëshira të plota... Kështu mbesonj, që të hyjë pak në udhë shkolla dhe të mbrothësojë...»²⁾.

Sipas vendimit që ishte marrë nga Këshilli apo Komiteti i Mësonjëtores, Thimi Markoja dhe Spiro Kosturi i drejtuan disa letra Nuçi Naçit në Egjipt. Ata e vinin në dijeni Nuçin mbi gjendjen e shkollës shqipe të Korçës dhe e ftonin që të vinte në qytetin e lindjes për të marrë përsëri drejtimin e saj. Nuçi Naçi po mbushte dy vjet që ishte larguar nga shkolla. Edhe në Egjipt, sado që u muar me tregti, ai ishte shquar si propagandist i çështjes kombëtare dhe si i tillë ishte luftuar nga grekomanët e atjeshëm. Gjithashtu kishte ruajtur, të gjallë dëshirën për t'u rikthyer në punën pedagogjike. Me marrjen e letrave nga Korça ai u tregua i gatshëm të plotësonte kërkesën e patriotëve të Korçës që ishte njëkohësisht dhe plotësimi i dëshirave të tij. Pasi u muar

1) Letër e Thimi Markos, dërguar shqiptarëve të Bukureshtit më 8/21 maj 1898.

2) Po aty.



Nuçi Naçi në moshë të pjekur

vesh me «interesuesit e idesë kombëtare në Korçë»¹⁾, vendosi të braktiste tregtinë e të kthehej në atdhe për t'iu kushtuar detyrës së ofruar.

Në gusht të vitit 1898 Nuçi Naçi la Egjiptin dhe u kthye në Korçë për të rimarrë drejtimin e shkollës.²⁾

Viti shkollor 1898-99 filloi rregullisht dhe me personelin mësimor të plotësuar. Përveç drejtorit, në shkollë u muarën edhe dy mësues të tjerë Thanas Nona dhe Nikolla Lako. Po ashtu vazhdonte punën Kristo Vodica.³⁾ Me masat që u morën u përmirësua gjendja e shkollës,

u plotësua kuadri mësimor, u pasurua programi dhe u shtua numri i nxënësve, «nga 20-40 që kish më parë, në 80-100».⁴⁾ Por përparimet e shkollës shqipe u pritën me shqetësim nga armiqtë e popullit shqiptar, të cilët e forcuan luftën e egër e të shumanshme kundër saj.

1) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 171.

2) Në shkrime të ndryshme, duke përfshirë edhe ato të Nuçi Naçit data e kthimit të tij në Korçë është vënë gabimisht gusht i vitit 1897. Letra e Thimi Markos e majit 1898, në të cilën thuhet se po bëhen përpjekje për të vënë Nuçi Naçin në drejtimin e shkollës është një dëshmi e qartë që provon se ai është kthyer në Korçë në verën e vitit 1898.

3) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 171.

4) Material autobiografik i N. Naçit, ruajtur nga i biri S. Naçi në Korçë.

Drejtoria e policisë filloi të kërkonte me insistim lejen e shkollës dhe diplomat e mësuesve.

Ndjekjet u shtuan sidomos me ardhjen në Korçë të mytesarifit të ri, Mehmet Ali Pashë Delvinës, feudal shqiptar i vënë në shërbim të sunduesit, i cili u shqua në luftën e ashpër që i bëri shkollës shqipe deri në fund të ekzistencës së saj. Lindi kështu rreziku i mbylljes së shkollës.

Autoriteteve qeveritare osmane iu paraqit si leje për shkollën ajo që ishte dhënë mbi emrin e Petro Nini Luarasit, me një shkresë nga ana e tij, ku thuhej se Nuçi Naçi ishte zëvendësi i tij mbasi ai, gjoja «për arësye shëndetësore», duhej të banonte

në Luaras. Megenëse kjo lejë u konsiderua e parregullt, Nuçi Naçi kërkoi t'i lihej një afat prej tre muajsh. Mytesarifi nuk pranoi dhe drejtori i shkollës shqipe iu dha prokurorisë si «njeri që kishte shkelur ligjet qeveritare». Patriotët shqiptarë, sidomos ata të Korçës dhe të Manastirit, bënë të gjitha përpjekjet për të ndryshuar këtë situatë të rrezikshme. Para se të vinte data e gjykimit, Nuçi Naçi, u nis për në Manastir, ku u prit me përzemërsi nga patriotët shqiptarë, të cilët ishin vënë në lëvizje për ta ndihmuar atë. Veçanërisht u dallua patrioti Halit Berzeshta, i cili ndonëse zyrtarisht ishte në shërbim të Perandorisë, kryente në ilegalitet një veprimtari të gjallë patriotike në dobi të lëvizjes kombëtare shqiptare.



Thanas Nona

«Në shtëpi të Bej Babajt (Halit Berzeshtës) — shkruan Nuçi Naçi — u bisedua një natë si të nisej puna, edhe u shtruan planet»¹⁾. I ndihmuar prej tyre, Nuçi Naçi mori lejën për të mbajtur çelur shkollën, dhe pas një provimi që dha përpara një komisioni në Manastir, mori edhe diplomën e kërkuar. Sipas pohimit të Nuçi Naçit në letrën që i dërgohej mytesarifit të Korçës nga valiu i Manastirit përsëritej porosia «Kjo shkollë u çel si u çel, le të lihet çelur; shikoni mos hapen të tjera!»²⁾



Nikolla Lako

Nuçi Naçi, së bashku me dokumentet e kërkuara, u kthye në Korçë dhe në datën e caktuar u paraqit në gjykatë. Duke parë se dokumentet e shkollës ishin të rregullta, gjykata e ndërpreu gjykimin e çështjes dhe drejtori i shkollës u konsiderua i pafajshëm e u lirua. «Gjithë miqtë u gëzuan — shkruan Nuçi Naçi — edhe armiqve u ra pika kur panë se dokumentet që donte ligji ishin të plota. Më shumë se 200 veta kishin ardhur atë ditë në gjyq»³⁾.

Mbrojtja me sukses e shkollës pati jehonë pozitive në masat e gjera popullore.

Viti i ri shkollor 1899-1900 filloi rregullisht. Numri i nxënësve u shtua në 64. Tani në shkollë ishin drejtori,

1) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 170.

2) Po aty.

3) Po aty, fq. 171.

mësuesi Thanas Nona e Kristo Vodica; mësuesi Nikolla Lako ishte larguar.

Për të frenuar sadopak përparimin e shkollës autoritetet qeveritare kishin urdhëruar që të ndalohej frekuentimi i shkollave shqipe të Korçës nga djemtë e vajzat myslimane. Urdhri ishte i prerë dhe prindrit e nxënësve myslimanë u detyruan ta zbatojnë në fillim. Megjithatë nxënësit myslimanë mblidheshin nëpër shtëpitë e njëri-tjetrit dhe studionin librat e shënimet e shkollës shqipe.

Ndonëse me shumë vështirësi, shkolla shqipe e djemve në Korçë e vazhdoi jetën e vet. Programi mësimor i saj ishte ai i një shkolle fillore katërklasëshe. Nuçi Naçi jepte mësim në klasën III e IV, ndërsa Thanas Nona në kl. I e II. Mësimi zhvillohej me klasë kolektive. Lëndët mësimore ishin: leximi, shkrimi, aritmetika, gramatika e gjuhës shqipe, histori natyre, njohuri elementare të shkencave natyrore, gjeografia dhe historia botërore, duke marrë parasysh veçanërisht Turqinë dhe Shqipërinë, si dhe greqishte e re dhe turqisht. Me përjashtim të një harte të Shqipërisë, në shkollë nuk kishte asnjë mjet tjetër mësimor. Të gjitha këto mungesa materiale duheshin plotësuar nga puna e gjallë e mësuesve, të cilët u treguan të pakursyer.

Një mungesë e madhe ndihej për tekstet shkollore. Librat kërkoheshin jo vetëm për shkollat, por edhe për gjithë ata që dëshironin të mësonin shkrim e lexim shqip, por sjellja e tyre në Shqipëri bëhej gjithnjë e më e vështirë.

Një diplomat i huaj shkruante në atë kohë nga Manastiri se «të gjithë miqtë e shkollës (sidomos ata të Manastirit), në mënyrë të përsëritur pothuajse u sulmuan me lutje për plotësimin e kësaj nevojë (për tekste mësimore)»¹).

Problem i vështirë ishte sjellja e librave nga Bukureshti e nga Sofja, ku shtypeshin ato. Autoritetet qe-

1) HHStAPAA: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 46, datë 14 korrik 1900.

veritare osmane kishin dhënë urdhra dhe kishin marrë masa që të ndalohej çdo libër shqip i dërguar me postë ose me rrugë të tjera. Nga një letër e Nuçi Naçit dërguar shqiptarëve të Bukureshtit mësojmë: «...Shumë në shtrëngim të madh jemi për vivlla (libra) dhe jo vetëm për abetare, po edhe për të tjera. Vivlla kërkohen shumë, po kur s'kemi ç'të bëjmë?... shikoni e përpiqi të na dërgoni ca copë që ngandonjë anë.

Ne këtu nuku mundim të bëjmë *as gëk!* kaq fort jemi rrethuarë!! Ja nga Seleniku ja nga ndonjë udhë tjetërë lipsetë të gjendet një farë udhe... U lutemi shumë të përkujdesi për këtë gjë, flisni me miqtë aty si të gjendet një farë udhe për të sjellë vivlla se ndryshe jemi në rrezik për motin që vjen. Ç'të bëjmë dhe ne të mjerrëtë që këtej? Ne na janë lidhur kemb' e duar bashkë...»¹⁾. Me gjithë këto, shkolla e djemve vazhdonte veprimtarinë dhe viti shkollor 1899-1900 u mbyll me shumë sukses. Ceremonia e organizuar me atë rast ishte nga më të gëzueshmet dhe me një pjesëmarrje shumë të madhe. «Kishim ftuar shumë njerëz pas zakonisht — shkruan Nuçi Naçi — po jo më shumë se 100, po kaq shumicë njerzish ardi sa s'kishim ku të rrinim, me një fjalë s'kishte ku të shtinje një mollë... Bashkë me ne kishin provime edhe në gjimnazio edhe vlehtë po as çereku i njerëzve që ardi ndër ne nuku kish vaturë në mësonjëtoret e tjera. Gjithë bota u gëzuan edhe ne u gëzuam se dualmë të nderuarë si kurrë ndonjëherë»²⁾.

1) AQSH i RPSSH, Fondi i Shoqërisë Shqiptare të Bukureshtit. Dos. Nr. 68, Letër e Nuçi Naçit datë 26 qershor 1900.

2) Po aty.

X

RRITJA E LËVIZJES PËR SHKOLLËN KOMBËTARE SHQIPE NË FUND TË SHEKULLIT XIX DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX u shënua një ngritje e re në lëvizjet për çlirimin kombëtar të popujve të shtypur të Ballkanit. Politika e shtypjes ekonomike, politike dhe kulturore e Perandorisë Osmane, zullumet dhe abuzimet e shumta të administratës së saj të korruptuar kishin keqësuar edhe më tepër gjendjen e masave popullore dhe si pasojë marrëdhëniet midis këtyre e sunduesit të huaj kishin ardhur duke u acaruar.

Në keqësimin e situatës politike në Ballkan dhe në rritjen e lëvizjes kombëtare në Shqipëri e Maqedoni ndikoi edhe politika reaksionare imperialiste e shoviniste e Fuqive të Mëdha evropiane dhe e shteteve fqinje ballkanike.

Shpallja e dekretit për «reforma në Maqedoni» nga ana e Sulltanit, në prill të vitit 1896, nuk mund të qetësonte gjendjen politike e aq më pak të zgjidhte detyrat që qëndronin përpara popujve të robëruar. Në të vërtetë dekreti i «reformave» synonte të ndalte hovin e lëvizjes kryengritëse maqedonase dhe, duke ruajtur gjendjen politike ekzistuese, të evitonte ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha në punët e brendshme të Perandorisë Osmane.

Lëvizja kombëtare shqiptare po kalonte në atë kohë

në një fazë të re zhvillimi. Krahas luftës kundër zgjedhës osmane asaj iu desh të përballonte edhe rreziqe të tjera imediate, siç ishte ai i copëtimit të viseve shqiptare. Rreziku i copëtimit vinte si nga riaktivizimi i shteteve fqinjve ballkanike për të realizuar synimet e tyre ekspansioniste në dëm të tokave shqiptare, tashti që po acaroheshin situata politike në Maqedoni, ashtu edhe nga zbatimi i të ashtuquajturave «reforma» për Maqedoninë. «Reformat» maqedonase do të zbatoheshin edhe në vilajetet e Manastirit e të Kosovës, ku shumica e popullsisë ishte shqiptare. Situata u ndërlikua më tepër me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha imperialiste, të cilat donin të nxirrnin përfitimet e rastit.

Rreziku i copëtimit të truallit shqiptar shkaktoi një shqetësim të ri tek të gjithë shqiptarët. Shqiptarët në përgjithësi ishin kundër përfshirjes së tokave të tyre në zonën ku do të zbatoheshin «reformat për Maqedoninë» dhe për organizimin e mbrojtjes nga çdo rrezik i jashtëm. Por, ndërsa krerët feudalë e bajraktarët shqiptarë mjaftoheshin vetëm me kërkesën e përjashtimit të krahinave shqiptare nga «reformat për Maqedoninë», duke e lënë Shqipërinë nën sundimin osman, rrethet patriotike rilindëse brenda dhe jashtë atdheut shtruan edhe kërkesën për sigurimin e të drejtave kombëtare të veçanta për Shqipërinë. Duke e vlerësuar drejt situatën e brendshme e të jashtme politike patriotët shqiptarë vazhduan t'i përmbahen edhe në këtë periudhë programit politik autonomist. Tashti që u vu në rend të ditës përsëri «çështja e reformave» për popullsitë e shtypura të Ballkanit, shqiptarët paraqitën kërkesat e tyre me karakter politik, ekonomik e kulturor. Ato synonin të lehtësonin gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhej populli shqiptar, që krahinat shqiptare të ndara në katër vilajete të bashkoheshin në një vilajet të vetëm, me një administratë të veçantë, me shkolla shqipe etj. Në vitet 1896-1897 patriotët shqiptarë brenda atdheut dhe ata të shoqërive patriotike të mërgimit i shprehën këto kërkesa në memorandumet që u drejtuan Fuqive të Mëdha

e qeverisë së Stambollit. Qëllimi i fundit i këtyre kërkesave ishte të shpëtohej Shqipëria nga copëtimi midis shteteve fqinje, të veçohej trualli shqiptar nga ai i Perandorisë Osmane, e cila po shkonte drejt shkatërrimit të pashmangshëm dhe të përgatiteshin kushtet që do të lehtësonin shndërrimin e Shqipërisë, në rrethana politike më të favorshme, në një shtet të lirë dhe të pavarur.

Lëvizja shqiptare u bë e fuqishme sidomos në krahinat verilindore dhe lindore të Shqipërisë, në Kosovë, në Dibër etj. që rrezikoheshin të shpërbëheshin nga trangu i atdheut dhe të përfshiheshin në zonën e «reformave për Maqedoninë». Krahas kërkesave në rrugë diplomatike, në Shqipëri shpërtheu një lëvizje e re për të kundërshtuar me armë çdo cenim të tokës shqiptare. Që në vitin 1897 u bënë përpjekje në Kosovë e më vonë edhe në Dibër e Shkodër për të krijuar një qendër drejtuese dhe organizuese të lëvizjes.

Një rol të rëndësishëm udhëheqës po luante në këto vite patrioti Haxhi Zeka. Duke ndjekur shembullin e viteve të shkëlqyeshme të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren, u organizuan shumë mbledhje, veçanërisht në Pejë, ku në janar të vitit 1899 u krijua një lidhje e re — Lidhja e Pejës.

Mbledhje të rëndësishme u organizuan në Dibër, Shkodër etj., të cilat solidarizoheshin me Lidhjen e Pejës. Me gjithë qëndrimin e kufizuar dhe të njëanshëm të krerëve feudalë, në këto mbledhje u shtrua jo vetëm çështja e luftës kundër copëtimit, por edhe kërkesa për autonominë e Shqipërisë.

Në kushtet kur në lëvizjen kombëtare shqiptare po shënohej një ngritje e re, si në organizimin e luftës së armatosur, ashtu edhe në zhvillimin e mëtejshëm të mendimit politik shqiptar, ishte fare e natyrshme që edhe lufta për përhapjen e shkrimit shqip dhe për shkollën kombëtare të ashpërsohej më tepër.

Në të gjitha mbledhjet dhe kërkesat shqiptare një vend me rëndësi zinte gjithnjë çështja e gjuhës dhe e shkollës shqipe.

Përveç kërkesave të plota autonomiste, shqiptarët brenda dhe jashtë atdheut parashtruan shumë herë gjatë viteve të fundit të shek. XIX edhe kërkesa të veçanta për gjuhën e shkollën shqipe. Bile nga fundi i shekullit XIX edhe lëvizja spontane e armatosur kundër barrës së taksave dhe shtypjes së pushtetit osman po shtronte gjithnjë e më tepër kërkesa kombëtare, para së gjithash kërkesat për hapjen e shkollave shqipe, për përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe etj. Kështu, në vjeshtën e vitit 1896 në Elbasan masat u revoltuan për shkak të mbledhjes së një takse për nevojat e shkollave të hapura nga sunduesi osman. Banorët e qytetit me anën e një peticioni kërkuan jo vetëm heqjen e taksës së re, por edhe hapjen e shkollave shqipe në Elbasan në vend të atyre turke. Në peticion thuhej ndër të tjera se hapja e shkollave shqipe duhej të përgatiste administrimin autonom të Shqipërisë. Meqenëse nuk morën përgjigje nga Stambolli, banorët e Elbasanit filluan të përgatiten për kryengritje të armatosur.

Në një kërkesë tjetër të bërë nga krahina e Shpatit të Elbasanit në fund të vitit 1896 shtrohej nevoja e ndërhyrjes pranë Portës së Lartë «me qëllim që ajo të na akordojë edhe neve lirinë për t'u arsimuar në gjuhën tonë kombëtare si të gjithë kombet e tjerë të nënshtruar të Perandorisë Otomane... Duke qenë shqiptarë dhe në qendër të Shqipërisë, ne nuk kuptojmë as greqisht, as bullgarisht dhe asnjë gjuhë tjetër, dhe nuk mund të shkillohemi veçse në gjuhën tonë shqipe.

...Ne dëshirojmë lejen zyrtare për të pasur shkolla shqipe në krahinën tonë... Me një fjalë ne dëshirojmë të kemi atë të drejtë që në Turqi e kanë të gjitha kombësitë...»¹⁾

Përkrahës dhe interpretë të këtyre kërkesave në Stamboll u bënë vëllezërit Frashëri si dhe patrioti Murat Toptani. Ky i fundit në një letër të po asaj kohe reko-

¹⁾ AQSH i RPSSH. Fondi i Ibrahim Temos, Dos. 32/6, dok. 237, dorëshkrim frëngjisht.

mandonte që kërkesa të tilla drejtuar Portës së Lartë duhej të dërgonin edhe krahina të tjera si dhe shqiptarët e kolonive të mërgimit. «...Sa ma (shumë) — t'ja shtrëngojsht (sunduesit) — shkruante Murat Toptani — aq më i vogël bëhet. Të mos rrini, të kërkojmë ditë e natë lirinë e mësonjëtorevet e të gjuhës shqipe. Sot asht dita!»¹⁾ Dhe vërtetë, në një kërkesë që i drejtonin Sulltanit, në pranverë të vitit 1897, shqiptarët e Rumanisë kërkonin të lejohej mësimi i shqipes duke e kërcënuar atë edhe me revolucion. «Kombi ynë shqiptarët — thuhej në këtë kërkesë — ...për të siguruar të drejtat e tyre s'kanë marrë udhën e ngritjes (revolucionit)... por Guverna (qeveria) asnjëherë s'ka dashur të bëjë të mirën dhe kombi ynë ka mbetur i varfër në literaturën kombëtare. Po nuk e pranoi qeveria që të mësojmë lirisht gjuhën domosdo myslimanë dhe të krishterë të gjithë djemt e mëmëdheut do t'i hidhemi armës... dhe guvernës do t'i kushtojë shumë shtrenjtë... Duhet të kemi gjuhën fare të lirë dhe gazetat në gjuhën shqipe që do të dalin në Evropë... edhe të tjera (botime shqipe)... t'i lini të hynë fare lirisht në të gjitha anët»²⁾.

Në një numër artikujsh gazeta «Shqipëria», që filloi të botohej në Bukuresht, tregonte se «nga të tëra anët e Shqipërisë miren kartëra, të cilat dëfthejnë që atje bënet një lëvizje e madhe. Njerëzit u squan edhe kërkojnë vivlla edhe duan të kenë shkollë»³⁾ se «llauzi (populli) atje kërkon shkollë të vendit, shkollë kombiare»⁴⁾.

Në nëntor të vitit 1898 në Bukuresht u mbajt një Kongres Kombëtar kushtuar posaçërisht problemit të shkollave shqipe. Konkluzioni i mbledhjes ishte se në kohën kur në Shqipëri të huajt kishin themeluar rreth pesë mijë shkollë, mësimi i gjuhës shqipe dilte si një detyrë urgjente për t'i bërë ballë kësaj situate dhe për të arsi-

1) AQSH i RPSSH. Fondi i Ibrahim Temos, Dos. 32/6, dok. 237, dorëshkrimi frengjisht.

2) Po aty, dos. 32/5, dok. 1398/4.

3) «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 23, dt. 11 tetor 1897.

4) Po aty, nr. 17, dt. 30 gusht 1897.

muar masat popullore shqiptare. Në fund u vendos t'i dërgohej sulltanit një telegram, nënshkruar prej 12 shqiptarësh të zgjedhur, me anën e të cilit i kërkohej që të lejonte mësimin e shqipes në të gjitha shkollat që ekzistonin në Shqipëri¹⁾, dhe se «çdo vonim në të mos lënë të lirë shqiptarët të mësojnë gjuhën e tyre do t'u ngrërë durimnë...»²⁾.

Dëshira e zjarhtë për të mësuar e për të çelur shkolla shtroi edhe problemin se si do të siguroheshin mjetet e nevojshme materiale që mungonin. Dhe përgjigjja më e drejtë ishte ajo e mbështetjes në forcat e veta. «Lipset t'a besojmë — shkruante gazeta «Shqipëria» në atë kohë — që ç'do gjë duhet t'a presim vetë nga vetëhja jonë»³⁾.

Krahas kërkesave për një shkollë shqipe të pavarur dhe kombëtare, në këtë periudhë vazhdoi të shtrohej edhe kërkesa për futjen e gjuhës shqipe në shkollat në gjuhë të huaj që ekzistonin në Shqipëri, ose për shndërrimin e tyre në shkolla kombëtare. Kështu në Shkodër shqiptarët e të dy besimeve i kërkuan më 1897 valiut që të futej «edhe gjuha shqipe ndë shkolla»⁴⁾. Kërkesa të tilla u bënë edhe nga krahina të tjera të vendit. Po në atë kohë gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit shtronte detyrën që shkollat «që mbahenë nga llasot (arkat) e venditë, (është fjala për shkollat në gjuhën greke) duhet dhe mundet t'i ktheimë në shkolla kombiare»⁵⁾.

Por qeveria otomane, e mbështetur nga politika imperialiste e ruajtjes së statukuosë e Fuqive të Mëdha, qëndronte e vendosur në politikën e saj antishqiptare. Ajo hodhi poshtë çdo kërkesë që iu drejtua për shkolla shqipe nga shqiptarët brenda dhe jashtë atdheut. Ajo ndalonte

1) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 54, datë 30 nëntor 1898.

2) «Kalendari Kombiar», viti III, Sofie, 1899, fq. 9-10.

3) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 23, dt. 11 tetor 1897.

4) Po aty, nr. 29, dt. 22 nëntor 1897.

5) Po aty, nr. 46 dt. 15 korrik 1898.

shkrimin shqip, shkollën shqipe dhe librin shqip, në një kohë kur vazhdonte t'u linte dorë të lirë veprimi në tokat shqiptare shkollave të huaja greke, sllave, italiane etj. dhe kur vetë përpiquej të shtonte sa më tepër shkollat në gjuhën turke.

Ndonëse të ndjekur e në kushte të vështira, patriotët shqiptarë i shtuan përpjekjet për të përhapur arsimin në gjuhën amtare. Në qytetet dhe në fshatrat e vendit arsimtarët patriotë u mësonin nëpër kurse të fshehta bashkatdhetarëve të rinj e të rritur abetaren e gjuhës shqipe. Zakonisht këto kurse zhvilloheshin nëpër shtëpi private dhe në vende të tjera të fshehta. Ngandonjëherë abetarja shqipe vazhdonte t'u mësohej nxënësve fshehurazi nëpër shkollat turke e greke. Kur këto përpjekje diktoheshin, shkaktonin ndërhyrjen e klerit fanatik turkoman apo grekoman dhe të xhandarmërisë në dëm të arsimtarëve trima apo të prindërve të nxënësve.¹⁾

Me gjithë vështirësitë e shumta dhe në luftë me reaksionin e jashtëm e të brendshëm, lëvizja ansimore e kulturore eci përpara. Shprehje e rritjes së mëtejshme të kësaj lëvizjeje ishte dalja, në vitet e fundit të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit tonë, e një numri organesh të reja dhe botimesh letrare, historike dhe pedagogjike. Në vitin 1897 filluan të botohen organe të tilla si gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit (1897-1899), almanaku i përvitshëm «Kalendari Kombiar» (1897-1915) etj., filloi të ribotohet gazeta «Shqipëtarë» e Bukureshtit (1899 dhe 1903), u botuan gazeta «Drita» e Sofjes (1901-1908), «Besa-Besën» në Kajro (1900-1904), «Albania» e Beogradit (1902-1905), «Kombi» i Bostonit, «Shpnesa e Shypnisë» (1905-1908), etj. U botuan gjithashtu broshura turqisht «Ujanallëm» («Të zgjohemi») e Dervish Himës më 1897, poema epike «Histori e Skënderbeut» e Naim Frashërit, traktati politik i Sami Frashërit, «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë» më 1899, etj.

Në këto vite patriotët shqiptarë nëpërmjet shtypit

1) Historia e Shqipërisë. vëll. II, Vep. e cituar, fq. 263.

demokratik, bënë një punë të madhe për përhapjen e shkrimit e të shkollës shqipe. Me anën e shtypit demokratik u bëhej thirrje gjithë shqiptarëve patriotë që të hapnin shkolla në Shqipëri dhe të mësonin në gjuhën amtare.¹⁾

Me anën e shtypit dhe të botimeve të veçanta dhe veçanërisht me veprën e Sami Frashërit «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë» u paraqitën në një mënyrë shumë më të plotë se gjer atëherë kërkesat shqiptare në fushën e arsimit e të kulturës kombëtare.

Në sistemin arsimor demokratik të Sami Frashërit parashikoheshin ndër të tjera: hapja e shkollave fillore në çdo fshat, ndërsa në qytete më shumë se një; arsimi fillor i detyruar për moshën 7 deri 13 vjeç dhe pa pagesë, bile nxënësve të varfër t'u jepeshin gratis librat, fletoret, lapsat dhe mjetet e tjera të domosdoshme për punën shkollore²⁾. Samiu parashikonte gjithashtu që në Shqipëri të hapeshin shkolla të dyta për djem e për vajza, shkolla profesionale për mjeshtritë e ndryshme, për bujqësinë dhe ushtrinë si dhe krijimin e gjithmësimës (universitetit) e të akademisë shqiptare.

Por mbi të gjitha qëndronte thirrja e fuqishme e Sami Frashërit për të përhapur diturinë dhe arsimin në masat popullore shqiptare. «Të hapim shkolla, të mësojmë, të mos mbesë ndonjë shqiptar i paditur — shkruante Samiu — të ngremë (të heqim) shkollat e huaja nga Shqipëria e të mbushimë mëmëdhenë tënë me shkolla shqip... edhe bariu edhe bujku edhe mjeshtri i murevet do të mos jenë pa dituri»³⁾. Në këtë mënyrë «ai — siç ka thënë shoku Enver Hoxha — luftonte për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe në të katër anët e vendit»⁴⁾.

1) «Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare» 1879-1908, Tiranë 1971, vëll. I, fq. 21.

2) S. Frashëri, Vepër e cituar, fq. 76.

3) S. Frashëri, Vepër e cituar, fq. 94.

4) «Shoku Enver Hoxha te rrapit në Mashkullorë kuvendon shtruar me fshatarët». Në «Zëri i Popullit» dt. 21 mars 1978, fq. 1.

Parashtrimi i kërkesave të reja në fushën politike e arsimore dhe zhvillimi i mëtejshëm i mendimit pedagogjik shqiptar ishin shprehje e aspiratave liridashëse e përparimdashëse të popullit tonë, ishin shprehje e rritjes në ato vite të lëvizjes masive popullore për përhapjen gjithnjë e më të madhe të shkrimit e të shkollës shqipe.

Dëshira për të mësuar shkrim e këndim shqip, për të lexuar abetaren, poezitë patriotike të rilindësve dhe gazetën në gjuhën shqipe ishte bërë e përgjithshme si për qytetin ashtu edhe për fshatin, si për zejtarin e tregtarin ashtu edhe për fshatarin e malësorin.

«Gjithë Shqipëria u ngjall — shkruante gazeta «Shqipëria» më 1897 — edhe dëftën dëshirë të ronjë një jetë më të mirë si komb i qytetëruar. Vivlla kërkonen; shkolla hapenë edhe ndë tërë vendin rëfeket një etje për mësim»¹). Po kjo gazetë na tregon se po bëheshin përgatitje për të çelur shkolla shqipe në Elbasan, Tiranë, Dibër dhe Krujë²), dhe se situata ishte mjaft e ndezur edhe në Gjirokastrë, Vlorë, Delvinë, Himarë etj.»³)

Pasi kishte parë gjendjen në vend, konsulli rus i Manastirit raportonte me keqardhje në fillim të vitit 1900: «Kohët e fundit jam duke dëgjuar gjithnjë më dendur lajmin mbi zgjimin e idesë kombëtare në mes të shqiptarëve dhe më kanë njoftuar se gati në të gjitha fshatrat janë duke u hapur shkolla të fshehta (shqipe).

...Duke dashur të bindem personalisht në se janë të vërteta këto lajme, gjatë udhëtimit tim për Elbasan jam ndalur në çdo fshat nëpër të cilin kalon rruga dhe kam hyrë në bisedime. Të gjithë ata... (shqiptarët) që në fjalët e para, filluan të shfaqin pakënaqësinë e tyre kundrejt qeverisë, e cila nuk lejon të hapen shkolla shqipe dhe hap me pahir shkolla turke, me qëllim që të zhdukë kombin shqiptar.

1) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 27, dt. 8 nëntor 1897.

2) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 17, dt. 30 gusht 1897 dhe nr. 29 datë 22 nëntor 1897.

3) Po aty, nr. 27, dt. 8 nëntor 1897.

Kur i pyeta, a ka shkolla të fshehta shqipe, të gjithë m'u përgjgjën se në fshatrat e malësisë ku pushteti osman është vetëm sa për sy e faqe, janë hapur shkolla, kurse në fshatrat e tjera mësojnë njëri-tjetrin dhe mua më treguan me kënaqësi librat shqip (tekste shkollore dhe almanakë të ndryshëm) si dhe gazeta të botuara në Bukuresht dhe në Sofje...

Mjerisht të gjitha këto libra e gazeta janë plot urrejtje jo vetëm kundër qeverisë otomane, po edhe kundër klerit grek, i cili përpiqet të greqizojë të krishterët...»¹⁾.

Popullsia e Elbasanit u shpreh kundër shkollave të reja turke që mendonin të hapnin autoritetet qeveritare (11 në zonën e Qukësit dhe 17 në të Elbasanit) dhe kërkonte mësues shqiptarë. «Po të kishte pasë mësues — raportonte një tjetër diplomat i huaj nga Manastiri, në tetor 1899 — shumë katunde do të kishin hapë shkolla me kokën e tyre, si p.sh. Berzeshta... Veç kësaj mungojnë edhe mjetet mësimore. . .

Të njëjtin opinion si në rrethin e Qukësit konstatova në të dy katundet myslimane Polis dhe Shushicë, që i përkasin Shpatit»²⁾. Gjithashtu në katundin Nezhan jo vetëm u bënë përpjekje për të çelur një shkollë shqipe, por u bisedua edhe për dërgimin e disa fëmijëve nga Shpati në shkollën e djemve në Korçë»³⁾.

Të ndodhur përballë ndjekjeve që i bëheshin mësimit e shkollës shqipe, patriotët shqiptarë po përpiqeshin të shfrytëzonin shkollat e huaja edhe në zonat malore, siç ishte ajo e Shpatit të Elbasanit. Për këtë qëllim patrioti shpatarak Isuf Qosja, në vitin 1900, pasi u muar vesh me krerët e fshatit Valësh dhe me ndërmjetësinë e konsullit grek të Manastirit, mori lejë nga autoritetet osmane

1) AQSH i RPSSH: Fondi «Çështja shqiptare në marrëdhëniet ruso-turke», Dos. 17.

2) HHStAPAA: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit Nr. 67 datë 26 tetor 1900.

3) Po aty, informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 76, datë 14 nëntor 1899.

për hapjen e një shkolle greke në atë fshat, gjoja për të mësuar greqisht.¹⁾ Mësuesi i kësaj shkolle Amina Biba (Bibaja) nga Elbasani, ditën jepte mësimet greqisht, ndërsa natën u mësonte nxënësve të tij shqip dhe kështu vazhdoi për shumë vjet.

Pikërisht në vrullin e kësaj lëvizjeje ishte krijuar në Elbasan shoqëria e fshehtë, e cila organizonte dhe drejtonte përpjekjet për mësimin e shkollën shqipe.

Në një letër interesante që i dërgohet nga Elbasani Halit Berzeshtës në Manastir nga fillimi i vitit 1900 mësojmë: «Shqiptarët e këtushëm (të Elbasanit) në pjesën më të madhe janë ashtu sikundër i duam. Ideja nacionale ka fituar shumë terren dhe bën përparime të mëtejshme. Neve u bashkuam në një shoqëri klandestine dhe me këtë... do të kryejmë një pjesë të mirë pune.

Kemi qëllim para së gjithash me ngritë kërkesën për njohjen e gjuhës sonë, dhe pikërisht së pari këtu dhe në qoftë se ajo nuk pranohet, edhe gjetkë, në shumë qytete. Më në fund kërkesa do të përsëritet telegrafisht me atë vend, të cilit i drejtohen për çështje të rëndësishme.

Por le t'i japim fjalën, besën shoqi-shoqit që mos ta lëmë shokun vetëm, por të përkrahim njani-tjetrin dhe në këtë mënyrë: me vepra dhe të holla!

Mitropoliti ortodoks grek përpiqet këtu me e shtue numrin e shkollave greke sidomos në Shpat. Atij i ka marrë koka erë qysh kur e dekoroi princi i Malit të Zi.»²⁾

Gjithashtu me anën e kësaj letre kërkohen tekste shkollore e veçanërisht abetare, për të cilat kishin «një nevojë të madhe»³⁾.

1) «Arsimi popullor» 1966, nr. 2, fq. 90-91. Një ndër ish-nxënësit e parë të kësaj shkolle, plaku Kolë Panxhi nga Valëshi tregonte para ca vitesh se «shkollën greke asi kohe e kërkuan pleqtë tanë për të bërë më të lehtë mësimin e gjuhës shqipe... Ditën mësojim greqisht e natën shqip. Mësimi shqip bëhej tinës dhe me rojë.»

2) HHStAPAA: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 17/res. datë 5 prill 1900.

3) Po aty.

Por një aksion i përbashkët në Elbasan pengohej nga qëndrimi i lëkundur e i njëanshëm i feudalëve çifligarë me influencë dhe nga rivaliteti e armiqësitë midis tyre. Qeveria otomane vepronte gjithashtu aktivisht për ta shtuar dasinë dhe armiqësinë midis tyre duke nxitur herë njerin herë tjetrin dhe për të penguar rritjen e lëvizjes.

Përpjekje për të përhapur shkrimin shqip u bënë edhe në krahinën e Çermenikës, e cila në atë kohë ishte një nga krahinat më të prapambetura të vendit. Në këtë drejtim u dalluan sidomos ata çermenikas që kishin emigruar për nevoja ekonomike. Këta filluan të interesohen edhe për mësimin e shqipes dhe për lëvizjen kombëtare. Zakonisht kur ktheheshin nga kurbeti zhvillonin një aktivitet patriotik dhe përhapnin shkrimin shqip pa marrë parasysh kundërshtimin e hoxhallarëve fanatikë.

Në vitet e fundit të shekullit të kaluar mësimi shqip pati një përhapje të mirë në krahinën e Mallakastrës, banorët e së cilës siguronin abetare e libra shqipe nga kolonitë e mërgimit nëpërmjet Beratit e Vlorës.¹⁾

Në katundin Grabovë të Oparit u bënë gjithashtu përpjekje për të çelur një shkollë shqipe. Një grabovare ortodokse e martuar në Vjenë kishte premtuar ta ndihmonte shkollën me 25 lira turke në vit. Këto do t'i jepeshin priftit të fshatit në qoftë se ai do të jepte mësimë në gjuhën shqipe. Për të siguruar librat e nevojshme për këtë shkollë një korçar mysliman kishte shkuar në Manastir për t'u interesuar²⁾. Por siç duket, për mungesë mësuesi dhe pengesa të tjera nuk iu arrit qëllimit.

1) Duke iu referuar viteve të fundit të shekullit XIX, nënkonsulli austro-hungarez i Vlorës konstatonte: «Në të tre vitet që unë kam kaluar në Vlorë pata prova se mallakastriotët interesohen për shkrimin shqip. Atyre u janë dërguar abetare edhe prej Bukureshtit.» (Në HHStAPAA: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Vlorës datë 20.8.1900).

2) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez nr. 79/res, datë 8 dhjetor 1899.

Mësimi i shqipes u përhap edhe në Lavdar të Oparit. Në vitin 1899¹⁾ Nuçi Naçi drejtori i shkollës shqipe të djemve në Korçë, duke shfrytëzuar pushimet verore, ndërmoi një udhëtim në Opar për t'u mësuar oparakëve shkrimin shqip dhe për t'u shpërndarë atyre libra në gjuhën shqipe²⁾. Ai u prit kudo me përzemërsi dhe dashuri si nga fshatarët ashtu edhe nga nxënësit e shkollës greke të Lavdarit. Kudo ai gjeti dëshirën e zjarrtë për të mësuar shkrimin dhe leximin shqip.³⁾

Gjatë kohës së qëndrimit në Lavdar, prej më tepër se një muaj, Nuçi Naçi shkonte çdo ditë në shkollën greke të fshatit ku kishte rreth 20 nxënës, djem e vajza. Ai u shpërndau abetare dhe filloi t'u jepte çdo ditë nga 1-2 orë mësim në gjuhën shqipe.⁴⁾

Nuçi Naçi i bëri aq shumë për vete nxënësit e asaj

1) I. M. Qafëzezi jep si datë vitin 1900, ndërsa ish-nxënësi i shkollës së atëhershme greke të Lavdarit Theodor Gogolli jep vitin 1903 (ky i fundit në «Fletë nga historiku i shkollës sonë» Tiranë, 1963, fq. 46).

2) AIH. Materiale të cituara të I. M. Qafëzezit.

3) «Si vajta në Lavdar — shkruan Nuçi Naçi — miqtë më pritnë fort bukurë, po si vëlla, më gëzuanë tepër me miqësinë e madhe që treguanë. Unë... pata marrë dhe ca libra shqip me vet-he edhe zura që të nesërmen e u a mësova çunave të Mëso-njëtores (greke) të Lavdarit, abecenë shqip; u habita fort kur pashë se në tri ditë mësuan që të gjithë të shkruajnë e të këndojnë gjuhën e tyre...» Në AIH. Materiale të cituara të I. M. Qafëzezit.

4) Kujtime të marra nga ish-nxënësi i asaj shkolle Mihal Xega, Korçë, Korrik 1972. Duke kujtuar takimin e parë me Nuçi Naçin një ish-nxënës i asaj shkolle shkruan: «Një mbrëmje, porza dualëm nga dera e kishës, u gjendëm përpara një njeriu të panjohur; ky menjëherë na tha: «E, more djem, si vini me shkollën dhe në ç'klasë jeni? Siç më kanë thënë, ky urata është i kujdesshëm dhe i zoti si mësues, po gjuhë të huaj ju mëson. Qasuni këtu pranë meje, se unë do t'ju mësoj në gjuhën tuaj.» Në «Fletë nga historiku i shkollës sonë», Tiranë 1963, fq. 46.

shkollë sa, kur ai hynte në klasë, të gjithë ngriheshin në këmbë «dhe shpërthenin në duartrokitje»¹⁾.

Përveç punës me nxënësit e shkollës, Nuçi Naçi njohu nga afër gjendjen e fshatrave të Oparit, u takua me fshatarë e barinj, u foli për gjuhën shqipe, për Shqipërinë dhe u dhuroi abetare e poemën «Bagëti e Bujqësi» të Naim Frashërit. Ai tregon se në gjithë krahinën e Oparit nuk kishte asnjë shkollë shqipe, përveç 3-4 shkollave në gjuhën greke, megjithëse «duan që të gjithë të mësojnë gjuhën e tyre, po Qeveria nuk jep leje të hapenë shkolla shqip». «Pashë në Opar — vazhdon N. Naçi — një vellazëri të mirë midis myslimanëve e të krishterëve.

Nëpër malet e nëpër pyjet e nëpër stanet e Oparit pashe të vërtetën vjershë të N.H.F. (Naim Frashërit), «Bagëti e Bujqësinë», të gjallë me sy, pa shkronja, edhe më tepër barinjtë kur e dëgjonin habiteshin për ç'u thosha edhe shumë nga ata muarë zell të madh të mësojnë gjuhën shqip»²⁾.

Pas largimit të Nuçi Naçit, në shtator të po atij viti, kur u hap shkolla greke e Lavdarit, ishin marrë të gjitha masat që të mos vazhdonte mësimi i gjuhës shqipe. Sipas urdhrave që kishte marrë prifti Papa Vasili, që ishte dhe mësues i fshatit, i mbloodhi nga nxënësit abetaret shqipe të shpërndara nga Nuçi Naçi dhe në shkollë nuk u vazhdua më mësimi i gjuhës shqipe.³⁾

Përhapja ishëhurazi e mësimit shqip dhe e librave e gazetave shqipe ishte zhvilluar më tej në këtë periudhë edhe në vise të tjera të vendit si në Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastër, Kolonjë, Përmet, Delvinë, Bregdet, Konsipol, Çamëri etj.

Në fillim të shekullit tonë u bënë përpjekje të reja për të çelur shkolla shqipe si në Berat, Delvinë etj. Në kërkesën që popullsia e Delvinës i drejtonte qendrës së

1) Kujtime të cituara të M. Xegës.

2) «Kalendari Kombiar», Sofje 1900, fq. 23.

3) Kujtime të cituara, të M. Xegës.

vilajetit në qershor të vitit 1904, thuhej: «Duke marrë parasysh aftësitë dhe zgjimin në një shkallë të mrekullueshme të popullit në rrugën e arsimit... dhe mungesën e shkollave shqipe në vend, kërkojmë që të aprovohet çelja e shkollave shqipe. Kjo gjendje, megjithëse është parashtruar dhe është dëgjuar disa herë... nuk i është arritur qëllimit deri më sot»¹⁾).

Në Kolonjë ishin gjithashtu «shumë të ndezur» dhe «duan doemos gjuhën shqip nga qeveria. Për ditë libra kërkojnë.»²⁾

Po kështu, në fshatin Pleshisht të kazazë së atëherëshme të Starovës, në vitet e fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit tonë, ndonëse pa patur shkollë dhe pa mësues, mësuan të shkruajnë e të lexojnë shqip nga njëri-tjetri më tepër se 45 veta, të gjithë në moshën 30 deri 50 vjeç.³⁾

Një zonë tjetër ku lëvizja kombëtare u zhvillua me shpejtësi dhe me vrull si asnjëherë tjetër ishte ajo e Dibrës. Krahas Kosovës, një rëndësi të veçantë mori edhe Dibra në ngjarjet politike që po zhvilloheshin në Ballkan në fund të shekullit XIX. Edhe në Dibër po ndihej rreziku imediat i shkëputjes nga trangu shqiptar dhe i përfshirjes në zonën ku do të zbatoheshin «reformat për Maqedoninë». Aty ndesheshin gjithashtu synimet shoviniste të disa shteteve ballkanike.

Në këtë situatë të rrezikshme duhej vepruar. Masat popullore duheshin sqaruar për situatën politike që po kalonte vendi dhe duheshin organizuar për t'i dalë përpara rrezikut.

Shkrimi dhe shkolla shqipe do të ishin një mjet i fu-

1) D. Toska, «U përpoqëm natë e ditë, sa nxorëm shqipen në dritë» Në «Mësuesi», dt. 26 shkurt 1969, fq. 4.

2) AQSH i RPSSH: Fondi i Asdrenit. Dos. 74/3 Kartpostale nga Sofja, dt. 28 prill 1906.

3) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 98, dt. 15 shkurt 1908, fq. 3.

qishëm për të përballuar situatën dhe për të forcuar ndër-gjegjen kombëtare tek dibranët. Nevoja për shkolla shqipe bëhej edhe më e ngutshme për shkak të shtimit të madh të numrit të shkollave në gjuhë të huaj turke, bullgare etj.

Viti 1899 qe i mbushur me ngjarje politike. Në Dibër u organizuan shumë mbledhje, ku shprehej solidariteti me Kosovën dhe gjithë lëvizjen kombëtare dhe shtroeshin e diskutoheshin çështjet që preokuponin më tepër vendin.

Pikërisht në atmosferën e rritjes së pakënaqësisë dhe të revoltës së masave popullore, me iniciativën e patriotëve dibranë, u hartua një kërkesë për njohjen e gjuhës shqipe dhe lejimin e shkollave shqipe. Kërkesa iu dorëzua dy të dërguarve të sulltanit, të cilët kishin ardhur për të qetësuar situatën politike në Dibër. Në kërkesën që mbante 30 firma thuhej midis të tjerash: «Meqenëse në qytetin tonë Dibër flitet vetëm shqip dhe fëmijët e vendit nuk kanë pasë mundësi të marrin mësim legalisht dhe të stërviten në gjuhën amtare, janë mbushë zemrat tona me hidhërim të thellë.

Në qoftë se lejohet hapja e një shkolle me shqipen s: gjuhë mësimi d.m.th. me gjuhën tonë amtare... atëherë do të përgjithësohesh arsimit popullor... dhe të gjitha shpenzimet do t'i paguajnë patriotët vetë...»¹⁾.

Nën presionin e këtyre ngjarjeve, në shtator 1899 u lirua nga burgu Hamdi Ohri me irade perandorake, duke u porositur që të mos përzihej në punët e Lidhjes në Dibër. Por me të dalë nga burgu, Hamdi Ohri e rifilloi aktivitetin patriotik dhe shumë shpejt hapi ilegalisht në shtëpinë e tij një shkollë shqipe, e cila arriti të kishte rreth 80 nxënës.²⁾ Megjithë kontrolllet e shumta që ishin bërë në shtëpinë e Hamdiut, autoritetet osmane nuk kishin mun-

1) HHStAPAA: Informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit Nr. 1, dt. 5 janar 1900.

2) AQSH i RPSSH. Fondi «Çështje shqiptare në marrëdhëniet ruso-turke» Dos. 12, dokument nr. 1308, datë 18 korrik 1901.

dur të zbulonin ekzistencën e kësaj shkolle.¹⁾ Përparimet që po bënte lëvizja kombëtare në këtë zonë e shqetësuan qeverinë e Stambollit, e cila mori një varg masash dhe bëri internime të reja. Në pranverë të vitit 1901 u dërgua në Dibër adjutanti i Sulltanit, majori Nuri beu, me detyrën zyrtare për të krijuar gjoja «rezerva ushtarake», po, në të vërtetë ishte ngarkuar të shqyrtonte në vend situatën dhe të informonte për këtë Pallatin. Po në atë kohë u dërgua në Dibër nga sulltani edhe një «komision arsimor» me porosi që të hapë atje rreth 100 shkolla të reja tunke. Udhëtimi i këtij komisioni qeveritar, prej më tepër se një muaj e gjysmë, mbeti pa ndonjë rezultat, sepse asnjëri nuk e përkrahu misionin e tij. Për të siguruar mjetet e nevojshme për këtë qëllim u provua të vihej një tatim mbi llixhën e Dibrës, por edhe kjo që e pazbatueshme. «Komisioni — konstatonte një diplomat i huaj në atë kohë — u kthye shumë i deziluzionuar nga pritja që i bënë shqiptarët, që refuzuan të marrin pjesë në mbajtjen e shkollave me pretekstin se janë të varfër. Me gjithë këtë gazetat e Stambollit kanë shkruar se komisioni është pritur me entuziazëm prej shqiptarëve që morën (gjoja) përsipër gjysmën e shpenzimeve»²⁾.

Ndërkohë adjutanti i sulltanit, Nuri beu, e kreu me zell të madh misionin e tij të fshehtë dhe i dërgoi vazhdimisht informata Stambollit për persona të ndryshëm, midis tyre edhe për Hamdi Ohrin. Si pasojë ky i fundit, me urdhër të Stambollit, u arrestua përsëri, u dërgua në burgun e Manastirit dhe më vonë u internua në vende të ndryshme të Perandorisë. Nuri beu kishte filluar të konfiskonte në Dibër edhe librat shqipe.

Të gjitha këto i indinjuan shumë dibranët, të cilët vendosën të vepronin kundër këtij agjenti të përbuzur të sulltanit. Kështu, në mesin e korrikut të vitit 1901, një

1) Po aty.

2) Po aty.

shqiptar qëlloi me armë në mes të pazarit të Dibrës adjutantit e Sulltanit, Nuri beun, dhe «megjithëse e panë shumë veta, guximtari u largua pa kurrfarë pengese prej qytetit dhe asnjëri nuk u përpoq ta ndalojë»¹). Kjo e bëri edhe më të pasigurtë gjendjen e sunduesve osmanë në Dibër.

Ringjallja e çështjes së «reformave për Maqedoninë» si dhe frika e një ndërhyrjeje evropiane e acaronte edhe më tepër gjendjen në Dibër, ku, siç shprehej konsulli austro-hungarez i Manastirit, «gjendej pika e gravitetit të situatës»²).

Në këto rrethana, kur lëvizja kishte marrë zjarr, dibranët mendonin të ngrinin vetë një numër shkollash shqipe, njëkohësisht në pikat më të rëndësishme të sanxhakut, në mënyrë që e gjithë krahina të ishte solidare me çështjen dhe qeveritarëve osmanë t'u pritej rruga e intrigave të zakonshme për të nxitur grindjen midis tyre. U vendos që të çelëshin përnjëherësh 7 shkolla shqipe dhe konkretisht në fshatrat Çidhna, Muhurr dhe Luzni të Dibrës së Poshtme; në Zogjej dhe Homesh të Dibrës së Sipërme; në Lis dhe Silenja ose Cuka të Matit.³) (sipas ndarjes së atëhershme administrative).

Ishte menduar që në vetë qytetin e Dibrës, ku qeveria otomane e kishte më lehtë të ndërhynte, ngritja e shkollave të lihej për një kohë të mëvonshme. Këto aksione përkrahej nga popullsia myslimane e kristiane dhe kishte karakter thjesht kombëtar. Dibranët u vunë në lidhje me patriotët shqiptarë të Manastirit, me anën e të cilëve kërkonin të siguronin ndihma financiare si dhe libra nga shoqëritë patriotike shqiptare jashtë atdheut.

Konsulli austro-hungarez i Manastirit, që ishte i mirëinformuar mbi ngjarjet e Dibrës, raportonte në fillim të

1) Po aty.

2) HHStAPAA: inform. i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 28, datë 8 mars 1902.

3) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 29/res, datë 13 mars 1902.

marsit 1902: «... U binda se hapja e atyre shkollave është krejt e sigurt... çasti është i favorshëm për arësye se Dibra është pa guvernator (qeveritar), se pushtetin qeveritar në fakt e ka uzurpuar populli dhe ua ka ngarkuar dy përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.

...Unë shoh edhe një vendosmëri për të çuar deri në fund veprën gjë që deri tani, në këtë masë, nuk e kam konstatuar kurrë ndonjëherë».¹⁾

Lidhjet e dibranëve me patriotët shqiptarë të Manastirit u bënë më të shpeshta dhe përgatitjet për hapjen e shkollave shqipe ishin në përfundim. Vështirësia kryesore që nuk ishte kapërcyer ende ishte mungesa e një shume të domosdoshme për fillimin e punës. Në pritje të ndihmave financiare u mendua që në fillim të prillit 1902 të organizohej një mbledhje me përfaqësuesit e Dibrës e të Matit, në të cilën do të merrnin pjesë përfaqësues edhe nga të gjitha fshatrat, ku do të hapeshin shkollat shqipe. Në këtë mbledhje u ftuan të merrnin pjesë edhe patriotë shqiptarë të Manastirit si Fehim Zavalani etj.

Në një letër që i dërgohej nga Dibra Fehim Zavalanit, më 23 mars 1902 i thuhej lidhur me këtë mbledhje: «... Është nevojë urgjente që të jeni prezent edhe ju... sepse në këtë mbledhje do të vihet guri i themelit për një të ardhme të lumtur të atdheut.

Mos e lëmë këtë rast të kalojë!»²⁾

Në këtë situatë të ndezur pati edhe fshatra të tjerë që bënë përpjekje për të hapur shkolla shqipe ose për t'i kthyer ato që ekzistonin në gjuhë të huaj në shkolla shqipe si Verbjani i Rekës etj. Ishte projektuar gjithashtu që në pranverën e vitit 1902 të mbahej një mbledhje tjetër e madhe me përfaqësues nga Shqipëria e Mesme dhe e Veriut: nga Dibra, Mati, Shkodra, Tirana dhe Elbasani. Vendi i mbledhjes do të ishte Martaneshi, si vend i fshehtë, ndër-

1) Po aty.

2) Po aty.

sa në rend të ditës do të ishin çështjet kombëtare, sidomos ajo e shkollës shqipe.

Ndonëse u muarën të gjitha masat për çeljen e 7 shkollave të përmendura në Dibër, si për lokalet shkollore, për sigurimin e mësuesve, të librave e të mjeteve të tjera mësimore, aksioni nuk u kurorëzua dot me sukses.

Në këtë drejtim ndikuan faktorë të ndryshëm politikë e financiarë. Sado që Dibra mbeti pa mytesarifin osman për 3 muaj e gjysmë, Porta e Lartë mori masa dhe e rivendosi më në fund autoritetin e vet në Dibër. Negativisht ndikoi acarimi rishtas i «çështjes maqedonase» dhe si pasojë rritja e rrezikut të jashtëm, të copëtimit të vendit si dhe përçarja e rivaliteti në radhët e atyre krerëve feudalë e bajraktarë dibranë, të cilët merrnin pjesë në lëvizje, por pa hequr dorë nga interesat klasore e personale dhe karakterizoheshin nga qëndrime të lëkundura e kompromisi.

Përveç këtyre në mosrealizimin e këtij aksioni të rëndësishëm arsimor ndikoi edhe mungesa e mjeteve materiale. Nuk u arrit të siguroheshin as mjetet financiare të domosdoshme për fillimin nga puna të këtyre shkollave. Se sa e «përkrahte» Austro-Hungaria qoftë edhe lëvizjen kulturore shqiptare provohet qartë edhe në rastin e Dibrës nga dokumentet sekrete të vetë Arkivit të Vjenës. Ministri i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë, Goluchovski, e porosiste me telegram shifër konsullin e tij në Manastir që të ishte tepër i rezervuar lidhur me këto shkolla: «Aksionin përkatës — shkruante ai në mars 1902 — për arsye që kuptohen lehtë, jemi të detyruar t'ia lëmë ekskluzivisht popullsisë», që ai të mos angazhohej «për ato shkolla dhe për fatin e tyre»¹). Për Vjenën ishte

1) Po aty, telegram shifër i ministrit të jashtëm austro-hungarez, Goluchovski, drejtuar konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 2, res, datë 10 mars 1902.

një gjë e padëshirueshme dhe e dyshimtë «të përkrahej një lëvizje, të cilën Porta e urren pa tjetër»¹⁾.

Vetëm me qëllim që të zgjeronte ndikimin e saj dhe për të evituar ndërhyrjen në këtë çështje të ndonjë fuqie tjetër rivale, siç ishte Italia, Vjena u kandis të jepte një shumë të parëndësishme në para, duke e shoqëruar edhe këtë me porosinë që «për sa u përket projekteve të tjera për krijimin e shkollave unë (ministri i jashtëm austriak) çdo ndihmë e konsideroj të dëmshme»²⁾.

Megjithëse nuk u çelën shkollat e parashikuara, përpjekjet e bëra dhe mbledhjet e diskutimet e organizuara me këtë rast e kishin çuar përpara lëvizjen kombëtare në Shqipërinë Lindore dhe kishin forcuar edhe më tepër ndërgjegjen kombëtare në masat popullore. Këto vazhduan, ashtu si më parë, të mësojnë ilegalisht shkrimin e gjuhës së tyre dhe të lexojnë pareshtur librat e gazetat e Rilindjes.

Në vitet e fundit të shekullit XIX mësimi në gjuhën shqipe po përhapej fshehurazi me shpejtësi edhe në qytetin e rrethin e Krujës. Për këtë qëllim rreth vitit 1898 në Krujë ishte krijuar një shoqëri nën kryesinë e Ali Dedejt. Mësuesit e parë kanë qenë Ibrahim Kaloshi e Hasan Kolashi. Përveç Dervish Himës, një kontribut me vlerë në lëvizjen kombëtare në rrethin e Krujës dha patrioti Meleq Shembërdhenji, i cili u bë ndërlidhësi kryesor me Shqipërinë e Jugut dhe përhapës i palodhur i librave shqipe³⁾, si dhe Murat Toptani.

Përveç qytetit të Krujës, shkrimi shqip mësohej edhe në Milot, Laç, Burizanë etj. Meleq Shembërdhenji shkonte shpesh nëpër fshatrat e Krujës, takohej me aktivistët e lëvizjes shqiptare dhe shpërndante abetare e libra të ndry-

1) Po aty: shkresë *tepër rezervate* e Vjenës dërguar konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 275, datë 17 prill 1902.

2) Po aty.

3) H. Goci, «Zhvillimi i arsimit në rrethin e Krujës» (Punim i pabotuar, pranë Institutit të Studimeve Pedagogjike») fq. 34-35.

shme. E gjithë kjo punë bëhej në ilegalitet dhe me forma të ndryshme.¹⁾

Të shqetësuara nga gjallërimi i lëvizjes dhe nga zgjerimi i të mësuarit shqip, autoritetet lokale të Krujës filluan të marrin masa të rrepta. Ata organizuan kontrolle të befasishme në shtëpitë e shumë patriotëve dhe bënë disa arrestime.

Interesi dhe dëshira për të mësuar shkrimin e leximin në gjuhën amtare, për të lexuar shtypin shqiptar e bofimet e rilindësve ishte rritur mjaft edhe në vise të tjera të Shqipërisë së Mesme si në Kavajë, Durrës etj.

Një qendër e rëndësishme e përhapjes së mësimit dhe e librave shqipe bëhet në këtë periudhë Shkodra. Me gjithë ndërhrvjetet e imperializmit austro-hungarez e italian në fushën arsimore-kulturore, me gjithë përpjekjet këmbëngulëse të shërbëtorit të tyre, klerit katolik, për të ruajtur të paprekur monopolin mbi arsimin e kulturën, popullsia, e veçanërisht rinia patriote e Shkodrës, gjetën forma të ndryshme. kryesisht ilegale, për të mësuar në gjuhën shqipe, për t'u edukuar me idetë kombëtare. «Ka disa vjet — shkruhej në gazetën «Drita» në vitet e para të shekullit tonë — që shkrimi e kënim i gjuhës shqype në Shkodër përparon edhe zun ta marrin vesh shkodranët dobin e kënimit e të shkrimit në gjuh t'vet e kah (nga) italishtja s'kan pasë e s'kan far hairit (kurrfarë dobie)»²⁾. Që nga fundi i shekullit XIX, në Shkodër veprojnë komitete e shoqëri të fshehta³⁾. të përbëra nga të rinj patriotë. Në vitet e para të shekullit tonë filloi të veprojë një sho-

1) Meleq Shembërdhenji, ndonëse ishte i sektit bektashi, nuk ngurroi të shëtiste nëpër krahina të ndryshme të Shqipërisë së Mesme i veshur herë me uniformën e priftit, herë me atë të shehut dhe herë me rroba të vjetra e të grisura, bile duke ndërruar edhe emrin dhe munda të shpërndante abetare shqipe në Krujë, Elbasan e Martanesh. (AQSH i RPSSH. Fondi «25-vjetori i Pavarësisë», Dos. e Meleq Shembërdhenjit).

2) «Drita» e Sofjes, nr. 95, dt. 1 janar 1908, fq. 2-3.

3) «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 21, dt. 27 shtator 1897, fq. 6.

qëri e fshehtë e përbërë nga elementë kristianë e myslimanë. Në të merrnin pjesë Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci etj. Qendër për veprimtarinë e kësaj shoqërie ishte bërë punishtja e fotografit patriot Kel Marubi, i cili luante një rol të rëndësishëm edhe për shpërndarjen ilegalisht të shtypit shqiptar.

Përveçse aktivist i lëvizjes kombëtare, Luigj Gurakuqi u dallua edhe si autor tekstesh shkollore, të cilat i hartoi në gegërisht e toskërisht e me alfabetë të ndryshme për një përdorim sa më të gjerë.

Për të shmangur ndjekjet e autoriteteve osmane dhe të armiqve të tjerë, këto tekste botoheshin me pseudonim. Shpërndarja e tyre bëhej pa të holla, sepse, siç shprehej vetë Luigj Gurakuqi në atë kohë, ato ishin «punë propagande», që nuk bëhej «për fitim, po për të mirë t' gjuhës e t'kombit shqiptar»¹⁾.

Mësimi në gjuhën shqipe, përhapja e shtypit të Rilindjes dhe e ideve kombëtare bëri që «t'i hapen sytë shumicës së djelmënisë shqiptare. . . tue e kuptue se sa poshtë



Luigj Gurakuqi

1) AQSH i RPSSH, Fondi i Asdrenit, Dot. 74/1: Kartpostale e Luigj Gurakuqit dërguar Asdrenit më 7.XII.1906.

gjindena përgjithësisht, politikisht, ekonomikisht e qytetënisht»¹⁾.

Mësuesit patriotë punuan pa u lodhur për ta përhapur mësimin e shqipes jo vetëm në fëmijët e moshës shkollore, por edhe në radhët e «djelmënis së tregut e të motënuemve»²⁾. Për këtë qëllim u arrit që në Shkodër të hapesh edhe një shkollë mbrëmjeje në gjuhën shqipe, e cila do të shërbente «për zhvillim të popullit t'onë si kahë mendja ashtu kahë zëmbra». Atë e frekuentonin më tepër se 100 djem e burra, të cilët «kur merte fund mësimi delshin nga shkolla vëllanisht, tue këndue kangë kombëtare»³⁾.

Këto përparime shqetësuan autoritetet osmane si dhe klerin katolik. «Idhnimi e tërbimi i priftëve të huaj, në Shkodër, sidomos e jezuitëve, me argjipeshkvin Paskuale Guerini në krye, qe aq i madh sa nisnë me gjith fuqi që kishin — për me u kundërshtue këtyne veprimeve, sepse qëllimi i tyre asht: me lanë popullin në terr e në fanatizëm tue e dijtë mjaft mirë, se një komb... i përparuem nuk ia vënë veshin përrallave të tyre»⁴⁾. Kundër mësimin të shqipes e shkollës së mbrëmjes u predikua në kishë, duke i cilësuar ato si «kundra fesë», u bënë kërcënime për burgime e internime etj.

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, në Shqipëri u forcua edhe më tepër depërtimi ekonomik, politik e ideologjik i fuqive imperialiste dhe rivaliteti midis tyre. Ato, duke shfrytëzuar rënien e përgjith-

1) Po aty. Fondi i N. Ivanaj, Dos, 4, dok. 64, Koncept i artikullit të Hil Mosit me titull «Kombësia dhe kleri katolik», shkruar në shtator 1907.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

shme të Perandorisë Osmane, i shtuan përpjekjet për të rritur ndikimin e tyre në zotërimet e saj. Në Shqipëri u ndeshën veçanërisht interesat e imperializmit austro-hungarez dhe italian.

Rivaliteti austro-italian u shpreh me forcë, përveç të tjerave, edhe në çështjen e kishës dhe të shkollës. Të dy fuqitë bënin shpenzime të mëdha për të bërë për vete klerin katolik, duke i dhënë atij subvencione të rregullta mujore ose vjetore.¹⁾

Një mjet i rëndësishëm depërtimi ideologjik ishte gjithnjë shkolla. Pas shkollave fetare dhe disa shkollave fillore në gjuhën italiane, të hapura qysh përpara në qytete të ndryshme të Shqipërisë, imperialistët austro-hungarezë, në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, çelën një numër shkollash të reja në qytete dhe në fshatra të Shqipërisë Veriore, të Mesme dhe në Kosovë.²⁾

Ashtu si Austro-Hungaria edhe Italia krijoi shkollat e saj në Shqipëri³⁾.

Me qëllim që të dobësojë ndikimin kultural italian që po rritej dhe njëkohësisht për të forcuar ndikimin dhe kontrollin e vet mbi lëvizjen kulturore shqiptare që kishte marrë vrull, Austro-Hungaria bëri, në këtë periudhë, të ashtuquajturin «nacionalizim» të shkollave katolike në Shqipëri. Në mjaft prej tyre ajo filloi të zëvendësojë gjuhën italiane me gjuhën shqipe.

Nën presionin e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të kërkesave të saj për të përhapur shkrimin shqip, edhe Italia u detyrua, ndonëse në një masë shumë të kufizuar, të verë mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e saj.⁴⁾

1) Historia e Shqipërisë, Dispensë, vëll. II (1882-1908), Tiranë, 1973, fq. 87.

2) Shkolla të tilla u çelën në Shkodër, Prizren, Pejë, Gjakovë, Tiranë, Durrës, Milot, Rrëshen, Shirokë, Bushat, Iballë etj.

3) Italia çeli shkolla profesionale dhe fillore në Shkodër, Durrës, Vlorë etj.

4) Historia e Shqipërisë, Dispensë e cituar, fq. 88.

Por, me gjithë këtë «nacionalizim», shkollat e çelura e të subvencionuara nga imperializmi austro-hungarez e italian mbetën, siç shprehej vetë një personalitet politik austriak, mjete për «depërtimin paqësor» në Shqipëri dhe «për të ndikuar mbi popullsinë» shqiptare¹⁾. Prandaj patriotët shqiptarë më largpamës i ruheshin me kujdes politikës që ndiqnin emisarët e Vjenës e të Romës në Shqipëri. Duke hedhur poshtë çdo lloj iluzioni për shkollat e çelura nga Austro-Hungaria, gazeta «Shqipëria» e Sofjes i konsideronte ato thjesht për qëllime propagandistike dhe porosiste çdo shqiptar që t'u «kthejë drunë mësonjëtove austriake»²⁾. Po kështu gazeta «Kombi», duke folur për shkollat austriake dhe italiane në Shqipëri, shprehej qartë se «as shkollat austriake, as ato italiane s'i shërbejnë Shqipërisë»³⁾.

Megjithatë, patriotët shqiptarë u përpoqën t'i shfrytëzonin aq sa ishte e mundur, edhe këto shkolla në të mirë të lëvizjes kombëtare shqiptare⁴⁾; ata protestonin kur i vihej më tepër rëndësi mësimit të gjuhëve të huaja dhe pati raste që u arrit deri në konflikte të ashpra me përfaqësuesit e Vjenës në Shqipëri. Përpjesëtime veçanërisht të mëdha mori konflikti i popullsisë së Prizrenit me konsullatën austro-hungareze.

Në Prizren ishte ngritur prej kohësh një shkollë nën patronazhin e Austro-Hungarisë.

Për vite me radhë punoi në këtë shkollë, si mësues i gjuhës shqipe, patrioti Mati Logoreci, i cili bëri një punë të mirë jo vetëm me nxënësit por edhe me popullsinë.


1) I. Gogaj, Vep. e cituar, fq. 28.

2) Gazeta «Shqipëria», Sofje, dt. 1.5.1907 (cituar sipas I. Gogaj, vep. e cit., fq. 33.).

3) «Kombi», dt. 20.12.1907.

4) S. Shaplllo, «Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri», Tiranë 1975, fq. 15-16.

Megjithëse shkolla subvencionohej nga Austria, ai mendohej të shfrytëzonte të gjitha mundësitë për edukimin patriotik të rinisë kosovare e për të përhapur mësimin e gjuhës shqipe në popull.¹⁾ Futja e shqipes si gjuhë mësimi dhe veprimtaria e mësuesit patriot Mati Logoreci bënë që shkollën e Prizrenit, me gjithë kërcënimet e autoriteve osmane, ta ndjekin edhe nxënës myslimanë.²⁾ Me shtimin e numrit të nxënësve, pranë Mati Logorecit filloi të punonte si mësues edhe Lazër Lumezi. Shpejt shkolla ndeshi në



Mati Logoreci

pengesa dhe në qëndrimin armiqësor të autoriteteve osmane. Atë e patën halë në sy gjithashtu shovinistët serbomëdhenj sepse ajo pengonte planet e tyre për shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare të Kosovës përmes kishës dhe shkollës së tyre.³⁾ Por përparimet e shkollës së Prizrenit trembën edhe konsullatën austro-hungareze, e cila, për të mos lejuar dobësimin e ndikimit të Vjenës, ndërmoi kundërmasa të ndryshme. Ndër masat e qeverisë vjeneze përshtypje të thellë bëri në banorët e Prizrenit sjellja aty e misionarëve fetarë kroatë, me të cilët shtohesh rreziku i përhapjes së gjuhës sllave.

1) S. Shaplo, «Disa letra të Mati Logorecit dhe shkolla shqipe e Prizrenit». Në gazetën «Mësuesi», dt. 25 shtator 1964, fq. 4.

2) H. Shpuza, «85-vjetori i shkollës së parë shqipe të Prizrenit». Në gazetën «Mësuesi», dt. 15 maj 1974, fq. 8.

3) Po aty.

Popullsia e qytetit, me të cilën u bashkuan edhe klerikët shqiptarë Pashko Trokshi e Ndue Bytyqi, protestoi rreptësisht.¹⁾

Konflikti i banorëve të Prizrenit me diplomacinë austro-hungareze dhe me Vatikanin erdhi duke u ashpërsuar dhe arriti kulmin në vitin 1898. Popullsia e Prizrenit u tregua e vendosur dhe nga bojkotimi i shkollës nuk ngurroi të kalojë edhe në bojkotimin e kishës. Ajo paraqiti gjithashtu një varg protestash, me anën e të cilave kërkonte, ndër të tjera, pezullimin e mësimit të sllavishtes.

Konflikti vazhdoi gati dy vjet. Kundër popullsisë u përdorën pa kursim mallkimet dhe çkishërimet. Përveç kësaj, me kërkesën e konsullit austro-hungarez, autoritet sunduese osmane arrestuan mjaft patriotë shqiptarë.²⁾ Por rezistenca u përhap edhe jashtë Prizrenit. Përkrah popullsisë së Prizrenit u radhitën banorët e krahinave të tjera të Kosovës, e sidomos ata të Gjakovës, të cilët, siç shprehej në një letër Mati Logoreci, «nuk janë gjin qi durojn, pse nër ta lun martina»³⁾.

Në anën e popullit qëndroi gjithashtu Mati Logoreci, i cili përkrahu edhe mendimin për «me çil një shkollë n'vedi pa ndihmë të tjetër kuj»⁴⁾. «Populli — shkruante Mati Logoreci — është i vendosur të shkëputet nga mbrojtja austriake duke refuzuar beneficet që ajo i jepte duke filluar nga shkolla, për të cilën janë grumbulluar tashmë shumat e nevojshme»⁵⁾.

Në kundërshtim me politikën antishqiptare të imperializmit austro-hungarez dhe të Vatikanit, popullsia e Prizrenit ngriti më 1899 një shkollë të re shqipe krejtësisht të pavarur. Mësues i saj u bë Mati Logoreci.⁶⁾

1) Historia e Shqipërisë, Dispensa e cituar, fq. 114.

2) Po aty.

3) AQSH i RPSSH, Fondi M. Logoreci, dot. 49, dok. 1.

4) Po aty, Letër e M. Logorecit, dt. 25 qershor 1899.

5) Po aty: Letër e M. Logorecit, dt. 28 maj 1899.

6) Historia e Shqipërisë. Dispensë e cituar, fq. 115.

Shkolla e re tërhoqi shumicën e nxënësve. Ajo kishte 60 nxënës, ndërsa shkolla që subvencionohej nga konsullata austro-hungareze vetëm 16.¹⁾ Kisha dhe kleri katolik po ndiqnin me shqetësim ngjarjet e Prizrenit dhe filluan të veprojnë «që ajo lëvizje anti-austriake të mos ushtrojë një influencë»²⁾ në krahinat e tjera. Për qëndrimin e papërkulur të M. Logorecit, kisha katolike e mallkoi atë bashkë me të shoqen.³⁾

Megjithëkëtë, rezistenca e gjatë dhe e vendosur e bënë më në fund efektin e tyre. Vjena dhe Vatikani u detyruan të bëjnë lëshime. Më 1900 mësuesit e huai u larguan nga shkolla dhe klerikët shqiptarë të larguar u kthyen në Prizren. Të dy shkollat u bashkuan në një shkollë të vetme shqipe.

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX mësimi shqip, librat e gazetat shqipe u përhapën edhe në vise të tjera të Kosovës, si në Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Drenicë etj.⁴⁾ «Nga Kosova na shkruajnë — informonte gazeta «Drita» — se... ka shumë njerëz që përpiqen për gjuhën e për kombin, ndjenjat kombëtare po ndizen me vrap të math, (armiqësia) kundër guvernës halldupe (qeverisë osmane) sa vete po shtohet».⁵⁾

Në të mirë të përhapjes së mësimin të shqipes u shfrytëzua dhe «shkolla katolike» e Tiranës. Në Tiranë shkrimi i shqipes kishte filluar të përhapej prej kohësh në forma ilegale. Në këtë periudhë ai mori një përhapje më të madhe. Nga Bukureshti dërgoheshin në Tiranë abetare e libra të tjera shqipe. Bile në vitin 1897 në Tiranë po punohej për të përshtatur një abetare në të folurën e

1) H. Shpuza artikull i cituar.

2) HHStAPAA: Letër e Preng Doçit dërguar ministrit të jashtëm austro-hungarez nga Shkodra më 1 korrik 1899.

3) S. Shaplo, artikull i cituar, në «Mësuesi» dt. 25 shtator 1964.

4) AQSH i RPSSH: Fondi i Asdrenit, Dos. 74 3: gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit, nr. 20, dt. 20 shtator 1897.

5) «Drita» e Sofjes, nr. 62, dt. 11 qershor 1905, fq. 4.

Shqipërisë së Mesme.¹⁾ Kur më 1898 austro-hungarezët celën një shkollë katolike në gjuhën shqipe, ajo filloi të frekuentohej nga nxënës të të tria besimeve. Më tepër se gjysma e tyre ishin myslimanë, me gjithë kundërshtimin e presionet e bëra nga kleri mysliman fanatik.

Në kundërshtim me vendimin e kryepeshkopit katolik të Durrësit, sipas kërkesës së qytetarëve patriotë shkolla përdori tekste mësimore të shtypura me alfabetin e «Naimit», siç quhej tani alfabeti i Shoqërisë së Stambollit.²⁾

Në vitin shkollor 1902-1903 u krijua edhe një kurs jashtëshkollor prej 15 nxënësish të rritur (të gjithë myslimanë) për mësimin e shkrimit të shqipes, i drejtuar nga mësuesi i shkollës, Filip Ashiku.³⁾

Përveç kësaj, Filip Ashiku u jepte mësimë privatisht në gjuhën shqipe, pa pagesë, një numri të madh të rinjsh që kishin dëshirë të madhe të mësonin, por e kishin veshirë të frekuentonin hapur shkollën.

Në fillim të shekullit tonë, mësimi i shqipes mori një përhapje të tillë në Tiranë sa që librat e sjella nga Bukureshti e Sofja nuk plotësonin dot kërkesat në rritje të popullsisë⁴⁾, prandaj ato shkonin dorë më dorë.

Numri i të rriturve që mësonin privatisht nga mësuesi i shkollës arriti në rreth 25 veta. Shkrimin dhe njohuritë e fituara këta i përhapnin në miqtë dhe shokët e tyre.⁵⁾ Vetëm në verën e vitit 1901 u sollën në Tiranë 500 libra nga Sofja, midis të cilave kishte abetare, botime të Naim Frashërit etj., si dhe gazeta në gjuhën shqipe.

Përveç këtyre Refik Toptani filloi të jepte fshehurazi mësimin e shqipes në shkollën turke të Kamzës «dhe

1) AQSh i RPSSH: Fondi D. Hima, Dos. 10, dok. 87: letër dërguar nga Tirana Dervish Himës në Bukuresht më 1897.

2) Historia e Shqipërisë, Dispensa e cituar, fq. 114.

3) K. Kërçiku, «Kontribut për historinë e shkollës shqipe». Në gazetën «Mësuesi», dt. 10 korrik 1964, fq. 3.

4) HHStAPAA: Filmi I/5 D4-C, Nr. inv. 843, fq. 1.

5) Po aty: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Durrësit, Nr. 20, datë 3 shtator 1901.

bile në një mënyrë që të mos përdroreshin libra».1) Një ndihmë të madhe në mbarëvajtjen e çështjes shkollore jepte shoqëria e fshehtë, e cila siç është përmendur u formua në Tiranë rreth vitit 1896 dhe sidomos arka e saj, administrator i së cilës duket se ishte vetë Refik Toptani.

Përparimet e mësimit shqip në Tiranë shkaktuan shpejt kundërveprimin e autoriteteve osmane dhe të kishës. Presione e kërcënime u bënë sidomos ndaj atyre familjeve myslimane që dërgonin fëmijët në shkollën e çelur. Në vitin shkollor 1902-1903, ndërhyjnë kajmekami, kleri mysliman fanatik, edhe vetë vali. Si pasojë, për tri javë rresht nxënësit myslimanë nuk shkuan fare në shkollë. Shumica e nxënësve myslimanë vinin nga shtresat e varfra, dhe, pa marrë parasysh kërcënimet e qeverisë, frekuentuan përsëri shkollën.2)

Me gjithë qëndrimin kundërshtar dhe përpjekjet e feudalëve, të hoxhallarëve turkomanë dhe të autoriteteve osmane, për ta mbajtur larg sidomos elementin mysliman, popullsia e Tiranës, shumica e së cilës ishte e besimit mysliman, tregonte dëshirë dhe gadishmëri për të mësuar në gjuhën amtare. Bile pati edhe shumë absolventë të medresesë së Tiranës që merrnin mësim shqip privatisht prej mësuesit Filip Ashiku.3)

Një tregtar mysliman, Zija Elezi, la me testament shumë prej 6000 lirash turke për qëllime kombëtare.4) Të shqetësuar nga kjo gjendje dhe nga fakti se nga 19 nxënësit që kishte «shkolla katolike», në fillim të shekullit tonë, 15 prej tyre ishin të besimit mysliman, autoritetet osmane, përveç kufizimeve të mëparshme, shpallën disa herë ndalimin e frekuentimit të kësaj shkolle nga myslimanët.5).

1) Po aty: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Durrësit, Nr. 20, datë 3 shtator 1901.

2) K. Kërçiku, Artikull i cituar.

3) HHStAPAA: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Durrësit, nr. 20, dt. 3 shtator 1901.

4) Po aty.

5) Po aty: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Durrësit, nr. 28, datë 6 tetor 1903.

Një shkollë tjetër e subvencionuar nga Austro-Hungaria, por që u shfrytëzua në të mirë të përhapjes së mësimin shqip e të çështjes kombëtare ishte shkolla e Iballës së Pukës. Sa e madhe ishte etja dhe dëshira për mësim e dituri edhe në malsorët e Pukës e tregon qartë fakti se për të pritur mësuesin që do të çelte shkollën në gjuhën shqipe kishte dalë i gjithë fshati, burra, gra e fëmijë.¹⁾ Por puna e palodhur e mësuesit patriot Kolë Zezaj dhe frekuentimi i shkollës nga nxënës të të dy besimeve nuk u pa me sy të mirë nga autoritetet osmane, të cilat për të mos dalë vetë në skenë²⁾, vunë në lëvizje klerin dhe parinë e vendit. Veprimtaria patriotike e mësuesit u kundërshtua gjithashtu nga kleri katolik, i cili bëri përpjekje për ta larguar atë nga Iballa.³⁾ Kleri katolik i lidhur me Austro-Hungarinë u shqetsua sepse mësuesi Kolë Zezaj nuk po vepronte në përputhje me synimet e subvencionuesit të shkollës. Reaksioni që kishte filluar të vepronte që kur u hodhën themelet e godinës shkollore arriti pas tre vjet ekzistence deri në djegien e shkollës së Iballës, në verën e vitit 1906.⁴⁾

Nga gjithë sa është thënë del e qartë se në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit tonë shkrimi shqip dhe shkolla shqipe kishin bërë përparime të dukshme. Ndonëse me një numër të kufizuar shkolllash e në shumicën e rasteve pa shkollat përkatëse,

1) «Puka dhe shkolla», 1974, fq. 22; shkolla e Iballës u çel në tetor të vitit 1903.

2) Qeveria osmane, ndonëse nuk e shihte me sy të mirë veprimtarinë e shkollave të organizuara nga Vjena, nuk mund të dilte hapur kundër tyre, sepse me anën e kapitulacioneve ajo ia kishte njohur prej kohësh Austro-Hungarisë të drejtën e organizimit të rrjetit arsimor në vendet me popullsi katolike të Perandorisë Osmane. Por ajo mori masa për t'i detyruar prindërit myslimanë që të mos i dërgonin fëmijët e tyre në këto shkolla.

3) AQSh i RPSSH, Fondi «25-vjetori i Pavarësisë», Dos. e Shkodrës; «Puka dhe shkolla», fq. 22.

4) Po aty.

pa mësues të përgatitur, me mjete të pakta dhe në përgjithësi fshehurazi nga autoritetet osmane dhe nga armiq-të e tjerë, mësimi në gjuhën shqipe mori një përhapje aq të madhe sa nuk ishte parë ndonjëherë gjer në atë kohë. Në kundërshtim me urdhrat e qeveritarëve osmanë dhe me propagandat e huaja, dëshira për të mësuar shkrimin shqip ishte bërë e përgjithshme si tek shqiptarët myslimanë ashtu edhe tek ata kristianë.

Duke vlerësuar gjithë sa ishte arritur deri në fund të shekullit të kaluar në këtë fushë, rilindësi i shquar Sami Frashëri shkruante: «... «Më njëzet vjet (që nga Lidhja e Prizrenit) shkronjatë shqip lëshuanë aqë rrënjë të shëndosha e zun' aqë themele të fortë, sa s'munt të çkulet e të rëzonet kurrë...»

Mbrodhëri' e shkonjavet shqip ishte vdekje për armikët e kombësisë sonë. Më parë gjithë thoshinë që kjo punë s'bëhetë, shqipja s'është një gjuhë që të munt një të shkruhetë, është një gjuh' e lig' e e prishurë, ... e kaqe të tjera fjalë të kota... Shqipja sot nuk' është një gjuhë e pashkruarë, ... sot është një gjuhë, që shkruhetë e këndohetë, edhe nga më të bukuratë...»¹⁾

Gjithashtu ishte zhvilluar në mënyrë të shpejtë letërsia shqipe, publicistika dhe në përgjithësi lëvizja kombëtare shqiptare.

1) S. Frashëri, Vep. e cituar, fq. 55-56.

XI

PËRËPJËKJET PËR T'I NGRITUR SHKOLLAT SHQIPE TË KORÇËS NË NJË NIVEL MË TË LARTË. FORCIMI I REAKSIONIT


Përhapja me sukses e shkrimit shqip dhe e shkollave të fshehta shqipe në fund të shekullit XIX, tregonte se lëvizja arsimore si pjesë përbërëse e lëvizjes sonë kombëtare po triumfonte mbi të gjitha pengesat e vështirësitë që i dilnin përpara. U përballuan ndjekjet, kërcënimet, internimet dhe burgimet e bëra nga sunduesit osmanë, institucionet fetare dhe elementët reaksionarë vendës. E gjithë barra e shpenzimeve u përballua nga masat popullore, të cilat megjithëse të varfra, sipas mundësive të tyre, bënë sakrificat më të mëdha për këtë qëllim.¹⁾

Përparimet ishin me të vërtetë inkurajuese. Në çdo fshat dhe qytet kërkoheshin dhe bliheshin me zell librat shqipe; korrespondenca midis shqiptarëve bëhej gjithnjë e më shumë në gjuhën amtare; ishte dobësuar fanatizmi fetar dhe ishte forcuar bashkëpunimi midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme; ishte pakësuar numri i turkomanëve e i grekomanëve dhe ishin forcuar ndjenjat kombëtare. Kishte mësues shqiptarë që shërbenin në shko-

1) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit Nr. 34/res, datë 4 maj 1899.

llat greke, të cilët ishin të gatshëm të shërbenin në shkollat shqipe, qoftë edhe kundrejt një pagese më të vogël.¹⁾

Rezultatet e arritura kishin krijuar një bazë për përhapjen e mëtejshme të arsimit e të kulturës shqiptare dhe për forcimin e propagandës kombëtare. Përveç kësaj, vetë



Kopje dëftese e shkollës shqipe të djemve

1) Po aty: Raport i Orhan Pojanit e Thanas Sinës mbi shkollën shqipe në Korçë, nëntor 1899.

rilindësit duke pasur edhe mbështetjen e masave popullore, e kuptuan se nuk duhej kënaqur me ato që ishin arritur; duhej zhvilluar e thelluar më tej puna e filluar për të plotësuar nevojat në rritje për arsim e kulturë kombëtare, të cilat tani kishin përfshirë pothuajse të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare në krahinat e ndryshme të vendit. Bile edhe zonat malore si Kolonja, Shpati, Dibra etj., ndonëse ishin më prapa nga pikëpamja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik-shoqëror, me përhapjen e ideve kombëtare dhe duke e ndjerë më pak peshën e sundimit osman, u bënë vatra të rëndësishme ku u përhapën shkrimi e shkollat e fshehta shqipe.

Por në kushtet e rënda të sundimit osman, të ndjekjes së egër që i bëhej lëvizjes sonë kombëtare në përgjithësi dhe gjuhës e shkollës shqipe në veçanti, duhej gjetur edhe rruga më e përshtatshme nëpër të cilën mund të ecej përpara. Përvoja kishte treguar se përpjekjet e bëra për të shtuar numrin e shkollave publike shqipe kishin ndeshur në kundërshtimin e rreptë të autoriteteve qeveritare osmane. Në Shqipërinë e Jugut vetëm dy shkollat shqipe të Korçës kishin mundur të qëndronin të hapura me shumë vështirësi dhe ishin të vetmet shkolla publike shqipe në zonën e përmendur.

Në këto rrethana rilindësit me të drejtë mendonin se pa hequr dorë nga kërkesat për të siguruar nga Porta e Lartë lejimin e shkrimit shqip e të shkollave shqipe, pa hequr dorë nga përhapja e mëtejshme ilegalisht e shkrimit shqip dhe e shkollave të fshehta shqipe, duhej punuar më shumë për të forcuar dhe ngritur në një nivel më të lartë dy shkollat shqipe të Korçës.

Nevoja e forcimit dhe e ngritjes në një nivel më të lartë të shkollave shqipe të Korçës shihej nga dy aspekte të rëndësishme: së pari, duhej ngritur cilësia e përgatitjes së nxënësve të këtyre shkollave; duhej kapërcyer niveli fillestar i tyre, me qëllim që nxënësit të përgatiteshin më mirë për jetën dhe në këtë mënyrë shkollat do t'i përgjigjeshin më mirë shkallës së zhvillimit të mëtejshëm ekonomik e shoqëror; së dyti, meqenëse shkolla të reja shqipe nuk mund të hapeshin, këto që ekzistonin duhej të zgje-

roheshin, të pajiseshin me konvikte në mënyrë që të frekuentoheshin edhe nga nxënës të krahinave të tjera të vendit, të cilët, pasi të mbaronin shkollën, do të ndihmonin në përhapjen e mësimin në gjuhën shqipe në të gjitha krahinat e Shqipërisë. Mendohej kështu që Korça «të bëhej një qendër intelektuale e të gjithë Shqipërisë»¹⁾ dhe, në kushtet kur ishte rritur nevoja jo vetëm për libra në gjuhën shqipe por edhe për mësues të shqipes, përgatitjen e tyre mund ta merrnin përsipër përkohësisht shkollat shqipe të Korçës.

«Njëri nga qëllimet e shkollës — shkruan Sevasti Qiri-riazi, duke iu referuar pikërisht fundit të shekullit XIX, — ishte t'i stërvisnim të gjitha nxënëset që të ishin në gjendje të kryenin detyrën e mësuesit. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të arrinim të përhapnim arsimin edhe në krahinat e largëta të vendit tonë...»²⁾

Duke analizuar gjendjen e arsimit në Shqipëri dhe të shkollave shqipe të Korçës, patriotët shqiptarë me të drejtë shtruan përpara vetes pyetjet: «ç'munt të mësojë djali mbë 4 vjet? a edhe ndë mësoftë mirë shqipenë, si do të muntjë njeriu të rronjë vetëm me gjuhën shqipe ndë vende të huaj, ku radhazi venë shqiptarëtë për të nxjerrë bukënë e tyre e për të fituarë? A si të mbarojë djali skolinë shqipe, mbë ç'skoli më të lartë do të vejë pastaj, që me shqipenë që mësoi të mbaronjë mësimetë, se tjetër skoli shqipe nuk ka?»³⁾ Konkluzioni që nxirrnin ata ishte se shkolla duhej ngritur në një nivel më të lartë, të forcohej mësimi i gjuhëve të huaja dhe të shtohej numri i nxënësve deri në 500.⁴⁾

«Skolia shqipe që kemi sot — shkruanin Orhan Pojani e Thanas Sina në fund të v. 1899, — është nevojë të bënetë kolezh, ku të mësonenë mirë përveç gjuhës shqipe edhe frengjishtja, gjermanishtja, turqishtja, që kështu me

1) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 2/sek, datë 4 janar 1901.

2) S. Qiri-riazi, vep. e cituar, fq. 36.

3) Raport i cituar i O. Pojanit e Th. Sinës.

4) Po aty.

të vërtetë të bënë pun' e dobishme për kombinë e për djemtë. Pa ky kolezh ndë pastë edhe pension (konvikt) për djem nga fshatratë e nga qytetet e Shqipërisë, atëhere do të jetë një vatrë drite e mbrohtësie e qytetërie për gjithë Shqipërinë.»¹⁾ Dhe kërkohet që të punonin të gjithë patriotët gjer në realizimin e këtij qëllimi.

Përpjekje të tilla u bënë edhe për shkollën shqipe të vajzave. Gjergj Qiriaz, e motra, Sevastia, dhe patriotët e tjerë bënë përpjekje për krijimin pranë shkollës së vajzave të një konvikti, i cili do të shërbente për të tërhequr një numër më të madh nxënësesh dhe jo vetëm nga rrethi i Korçës, por edhe nga krahinat e tjera të Shqipërisë.

Përpjekjet e para për të tërhequr vajzat konvikto-re në shkollën e vajzave u bënë qysh në vitin shkollor 1899-1900 dhe ishte menduar të fillohej me dy vajza, një nga Negovani dhe tjetra nga Elbasani.

SKOLIA QOMIE E VAJZAVET

KORÇE, QOMPRE

Kopje deftese, 1899, në Korçë

... kopje deftese e kësaj shkolle për pas vërtetimit të rregullt të punës së shkolle dhe ndërkohërisht për shpërndarjen e parave të shkolle.

Kopje deftese.

Shprehjet

Kopje deftese e shkollës shqipe të vajzave

1) Raport i cituar i O. Pojanit e Th. Sinës.

Duke folur për rezultatet e arritura dhe për perspektivën, Gjergj Qiriazhi shkruante në vitin 1901: «... Me të vërtetë se dyke marrë ndërsy vegëlat (duke marrë parasysht mjetet) që kemi e përdorimë edhe dyke vënë re mbrodhësin' e punës (përparimin) s'mundim përveç të ndjejmë gëzim...» — Por vazhdonte ai — «Kjo ishte e vetmja skoli për vasha ndë tërë Shqipërinë. Ndë gjendjet' e tanishme nukë është lehtë që të hapen edhe të tjera pa le që s'kemi edhe vegëlat. Kjo gjë na ka nagasurë (shtytur) të ndjejmë nevojë të madhe për të hapur një pension (konvikt), që të mundin edhe vasha nga të tjera vise të Shqipërisë të fitojnë dobinë e skolisë s'onë...»¹⁾

Mirëpo edhe përpjekjet për zgjerimin e shkollës dhe për krijimin e konviktit ndeshnin në vështirësi të shumta. Mungesa e mjeteve materiale ishte një pengesë serioze që, krahas të tjerave, e vështirësonte krijimin e konviktit. Shtimin e numrit të nxënësve dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme shkollore.

Në verën e vitit 1900, kur Qiriazët dhe patriotët e tjerë shqiptarë mendonin për krijimin e konviktit, misionarët protestantë, duke njohur vështirësitë materiale që u dilnin shqiptarëve në këtë drejtim, e konsideruan rastin të favorshëm që të vinin dorë mbi shkollën e vajzave për qëllimet e tyre politike e fetare. Ata u ofruan që të krijojnë konviktin me shpenzimet e veta, me konditë që të kishin pastaj të drejtën e vetme mbi këtë institucion.

Gjergj e Sevasti Qiriazhi, duke patur të qartë se çfarë fshihej pas asaj oferte dhe ç'rëndësi politike kishte kondita e vënë nga misionarët e huaj, e refuzuan me vendosmëri atë propozim. Megjithatë, kushtet e vështira politike në të cilat funksiononte shkolla dhe masat e rrepta të autoriteteve osmane bënë që edhe më vonë të mbahej formalisht, sa për opinionin, etiketa e huaj.²⁾

1) Po aty: Gjergj Qiriazhi, «Ca shënime për punën ndë Korçë për motin 1901», gusht 1901.

2) Lidhur me këtë problem vetë Gjergj Qiriazhi na ka dhënë sqarime të plota: «Ndërmarrja e madhe (çelja dhe mbajtja e shko-

Megjithë vështirësitë financiare u arrit që në vitin shkollor 1900-1901 shkolla, përveç nxënësve të jashtme, të kishte edhe 5 nxënës konviktore, të cilat u mbajtën vetëm me kontributet e shqiptarëve. Në vitin shkollor 1901-1902 numri i konviktoreve u rrit në 9, të cilat «që të gjitha — siç shkruante Gjergj Qiriazi, — vasha që na japin shpresë se një ditë do t'i shërbejnë kombit me gjithë zemër».1)

Krijimi i konviktit e shtoi numrin e nxënësve, të cilat tani vinin edhe nga krahinat e tjera të vendit, por njëkohësisht u rritën shpenzimet dhe nevojat e shkollës dhe të konviktit. Dilte nevoja të zgjerohej përsëri godina shkollore dhe të shtohej numri i dhomave që duheshin edhe për fjetje.2)

llës shqipe të vajzave) është realizuar prej qytetit (të Korçës) dhe pjesëtarëve të shtëpisë (së Qiriazëve), dhe deri më sot shkolla nuk ka hequr dorë nga qëllimi i saj, por punon për gjuhën dhe përparimin e kombit... Puna kombëtare shkonte përpara dhe qëllimi i shkollës u plotësua... Ata (misionarët protestantë amerikanë) nuk kanë pasur kurrë ndërmendje që të përkrahin punën kombëtare. Ata synojnë që të japin ndihma më shumë atje, ku njerëzit bëhen protestantë, por qëllimi i vendasve (shqiptarëve) është më i thellë: që të zgjuajnë kombin nga gjumi i tyre i thellë dhe të shkojnë përpara në civilizim, njësoj si popujt e tjerë. Në këtë shkollë ekziston liri e plotë. Vajzat mund të jenë ortodokse, myslimane ose katolike. Në 13 vjetët e ekzistencës së saj shkolla ka bërë punë të mbëdha, dhe sipas mendimit të vendasve ka dhënë rezultate të mira për popullin. Sipas mendimit të amerikanëve ajo nuk ka dhënë asnjë frut, pse gjatë gjithë këtyre vjetëve asnjë vajzë nuk mori fenë protestane...». Gjergj Qiriazi «Disa vrejthe mbi shkollën shqipe të vajzave», Manastir, 1904.

1) Shënime të Gj. Qiriazit «Mbi shkollën shqipe të vajzave», nëntor 1901.

2) «Siukur të rri të shënoj nevojat e punësë ndë hollësirët të tyre, — shkruante Gjergj Qiriazi, — do të mos më sosin (mjaftojnë) ditë të tëra të shkruanj... Për mua është veçanërisht e qartë se po të ekzistonin më tepër mjete munt të bëhesh

Megjithëkëtë patriotët vazhduan përpjekjet për ta shtuar numrin e nxënësve konviktore. Si rezultat, brenda dy-tre vjetëve në konviktin e shkollës së vajzave pati më shumë se 15 nxënës konviktore, numri i kërkesave vinte duke u rritur dhe në përgjithësi shkolla arriti suksese mjaft të mira.

Interesant është krahasimi që bën konsulli austro-hungarez i Manastirit ndërmjet shkollës shqipe të vajzave në Korçë dhe një shkolle bullgare vajzash në Manastir: «Shkolla bullgare-angleze në Manastir — shkruan ai, — ka shumë kohë që e ndjek me xhelozzi zhvillimin e institutit shqiptar për vajza në Korçë. Ndërsa shkolla në Manastir, megjithëse ka gjashtë mësuese, pjesërisht shumë të zonjat, lokale shumë të bukur dhe internat, prapsepër çdo vit ia mbrin me mundime frekuentimit prej 18 nxënësve të brendshme dhe po aq të jashtme, duke pasur me këtë rast dhe shpenzime të jashtëzakonshme, kurse shkolla e Korçës, me mundësira dhe kondita ekzistence në çdo pikëpamje jo të favorshme dhe me shpenzime mirëmbajtjeje relativisht më të vogla, nuk mund t'u bëjë ballë kërkesave të nxënësve».¹⁾

Për të përballuar nevojat e shkollës ishte krijuar një arkë, nga e cila mbaheshin nxënëset konviktore, paguhe-shin personeli mësimor e shërbyes dhe shpenzimet e tjera.

Megjithë vështirësitë e ndeshura, shkollat shqipe të Korçës u zhvilluan më tej: numri i nxënësve dhe i mësuesve u rrit, u zgjeruan lokalet shkollore, u shtua numri i klasave, u zgjerua programi mësimor etj.

Në shkollën e djemve tani kishte 6 klasë së bashku me një përgatitore; u forcua dhënia e gjuhës franceze dhe u bënë përpjekje për të siguruar edhe një mësues të përgatitur mirë. Shkolla e vajzave kishte tani 5 klasë prega-

edhe shumë më tepër punë. Dhe në fakt, për ne është e vështirë, kur mendojmë se sa e nevojshme është puna, dhe kur shohim, se ajo duhet që të mbetet pa u kryer për shkak të të hollave... Po aty.

1) HHStAPAA: Raport i Konsullatës austro-hungareze të Manastirit, nr. 2/sek., datë 4 janar 1901.

titore (kopshtore) ku mësohej edhe shkrim e këndim, si dhe 4 klasë të rregullta. Në shkollën e djemve kuadri mësimor mbeti i kufizuar: Nuçi Naçi drejtor dhe mësues për



Helidhona Titu (Falli)

klasat e larta. Thanas Nona mësues për klasat e ulëta dhe Kristo Vodica, ndërsa në shkollën e vajzave përveç drejtoreshës, Sevasti Qiriazi, dhe dy mësueseve të përmendura, Fanka Efthim dhe Polikseni Luarasi, jepnin mësim edhe Thanas Sina e Grigor Cilka. Në vitin shkollor 1902-1903 u shtuan edhe dy mësuese të reja që sapo mbaruan atë shkollë, Helidhona Titu (Falli) dhe Thomaidha Llazo, të cilat dhanë mësim në klasat e ulëta. Mësueset e reja kishin qenë nga nxënëset e para të shkollës së vajzave.¹⁾

Në vitin 1904 shkollës së vajzave iu shtua mësuesja e talentuar Parashqevi Qiriazi, e cila atë vit kishte përfunduar studimet e larta jashtë vendit.

Programi i shkollës së djemve me atë të vajzave ishte afërsisht i njëjlojtë: në të parën mungonin gjuha angleze

1) Helidhona ishte bija e një robaqepësi të thjeshtë, por të brumosur me dashurinë për atdheun. I ati i saj, pa marrë parasysh asnjë pengesë, e çoi vajzën e vet të ndiqte deri në fund shkollën shqipe. Ndërsa Thomaidha ishte bija e Polikseni Nikollës, që për shumë vjet punoi në shkollën e vajzave si shërbyese dhe guzhiniere. Të dy vajzat e kësaj punëtoreje të varfër, Thomaidha dhe Marigoja, vazhduan mësimet në shkollën shqipe të vajzave dhe e para u bë edhe mësuese në atë shkollë.

dhe mësimi i punëdores, por shtoheshin turqishtja dhe frëngjishtja.

Nga të dhënat që kemi rezultoi se, në fillim të shekullit tonë, ndarja e lëndëve sipas klasave në dy shkollat shqipe të Korçës ishte:

Në shkollën e djemve:

I. Stërvitore dhe klasa I

- 1) Mësime me gojë gjithë tok (ushtrime të foluri);
- 2) Këndim shqip;
- 3) Këngë;
- 4) Të shkruarë;
- 5) Të shkruarit e numërave gjer më 1000.



Parashqevi Qiriazi

II. Klasa II

- 1) Këndim shqip;
- 2) Mësime me gojë;
- 3) Historia e Shqipërisë;
- 4) Numeratore (aritmetikë);
- 5) Ushtrime të shkruari;
- 6) Greqisht.

III. Klasa III.

- 1) Këndim shqip;
- 2) Shkronjëtores (gramatikë);
- 3) Dheshkronjë (gjeografi);
- 4) Histori;
- 5) Numeratore (aritmetikë);

- 6) Mirë-shkronjë (bukurshkrim);
- 7) Këngë.
- 8) Kafshë-shkronjë (e nga ato që ka Dituria);
- 9) Këndim greqisht.

IV. Klasa IV

- 1) Këndim shqip e shkronjëtoore (gramatikë);
- 2) Historia e përgjithshme — Popujt e vjetër;
- 3) Njeri-tregonjë;
- 4) Kafshë-shkronjë;
- 5) Fizikë;
- 6) Këngë;
- 7) Piktive (vizatim);
- 8) Letër-shkronjë;
- 9) Përralla;
- 10) Numëratore (aritmetikë);
- 11) Dhemasje (gjeometri);
- 12) Mirë-shkronjë;
- 13) Dheshkronjë;
- 14) Këndim turqisht;
- 15) Frëngjisht;
- 16) Këndim greqisht.

V. Klasa V.

- 1) Këndim shqip e shkronjëtoore;
- 2) Histori e përgjithshme;
- 3) Njeri-tregonjë;
- 4) Kafshë-shkronjë;
- 5) Fizikë;
- 6) Këngë;
- 7) Piktive;
- 8) Letër-shkronjë;
- 9) Dhemasje;
- 10) Numeratore;
- 11) Greqisht;
- 12) Përralla me të shkruarë;
- 13) Dheshkronjë;

- 14) Këndim turqisht;
- 15) Këndim frëngjisht e shkronjëtoare.

VI. Klasa VI

- 1) Këndim shqip;
- 2) Shkronjëtoare;
- 3) Dheshkronjë;
- 4) Histori e Maqedonisë;
- 5) Njeri-tregonjë;
- 6) Kafshë-shkronjë;
- 7) Oriktologji (mineralogji);
- 8) Bimë-tregonjë;
- 9) Mirë-shkronjë;
- 10) Letër-shkronjë;
- 11) Fizikë;
- 12) Dhemasje;
- 13) Numeratore;
- 14) Piktime;
- 15) Këngë;
- 16) Përralla me të shkruarë;
- 17) Këndim frëngjisht e shkronjëtoare;
- 18) Këndim greqisht e shkronjëtoare;
- 19) Këndim turqisht e shkronjëtoare.

Duke përjashtuar gjuhën turke, e gjithë ngarkesa pedagogjike për të 6 klasët ndahej midis drejtorit të shkollës, Nuçi Naçit dhe mësuesit Thanas Nona¹⁾.

1) Lëndët mësimore për vitin shkollor 1900-1901 ishin të ndara në këtë mënyrë:

Nuçi Naçi zhvillonte: aritmetikë (kl. I-II-III), ushtrime të shkruari (kl. II), mirë-shkronjë (kl. III-IV-VI), lexim shqip e gramatikë (kl. IV-V-VI), histori e përgjithshme (kl. IV-V), njeritregonjë (kl. IV-V-VI), kafshë-shkronjë (kl. IV-V-VI), fizikë (kl. IV-V-VI), gjeografi (kl. IV-V-VI), Histori e Maqedonisë (kl. VI), mineralogji (kl. VI), botanikë (kl. VI), greqisht (kl. II-III), këngë (kl. III-IV-V-VI), vizatim (kl. IV-V-VI), letër-shkronjë (kl. IV-V-VI) dhe përralla (kl. IV).

Në shkollën e vajzave:

I. Klasat përgatitore që zgjasnin sipas moshës dhe përparimit të vajzave 1-5 vjet:

- 1) Mësim vështrimi;
- 2) A.B.C. Lexim, shkrim;
- 3) Aritmetikë.

II. Klasa I

- 1) Lexim-shkrim — të mësuarit përmendësh;
- 2) Aritmetikë;
- 3) Gjeografi e Shqipërisë;
- 4) Greqisht;
- 5) Anglisht.

III. Klasa II

- 1) Lexim-shkrim;
- 2) Gramatikë shqipe;
- 3) Aritmetikë;
- 4) Histori dhe gjeografi e Shqipërisë;
- 5) Anglisht;
- 6) Greqisht.

IV. Klasa III

- 1) Gramatikë shqipe, lexim dhe shkrim;
- 2) Aritmetikë;
- 3) Histori dhe gjeografi e përgjithshme;
- 4) Histori natyre (Zoologji);

Thanas Nona zhvillonte: ushtrime të foluri (kl. I-II), lexim shqip (kl. I-II-III), ushtrime të shkruari (kl. I), histori e Shqipërisë (kl. II), këngë (kl. II), gramatikë (kl. III), gjeografi (kl. III), histori (kl. III), kafshë-shkronjë (kl. III), aritmetikë (kl. IV-V-VI), gjeometri (kl. IV-V-VI), frëngjisht (kl. IV-V-VI) dhe greqisht (kl. IV-V).

- 5) Dituri natyre;
- 6) Anglisht;
- 7) Greqisht;

V. Klasa IV

- 1) Gramatikë shqipe, lexim dhe shkrim;
- 2) Aritmetikë;
- 3) Histori dhe gjeografi e përgjithshme;
- 4) Histori natyre (botanikë);
- 5) Dituri natyre (fiziologji dhe astronomi);
- 6) Anglisht;
- 7) Greqisht.

— Punë dore për femrat, këngë dhe gjimnastikë për të gjithë.¹⁾

Në të dy shkollat shqipe të Korçës zhvillohej si lëndë e veçantë edhe mësimi i fesë.

Shkolla e vajzave normalisht vazhdonte 9 vjet: 5 vjet pregatitore dhe katër klasë të plota.

Në përfundim të shkollës qoftë të djemve, qoftë të vajzave, nxënësi pajisej me një dokument shkollor.

Përhapja me sukses e shkrimit shqip dhe e shkollave të fshehta shqipe si dhe forcimi i shkollave shqipe të Korçës e kishte shtuar shqetësimin e sundimtarëve os-

1) Po aty: shtojcë e raportit të konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 8, datë 14 janar 1902. Raport i cituar i O. Pojanit e Th. Sinës «mbi shkollën shqipe»,

Personeli pedagogjik i shkollës së vajzave në vitin shkollor 1900-1901 jepte këto lëndë:

Sevasti Qiriazi: Historinë e Gjeografinë e Shqipërisë, historinë e përgjithshme, anglisht, greqisht dhe aritmetikë.

Fanka Eftimi: aritmetikë, gjeografi, histori natyre.

Polikseni Dhespoti (Luarasi): mësimë demonstrimi, lexim dhe shkrim.

Thanas Sina: Gramatikë shqipe, greqisht.

Grigor Cilka: anglisht dhe dituri natyre.



Grigor Cilka

manë, të Fanarit të Stambollit dhe të gjithë armiqve të lëvizjes kombëtare shqiptare. Si rrjedhim, në vitet e fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX lufta kundër gjuhës dhe shkollës shqipe u bë edhe më e ashpër. Në këtë periudhë, shpërtheu një fushatë e re ndjekjesh, presionesh, kërcënimesh, internimesh dhe burgimesh. Porta e Lartë, pasi doli fituese nga lufta me Greqinë në vitin 1897, e ndjeu veten përkohësisht më të sigurt ndaj rrezikut grek dhe e përqëndroi vëmendjen në shtypjen e lëvizjes shqiptare.

Në tetor të vitit 1898 Porta e Lartë u dërgoi një urdhër të fshehtë vilajeteve shqiptare, me anën e të cilit urdhëronte që të «shtypnin sa të ishte e mundur përdorimin e gjuhës shqipe, t'i ndiqnin botimet në gjuhën shqipe, të kontrollonin shtëpitë e atyre personave që ishin të dyshimtë për mbajtjen e tyre dhe ata që do të kapeshin me të tilla të bëheshin përgjegjës»¹⁾.

Sulltani turk mbahej gjithnjë fort mbas parimeve fetare e shtetërore të Perandorisë së kalbur osmane, sipas të cilave të gjithë nënshtetasit myslimanë, pavarësisht nga kombësia, duheshin arsimuar dhe edukuar «në fenë e shtetit» dhe me «gjuhën e shtetit» dhe për këtë ata duhej të ndiqnin vetëm shkollat në gjuhët turke ose arabe. Sull-

1) Po aty: Promemorie e baronit Zwidinek dërguar nga Vjena, në mënyrë shumë rezervate konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, T. Ippen, datë 21 nëntor 1898.

tani kishte frikë t'u bënte qoftë edhe lëshimin më të vogël shqiptarëve myslimanë, të cilët donte t'i mbante gjithnjë të lidhur nga ana fetare e politike dhe shqetësohej shumë sidomos nga afrimi i tyre me vëllezërit e vet, shqiptarët kristianë.

Në vazhdim të kësaj politike, në muajt e parë të vitit 1899, me irade të veçantë të Sulltanit, urdhërohej heqja e fëmijëve myslimanë nga shkollat shqipe të Korçës. Autoritetet osmane të vendit dhe veçanërisht mytesarifi i Korçës, feudali reaksionar shqiptar Mehmet Ali Delvina¹⁾ përdorën të gjitha arbitraritetet për të çuar në vend fjalën e eprorit të tyre, padishahut osman. Nga të gjitha këto masa, një pjesë e shqiptarëve myslimanë u detyrua të largojë fëmijët nga shkollat shqipe, por lëvizja kombëtare dhe arsimit shqiptar nuk mund të ndaleshin me urdhëra e me masa arbitrare. Nxënësit myslimanë vërtet u ndaluan të frekuentonin shkollën shqipe aq të dashur për ta, por ata vazhduan mësimet në gjuhën shqipe fshehurazi, duke u mbledhur në shtëpitë e njëri-tjetrit.

Shumë prindër myslimanë u detyruan të tregohen më të rezervuar ndaj shkollës. Vetë Alo Deshnica u lëkund, nuk mundi t'u qëndronte deri në fund presioneve të vazhdueshme dhe u tregua më i rezervuar.

Në vitet e para të shekullit tonë lufta e sunduesve osmanë kundër lëvizjes kombëtare dhe mësimt të gjuhës shqipe u bë më e ashpër dhe e përgjithshme. «Në bazë të urdhrave turke më të reja — detyrohej të shkruante konsulli austro-hungarez i Shkodrës, — dënohet posedimi i një libri shqip ose përdorimi i gjuhës shqipe në korrespondencë. Veçanërisht të ndaluara janë gazetat shqipe që janë shtypur jashtë dhe vendasit (shqiptarët) tregojnë një guxim e sakrificë jo të vogël, kur i ruajnë ato ose i japin hua dorë më dorë.»²⁾

1) Mehmet Ali Delvina ishte dhëndri i Ferit Pashë Vlorës, i cili, i vënë plotësisht në shërbim të sunduesit kishte arritur deri në gradën e lartë të Vezirit të Madh (kryeministrit) të Perandorisë Osmane.

2) Po aty: Dosje XIX-XX/54, D. 15, nr. inv. 867, viti 1905.

Kontrolle të forta u bëheshin qiraxhinjve shqiptarë, të cilët së bashku me mallrat tregtare transportonin edhe libra në gjuhën shqipe e koorrespondencë personale.¹⁾

Vëmendje veçanërisht të madhe autoritetet qeveritare osmane u kushtuan dy shkollave shqipe të Korçës të cilat, sipas shprehjes së një diplomati të huaj «i kishin halë në sy» dhe që «çdo ditë gjendeshin në rrezik të mbylleshin prej autoriteteve»²⁾. Autoritetet sunduese kërkonin të gjenin qoftë edhe një pretekst të vogël për të «justifikuar» mbylljen e këtyre shkollave. Objekt i ndjekjeve të forta u bë veçanërisht drejtori i shkollës shqipe të djemve, Nuçi Naçi. Megjithëse gjyqi i kurdisur kundër tij dështoi, mytesarifi i Korçës, Mehmet Aliu, duke shfrytëzuar pozitën qeveritare dhe i përkrahur nga elementët reaksionarë e proturkë i vazhdoi më me ngulm përpjekjet e tij anti-shqiptare për të mbyllur shkollën. Disa herë në vit përsëriteshin kontrollet, marrjet në pyetje nga policia, kontrolli i dokumenteve: i lejes, i diplomave të mësuesve, i librave shkollorë etj. Vetë drejtori i shkollës ishte nën një survejim të vazhdueshëm dhe shtërëgohej me mënyra të ndryshme që të mbyllte shkollën, por pa dobi. Autoritetet osmane dhe policiaurvejonin gjithashtu të gjithë ata që ndihmonin shkollën ose mbanin anën e lëvizjes kombëtare.

1) Në një rast të tillë, në muajt e parë të vitit 1900, autoritetet qeveritare të vilajetit të Manastirit i telegrafuan Korçës, që qiraxhinjve të nisur prej andej t'u dilej përpara në Plasë (12 km nga Korça) dhe t'u konfiskohej korrespondenca që kishin me vete. Por lajmi ra në vesh të patriotëve korçarë dhe këta me shpejtësinë më të madhe nisën në drejtim të qiraxhinjve një kalorës besnik, i cili u takua me ata tek hani i Zvezdës (5 km në veri të Plasës) dhe në këtë mënyrë u fshehën të gjitha letrat me rëndësi politike dhe që mund të dëmtonin shqiptarët.

2) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 46, datë 14 korrik 1900.

Shumë patriotë shqiptarë nuk lejoheshin të largoheshin nga Korça. Me anë të një telegrami të dërguar nga qendra e vilajetit, nga Manastiri, i rekomandohej mytesarifit të Korçës një survejim i veçantë ndaj patriotit Thimi Marko.¹⁾

Patriotët shqiptarë të ndodhur «përpara kundërmasave drakoniane të qeverisë otomane mund të vepronin vetëm fshehurazi».²⁾ Mytesarifi i Korçës Mehmet Ali Delvina ishte vënë në lidhje të drejtpërdrejtë me Stambollin dhe për vitin shkollor 1900-1901 i shtoi edhe më tepër ndjekjet e presionet. Patriotët korçarë dhe mësuesit e shkollës, duke parë se sunduesit osmanë kërkonin vetëm një pretekst për mbylljen e shkollës, vepruan me shpejtësi për të fshehur librat shqipe të ndaluara nga Porta e Lartë, korrespondencat personale dhe çdo dokument që mund të ngjallte dyshime tek sunduesit.

Ndjekjet e autoriteteve osmane nuk kufizoheshin vetëm në Korçë, ato ishin shtuar në të gjitha viset shqiptare dhe kudo që veprohej në dobi të lëvizjes kombëtare shqiptare. Duke folur për këtë çështje, nënkonsulli austro-hungarez i Vlorës konstatonte në mesin e vitit 1901: «Ka afër një vit që qeveria otomane ka filluar t'i kushtojë lëvizjes kombëtare të shqiptarëve një vëmendje shumë më të madhe se sa deri më sot. Librat dhe gazetat shqipe kanë qenë të ndaluara edhe më përpara. Patriotët e njohur prej autoriteteve, si në Vlorë ashtu edhe në Berat, kanë qenë edhe më parë objekt i një kontrolli të fortë, porse këtë vit qeveria e ka marrë këtë lëvizje kaq seriozisht, sa

1) Edhe patrioti shqiptar Dhimitër Mole nga Korça, që jetonte si i emigruar në Filipopol të Bullgarisë dhe në vitin 1900 po vinte në atdhe për të parë të afërmit e tij, kur arriti në Manastir iu nënshtrua natën dy herë kontrollit me gjithë grua e fëmijë. Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 46, datë 14 korrik 1900.

2) Po aty: Dosje XIX-XX/54, D. 15, Nr. inv. 867, viti 1905.

duket sikur ajo është një rrezik imediat për vetë ekzistencën e perandorisë»¹

Në veprën e vet antishqiptare Porta e Lartë mbështetjesh si edhe më parë në parinë reaksionare shqiptare dhe në klerin mysliman fanatik. Shtresat e pasura reaksionare vendase interesoheshin në radhë të parë të ruanin pronat e privilegjet e tyre klasore. Për këtë arsye ato ndiqnin dhe zbatonin me besnikëri politikën dhe urdhëresat e sunduesit të huaj osman dhe ishin kundër përhapjes së arsimit dhe ndriçimit të masave popullore që shfrytëzoheshin prej tyre. Duke treguar shkakun e vërtetë të këtij qëndrimi reaksionar të parisë shqiptare, gazeta shqiptare «Drita» e Sofies shkruante në fillim të shekullit tonë: «Parësia e Shqipërisë nukë duan të ndritohen shqiptarët me dituni se duan t'i përdorin ashtu si duan ata vetë, për fitime të paudhëshme të tyne. Nga ky shkak të parët e Shqipërisë nukë duan mësim e dituni për popullin me shkronja shqyp; se tui marë mësim në gjuhë të vet hapin sytë shqypetarët edhe kështu prishet interesi i të parëve të vendit, i pashallarëve, i bejlerëve e i agallarëve. Vetëm nga shkalla e dytë ka që punojnë për gjuhën tonë.»²)

Klerikët myslimanë dhe institucionet fetare islame ishin gjithashtu mbështetje e politikës së Portës së Lartë dhe, duke përdorur fenë e sunduesit, këtë opium të popujve, punonin me ngulm për të mbajtur popullin në padituri dhe në fanatizëm fetar. «Tashti — vazhdonte gazeta «Drita», — le të vijmë edhe në kryelidhunit hoxhë, myfti e myderisë, të cilët janë pështjellë nën petkat e shpirtënit e me këtë fuqi të tyntë na ndalojnë këndimin tui thanë se këndimi në gjuhë shqyp na prish fenë. . . Por hoxhët nuk duan dituni se janë ata vetë të paditun e të verbën. . . Se fanatizma u ka prishur trutë të mjerëve e s'dinë ç'flasin. Shkrimet shqyp nuk janë kundër fevet. . . flasin të drejtën, thonë të vërtetën.»³)

1) Po aty: informacion i nënkonsullit austro-hungarez të Vlorës, Nr. 49/res, datë 26 gusht 1901.

2) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 57, datë 11 shkurt 1905, fq. 2.

3) Po aty.

Një armik tjetër po aq i rrezikshëm sa edhe sunduesi osman ishte gjithnjë kisha ortodokse dhe kreu i saj, Patrikana e Stambollit, të cilat në këtë periudhë të re gjithashtu e kishin zgjeruar e forcuar veprimtarinë anti-shqiptare. Përveç veprimtarisë së drejtpërdrejtë reaksionare që zhvillonin kundër shkollës e lëvizjes shqiptare, ato vazhdonin ashtu si më parë të kërkonin ndihmën e autoriteteve osmane, të bashkëpunonin me to dhe t'u shërbenin atyre edhe si informatorë. «Neve shqiptarët — shkruan gazeta «Drita» e Sofjes, — nuk kemi vetëm Halldupnë (epitet përbuzës që i është vënë sunduesit osman) mi krye që na mundon, nga Perëndia kemi edhe mëkëmbësit e Krishtit; është Fron i Fanarit i cili nukë ka tjetërë punë përveç të bëhet këpucë-grisur (spion) i Halldupit edhe të tradhëtonjë shqipëtarët. Ato më të fortat urdhërata janë dërguar mi të gjithë Dhespotlerët që të ndjekën shqiptarët me çfarëdo mënyre, ata që kanë dashuri për gjuhën shqip, andaj gjithë Dhespotlerët janë sot spiunët e Dovletit»¹⁾. Në disa krahina, si në atë të Shpatit të Elbasanit, politika helenizuese po kryhej edhe nën flamurin rus. Ndërhyrja ruse në çështjet thjesht shqiptare, ndonëse bëhej nën maskën e mbrojtjes së ortodoksizmit²⁾, i shërbente politikës pansllaviste.

Por «populli, edhe pse vonë, e kuptoi se veç giarpit të helmatisur nuk ishin tjetër këta priftën që bridhnin lirisht në atdheun tonë nën petkun e qingjit kin për t'i sjellë shërbime njerëzisë e qytetërimit»³⁾.

Gjatë viteve 1900-1901 autoritetet sunduese osmane kontrolluan shumë shtëpi të patriotëve të ndryshëm dhe bënë shumë arrestime e internime shqiptarësh, si në vend

1) Po aty, nr. 49, datë 13 gusht 1904, fq. 4. «Letër nga Korça». Dovlet ose Devlet do të thotë shtet dhe këtu ka kuptimin e shtetit osman.

2) HHStAPAA: ekstrakt nga një raport i konsullatës austro-hungareze të Manastirit, nr. 23, datë 4 prill 1899.

3) D. Hima, «Ujanallëm» (Të zgjohemi) fq. 8 (përkthim shqip në AIH).

ashtu edhe në Stamboll. Kështu u kontrolluan shtëpitë e Babë Dudë Karbunarës dhe të Islam Vrionit në Berat; u arrestua përsëri Hamdi Ohri, u arrestua mësuesi i shkollës shqipe të vajzave Thanas Sina. U bënë kontrolle të befasishme në shumë shtëpi patriotësh në Krujë, midis të cilëve edhe në atë të Ibrahim Kaloshit. Këtij të fundit i gjetën shumë libra shqipe, e arrestuan dhe pas dy ditësh e nisën nga burgu i Krujës për në burgun e Shkodrës.¹⁾ Në vitin 1900 u arrestua në Filat Rexhep Demi, i cili u dërgua pastaj në burgun e qendrës së vilajetit, në Janinë. Me urdhër të valiut të Janinës u dërgua në Filat një kolonel turk, posaçërisht për të kontrolluar shtëpinë e të arrestuarit dhe për të provuar fajësinë e tij. Gjatë kontrollit u gjetën shumë libra e gazeta shqipe, të cilat u konfiskuan. Në Janinë Rexhep Demi u mbajt dy vjet në bodrumet e famshme të burgjeve të atjeshme.²⁾

Edhe në burg Rexhep Demi nuk e pushoi aktivitetin patriotik. Ai u vu në lidhje me ish-nxënësin e tij Qamil Çamin, i cili i inkurajuar nga këto kontakte, themeloi në gjimnazin turk të Janinës, ku kishte vajtur për studime, një shoqëri të fshehtë shqiptare të përbërë prej 28 nxënësish.³⁾

Aty nga qershori i vitit 1901, në afërsi të Stambollit u arrestuan 4 shqiptarë, midis tyre edhe Sotir Ollani.⁴⁾ Këta, me një grup shokësh, kishin instaluar në qilarin e një shtëpie pranë Stambollit një shtypshkronjë të vogël, përdornin alfabetin e Stambollit dhe gërma të veçanta të tij, që nuk gjindeshin në vend, i zëvendësuan me gërma

1) AQSH i RPSSH, Fondi «25 vjetori i pavarësisë» Dos. e Krujës; H. Goci, Vepër e cituar, f. 34-35. Kruja në atë kohë nga ana administrative bënte pjesë në Vilajetin e Shkodrës.

2) AQSH i RPSSH, Fondi «25 vjetori i pavarësisë». Dos. e Sarandës.

3) Po aty.

4) Sotir Ollani kishte punuar me Abdyl Frashërin e më vonë me Shahin Kolonjën dhe vazhdonte t'i shërbente me besnikëri çështjes kombëtare.

të ngjashme.¹⁾ Edhe pas lirimit nga burgu, këta u mbajtën nën mbikqyrje dhe nuk u lejuan të vazhdonin vepërinë e filluar.

Po atë vit u arrestuan Koço Sotiri dhe Stefan Th. Postenani, të cilët u dënuan më vonë me 101 vjet burg.²⁾

Në fillim të vitit 1902 u bënë arrestime të reja. Në Elbasan u arrestuan dy vetë si «të dyshimtë» për marrëdhënie me komitetet shqiptare jashtë vendit, në të vërtetë sepse mësonin shkrimin shqip. Gjatë kontrollit atyre iu gjetën edhe korrespondenca që tregonin lidhjet e tyre me shqiptarë të tjerë, që banonin në qytete të ndryshme të vilajetit të Shkodrës dhe të Janinës. Për këtë arsye, vali i Manastirit u telegrafoi vilajeteve fqinje që të arrestonin personat që kishin qenë të lidhur me të arrestuarit në Elbasan.

Tepër i vështirë qe për shkollën shqipe të djemve viti shkollor 1901-1902. Drejtori i shkollës, Nuçi Naçi, vepëronte në kondita shumë të rënda. Ai fshehu gjithë korrespondencën që kishte me shqiptarët brenda dhe jashtë atdheut. Bisedat e tij në treg ose në kafene me patriotët shqiptarë ose me miqtë ishin ndërprerë. Çdo takim bëhej natën dhe në vende të caktuara qysh më parë.³⁾ Ndihamat që mblidheshin në Korçë vinin due u pakësuar.

Me urdhër të mytesarifit ai thirrej çdo javë në polici për t'i bërë presion⁴⁾. Si u pa se ai ishte i patrembur dhe i papërkulur kundrejt të gjitha atyre që u përdorën kundër tij, për të arritur në mbylljen e shkollës u vendos të përdroreshin mjete të tjera dhune.

Vetëm dy ditë pas përfundimit të atij viti shkollor, më 24 qershor 1902, bastiset shkolla shqipe dhe shtëpia e drejtorit të saj. Për të ndikuar më tepër dhe për të bërë presion mbi banorët e Korçës, kontrolli i shkollës dhe i

1) HHStAPAA: informacion i Konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 48, datë 2 korrik 1901.

2) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 21, datë 14 shkurt 1903, fq. 3.

3) N. Naçi, Artikull i cituar, f. 173.

4) I. M. Qafëzezi. Vep. e cituar, fq. 154.

shtëpisë së Nuçi Naçit u bë në mënyrë të bujshme, sikur po bëhej diçka tepër e rëndësishme dhe bile personalisht prej mytesarifit, i cili shoqërohej edhe prej një numri personash të tjerë. Me sa duket mytesarifi i Korçës ishte i autorizuar direkt nga Stambolli për këto veprime. U konfiskua biblioteka personale e Nuçi Naçit si dhe e gjithë biblioteka e shkollës. Si «teper kompromentonjëse» u paraqitën nga autoritetet sunduese fotografia e Skënderbeut dhe e Abdyl Frashërit që zbukuronin prej shumë vitesh muret e shkollës si dhe një numër i «Kalendarrit Kombiar» që botohej në Sofje. Drejtori i shkollës u arrestua dhe, bashkë me disa thasë me libra të konfiskuarra, u çua në qendrën e policisë së Korçës.¹⁾

I gjithë ky veprim drejtohej në radhë të parë kundër shkollës shqipe. Konfiskimi i teksteve shkollore dhe i të gjitha mjeteve të tjera të mësimit dhe arrestimi i drejtorit të shkollës, që mbante edhe peshën kryesore në procesin mësimor, do të kishte si përfundim logjik mbylljen e shkollës.

Në këtë mënyrë u mbyll nga sunduesit osmanë shkolla e parë shqipe e Korçës dhe drejtori i saj, patrioti i palodhur Nuçi Naçi, u përplas në burgun e Manastirit.

Kjo masë e rëndë antishqiptare dhe arrestimi i drejtorit të shkollës së parë shqipe të Korçës, ngjallën një valë zemërimi në të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë atdheut. Kjo shkollë kishte 15 vjet që punonte pa ndërprerje. Ajo, e përkrahur nga populli dhe patriotët rilindës, kishte përballuar deri tani të gjitha pengesat e vështirësitë, të gjithë luftën që i kishin bërë sundimtarët osmanë dhe gjithë armiqtë e tjerë të jashtëm e të brendshëm.

1) «Dy ditë pasi bëmë provimet dhe festimin shkollor — shkruan ish nxënësi i asaj shkolle I. M. Qafëzezi — muarmë vesh me pikëllim se drejtorin e dashur «*e vu hapc Pashaj i lik!*» Duarlidhur me zinxhira, sikur të kish vrarë, Drejtori i Mësonjëtores shqipe u shpu në Manastir, ku u mbyll në hapsanën (burgun) e katilëve (kriminelëve)». Në: I. M. Qafëzezi. Vep. e cituar, f, 157.

Ndonëse me mjete të kufizuara dhe me një personel të pakët mësitor, shkolla e parë shqipe e Korçës kishte dhënë një kontribut të madh në përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe dhe në edukimin e brezit të ri dhe të popullit me ndërjegjen kombëtare. Në vitet e errëta të sundimit feudal osman, të mbizotërimit të shkollave në gjuhë të huaj si dhe të propagandave armike e të fanatizmit fetar, shkolla shqipe e Korçës ishte bërë fener ndriçues dhe një shembull frymëzimi për gjithë Shqipërinë. Ajo kishte kontribuar në bashkimin politik, në vëllazërimin e shqiptarëve pa dallim feje dhe për zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar.

Gjithashtu ajo kishte ndihmuar në sqarimin e asaj pjese të popullsisë së Korçës e të rretheve, që ishte ndikuar nga propaganda e huaj osmane e greke.

Duke shprehur zemërimin e madh për ato që ndodhën, në një letër që i dërgohej gazetës «Drita» të Sofjes, nga Korça, shkruhej ndër të tjera:

«...Zemra m'u trondit, shpirti m'u vreros, sa edhe gjarpëri të kafshonte më mua do të helmohej! andaj do të vjell gjithë vrerë që kam në zemrën time dhe le të mësojë i madh e i vogël, muhamedan e i krishterë, ç'punëra bëri (sunduesi osman) në Shqipëri me kombin shqiptar!... (Ai) shumë shpejt e ka për të gjetur vëndin që nga ka ardhur! Thotë se me të mbyllur (burgosur) e me të munduar shqiptarët do të frikësonen? Kurrë!... përkundrazi do të punojnë më tepër, se e drejta është jona!»¹⁾

Dhe po në atë kohë poeti shkodran Ndre Mjeda, në poezinë «Për një shkollë shqype mbyllë prej Qeverisë Otomane», shprehte urrejtjen e thellë për sundimtarin shekullor osman si dhe zemërimin e madh që kishte shkaktuar tek të gjithë shqiptarët mbyllja e shkollës shqipe të Korçës.

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, Nr. 14, datë 22 korrik 1902, «Letra nga Shqipëria».

*Pra një pakicë ferishte
Që fjalët e nanës belboshin,
E n'agim t'jetës u mësoshin
Në zyrë t'njerzis, në dashtnim,*

*Të tremne në Stamboll'o tigër,
E t'farmakuene gjumin
Keqas, o i mjerë, ti lumin
Me e pritë ké ba mendim*

.....

*Ma mirë, përmbi krye tande
Prush grumbullove e thengjija
Pr'at ditë kur mbarë Shqypnija
T'shkrehet mbi ty në disprim¹).*

Në mbylljen e shkollës shqipe të Korçës kishin gisht edhe qarqet shoviniste greke. Duke folur për arsyet pse mbahej i burgosur në Manastir Nuçi Naçi i pafajshëm, gazeta «Drita» e Sofjes, nën titullin «Kemi armiq shumë», shkruante në gusht të vitit 1902: «... Këto djallëzi të poshtëra e spiunëri të pashkakta, i bën mitropolit'i grekut me shokët e tij grekomanë: shkollënë shqip e kanë halë ndër sy.

Një lepushkë (gazetë) «Astir-Yll», që del në Athinë, tregonte të madh gëzim q'u çua Nuçi në Manastir. Pandej se shkoi gjuha shqip, beson se u mbarua dëshir' e grekërisë!..²)»

Mbyllja e shkollës shqipe të Korçës dhe arrestimi i Nuçi Naçit u shoqëruan nga autoritetet qeveritare osmane me masa të reja, që drejtoheshin kundër gjithë lëvizjes kombëtare shqiptare. Porta e Lartë u kishte dhënë urdhra të reja të rrepta të gjitha autoriteteve provinciale në Shqipëri, për t'i kushtuar një vëmendje të veçantë lëvizjes kombëtare shqiptare. Qeveritarët osmanë të vila-

1) N. Mjeda, «Juvenilja dhe vepra të tjera». Mbledhur e redaktuar nga M. Gurakuqi, Tiranë, 1964, fq. 63.

2) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 15, datë 29 gusht 1902, fq. 3.

jeteve shqiptare ishin porositur që të mbikqyrnin gjithë ata persona, që njiheshin si patriotë shqiptarë, të bënë hetime mbi marrëdhëniet dhe bisedat e tyre dhe, në mënyrë të veçantë, të vepronin për të ndaluar përhapjen e librave e botimeve në gjuhën shqipe.

Për të zbatuar me përpikmëri këto detyra, u shtuan organet e policisë publike dhe sekrete. Zyrat postare kishin marrë instruksione që të konfiskonin «korrespondencën e dyshimtë» të shqiptarëve dhe broshurat në gjuhën shqipe. Meqenëse në krahinat e brendshme të vendit korrespondenca bëhej jo aq me postë sesa me anën e qiraxhinjve, udhëtarëve dhe karrocierëve, policia i ndalonte dhe i kontrollonte ata. Kontrollit të policisë i nënshtroheshin sidomos karvanet e qiraxhinjve, të cilët shkonin e vinin në mënyrë periodike midis qyteteve më të mëdha të vendit dhe ishin të detyruar të ndiqnin rrugë të caktuara udhëtimi dhe nuk mund t'i shmangeshin policisë. Të zakonshme ishin bërë këto kontrolle veçanërisht përpara qyteteve të Korçës, Elbasanit, Dibërës e Kërçovës. Qeveritarët osmanë ishin shumë të shqetësuar edhe nga lidhjet e shqiptarëve brenda vendit me ata jashtë atdheut dhe u përpoqën që t'i pengonin ato e të mos lejonin hyrjen e literaturës shqipe që botohej jashtë Shqipërisë.

Njëkohësisht me këto masa sulltani turk lëshonte një iradë, me anën e së cilës ftonte 20 djem shqiptarë nga vilajetet e Shqipërisë që të shkonin për «të mësuar» në Stamboll në shkollën «Ahiret», e cila ishte ngritur për popujt që gjendeshin nën sundimin e Perandorisë Osmane. Ky ishte një mashtrim që sulltani donte t'u bënte shqiptarëve dhe të ulte zemërimin e tyre. Një përgjigje të goditur jepte në këtë rast gazeta «Drita» e Sofjes, e cila shkruante në korrik të vitit 1902: «Do të bënte shumë më mirë që Sulltani të epte një iradë për të mësuar gjuhën shqip në Shqipëri, pa me 20 djem që të venë në Stamboll e të mësojnë një gjuhë të huaj s'ka ndonjë dobi Shqipëria; me të këtilla lajka shqiptarët nuk gënjehen»¹).

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 14, datë 22 korrik 1902, fq. 4, «Iradë nga Sulltani».

Rrethet patriotike shqiptare dhe shtypi i kohës u ngri-
tën kundër arrestimit të drejtorit Nuçi Naçi dhe kundër
masave të reja që po merrnin sunduesit e huaj. Patriotët
shqiptarë shqetësoheshin me të drejtë jo vetëm për faktin
se u arrestua një person ose disa persona, por për faktin
se mbajtja e Nuçi Naçit në burg për një kohë të gjatë do
të kishte si pasojë mbylljen përfundimtare të shkollës
shqipe që drejtonte ai. Prandaj u bënë të gjitha përpje-
kjet që ai të lirohej para fillimit të vitit shkollor. Patrio-
tët shqetësoheshin edhe për arsye të tjera. Në shtetin
osman, i cili prej kohësh kishte hyrë në rrugën e deka-
dencës dhe të korrupsionit, të arrestuarit, veçanërisht ata
shqiptarë, plaseshin nëpër burgje dhe mbaheshin për një
kohë të gjatë të pagjykuar, aq më tepër kur arrestimet
e patriotëve shqiptarë bëheshin pa patur provat e ne-
vojshme.

Hamdi Ohri i arrestuar që në vitin 1901 mbahej në
burg ende i pagjykuar. Po kështu po veprohej tani me
Nuçi Naçin. Kishte raste që, për t'i zhdukur fare, përd-
orej edhe helmi. Kështu, dy muaj pas internimit në Sivas
të Hasan Vrionit me të birin, atë e helmuan¹⁾. Dhe kjo
ndodhi sepse të birit, Nyzhet Vrionit, kur ishte në Stam-
boll, i kishin gjetur disa libra shkollorë në gjuhën shqipe²⁾

Përveç kësaj, efektet e masave represive osmane ndaj
shqiptarëve bëheshin edhe më të mëdha, për arsye se këta
nuk prisnin asnjë ndihmë ose ndërhyrje nga jashtë, si
ndodhte me popujt e tjerë ballkanikë.

Shqiptarët jo vetëm nuk prisnin ndihmë nga jashtë,
por duhej të përballonin edhe ndërhyrjet armiqësore sho-
viniste dhe imperialiste të shteteve ballkanike dhe evropiane.

Ndonëse në kushte të vështira, patriotët shqiptarë
brenda dhe jashtë atdheut vepruan energjikisht për të
ndihmuar Nuçi Naçin si materialisht ashtu edhe mora-
lisht. Në gusht të vitit 1902, në një mbledhje të Komite-

1) Po aty, nr. 18, datë 20 nëntor 1902, fq. 1.

2) Po aty.

tit të Shoqërisë «Dituria» të shqiptarëve të Bukureshtit, pasi u bisedua mbi gjendjen e N. Naçit, «u vendos që t'i dërgohej nga ana e shoqërisë mësuesit të shkollës shqiptare të Korçës një ndihmë në të holla prej Lei (200 dyqind»¹).

Patriotët shqiptarë u shqetësuan edhe më tepër kur u afrua koha e fillimit të vitit të ri shkollor dhe Nuçi Naçi vazhdonte të ishte në burg. Nga Shqipëria u kërkohesh shqiptarëve të kolonive të mërgimit që të bashkëvepronin e të ndërhyenin energjikisht pranë shteteve evropiane. Në një letër të Kristo Luarasis, dërguar nga Sofja shqiptarëve të Bukureshtit në gusht 1902, mësojmë se shqiptarët brenda atdheut i porositnin: «*Bashkohuni ju të jashtëm gjithë më një, dhe thërrisni në Evropë, se shkollën kërkon ta mbyllnjë* (sunduesi osman)... po vjen koha për të çelur shkolla, ç'është kjo?»²).

Shqiptarët e mërguar, të shqetësuar për ato që po ndodhnin në atdhe, u muarën vesh midis tyre dhe u përpoqën të ndihmonin për riçeljen e shkollës shqipe në shtator³). Ata u përpoqën gjithashtu që, me gjithë kushtet e vështira politike, të mbamin lidhje të vazhdueshme me patriotët brenda vendit dhe të informoheshin mbi gjithçka ndodhte në Korçë e gjetkë⁴).

Një mbrojtje të flaktë i bëri Nuçi Naçit shtypi shqip-

1) AQSH i RPSSH, Fondi «Shoqëritë e Bukureshtit», Dos. 11, dok. 6.

2) Po aty: Materialet e Kristo Luarasis.

3) Po aty: Materialet e Kristo Luarasis.

4) Shqetësimet e tyre shprehen qartë në letrën e datës 21 gusht 1902, në të cilën thuhet: «Nga erdhi urdhëri për të mbyllur shk... (shkollën) dipl. dhe rus... (diploma dhe leja që mbante drejtori) ku gjenden në qytet (Kor...)? apo ku është burgosur N...? (Nuçi) Qita... (librat) të gjitha i muarën?... Për të çelur tani në vj... (vjeshtë — shtator) ç'duhet? N... (Nuçi) akoma në burg është? a do të shënojmë nonjë për të çelur shk... (shkollën e djemve)» dhe në një letër tjetër «shkollën e vashëve a e çelët?...». Në AQSH i RPSSH — Materialet e Kristo Luarasis.

tar i kohës dhe veçanërisht gazeta «Drita» e Sofjes. Në një numër artikujsh dhe korrespondencash të botuara në shtyp shkruhej me një ton të ashpër kundër qeveritarëve osmanë, që arrestuan drejtorin e shkollës shqipe të Korçës dhe e mbamim për muaj të tërë në burg, pa e gjykuar fare. Në shtyp demaskoheshin edhe intrigat e kishës dhe të agjenturës shoviniste greke dhe bëheshin të qarta publikisht synimet e vërteta politike të sunduesit e të shovinistëve fqinjë.

Në njërin prej artikujve të vet gazeta «Drita» shkruante në fund të nëntorit 1902: «Mësonjësi i shkollës shqipe të Korçës, Nuçi edhe (ende) gjendetë mbyllur (i burgosur) në Manastir... shkak që e mbajnë mbyllur është se i gjetnë ca vivlla që janë shtypur këtu në Sofje... Të gjitha janë vivlla për shkollë. Nukë është këtu puna; puna është për të gjetur shkak që të mbyllin shkollën; (Perandoria osmane) nuk do të përparojë shqiptari, do ta shohë shqiptarin gjithnjë të verbërë dhe ta heqnjë për peri... Dhe në del nonjë njeri që të hapnjë gojën e të thotë gjë për të mësuarë gjuhënë shqip, e burgos, e syrgjynos (internon), dhe në fund e humbet fare» dhe përfundon duke shprehur optimizmin për të ardhmen: «do të vijë dita që të zgjonetë shqiptari, ... tani që zu të shkruhetë gjuh' e tij do t'i hapnjë sytë; si do që të bësh, çdo mënyrë që të përdorç për të ndalurë të mësuarit e gjuhësë, më kot e ke, u mbuall këjo farë, zu rrënjë, një rrënjë të shëndoshë»¹).

Vetëm pas 8 muaj burgimi të pafajshëm në Manastir, Nuçi Naçi u lirua më 5 mars 1903 dhe u kthye në Korçë.

Për disa kohë ishte ruajtur shpresa se me t'u liruuar Nuçi Naçi mund të veprohej për të rihapur shkollën. Por mbajtja e tij në burg deri në mars 1903 dhe fushata e ndjekjeve që ishte organizuar nga autoritetet osmane pas arres-

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 18, datë 30 nëntor 1902, fq. 1.

timit të tij, patën si pasojë që shkolla shqipe të mos ha-
pej dot për vitin shkollor 1902-1903.

Megjithatë drejtori i shkollës, Nuçi Naçi, sapo u kthye nga burgu, që të nesërmen, shkoi në shkollë për të kontrolluar gjendjen e materialeve që kishte lënë të fshehura dhe gjithçka e gjeti ashtu si e kishte lënë¹⁾. Kjo ia forcoi më tepër shpresat e tij, të cilat nuk ia shoi dot as burgu dhe as shëndeti i dobësuar. Pastaj filloi të binte në kontakt me patriotët korçarë dhe të bisedonte me ta për përgatitjet që duheshin bërë për riçeljen e shkollës në vitin e ardhshëm shkollor²⁾. Bisedat për riçeljen e shkollës u përhapën me shpejtësi në familjet korçare, në kafenetë, në tregun e qytetit dhe në vetë nxënësit, të cilët prisnin me gëzim shtatorin për të rifilluar mësimet. Por përgatitjet që po bëheshin në Korçë për riçeljen e shkollës shqipe ngjallën menjëherë shqetësimin e kundërveprimin e autoriteteve qeveritare dhe të qarqeve shoviniste greke. Duke përdorur akuza të rreme, të kurdisura nga shovinistët grekë dhe në përgjigje të kërkesës së Portës së Lartë për ta informuar mbi ata persona që mund të pengonin zbatimin e «reformave për Maqedoninë», mytesarifi i Korçës, Mehmet Ali Pashë Delvina, shpejtoi t'i shkruante Stambollit se «që të marrin fund këto lëvizje të shqiptarëve propagandistë në Korçë duhej të zireshin edhe të largoheshin nga ky qytet një orë e më parë: Orhan Pojani, Thimi Markoja, Nuçi Naçi, Hysen Qani Ballanca (Dibra), Emin Zhurka (Selenica) etj.»³⁾

1) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 175.

2) Sipas një artikulli të gazetës «Shqipëtar» të Bukureshtit viti III, Nr. 10, 1903, shkolla u rihap me kthimin e drejtorit të saj nga burgu. Materialet e tjera të shfrytëzuara prej nesh dhe vetë Nuçi Naçi në shkrimet e tij mbi shkollën nuk e vërtetojnë këtë gjë. Qëndrimi i N. Naçit vetëm për një kohë të shkurtër në Korçë, pas lirimit nga burgu, gjithashtu nuk flet në favor të atij pohimi.

3) N. Naçi, Artikull i cituar, fq. 175; I. M. Qafëzezi. Vep. e cituar, fq. 157-158; Gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit, nr. 10, datë 16 nëntor 1903, fq. 2.

Propozimi i mytesarifit të Korçës u pranua nga Porta e Lartë, e cila lëshoi urdhërim për arrestimin dhe dërgimin e tyre në Stamboll. Ndërsa Orhan Pojani dhe dy shqiptarët e tjerë myslimanë u arrestuan në Manastir, në qendrën e vilajetit, ku ishin thirrur gjoja me shërbim, shqiptarët e krishterë — Thimi Markon dhe Nuçi Naçin — i arrestuan në Korçë.

Patriotët shqiptarë të shqetësuar për arrestimin e shqiptarëve të lartpërmendur dhe sidomos nga urdhëri për t'i dërguar ata në Stamboll, prej nga mund të internoheshin në vende të humbura të Azisë së Vogël ose mund të zhdukeshin fare, bënë të gjitha përpjekjet që shqiptarët e arrestuar, të paktën, të mos dërgoheshin në Stamboll. Si rezultat u lëshua një urdhër i dytë nga Sulltani, sipas të cilit hetimet dhe gjykimi mbi të arrestuarit shqiptarë do të bëheshin në Selanik dhe do t'i paraqiteshin për aprovim Këshillit të Ministrave.

Në këtë mënyrë, Nuçi Naçi dhe shqiptarët e tjerë që u arrestuan në Korçë, megjithëse nuk u ishin gjetur veçse disa libra e letra në gjuhën shqipe¹), u gjykuan në Selanik nga gjykata ushtarake e krijuar posaçërisht për kryengritësit maqedonas. Gjykata nuk pranoi që shqiptarët të paraqisnin as avokat mbrojtës. Sipas vendimit të saj, të tre shqiptarët myslimanë, Orhan Pojani, Hysen Dibra dhe Emin Zhurka, u internuan në Anadolli; Thimi Markoja u lejua të kthehej në Korçë dhe do të ishte nën mbikqyrjen e policisë, ndërsa Nuçi Naçi u dënua me dy vjet burg në Jedikule të Selanikut.

Arrestimet dhe dënimet e Korçës ngjallën një valë të re zemërimi në masat popullore shqiptare, në rrethet patriotike dhe në shtypin shqiptar. Gazeta «Drita» e Sofjes shkruante në nëntor 1903: «Ata shqiptarë që duan të mësojnë gjuhën e vet, qeveria otomane po i ndjek si Faraoni Moisinë»²).

1) Në librat shqipe që u konfiskuan u gjend edhe një pjesë e veprës së Viktor Hygoit «Les Miserables» (Të mjerët) e përkthyer në gjuhën shqipe.

2) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 32, datë 5/18 nëntor 1903.

Ndërsa gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit, duke goditur me forcë shkaktarët e vërtetë të këtyre ngjarjeve shkruante: «do të vijë një orë kur ata që mbajnë në zgjedhë shqiptarin nga foleja e paudhë që quhet Patriarhi, do të ndiejnë peshën e jataganit shqiptar si shpërblim të drejtë për punrat e tyre të liga.

Është edhe një fajtor më i madh: Ky fajtor është Porta e Lartë! Është turp të quhet dhe sot Porta e Lartë... Skëtterra Stamboll do të rrezohet nën peshën e krimeve të saj dhe as nonjë fuqi s'mundet ta shpëtojë...

Po drita për të cilën kemi nevojë do të hyjë sado që të na mbodhisin. Kombi Shqiptar rron dhe do të rrojë¹⁾.

Shtypi përparimtar shqiptar i kohës demaskoi edhe elementin shqiptar grekoman, i cili ishte vënë në shërbim të propagandës shoviniste e kishës ortodokse dhe vepronte kundër interesave të atdheut. Grekomanë të tillë si Tushi Llambro Mborjen, shtypi shqiptar i damkosi publikisht si tradhtarë e spiunë të popullit të vet²⁾.

Në Selanik Nuçi Naçi vuajti edhe më tepër se në burgun e Manastirit. Edhe këtë radhë ai u mbajt për disa kohë i pagjykuar, nën pretekstin se nuk gjendej njeri që të përkthente materialet që i ishin gjetur si dhe fjalët e tij në gjyq. Në të vërtetë, ishte vështirë të gjeje njeri si përkthyes për shqipen, se do të akuzohej menjëherë si armik i Perandorisë.

Ndjekjet dhe arrestimet përfshinë gjithë Shqipërinë. Në maj të vitit 1903 u arrestua Petro Nini Luarasi, i cili në fillim u dërgua në Ersekë e pastaj në Korçë, ku bëri dy muaj burg³⁾. Po më 1903 u arrestua Kristo Karbunara në Vlorë, të cilit iu konfiskuan të gjitha librat shqipe që iu gjetën në shtëpi dhe u internua për një vit në bodrumet

1) Gazeta «Shqipëtar» e Bukureshtit, nr. 10, datë 16 nëntor 1903, fq. 2.

2) Po aty; Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 47, datë 5 korrik 1904, fq. 4.

3) «Petro Luarasi», vep. e cituar, fq. 70-72.

e kalasë së Janinës¹). Më 1904 u arrestua Papa Kristo Negovani në Manastir, ku kishte shkuar për të marrë pjesë në një mbledhje të fshehtë të patriotëve shqiptarë dhe u mbajt dy muaj në burg²). Në Shkodër u arrestua Filip Kraja dhe dy të tjerë, në Dibër Kadri Fishta, në Krujë Haxhi Ismail Subashi etj.

Kontrolle për libra e gazeta shqipe u bënë në Delvinë e në vise të tjera të Shqipërisë së Jugut. «Për një gazetë të paktën dy vjet burg» shkruante gazeta «Drita» më 1904. «Megjithëkëtë — vazhdonte po ajo gazetë, — për gjuhën shqip kanë shumë dëshirë, kur shohin nonjë gazetë kush ta rrëmbejë më parë»³).

Në një letër nga Shkodra, të tetorit 1904, shkruhej: «Po të bëj me dijtë qi këtu punët janë si jo ma zii. Qeveria ka marrë frenin mepër kambë e kërkon (kontrollon) shumë shpia kush ka letra, gazeta e libra ç'faret do që të jenë, i mbyll në një thes dhe i çon në hyqymet për ti pamun edhe asht tui pasë frigë të madhe. Mjer ati që t'i gjinnet ndoj libër qi flet për Skënder Begun e ftyra (fotografia) e tij! Nër këto ditë janë djegun libra e fytyra shumë. Prej këtyne punëve të padrejta ka mbet mbrapa e shkreta Shqypni, tui djegun librat prej të cilavet marrin mësim e dritë Shqyptarët»⁴).

Sulltani dhe kryeministri, feudali reaksionar shqiptar Ferit Pashë Vlora, pothuajse çdo javë u dërgonin telegrame të fshehta valinjve të Kosovës, Shkodrës, Manastirit e Janinës «që me ç'do mënyrë, me shkak e pa shkak, të përkujdesen shumë për të vënë në dorë ç'do shqiptar që do gjuhënë shqip»⁵).

Arrestimet vazhduan edhe më vonë. Më 1905 u arrestua në Korçë mësuesi Thanas Nona. Më 1906 në Prevezë

¹) AQSH i RPSSH. Fondi «25 vjetori i pavarësisë». Dos. e qarkut të Beratit.

²) Dh. Fullani, vep. e cituar, fq. 191.

³) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 49, dt. 13 gusht 1904.

⁴) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 51, datë 18 tetor 1904.

⁵) Po aty.

burgoset Sabri Preveza,¹⁾ ndërsa në Krujë Haxhi Muhamet Baba etj. Ky i fundit u dënua me dy vjet burg.²⁾

Duke përfituar nga politika antishqiptare e Portës së Lartë, qarqet shoviniste greke, kisha ortodokse dhe elementët grekomanë po vepronin gjithashtu me energji.

Në fillim të shkurtit 1905 u vra barbarisht prej tyre mësuesi dhe patrioti Papa Kristo Negovani. «Dhespoti i Korçës e dogji të gjallë si pishtar Papa Kristo Negovani»³⁾, sepse ai punoi me këmbëngulje deri në fund të jetës së tij për përhapjen e shkrimit dhe të literaturës në gjuhën shqipe⁴⁾.

Kjo vrasje shkaktoi një valë të re zemërimi në mbarrë popullin shqiptar si dhe në kolonitë shqiptare të mërgimit. Vepra gjakatare e klerit dhe e agjentëve shovinistë grekë e grekomanë i demaskoi edhe më tepër ata në sytë e masave popullore. Duke shprehur këtë zemërim gazetë «Drita» e Sofjes shkruante plot indinjatë në atë kohë: «Të shenjtët dhespotër greq një mijë intriga të poshtra e të padëgjuaara gjer sot, punojnë për të ndaluar gjuhën shqip, t'i kenë në dorë gjakun do t'u pinë ortodoksëvet shqiptarë që thonë jemi shqiptarë edhe duan gjuhën e tyre!»⁵⁾

Po në këtë kohë mësuesi Nuçi Naçi vazhdonte të vuante në burgun Jedikule të Selanikut dhe u lirua ve-

1) Gazeta «Bashkimi», datë 2 shtator 1971, fq. 3.

2) H. Goci, vep. e cituar, fq. 37.

3) «Shoku Enver Hoxha te rrapit në Mashkullorë kuvendon shtruar me fshatarët». Në «Zëri i Popullit», dt. 21 mars 1978, fq. 2.

4) Në një letër që Papa Kristoja u shkruante dy ditë para se të vritej shqiptarëve të Brailës, u thoshte: «Në çdo punë aty shikoni të silli me kujdes, të ruhi se këtu kemi shumë tradhëtarë edhe na kallzojnë në ata që rrinë brenda, d.m.th. në shokët e zezësë. Tri herë më kanë gjykuar për shkakun e shqipesë, nuk kanë pësuar gjë gjer më sot, po frikë është në pranverë se mos na korrin, se po dëgjojmë fjalë andej këndeje edhe shumë të kanosura» (në gazetën «Drita», viti IV, nr. 60, datë 22 prill 1905 fq. 1.).

5) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 58, fq. 4.

tëm pasi plotësoi dënimin dyvjeçar të dhënë nga gjykata. Me gjithë vuajtjet e hequra, Nuçi Naçi nuk hoqi dorë nga rruga e nisur.

Duke e ditur se ç'e priste po të kthehej në Korçë, Nuçi Naçi vendosi të qëndronte përkohësisht në qytetin e Manastirit (që ishte një qendër e rëndësishme e lëvizjes kombëtare). Aty ai e vazhdoi veprimtarinë patriotike. Ai mori pjesë në Komitetin e fshehtë «Për lirinë e Shqipërisë», që u formua në Manastir në fund të vitit 1905 dhe u zgjodh sekretar i tij. Krahas veprimtarisë politike, Nuçi Naçi vazhdoi të punonte edhe në dobi të gjuhës e të arsimit shqiptar; më 1906 për nevojat e shkollës shqipe përgatiti librin «trup-tregonjë» (anatomji) dhe, siç shprehej në parathënien e tij, ruante gjithnjë shpresën se «koha për të çelurë mësonjëtoresh shqipe në të gjithë anët e Shqipërisë po afron»¹).

Edhe shkolla shqipe e vajzave në Korçë po kalonte një nga periudhat më të vështira të saj. Pas urdhërit të lëshuar nga Stambolli, që ndalonte frekuentimin e kësaj shkolle nga nxënëset myslimane, autoritetet osmane vepuruan me këmbëngulje dhe sistematikisht për të arritur që ta mbyllnin fare edhe këtë shkollë shqipe.

Në vitin 1904 qeveria otomane ndaloi përdorimin e shqipes si gjuhë mësimi në këtë shkollë. I nisur nga ky urdhër, konsulli i përgjithshëm austro-hungarez i Shkodrës, në promemorjen mbi Shqipërinë, drejtuar Vjenës në fillim të vitit 1905, e konsideroi si «të mbyllur definitivisht» edhe shkollën shqipe të vajzave që më 1904²). Por në të vërtetë kjo shkollë, me gjithë persekutimet dhe urdhrat e qeveritarëve osmanë, e vazhdoi jetën e vet. Patriotët shqiptarë si dhe personeli pedagogjik i shkollës bënë përpjekje të shumta për ta mbajtur të hapur këtë shkollë.

1) Nuçi Naçi, Parathënie e librit «Trup-tregonjë», Manastir, 1906, dorëshkrim.

2) HHStAPAA: *Promemorie mbi Shqipërinë* (ç'prej fundit të vitit 1901 deri në fillim të vitit 1905).

Pas ndalimit të shqipes si gjuhë mësimi, u ndalua përdorimi i librave shqipe në shkollë, duke i cilësuar ato si «jashtëzakonisht të dëmshme»¹⁾. Tani në shkollën e vajzave mund të përdroreshin vetëm librat anglishte dhe greqishte, megjithëse vajzat ishin të gjitha shqiptare.

Pas shumë ndërhyrjesh në Manastir, nëndrejtori i arsimit për vilajetin e Manastirit njoftoi se «me gojë mund të jepej mësim në çdo gjuhë, por librat shqipe janë krejtësisht të ndaluara»²⁾.

Shpejt pas urdhrit të qeverisë otomane, që ndalonte frekuentimin e shkollës nga vajzat myslimane, kleri grek u riaktivizua për të ndaluar edhe vajzat ortodokse që të frekuentonin këtë shkollë.

E gjithë kjo luftë kundër shkollës shqipe bëhej me mjetet më të ndryshme dhe me mënyrat më të ulëta. Mitropoli dhe Dhimogjerondia e Korçës u bënëin presion jo vetëm familjeve korçare por edhe shqiptarëve të emigruar jashtë atdheut, me qëllim që me anën e tyre të ndikohej mbi farefisin që kishin në Korçë³⁾.

Një luftë e ashpër iu bë veçanërisht personelit mësimor. Kundrejt mësueseve shqiptare u përdorën të gjitha

1) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 39/sek., datë 2 qershor 1905.

2) Po aty: informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, Nr. 3/sek., datë 9 janar 1905.

3) Në një letër dërguar Pandeli Durmishit në Bukuresht në nëntor të vitit 1905, shkruhej: «Meqenëse... e shenjta Mitropoli dëshiron t'i heqë ato të paka vajza të cilat venë në shkollën Protestante të këtushme (në shkollën shqipe të vajzave në Korçë), e cila dihet prej çdokujt, ka qëllim të keq të tërheqë vajzat e vogla edhe të pafaj prej orthodoksisë... edhe t'i klasë në tjetër fé, për randaj ne si edhe gjithë qytetarët e këtushëm, muarrmë vendimin që të çkishërojmë çdo familje, e cila dërgon fëmijët e saj në shkollën Protestane... Meqenëse edhe kumati juaj nuk e pat hequr të bijën e tija më të madhe edhe mbesën tuaj Aleksandrën, andaj e gjetëm më udhë të ju shkruajmë edhe të ju lutemi, që, sa më shpejt t'i shkruani kumatit tuaj që t'a heqë të bijën nga shkolla

metodat për t'i larguar nga shkolla shqipe. U dërgonin priftërinj në shtëpi për t'u bërë presion, i thërrisnin në Mitropoli, ku u bënë edhe premtime të ndryshme si për dyfishimin e trefishimin e rrogës në rast se braktisnin shkollën shqipe. Në një rast të tillë mësuesja e re patriotike dhe trime Helidhona Falli u përgjegj: «Vërtet jam një çupë e varfër dhe jetime, por dëshira ime është të punoj për gjuhën time» dhe kur mitropoliti e kërcënoi se qeveria otomane do ta burgoste dhe «do t'i kalbeshin kockat në burg», ajo shtoi: «qeveria don ta mbyllë shkollën shqipe, por unë do të vete nëpër shtëpi dhe do t'u mësoj fëmijëve shkrim e këndim shqip»¹⁾. Atëhere Helidhona u mallkua publikisht nga dhespoti. Dhe pas pak, kur Helidhonës i vdiq e motra, që kishte qenë edhe nxënëse në shkollën shqipe, kisha, për hakmarrje, nuk pranoi ta varroste; kufoma e saj qëndroi tri ditë në shtëpi, deri sa familja vendosi ta varroste pa prift²⁾.

Vendosmëria për të mbajtur çelur shkollën shqipe të vazhdeve shprehet qartë edhe në përgjigjen e prerë që Sevasti Qiriazia i kishte dhënë mitropolitit të Korçës, «se ajo nuk e ka për të mbyllur shkollën sikur edhe me një vashë të mbetet»³⁾.

Presioni i kishës ortodokse ishte bërë tepër shqetësues jo vetëm në Korçë, por në gjithë Shqipërinë e Juçut. Ai rëndonte kryesisht mbi popullsinë shqiptare ortodokse, e cila, ndonëse kishte qenë objekti kryesor i politikës he-lenizuese, po i kundërvihej gjithnjë e më shumë shovinizmit grek. «Në këto dy jav' e sipër — shkruante gazeta

Protestane, sepse do të jetë e shtrënguar e shenjtja Mitropoli ta çkishërojë familjen e kumatit tuaj...». Në «Foleja kombëtare». Vepër e cituar, fq. 51.

1) Autobiografia e Helidhona Fallit, ruajtur nga e bija, S. Falli, në Tiranë.

2) Po aty.

3) AQSH i RPSSH. Fondi i Asdrenit, Dos. 74, 2. dok. 754. Letër e Pandeli Durmishit dërguar Asdrenit më 15 shkurt 1906.

«Drita» në mesin e dhjetorit 1905 — kemi marrë shumë letra, më shumë se nga çdo herë...

...Barbarizma po mbretëron në Perandorinë osmane, inkuizicioni po punon në Shqipëri midis fatzezëve shqiptarë orthodoksë që ndodhen nënë zgjedhët të tmerruar të Kishës orthodokse, dhjetë herë më shumë se në kohët të Mesme. Shqipëtarët e tjerë janë nënë një zgjedhë, shqipëtarët orthodoksë nënë dy ... Mitropolit i Korçës shkoi shtëpi më shtëpi dhe bërtiste: ata që do të mos i heqin shpejt vajzat e tyre nga shkolla ku mësohet shqipja, të gjithë do t'i mallkonj, të gjithë do t'i vdes, do t'i dërgonj në Sketerrë...»¹).

Por ndjekjet, presionet, burgimet, internimet e mallkime jo vetëm nuk mundën ta shuanin zjarrin e ndezur të lëvizjes kombëtare shqiptare, por ato shkaktuan edhe një rritje të përgjithshme të pakënaqësisë në Shqipëri.

Pikërisht në kushtet e rritjes së reaksionit osman, të rritjes së agjitacionit dhe të dhunës nga shovinistët fqj-



Sevasti Qiriazhi

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 71, 15 dhjetor 1905, fq. 1. Presionet ushtroheshin si nga mitropolit i priftërinjtë ashtu edhe me anën e njerëzve të afërt, që ishin nënë ndikimin e kishës orthodokse.

Një rast tjetër i veçantë që bëri bujë ishte mospranimi i kishës greke për t'i vënë kurorën e martesës djalit të Jovan Kosturit, Kristaqit. Duke mos pranuar konditat e ulëta që vuri kisha, Kristaq J. Kosturi së bashku me nusen dhe shqiptarë të tjerë vaji

një, shtrohej nevoja e organizimit më të mirë të lëvizjes kombëtare shqiptare, nevoja e shtimit të përpjekjeve për të forcuar ndërgjegjen kombëtare dhe për të bashkuar popullin shqiptar. Këto detyra mund të zgjidheshin duke krijuar brenda në Shqipëri një organizatë të fshehtë politike, që do të merrte në dorë drejtimin e lëvizjes shqiptare.

Me iniciativën e patriotëve revolucionarë e demokratë, pesha e të cilëve në lëvizjen kombëtare kishte filluar të rritej në fillim të shekullit XX, në fund të vitit 1905 u krijua në Manastir një Komitet i fshehtë me emrin «Për lirinë e Shqipërisë».¹⁾ Krijimi i Komitetit të Manastirit dhe i komiteteve lokale në krahinat e tjera të vendit shënonte një hap të rëndësishëm përpara dhe një moment ngritjeje të lëvizjes sonë kombëtare.

Me vendim të Komitetit të Manastirit dhe nën drejtimin e tij, qysh në fillim të vitit 1906, u krijuan edhe çeta të armatosura, të cilat vepruan kryesisht në Shqipërinë e Jugut. Një nga detyrat e rëndësishme të këtyre çetave ishte propagandimi i ideve kombëtare dhe mobilizimi i popullit në luftën për çlirimin kombëtar. Popullsisë i shpërndareshin flamurë kombëtarë, fotografi të Skënderbeut etj. të sjella fshehurazi nga shoqëritë shqiptare të mërgimit²⁾.

Lufta për shkrimin e për gjuhën shqipe mbështetej tani nga lufta e çetave të armatosura shqiptare. Pjesëtarët e këtyre çetave shqiptare, të udhëhequra nga Bajo e Çerçiz Topulli, Mihal Grameno etj., shkonin nga fshati në

në Rumanë për të bërë kurorëzimin e martesës. Udhëtimi i tij u bë në mënyrë demonstrative, kudo që kaloi nëpër shqiptarët e Bullgarisë dhe të Rumanisë u prit në mënyrë madhështore. E gjithë kjo në të vërtetë ishte një manifestim tjetër i fuqishëm patriotik i shqiptarëve.

1) Në Komitetin e fshehtë të Manastirit bënin pjesë Bajo Topulli, Halit Bërzeshta, Gjergj Qiriazi, Fehim Zavalani, Nuçi Naçi etj.

2) «Historia e Shqipërisë», vepër e cituar, fq. 274 dhe 285.



Shkolla shqipe e vajzave (Fotografi e viteve 1904-1905)

fshat dhe bënin propagandë kombëtare, duke i bindur njerëzit se «duhet të bëhen gati që të dalin edhe me krahror hapët të luftojnë me qeverinë duke kërkuar arsimm' e tyre me anën e gjuhës së vendit. . .»¹⁾

Shkolla shqipe e vajzave në Korçë u bë në ato vite — siç e quajti Mihal Gramenoja — një «fole kombëtare» e vërtetë. Ajo furnizonte çetën e Bajo Topullit me libra e gazeta shqipe për t'i shpërndarë në fshatrat e Kolonjës, të Gorës, në fushën e Korçës e gjetkë²⁾, dhe, në raste të veçanta, disa pjesëtarë të çetës i strehoi e i mbajti ilegalisht në lokalin e saj. «Vitin 1907-1908 — shkruan një ish-nxënëse e shkollës së vajzave — shkolla u bë mbrojtja e komitave shqiptarë e shtrofkë ku bashkoheshin kryetarët e Komitetit të fshehur.

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 82, datë 2 gusht 1906, fq. 2.

2) «Revista pedagogjike», 1972, nr. 1, fq. 177.

Në katin e poshtëm, në një dhomë me vatër ku mbahej një zjarr i madh, ishin komitat e fshehur, e në katin e dytë vijonte në qetësi shkolla.

Kafazi (rojtësi) i shkollës, Osmani (O. Dërsniku) ngushte nxënëset në pushimet e ditës të këndonin këngë shqipe të kërkuara nga komitet»¹).

Çetat, nga ana e tyre, bënë shumë për të shpërndarë libra në gjuhën shqipe dhe për të mbrojtur shkollën shqipe. Përveç kësaj, çetat patriotike shqiptare u dërguan letra kërcënuese hoxhallarëve e mësuesve të shkollave turke (fillore e të mesme) të Shqipërisë, me anën e të ci-



Dy nga pjesëmarrësit e luftës së Mashkullorës: Çerçiz Topulli (në të djathtë) dhe Zeman Mashkullori (në të majtë).

Në mes është Bajo Topulli.

1) «Kujtime të paharruara», botuar më 28 nëntor 1937.

lave kërkohej që në ato shkolla, krahas turqishtes, të jepej edhe mësimi i gjuhës shqipe. Në një nga këto letra shkruhej midis të tjerash «... O ju hoxhallarë që ipni mësimet turqisht djemve të Shqipërisë në shkollat që gjenden në Shqipëri, ja se do të rëfeni edhe mësimet shqip ja se nukë do të rëfeni edhe turqishten, ndryshe do t'u vrasim, ta dini mirë»¹).

Për t'i prerë hovin politikës antishqiptare të qarqeve shoviniste greke dhe veprimtarisë terroriste të bandave të tyre, çetat shqiptare organizuan vrasjen e kryeagjentit dhe armikut të tërbuar të shkollës shqipe e të lëvizjes kombëtare, mitropolitit të Korçës, Fotit, në shtator të vitit 1906.

Me anë të një thirrjeje²) drejtuar shqiptarëve bëheshin të qarta arësytet e vrasjes së mitropolitit dhe luftohej kundër zhurmës së shtypit e propagandës shoviniste greke që bëhej kundër atyre që guxuan të vrisnin këtë «udhëheqës shpirtëror» të një krahine të tërë. «Mos u lini pra që t'ju gënjejnë mësonjësit dhe priftërit grekë si dhe veglat e tyre që kanë — thuhej në thirrje — Mjaft u gë-

1) Gazeta «Drita» e Sofjes, nr. 81, datë 15 korrik 1906, f. 1-2.

2) Në këtë thirrje thuhej:

«Vëllezër shqiptarë!

... Shenjtëria e tij (mitropoliti Foti)... ishte gjakpirës sepse me vetëdijen e dashjen e tij të plotë, bëri kaq pabesi, edhe u bë vrasësi i një populli të tërë, vrasësi i kombit tonë! Kush tjetër më tepër se ay mbolli nakar edhe mosbashkim midis nesh? Kush tjetër më tepër se ay na shtynte që të ndahemi nga kombësia jonë dhe të përkrahim kombësinë greke? Kush vajti kundër kanuneve më tepër se sa ay? S'është ay që na kujtonte kurdoherë që të heqim dorë nga dëshirat tona? S'është ay që na solli zihjet edhe qërtimet midis nesh? Pra shorti i shenjtërisë së tij ishte me të drejtë i merituar edhe ay duhet t'u shërbejë si mësim gjurmashëvet (pasuesvet) të tij». AQSH i RPSSH. Fondi «Materiale dokumentare të shoqërive e koleksione arkivore», dosja: «Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare», dorëshkrim pa datë.

njjet, u çveshtë edhe u roptë ndë rjedhjet e shekujve të shkuar»¹).

Me vrasjen e Fotit reaksioni grek ndërmori masa të reja kundër lëvizjes shqiptare e patriotëve të veçantë. Viktimë e tyre ra Spiro Jovan Kosturi, i cili u vra në Selanik po në vitin 1906.

Situata e krijuar bënte që shkolla shqipe e vajzave në Korçë të funksiononte me shumë vështirësi. Pengesat ishin bërë pothuajse të pakapërcyeshme. Urdhëri për ndalimin e përdorimit të shqipes si gjuhë mësimi në të gjitha shkollat e Perandorisë ishte përsëritur disa herë nga autoritetet lokale osmane. Megjithatë, shkolla e vajzave vazhdonte të përdorte gjithnjë shqipen si gjuhë mësimi, dhe, ndonëse me një numër të kufizuar nxënësesh, mësimet zhvilloheshin rregullisht në bazë të programit të shkollës. Atëherë drejtori i arsimit për Vilajetin e Manastirit paraqiti një ankesë të re në Stamboll, me anën e së cilës bëhej e ditur se «gjuha shqipe përdorej ende në shkollën e vajzave në Korçë»²). Si pasojë, në fillim të vitit 1907 veziri i madh i Perandorisë lëshoi një urdhër për mbylljen e kësaj shkolle.

Duke u nisur nga ky urdhër konsulli austro-hungarez i Manastirit njoftonte për herë të dytë Vjenën, në fillim të shkurtit 1907, se «shkolla shqipe e vajzave në Korçë u mbyll nga ana e autoriteteve»³). Por autoritetet lokale osmane nuk guxonin ta zbatonin këtë urdhër. Atëherë Stambolli, duke parë se nuk po zbatoheshin urdhëri i vezirit të madh për mbylljen e shkollës, në qershor 1907 dha porosinë që «të përdorej edhe forca për zbatimin e tij»⁴). Njëkohësisht, gjatë po asaj vere, patrioti G.Cilka iu dha gjy-

1) Po aty. AQSH i RPSSH, Fondi «Materiale dokumentare...»

2) HHStAPAA — shtojcë e raportit të konsullatës austro-hungareze të Manastirit, nr. 10, datë 1 shkurt 1907.

3) Po aty, shtojca e raportit të konsullatës austro-hungareze të Manastirit, nr. 13, datë 5 shkurt 1907.

4) Po aty, informacion i ambasadorit austro-hungarez të Stambollit, nr. 39/K, datë 19 qershor 1907.

qit nën akuzën se, pa marrë parasysh ndalimin që ekzis-
tonte, kishte vazhduar mësimet në shkollën e vajzave.

Ndonëse në kushte shumë të rënda, shkolla shqipe e vajzave u çel edhe për vitin shkollor 1907-1908. Përveç vajzave atë po e frekuentonin edhe 5-6 djem të moshës nën 12 vjeç. Deri në janar të vitit 1908 shkolla kishte mundur të ruante një kontigjent prej 22 nxënësish, nga të cilët 10 nxënëse të brendshme dhe afërsisht 12 të jashtëm, midis të cilëve edhe djemtë. Nga personeli pedagogjik vazhdonin të jepnin mësim tri mësuese dhe G. Cilka.

Në vijim të politikës së tyre, sundesit osmanë, në mars të vitit 1908, i dhanë një goditje tjetër shkollës shqipe. Autoritetet lokale, duke frikësuar dhe duke arrestuar prindërit, arritën të largojnë nga shkolla të gjithë nxënësit e jashtëm që kishin mbetur dhe pjesën më të madhe të nxënësive të brendshme, gjë që e paralizoi pothuajse krejt veprimtarinë e shkollës. Po në mars, Grigor Cilka iu dha përsëri gjyqit me të njëjtën akuzë të vitit të mëparshëm. Sipas pohimeve të vetë valiut të Manastirit, për G. Cilkën «dyshohej (gjithashtu) se është në marrëveshje me propagandën shqiptare dhe se ishin zbuluar korrespondenca të ndryshme që e përforcojnë këtë dyshim»¹⁾.

Më 20 mars iu bë një kontroll shtëpisë së G. Cilkës, iu konfiskuan disa valixhe me libra e revista dhe ai vetë u muar e u mbajt i arrestuar.

Në këtë mënyrë, duke përdorur dhunën, duke ndaluar prindërit të dërgojnë fëmijët në shkollë, duke bërë arrestime, numri i nxënësve u pakësua aq shumë sa që edhe shkolla shqipe e vajzave mund të konsiderohet faktikisht e mbyllur.

1) Po aty: Informacion i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr. 16, datë 24 mars 1908.

E gjithë kjo fushatë e madhe ndjekjesh, presionesh, burgimesh, internimesh, helmimesh dhe vrasjesh, e organizuar nga sundimtarët osmanë, nga shovinistët fqinjë dhe armiqtë e tjerë kundër shkollave shqipe, mësuesve e përkrahësve të tyre dhe në përgjithësi kundër lëvizjes kombëtare shqiptare e pengoi seriozisht zhvillimin e arsimit tonë kombëtar në përgjithësi dhe të shkollave të para kombëtare në veçanti. Si pasojë numri i shkollave shqipe jo vetëm nuk u rrit dot, por edhe ato që ekzistonin po mbylleshin me forcë. Megjithatë, në fillim të shekullit XX, përhapja e shkrimit të shqipes, e ideve kombëtare dhe e diturisë ishte shndërruar në një lëvizje të fuqishme dhe nuk kishte forcë ta ndalte ecjen e saj përpara.

Populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij më të përparuar, patriotët e Rilindjes, jo vetëm nuk u përkulën përpara armiqtë të atdheut, por mobilizuan të gjitha forcat për t'u bërë ballë terrorit e intrigave të sunduesve osmanë dhe të qarqeve shoviniste fqinje. Duke shprehur vendosmërinë e popullit shqiptar për të ruajtur dhe për të shkruar gjuhën amtare, gazeta «Kombi» shkruante në dhjetor të vitit 1907 se «sido që jemi të varfër e që na ndjek qeveria dhe s'na lë të çelim mësonjëtoje, gjuha shqip dhe nga gurët e rrugëve do të shkruhet dhe do të këndohet»¹).

Se sa e madhe ishte dëshira e popullit shqiptar për të shkruar gjuhën e vet dhe për të çelur shkolla në gjuhën shqipe e tregon më së miri hovi i ri i lëvizjes arsimore-kulturore që shpërtheu në Shqipëri menjëherë pas fitores së revolucionit të turqve të rinj më 23 korrik 1908.

Me gjithë karakterin e kufizuar të revolucionit xhon-turk, rrethet më të përparuara të lëvizjes kombëtare shqiptare, pa hequr dorë nga synimet politike të lëvizjes kombëtare, i shfrytëzuan mundësitë e përkohshme legale

1) «Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare», vepër e cituar, fq. 23.

të krijuara me shpalljen e kushtetutës nga turqit e rinj dhe i shtuan përpjekjet për të ngritur ndërgjegjen kombëtare dhe për bashkimin e popullit shqiptar nëpërmjet përhapjes së mësimit të gjuhës shqipe në gjithë Shqipërinë, nëpërmjet futjes së gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e huaja në Shqipëri si dhe me anën e vendosjes së një alfabeti të vetëm¹⁾.

Në vitet 1908-1912 lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar hyri në etapën më të lartë dhe të fundit të zhvillimit të saj. Suksese të reja të rëndësishme u arritën, në këtë etapë, në zhvillimin e arsimit e të kulturës sonë kombëtare. Në luftë me reaksionin xhonturk u çelën shkolla shqipe të ditës dhe të mbrëmjes, u krijuan klube e shoqëri patriotike legale dhe ilegale, u organizuan kongrese kombëtare e u bënë botime të shumta në gjuhën shqipe brenda dhe jashtë atdheut.

Lufta për shkollën kombëtare shqipe si pjesë e pa-ndarë e luftës së madhe të armatosur të popullit tonë kontribuoi drejtpërsëdrejti në çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha e rëndë pesëshekullore osmane, më 28 nëntor 1912.

1) SH. Demiraj — K. Prifti, vep. e cituar, fq. 28.

DISA PËRFUNDIME

Në kushtet e sundimit shumëshekullor osman lufta për gjuhën dhe shkollën shqipe përbënte një aspekt të rëndësishëm të qëndresës aktive të popullit shqiptar në përgjithësi e të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në veçanti. Përpyekjet e rilindësve shqiptarë gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX për zhvillimin e arsimit e të kulturës kombëtare ishin me rëndësi të madhe politike, ekonomike dhe ideologjike.

Rruga nëpër të cilën u krijuan dhe u zhvilluan shkollat e para kombëtare shqipe ka qenë një rrugë shumë e vështirë. Pengesat që iu desh të kapërcente popullit shqiptar në fushën e arsimit e të kulturës kombëtare nuk i njohu asnjë nga popujt e tjerë të Ballkanit. Po ata armiq që i kishin mohuar lirinë politike popullit shqiptar ose synonin të shkëpusnin vise shqiptare nga trangu arbëror, po ata armiq i mohonin atij edhe të drejtat arsimore e kulturore.

Feja dhe institucionet fetare të të tria besimeve, si pjesë e superstrukturës sunduese të Perandorisë Osmane apo si mjete të fuqishme ideologjike në shërbim të shteteve të huaja armike të popullit shqiptar, kanë luajtur një rol të theksuar reaksionar e antikombëtar ndaj shkollës sonë kombëtare.

Shkollës kombëtare shqipe iu desh të çante përpara në luftë edhe me fanatizmin, patriarkalizmin, ndarjet krahinore e fetare, të cilat ishin pasoja të sundimit të huaj dhe të sistemit feudal mesjetar, si dhe në luftë me qëndri-

min reaksionar e konservator të feudalëve të mëdhenj shqiptarë, të elementëve turkomanë, grekomanë etj.

Në vitet e shkëlqyera të luftës së armatosur të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare, u shënua një ngritje e re edhe për arsimin e kulturës kombëtare shqiptare. Nga përpjekjet individuale të rilindësve të parë tani u kalua në përpjekje të organizuara. Kërkesa për gjuhën e shkollën shqipe bënte pjesë në të gjitha programet e përpunuara nga lëvizja kombëtare në vitet 1878-1881.

Ndërsa Lidhja Shqiptare mori në dorë drejtimin e luftës së armatosur e politike, «Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip», e themeluar një vit më vonë, më 1879 në Stamboll, u vu në krye të luftës për përhapjen e shkrimit shqip, të shkollës shqipe dhe të kulturës kombëtare.

Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare më 1881, lufta për shkrimin shqip dhe shkollën kombëtare shqipe hyri në një etapë të re zhvillimi. Në situatën politike të Ballkanit në fund të shekullit XIX, në frontin e arsimit e të kulturës lufta ishte bërë më e ashpër se kurrë.

Duke shfrytëzuar kushtet e «stabilitetit politik» të përkohshëm, të vendosur pas Kongresit të Berlinit, shtetet e ndryshme imperialiste e shoviniste evropiane e ballkanike i intensifikuan përpjekjet për të rritur ndikimin e tyre në Shqipëri, duke përdorur në shkallë të gjerë, përveç të tjerave, shkollën dhe kulturën e tyre, «agresionin ideologjik» që do t'i paraprinte pushtimit ushtarak.

Në përputhje me situatën politike dhe me nevojat objektive të zhvillimit, në këtë periudhë lufta për shkollën kombëtare shqipe u bë edhe më e mprehtë. Nga përhapja fshehurazi e shkrimit shqip në shkollat në gjuhë të huaja, në ndonjë zonë malore ose në donjë shkollë të vogël, u arrit që më 7 mars 1887 të çelej shkolla e parë kombëtare shqipe në Korçë.

Çelja e shkollës shqipe të Korçës shënonte një hap të ri cilësor në fushën e arsimit tonë kombëtar. Ajo ishte shkollë kombëtare e laike dhe si e tillë ajo realizonte për herë të parë në praktikë idetë demokratike e iluministe të rilindësve shqiptarë.

Shkolla kombëtare e Korçës ishte frut i përpjekjeve të përbashkëta të patriotëve shqiptarë brenda dhe jashtë At-dheut. Ajo u bë model për gjithë shkollat që u çelën pas saj në Shqipëri.

Përveç shkollës shqipe të Korçës u çelën edhe një numër shkollash të tjera shqipe në krahina të ndryshme të vendit, shumica e të cilave pa lejen e Portës së Lartë. Mirëpo zgjerimi i lëvizjes për çeljen e shkollave në gjuhën shqipe ndeshte në pengesa gjithnjë e më të mëdha si nga autoritetet qeveritare sunduese ashtu edhe nga institucionet fetare e armiqte e tjerë të vendit tonë. Kështu që shumica e shkollave të hapura nuk mundën të vazhdojnë gjatë. Prandaj në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX shkrimi dhe leximi në gjuhën shqipe vazhduan të përhapeshin me mënyra ilegale në shkollat në gjuhë të huaja, nëpër shtëpi, në burgje dhe bile jashtë në natyrë.

Krahas mësimit të fshehtë individual, në vise të ndryshme të Shqipërisë funksionuan edhe një numër shkollash apo qendrash mësimore të fshehta shqipe. Ndonëse pa godina përkatëse, pa kuadrin pedagogjik të përgatitur dhe pa mjetet e tjera të nevojshme, në këto forma ilegale mësuan qindra e mijëra vetë shkrim e lexim shqip krahas atyre që patën mundësinë të ndjekin shkollat e pakta të rregullta shqipe që vazhduan për një kohë më të gjatë.

Për shkak të kushteve në të cilat vepruan dhe të kohës së shkurtër që funksionuan, është vështirë të flasësh për programet mësimore dhe nivelin e shumicës së shkollave shqipe në atë periudhë. Një ide më e qartë formohet për shkollat shqipe të Korçës, të cilat, ndonëse me vështirësi të shumta, vazhduan për vite me radhë. Nga afati i studimit dhe nga përmbajtja e programeve mësimore del se shkollat shqipe të Korçës ishin të një niveli mjaft të ngritur për kohën. Përveç lëndëve kryesore (gjuhës shqipe, artmetikës, historisë dhe gjeografisë) në programet e tyre përfshiheshin edhe lëndë të tilla si fizika, gjeometria, botanika, zoologjia, anatomia etj.

Me interes është fakti se që të dyja shkollat shqipe të

Korçës, veçanërisht ajo e vajzave, i kushtuan një vëmendje të madhe përgatitjes parashkollore, e cila ishte një pjesë e veçantë e planit të përgjithshëm mësimor të tyre. Me këtë u hodhën edhe themelet e para të arsimit parashkollor në vendin tonë. Njëkohësisht qysh në fund të shekullit XIX u bënë përpjekje për t'i ngritur shkollat shqipe të Korçë në një shkallë më të lartë se shkollat fillore.

Përparimet e arritura në fushën e arsimit kombëtar ndihmuan drejtpërsëdrejti në forcimin e ndërgjegjes kombëtar tek shqiptarët dhe në ngritjen e mëtejshme të lëvizjes kombëtare në përgjithësi. Shkollat shqipe u bënë jo vetëm vatra për përhapjen e njohurive të parashkencore, por edhe vatra të rëndësishme për edukimin patriotik të brezit të ri. Korrespondenca në gjuhën shqipe u bë një mjet i rëndësishëm komunikimi midis shqiptarëve.

Zhvillimi i arsimit kombëtar ndihmoi gjithashtu për të afirmuar të drejtat e kombit shqiptar në arenën ndërkombëtare dhe për të luftuar përpara opinionit publik tezat e gabuara antishqiptare që përhapeshin nga armiqtë e popullit shqiptar.

Në luftë e sipër për të krijuar shkollën kombëtare, për të hartuar tekstet shkollore shqiptare dhe programet e planet mësimore, rilindësit shqiptarë përpunuan dhe paraqitën edhe pikëpamjet e tyre mbi arsimin dhe edukatën. Ata dhanë një kontribut të çmuar në zhvillimin e mendimit pedagogjik shqiptar dhe u bënë përçuesit e pikëpamjeve iluministe e pedagogjike përparimtare evropiane të kohës në Shqipëri. Në shkrimet e Naum Veqilharxhit, Zef Jubanit, Naim e Sami Frashërit, Gjerasim e Sevasti Qiriazit etj. në tekstet shkollore, në shtypin e kohës, apo në botime të veçanta u shprehën më qartë se kudo tjetër pikëpamjet pedagogjike të Rilindjes Shqiptare, gjatë së cilës u bënë përpjekje për të krijuar një sistem arsimor unik me karakter demorkatik kombëtar.

Me gjithë karakterin përparimtar për kohën dhe rolin progresiv që luajtën, pikëpamjet pedagogjike të rilindësve shqiptarë, nuk mund të mos kishin edhe kufizimet e

tyre klasore e ideologjike. Koha kur jetuan e punuan do të linte pa dyshim vulën e vet në veprën e rilindësve. Duke qenë shprehës të interesave të forcave të reja shoqërore të asaj kohe, në radhë të parë të borgjezisë shqiptare, rilindësit dhe vepra e tyre nuk dilnin jashtë kuadrin të demokracisë borgjeze, gjë që shprehej në qëndrimin ndaj problemeve shoqërore, në qëndrimin ndaj fesë etj. Si përfaqësues të borgjezisë, e aq më tepër të një borgjezie të dobët nga pikëpamja ekonomike e politike, tek ata, në përgjithësi, vihet re një mbivlerësim i rolit të arsimit e të kulturës në zhvillimin e shoqërisë.

Pengesat e vështirësitë e mëdha që dilnin në rrugën e zhvillimit të arsimit kombëtar u përballuan dhe u kapërcyen në sajë të mbështetjes së fuqishme që shkolla shqipe gjeti në forcat e shëndosha të shoqërisë shqiptare — në masat popullore arsimdashëse, në rilindësit shqiptarë që ishin elementët më përparimtarë të borgjezisë e të mikroborgjezisë shqiptare dhe në rininë trime e patriotike.

Një kontribut të madh në dobi të shkollave të para kombëtare dhanë shoqëritë patriotike shqiptare të mërgimit dhe veçanërisht shoqëritë shqiptare të Bukureshtit. Ato ndihmuan si nga ana materiale ashtu edhe nga ana morale dhe u bënë në atë periudhë vatrat më të rëndësishme për botimin e teksteve të para shkollore shqipe, të literaturës artistike dhe të shtypit shqiptar, i cili i mbështeti fuqimisht aspiratat e popullit shqiptar dhe u bë zëdhënësi i tij.

Merita të veçanta në fushën e arsimit kombëtar kanë mësuesit rilindës. Me punën e tyre të madhe e këmbëngulëse mësuesit e shkollave të para shqipe u dalluan jo vetëm si mësimdhënës, por edhe si aktivistë të lëvizjes kombëtare, si frymëzues të luftës për çlirimin kombëtar. Historia e arsimit tonë kombëtar ka shkruar me shkronja të arta emrat e Naum Veqilharxhit, Koto Hoxhit, Pandeli Sotirit, Papa Kristo Negovanit, Petro Nini Luarasit, etj., të cilët nuk kursyen as jetën e tyre për çështjen e shkollës dhe të Atdheut.

PASQYRA E LËNDES

	Faqe
Parathënie	5
I. Lufta për shkollën shqipe — pjesë e pandarë e luftës për çlirimin kombëtar	9
II. Përpjekjet e para për krijimin e shkollës kombëtare shqipe	24
III. Kushtet politike arsimore të Shqipërisë pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	43
IV. Çelja e shkollës së parë shqipe të Korçës	54
V. Formimi i «Shoqërisë së Mësimit Shqip» në Korçë	81
VI. Çelja e shkollës së parë shqipe për vajza në Korçë.	96
VII. Çelja e shkollave të reja shqipe në Kolonjë e në Vakëfe	118
VIII. Përhapja e shkrimit shqip dhe e shkollave të fshehta shqipe në krahinat e tjera të vendit në vitet 90 të shekullit XIX	131
IX. Përparimi i mëtejshëm i shkollave shqipe të Korçës në dekadën e fundit të shekullit XIX	147